

NOS XHUVANI – PAVLI HAXHILLAZI

NA FLET VISARION XHUVANI

Tiranë, 2008

Redaktor:

PAVLI HAXHILLAZI, gjuhëtar.

Recensues: Kasem Biçoku, historian
Ilirian Martiri, gjuhëtar

PARATHËNIE

Dr. Visarion Xhuvani është Kryetari i parë shpirtëror i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, e cila u shpall më 11.9.1922 në Kongresin Kishtar të Beratit. Për jetën dhe veprimtarinë e shquar atdhetare dhe kishtarë të Dr. Visarion Xhuvanit (1.5.1887 – 15.12.1965) janë botuar këta libra: 1. Visarion Xhuvani – apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare, Tiranë 2003, 262 faqe, nga Nos Xhuvani dhe redaktorë shkencorë Pavli Haxhillazi dhe Kasem Biçoku; 2. Visarion Xhuvani, Vepra, Tiranë 2007, 518 faqe, përgatitur nga Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi dhe redaktor i saj Pavli Haxhillazi.

Lexuesit shqiptar tani po i jepet edhe libri i tretë Na flet Visarion Xhuvani, Tiranë 2007, 318 faqe, me autorë Nos Xhuvanin dhe Pavli Haxhillazin, redaktor Pavli Haxhillazi. Ky libër i është kushtuar veprimtarisë së shquar atdhetare dhe kishtarë të Visarion Xhuvanit, Kryepeshkopit të parë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Në pjesën e parë të titulluar “Nga vepra e Visarion Xhuvanit” janë ribotuar Çështje politiko religjioze Kostandinopoli –Tiranë, pjesa e parë dhe e dytë, botuar për herë të parë në Tiranë më 1926; Kujtim vepre dhe intrige, Tiranë 1926; artikujt Formimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare nga pikëpamja juridike dhe kanonike, botuar në Gazetën e Re më 20 qershor 1929 dhe Referate mbi krizën politiko – fetare të komunitetit ortodoks të Shqipërisë këto ditë, që botohet sipas dorëshkrimit të daktilografuar që ruhet në Arkivin Qendror të Shqipërisë, Fondi 536, Dosja 1432, viti 1937. Nga vepra e shkruar e Dr. Visarion Xhuvanit po ribotojmë shkrimet e mësipërme sepse ato përbëjnë platformën e përgjithshme teorike e kanonike të veprimtarisë atdhetare dhe teologjike, që i shërbeu drejtpërdrejt lëvizjes ortodokse të kohës për shpalljen e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Kombëtare Shqiptare. Dialogu fetar – politik i viteve 20 – 30 të shekullit XX hodhi poshtë me argumente kanonike dhe historike të gjitha pretendimet fanariote dhe greke, me të cilat pengoheshin veprimet për shpalljen e Kishës Ortodokse Autoqefale të shqiptarëve në Ballkan. Dr. Visarion Xhuvani kundërshtoi fuqishëm ndërhyrjen e Patriarkanës Ekumenike të Stambollit për të emëruar peshkopë të huaj në dioqezat shqiptare, të cilën ai e cilësoi edhe si antikanonike dhe antikombëtare. Me shpalljen e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar më 1912 në Vlorë de jure shqiptarët ortodoksë shqiptarë e kishin të proklamuar Kishën e tyre Autoqefale, por tashmë Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare Shqiptare duhej shpallur edhe de fakto, duke krijuar Sinodin Episkopal dhe prej tij të zgjidhej edhe Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Ashtu si çdo komb tjetër i besimit ortodoks, edhe populli ortodoks shqiptar lipset të përdorë gjuhën e vet shqipe për meshën kishtarë, për mësimin e Ungjillit dhe për çdo shërbim fetar, sepse në gjuhën shqipe i shërbehet më së miri edukimit fetar të ortodoksëve shqiptarë.

Fushatës së shfrenuar kundër autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare Visarion Xhuvani i është përgjigjur në Gazetën e Re, më 20 qershor 1929, me artikullin e posaçëm “Formimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare nga pikëpamja juridike dhe kanonike” dhe me pjesën e parë “Referate mbi krizën politiko – fetare të komunitetit ortodoks të Shqipnisë këto ditë”, që ia ka drejtuar në vitin 1937 autoriteteve më të larta të Kishës Ortodokse dhe të Shtetit Shqiptar.

Në pjesën e dytë të librit “Na flet Visarion Xhuvani”, që është titulluar “Për veprën e Visarion Xhuvanit”, janë përmbledhur 8 artikuj të botuar në organet e shtypit shqiptar për ngjarjet më të rëndësishme të historisë së autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare dhe për veprimtarinë atdhetare e kishtarë të Visarion Xhuvanit, Kryepeshkopit të parë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Këta artikuj pasqyrojnë gjendjen e Kishës Ortodokse Shqiptare në vitet 20 deri në vitet 40 të shekullit XX kur u arrit zgjidhja kombëtare e autoqefalisë së saj, e cila u mbështet dhe u përkrah në atë kohë nga autoritetet më të larta shtetërore dhe qeveritare, duke i kërkuar Imzot Visarion Xhuvanit që të dorëzonte peshkopë të tjerë për të plotësuar nevojat e dioqezave ortodokse shqiptare. Edhe sot zgjidhja e çështjes së autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë ka rëndësi të madhe kombëtare për kombin shqiptar. Kjo çështje e rëndësishme më shumë spikat për vlerat e veta atdhetare dhe fetare për të gjithë shqiptarët e në veçanti për komunitetin e krishterë ortodoks në mbarë trojet shqiptare.

*Pavli Haxhillazi
Tiranë, gusht 2007*

PJESA E PARË:

NGA VEPRA E VISARION XHUVANIT

15. MAJ 1926

Çashtje politiko-religjoze **KONSTANDINOPOLI -TIRANË**

PREJ:

EPISKOPIT VISARION XHUVANIT

Theollog me Dipllomë t'Universitetit t'Athinës
Ish Senator i Elbasanit dhe ish Deputet i Durrësit

**Botohet me rastin e bisedimevet përkatëse që janë
duke u bamë kto ditë në Tiranë.**

BOTOHET NË DY PJESE

Landa e Pjesës së I-rë:

- 1) Kisha Orthodhokse Shqiptare dhe Patriarhia e Konstandinopojës
- 2) Ndërhymja e Patriarhis së Konstandinopojës
- 3) Episkopët e huej në Shqipni
- 4) Gjuha e huej në Kishë
- 5) Gjuha e huej në Shkollat Shqiptare

KOSTON NJI KORONË

TIRANË

Shtypshkronja "Tirana"

1926

**Kjo vepër e vogël i dedikohet Shqiptarit të
mirë Elbasanas, Zotni Dr. Filip Papajanit.**

KISHA ORTHODHOKSE SHQIPTARE DHE PATRIARHIA E KONSTANDINOPOJËS

Delegatët Klerikë dhe Laikë të gjithë elementit Orthodhoks të Shqipnis, u mbledhën në Berat në një Kongres të posaçëm Kishtar.

Atje më 11 të Vjeshtës së I të vitit 1922 proklamuen Kishën Orthodhokse Autoqefale (Indipendente në pikëpamje administrative). Asnji delegat nuk votoi kundër; dhe asnjë krahinë si dhe asnjë qytet nuk mungoi për me u përfaqësue. Ky Kongres formoi dhe këshillin e naltë të kishës së Shqipnis për Qeverimin e saj dhe votoi statutin provizor të kishës. Statutin definitiv ja la për detyrë një kongresi tjetër kishtar që do të mbledhet pas dy vjet; d.m.th më 1924.

Këto vendime u bënë në bazë të Kanoneve Kishtarë Pan-orthodhoks. N'at kohë në Shqipni nuk kishte për fat asnjë Episkop. Për formimin e këshillit të naltë definitiv, d.m.th të Sinodhit Episkopal, Kongresi para-vështroi dhe vendosi si duhej kanonikërisht për Episkopët e Kishës. Por vendimet e tij për këtë pikë nuk hynë në veprim deri sot. As kongresi i ri për formimin e Statutit definitiv nuk u mbledh më 1924, si dhe as deri sot nuk asht provokue.

Për shkaqet e kësaj të mete do të bajmë fjalë veçanërisht.

Tash le të spiegojmë pak arsyenat kanonike që provokuen krijimin e kishës autoqefale të Shqipnis dhe randësinë e nevojës për të njoftunin e kishës s'onë prej Patriarhis së Konstandinopojës e cila akoma mban titullin e Patriarkis Ekumenike, d.m.th ka vendin e parë të nderit ndërmjet Patriarhinave dhe kishavet të tjera orthodhokse autoqefale të Botës. Nga kjo Patriarhi urdhënohej kisha orthodhokse e Republikës Shqiptare kur Shqipnia ishte nën sundimin t'ati shteti, nën sundimin e të cilit ishte dhe asht sot Patriarhia e Konstandinopojës, nën Turqinë.

Kanonet Apostolikë të statutit të përgjithshëm Pan-orthodhoks urdhënojnë:

“Eteras Vasilias Ekklisia mi dhiatatestho ta eteras”, d.m.th: “një kishë e një Shtetit tjetër të mos urdhënojë ma një kishë të një shteti tjetër”, dhe: **“Elefthera Ekklisia En Elefthero Krati”**, d.m.th. “Kishë e lirë në një Shtet të lirë”.

Për këto arsye kanonike të patundshme orthodhoksët e Shqipnis kishin detyrë të krijojnë kishën e vet Autoqefale, e cila **de jure**, pas kanoneve të sipërm, ishte Autoqefale që prej proklamimit të Indipendencës politike të Shqipnis në Vlonë. Por q'at-herë deri më 1922, revolucionet e ndryshme kundër Shqipnis, si dhe ato kundër Regjimit Mbretnuer të Vidit dhe luftat e Përgjithshme, nuk i dhanë rastë Orthodhoksvet të Shqipnis me e pasë Proklamue edhe **de fakto**.

Tash Kisha Autoqefale Shqiptare asht edhe **de fakto** në veprim q'prej vitit 1922 e deri sot, e paskëtaj autoqefale.

Asnjë kanon kishtar dhe asnjë arsye nuk mund të ndalojë vazhdimin e jetës autoqefale të kishës s'onë.

Por vetvetiu vinë këto pyetje:

I-Ç' relacion duhet të ketë kisha e Shqipnis prej vitit 1922 e deri më sot dhe paskëtaj, me kishat e tjera autoqefale orthodhokse të Botës dhe sidomos me Patriarhin e Konstandinopojës dhe ç'lidhje?

II-A ka ndonji të drejtë Patriarhia e Konstandinopojës mbi kishën t'onë sot e paskëtaj q' prej vitit 1922?

III-A njihet kisha jonë prej kishave të tjera të çdo vendi të huej, si njihen gjithë kishat orthodhokse autoqefale njena prej tjetrës, dhe a gëzon kisha jonë sot nderimet e zakonshme që i detyron njana kishë autoqefale tjetrës?

Këto pyetje kanë përgjigjet që pasojnë:

I-Kisha jonë duhet të ketë relacione miqsore me gjithë kishat orthodhokse të Botës dhe bashkim Dogmatik Fetar, dhe duhet të rrejë pikërisht gjith Kanonet kishtare të përmbledhuna në të drejtën kanonike të përgjithshme kishtare orthodhokse dhe kjo vetëm asht lidhja.

II-Patriarhia e Konstandinopojës kanonikërisht nuk ka sot asnji të drejtë ndërhyrje mbi Kishën e Shqiptare (shih artikullin përkatës që pason).

III-Kisha jonë nuk njihet deri sot prej asnji Patriarhie, prej asnji kishë autoqefale orthodhokse të botës, si dhe as prej Patriarhis Konstandinopojës, por tolerohet, durohet deri sot prej anës tyne dhe nuk gëzon nderimet e zakonshme si një kishë e rregullshme Autoqefale.

Prej tri pikave të sipërme vetëm kësaj të fundit do t'i spiegojmë shkurt një pjesë, tue i lanë dy të parat për një rast tjetër.

Shkaku i kësaj mosnjohjeje të kishës sonë dhe të mosnderimit të saj asht:

I-Mosnjohja e saj nga ana e Patriarhisë së Konstandinopojës, dhe vazhdimi i një kryetari Prift dhe një këshilli **Prifto-civil** në krye të kishës sonë duke mos i dhanë kështu besimin e duhur Botës Orthodhokse të brendshme si dhe asaj të jashtme.

II-Mosformimi i një Sinodhi Episkopal me Theollogë Episkopë rregullisht, si kanë gjithë kishat e tjera.

III-Mosplotësimi i vendimevet dhe i statutit të Kongresit të Beratit edhe dy vjet pas datës së caktueme për plotësimin e këtyne vendimevet, duke mos pasë asnji pengim për të plotsuemunit e vendimeve të kongresit të sipërpërmendun, që asht baza themeltare e Kishës Autoqefale Orthodhokse të Shqipnis.

Mosnjohja nga ana e Patriarhisë së Kostandinopojës nuk prish asnji punë dhe nuk na e ve në asnji rrezik kishtar kishën autoqefale të Shqipnisë, as autoqefalinë e saj.

Provë asht se kishën greke Patriarhia e Konstandinopojës nuk e njohu por, pas 10 vjet rresht pasi kisha e Greqisë u proklamue dhe vepronte autoqefalisht. Kisha autoqefale e Greqisë nuk pranoi kondicionet e Patriarhisë për me pasë njohjen e saj dhe vazhdoi në veprim autoqefal deri sa Patriarhia u shtrëngue në fund prej kanonevet të kishës dhe e njohu Autoqefalinë e kishës së Greqisë pa kondicione të veçanta, por pas 10 vjet veprimi autoqefal të saj. Dhe aq keq ishin relacionet e kishës autoqefale të Greqisë me Patriarhinë e Konstandinopojës, sa kur kisha e Greqisë i dërgoi Patriarhisë një letër falenderimi për nderimet kishtare që Patriarhia i kishte ba vorrimit të përfaqësuesit diplomatik të Greqisë në Konstandinopojë, Patriarhia ja ktheu prap letrën **Sinodhit të Greqisë**, duke shënue në letër këto fjalë: “Agnoumen iparhusan tiaftin en Elladhi ekklision” d.m.th Nuk dimë se ka një kishë të tillë në Greqi.

Pas rregullave Kishtare dhe kanoneve t'orthodhoksisë, një kishë e ndonji shteti po të ketë në krye një Sinodh vetëm prej episkopësh të cilët duhet të jenë të paktën 2,3.

Krishti ka thanë: “Opu dhio i tris en onomati mu eqi qe ego en meso afton imi.” d.m.th.: “ku janë dy ose tre n’emnin tim atje jam edhe unë në mes tyne”, d.m.th. mundet të jetë kishë e rregullshme autoqefale edhe me një Sinodh prej 3 Episkopësh. Dhe kjo duhet të njihet medoemos prej kishave të tjera të botës orthodhokse dhe prej gjithë Patriarhinave si dhe prej asaj të Konstandinopojës. Patriarhia e Konstandinopojës mundet të bjerë ndalime, por çdo ndalim i saj nuk ndalon kishat e tjera, as Patriarhinat e tjera orthodhokse për me njohë kishën tonë, n’asht se kjo kryesohet prej Episkopësh kanonikë theologë vetëm, dhe kjo si sot. Dhe në fund dhe Patriarhia e Konstandinopojës do detyrohet me e njohë edhe kjo, se urdhënohet prej kanonevet kishtarë. Mjafton vetëm që kisha autoqefale e Shqipnis të qëndrojë në udhën e drejtë kanonike dhe dogmatike.

Këto që thomi këtu janë përsëritë shumë herë në historinë gati të të gjitha kishave, kur janë krijuar për të parën herë, si e spieguem edhe për Greqinë.

Pra detyra e parë e të gjithë atyne që i duen të mirën kishës autoqefale dhe duen nderin e orthodhoksisë së Shqipnisë asht: Të formojnë Sinodhin Episkopal të kishës autoqefale, me shpejtësi dhe ngutsi të madhe, rregullisht dhe pas vendimeve të kongresit të Beratit, me anë të këshillit të naltë kishtar që qëndron edhe sot në fuqi dhe pastaj të bisedojmë e t’i drejtohem kishave autoqefale Orthodhokse të botës, Patriarhivet orthodhokse si dhe, në krye, Patriarisë së Konstandinopojës. Dhe duhet të vemë themele, jo vetëm për një kohë të shkurtën por të paravështrojmë dhe për nesër, për sinodhet e paskëtajshme të Shqipnis, që kanë të bëjnë për interesat Fetarokombëtare dhe të përparimit social të brezave t’ardhshëm, që janë shpresa e artë e shqiptarizmës.

Kemi pra detyrë me organizue e me rregullue vetë ne Shqiptarët kishën tonë me Sinodh Episkopal, Shqiptar, dhe jo të vrasim mendjen me bisedime kot me botën, duke humbë kohën, **dhe duke i dhanë rast askujt ose duke u shtërngue me ba dëshirën e të tjerëvet jo aq për dobinë tonë.**

Çashtja në fjalë asht punë tepër me randësi historike **Politikoreligjoze** si dhe krejt, socialo-morale shumë dhe shtetnore.

Duhet ta peshojmë mirë vleftën e njohjes nga ana e Patriarisë, dhe jo ta madhojmë aq në fantazinë tonë si i intereson qëllimeve të ndryshme, jo aq shqiptare.

Por edhe **me** njohjen, si dhe **pa** njohjen Patriarkale të Konstandinopojës, kisha jonë nuk mund të vejë mbarë po nuk pat dëshirën e mirë t’orthodhoksëvet që e përbajnë, po nuk pat udhëheqjen e duhur të një sinodhi Episkopal dhe po nuk pat përkrahjen e sinqertë të shtetit, por pa prapamendim, dhe pa qëllime të ndryshme të politikanëve të Shqipnisë, deputetëve, Ministrave dhe nëpunsave të naltë të shtetit.

Por pika e parë asht: nevoja me largue prej shpirtit të vet, çdo orthodhoks, ambicionet dhe dëshirat që i bien pengime së mirës së kishës.

NDËRRHYMJA E PATRIARHISË SË KONSTANDINOPOJËS

Episkopët e Korçës, Imzot Jerotheu, i Beratit, Imzot Kristofori, dhe i Durrësit Imzot Fan Noli, janë kanonikërisht në dioqezat e tyre, nga pikpamja kanonike e të drejtave Juridike t'anës Patriarhisë së Konstandinopojës sot; kanë të drejtë me dorëzue, me ba, Episkopë të rij, dhe Patriarhija e Konstandinopojës nuk ka të drejtë ma sot e paskëtaj me emnue asnji episkop në Shqipni, për me njohë kishën tonë autoqefale.

1) Se, kanoni Apostolik i posaçëm thotë: “ETERAS VASILIAS EKKLISIA MI DHIATATESTHO TA ETERAS” d.m.th. se: “NJI KISHË E NJI SHTETI TJETËR TË MOS JAPË URDHËN MË NJI KISHË TË NJI SHTETI TJETËR”.

Kështu q'prej shpalljes së independencës së Shqipnisë Patriarhia e Konstandinopojës nuk e ka ma këtë të drejtë, dhe sidomos q'prej proklamimit të Kishës Autoqefale në Shqipni, mbasi emnimi asht një urdhën Kishtar principal, punë e cila i kundërshton KANONIT të sipërm, i cili asht i pacenueshëm, se asht KANON themeltar i detyrueshëm për të gjitha kishat që quhen Orthodhokse.

2) Se, i pari delegat fuqiplotë (EKSARK) i Patriarhisë, Imzot Jerotheu, deklaroi, n'emën të Patriarhis së Konstandinopojës, se i njeh të vlefshme dhe kanonike, dhe se i bekon të gjitha vendimet, dhe statutin e Kongresit të Beratit.

Dhe asht e ditun se, ky Kongres formimin e Sinodhit të parë Episkopal ia dha për detyrë dhe kompetencë vetëm Këshillit të Naltë Kishtar të Kishës Autoqefale Shqiptare, dhe jo Patriarhisë së Konstandinopojës.

Këto i u banë me ditë Patriarhisë së Konstandinopojës q'prej vitit 1922 dhe më 1923, posaçërisht prej një komisioni të posaçëm i cili vajti për këtë punë në Patriarhi të Konstandinopojës.

3) Se, Patriarhia e Konstandinopojës nuk e përgënjeshtroi as nuk protestoi me asnji mënyrë DEKLARATËN e sipërmendun të bame n'emën të saj prej Imzot Jerotheut me datë: Korçë 19.12.1922.

4) Se, jo vetëm në Rumani, Serbi dhe Greqi, por edhe në POLONI, tash afër dy vjet, kur njohu kishën e POLONISË autoqefale, Patriarhia nuk emnoi atëherë Sinodhin e parë atje po njohu atë që kishin emnue vetë Polonjakët. Asht e ditun se atje, Patriarhia e Konstandinopojës, nuk pat emnue asnji nga Episkopët ma parë se të deklarojë Polonia Kishën e vet Orthodhokse AUTOQEFALE. Dhe asnji prej Episkopëve të Polonisë nuk ishte dorëzue prej Patriarhisë së Konstandinopojës si janë dorëzue prej kësaj Patriarhie Imzot Jerotheu dhe Kristofori.

5) Se, a) Patriarhia e Konstandinopojës emnoi Episkopët Germanos, Joaqim dhe Jakov në dioqeza jashtë Shqipnisë, **pasi në dioqezat e vjetra të tyre u emnuen** Jerotheu, Kristofori dhe Fan Noli prej Këshillit të Naltë Kishtar të Kishës Autoqefale të Shqipnisë.

Se, b) në vendin e Germanoit, Joaqimit dhe Jakovit d.m.th. në dioqezën e Korçës, të Beratit dhe Durrësit, Patriarhia e Konstandinopojës nuk emnoi të tjerë si pas rregullës kishtare ndërmjet 40 ditë. Dhe tash kanë kalue dy vjet që ata janë emnue jashtë, dhe 3 vjet, që tri dioqezat e sipërpërmenduna janë plotsuem prej tre Episkopëvevet që gjenden sot

këtu në veprim, me anë të emnimit Autoqefal shqiptar të sipërmërmendun, dhe patriarhia akoma nuk ka emnue asnji në vend të tyne, sa do që kanonet e kishës thonë kategorikisht se një dioqezë nuk mund të rri pa Episkop ma shumë se 40 ditë.

Se, c) Vasilin, Episkopin e Gjinokastrës, Patriarhia nuk e ka emnue akoma më asnji vend tjetër, dhe këtë mbasi ne nuk kemi emnue akoma asnji Episkop në Gjinokastër, si emnuem në Korçë, Berat dhe në Durrës.

Se, d) Vasili, ISH Episkopi i Gjinokastrës, ka 9 vjet që ka dalë jashtë Shqipnisë, dhe pas rregullave kishtarë duhej ky t'ëmnohej më një vend të ri ma parë se Germanoj, Joaqimi dhe Jakovi, të cilët kanë vetëm 7-5 vjet që janë largue prej Shqipnie, d.m.th 2 vjet ma pak se Vasili, i cili asht edhe ma i moçëm se 3 të parët, punë e cila asht edhe një shkak tjetër që detyronte Patriarhinë me e emnue ma parë Vasilin jashtë.

Pra, mbasi Patriarhia e Konstandinopojës Germanonë, Joaqimin dhe Jakovin i emnoi jashtë Shqipnisë 6-5 vjet pasi duelhën jashtë Shqipnisë, dhe pasi Jerotheu, Kristofori dhe Fan Noli u emnuen në Korçë, Berat dhe Durrës.

Mbasi tash 2 vjet që këta janë emnue, PATRIARHIA nuk ka emnue të tjerë për Korçë, Berat dhe Durrës.

Mbasi një kishë, atje ku ka juridiksionin e vet nuk mundet të mos plotësojë vendin ma vonë se pas 40 ditë pasi të transferohet ose mbasi të vdesë Episkopi i një Dioqeze.

Mbasi vetëm atje ku Kisha AUTOQEFALE SHQIPTARE (në Gjinokastër) nuk ka emnue, edhe Patriarhia atje vetëm nuk emnoi tjetër, kuptohet sheshit se Patriarhia e Konstandinopojës **de fakto** ajo vetë, i njeh KANONIKË, dhe si EPISKOPË të Korçës Jerothenë, si të Beratit Kristoforin dhe si të Durrësit Fan Nolin, rregullisht, dhe prandaj, si dhe për arsyenat e tjera të sipërtregueme, Patriarhia e Konstandinopojës nuk ka asnji të drejtë kanonike me emnue kjo Episkopët e Sinodhit të parë të Kishës Autoqefale të Shqipnisë, por këto i emnon Këshilli i Naltë i Kishës Autoqefale Kombëtare të Shqipnisë, si pas vendimeve të Kongresit të Beratit.

Dhe mbasi Episkopët që gjinden në Shqipni janë kanonikërisht në vendet e tyne, dhe mbasi autoriteti ma i naltë kishëtar në Shqipni asht Këshilli i Naltë Kishtar, për deri sa të formohet Sinodhi Episkopal, Episkopët e ndodhun në Shqipni kanë plotësisht të drejtë me ba Episkopë të tjerë (me dorëzue, shugurue, Hirotonisë, Episkopë të rij) sipas urdhënit të Këshillit të Naltë Kishëtar, dhe pas vendimevet të Kongresit të Beratit.

Episkopët që gjinden në Shqipni, duke u bazue mbi gjithë sa thamë, dorzuen Fan Nolin episkop në vitin 1923, në kishën katedrale të Korçës. Kjo vepër kishtarë e tyne u ba e njohun në gjithë botën e brendshme dhe të jashtme dhe në Shqipni u krye me një ceremoni shumë pombike dhe në sy të gjithë klerit e të popullit të Korçës. Pasi muer gradën episkopale Fan Noli, kështu në fillim të vitit 1924 u instalue në Mitropolinë e Durrsit, dhe i fronzuem në të si episkop i kësaj Dioqeze, ky vazhdoi me ekzekutue këtë detyrë dymbëdhjetë muej rresht. Dorzoi priftën të rij dhe erdh në relacione zyrtare kishtarë episkopale dhe me Përfaqësuesin diplomatik të Greqisë, Z. Panurias.

Por me gjithë këto vepra të shpalluna edhe në fletoret e ndryshme si dhe në fletoren zyrtare të Shtetit Shqiptar, Patriarhija e Konstandinopojës nuk bani asnji veprim kundrejt kësaj veprë me randësi të madhe kishtarë që e intereson të gjithë botën orthodhokse, mbasi asht e ditun se Fan Noli pat skandalizue në një mënyrë të pashembull kishën, duke u paraqitë, duke meshue dhe duke veprue ndër kisha, edhe në Shqipni, si episkop duke mos qenë ky i dorëzue episkop prej asnji episkopit si asht e ditun prej vitit 1919-1923.

Pra kur Imzot Jerotheu dhe Kristofori, si Episkopët e Korçës edhe të Beratit, në mbarim të vitit 1923 dorzuen të sipërpërmendunin, kur këta nuk kishin të drejtë me ba asnji dorzim episkopal (hirotoni) pa urdhënin e Patriarhisë së Konstandinopojës, pse kjo tash tre vjet plot nuk i thirri n'apologji dhe nuk protestoi dhe nuk muer asnji masë disiplinore kundra tyne? Po të kishe pasë të drejtë kanonike do ta kishte ba.

Kështu vërtetohen përsëri gjith sa në fillim të këti artikulli parathamë.

Dhe puna kuptohet edhe ma mirë se, para se të shpallet kisha autoqefale këtu, Patriarhia e Konstandinopojës atëherë protestoi kur muer vesh se Fan Noli meshton si Episkop pa qenë Episkop, dhe i dërgoi kishave të Shqipnisë një cirkular të posaçëm kundra Fan Nolit më 1919.

Dhe n'at kohë Fan Noli nuk ishte kler i asnji Dioqeze të Shqipnis dhe as nuk kishte ardhë në Shqipni, po vepronte n'Amerikë.

EPISKOPËT E HUEJ NË SHQIPNI

Me të vërtetë gjendja e soçme e Këshillit të Naltë Kishtar nuk i jep leje as Patriarhisë së Konstandinopojës por edhe asndonji kishe tjetër, me e njoftë Kishën autoqefale të Shqipnisë; prandaj asht punë me ngutsi formimi i Sinodhit Episkopal.

Ky Sinodh duhet të ketë katër Episkopë dhe në rast nevoje jo ma pak se tre. Dhe Episkopët duhet të jenë medoemos Shqiptarë për këto arsena:

Se, n'asht se pranohet një Grek në shërbim aktiv në Shqipni atëhere do të lypin DIKUR edhe Rumunët sigurisht me pasë një Episkop Rumun në Kishën e Shqipnisë, dhe ashtu do të qëndrojnë edhe Serbët për me pasë edhe këta një Serb në Kishën tonë Kombëtare, punë e cila prish dinjitetin nacional të Kishës Shqiptare dhe asht shkak konsekuence të influencave të hueja në Shqipni, përziën keq politikën e jashtme të republikës sonë dhe trazon politikën e brendshme, por edhe humb krejt karakterin kombëtar të cilin ka votue Kongresi kishtar i Beratit për Kishën Orthodhokse të Shqipnisë, mbasi këtë cilsi kombëtare e kan edhe të gjitha Kishat autoqefale në çdo shtet.

Por edhe në asht se merret në shërbim kishtar për ndonji nga Dhioqezat tona, ose si kryetar i Sinodhit, një Episkop i cili sot (pas 5 vjet së qenmeje të Kishës autoqefale), i cili sot mund të shërbejë në një kishë të huej, edhe kjo kishte me pasë po ato përfundime dhe pengime të cilat ka marrja në shërbim të një Episkopi Grek, për arsyenat që pasojnë:

Një njeri i tillë mund të zgjidhet në Greqi, por edhe Serbia dhe Rumania nuk kanë me votue me u përzi, mbasi kanë njerëz me origjinë shqiptare, të cilët edhe në mos qofshin dorëzue Episkopë shpejt i dorëzojnë dhe i paraqisin gjithashtu dhe me at mënyrë që ka me e paraqitë kisha e Stambollit ose e Athinës, dhe diplomacia ka me u ngatërrue keq.

Pranimi i një Episkopi Shqiptar, por i nënshtetësisë së huej deri sot, dhe në shërbim aktiv të huej tash, përveç se asht kundra tradicionevet ligjore edhe kombëtare në Shqipni, por asht edhe kundra interesave shtetnore, dhe cenon gjithashtu si një Episkop i kombësisë së huej, nderin kombëtar dhe dinjitetin e shqiptarve, të cilët sot kanë këtu, katër teologë të meritueshëm për formimin e Sinodhit Episkopal të Shqipnisë. Pse pra të marrim të huej për me përlye historinë tonë të re fetaro-kombëtare?

Në pikpamjen e politikës së brendshme pranimi i një Episkopi të kombësisë së huej ka me bamë përshtypje të keqe jashtë si edhe ndër popullin e gjithë Shqipnisë dhe veçanërisht ka me shkaktue kritika të rrepta, por me arsye, nga ana e opozitës, shpejt ose vonë, për dam sidomos moral të qeverisë së regjimit të sotçëm si dhe të partisë në fuqi. Ka me shkaktue edhe një rrymë të keqe kundra relacioneve të mira ashtu me Greqi si dhe me Serbi dhe Rumani. Këto kanë me u zhvillue në dam të përbashkët sidomos **shqiptarogrek**. Dhe në rast të parë si Episkopi i kombësisë së huej ashtu dhe ai i nënshtetësisë së huej ka me u qitë jashtë shtetit skandalozisht, si Imzot Vasili prej Gjinokastrës dhe si ish mitropoliti i Durrësit Jakovi, kur u dëbue prej shqiptarëve nga Korça disa vjet përpara, më 1921-1922, por edhe sado që pat Jakovi edhe shumë miq personal të tij, politikanë etj, Shqiptarë, të cilët i pat fitue ndër kohna të gjata të shërbimit të tij fetar në Shqipni; por ky u dëbue megjith se kishte deklarue dhe thoshte se ishte gati

t'i ndihmojë proklamimit të kishës autoqefale shqiptare, për me pasë ky vetë kryesinë e saj.

Dhe tash opinioni nacionalist kishtar asht ma i përparuem në Shqipni, se më 1921, dhe ma i kristalizuem, mbasi tash gati pesë vjet jeton një kishë autoqefale këtu.

Pra kështu atëhere, përsëri nuk kanë me mungue shkaqet e anarhisë kishtarë dhe të grindjeve fetare në Shqipni. Por veçanërisht për kryefetarët ka dhe një ligj shteti shqiptar, të posaçëm sot, ligjin e komuniteteve fetare të votuem prej parlamentit shqiptar. Dhe dispozitat e këtij ligji detyrohemi sot me i marrë para sysh, si dhe ato të statutit kishtar në fuqi.

Kualiteti i kombësisë s'Episkopëve **katolikë** në Shqipni nuk mund të merret parasysht dhe as si bazë për Episkopët Orthodhoksë. Se, kisha katolike e Romës nuk ka karakter lokal as kombëtar, si kishat orthodhokse autoqefale, por asht një kishë internacionale me kryetar të zgjedhun internacionalisht (prej gjithë Episkopëve katolikë Romaikë të botës) dhe prandaj në secilin komb, si edhe në Greqi edhe në Shqipni, Papa dërgon Episkopë, ata që do Papa vetë, se asht monark absolut dhe zotnues i kishës katolike Romake internacionale. Por me gjithë këtë Episkopët katolikë të Shqipnisë janë shqiptarë, kanë shkruar libra shqip, kanë ba shërbime nacionale për vendin tonë, janë banues në Shqipni gjithsecili prej shumë vjetësh; dhe veçanërisht sa për Episkopin katolik Romak të Durrsit, të cilit dioqeza i shtrihet deri në Janinë e Prevezë, ky ka gati tridhjetë vjet që banon në Shqipni ku ka themelue kisha dhe ka botue libra duke ditë vetë gjuhën shqipe. Dhe veçanërisht me gjithë këtë sistem të kishës katolike Romake, prap Papa në konkordate të ndryshme me shumë shtete, ka marrë detyra të ndryshme për cilësinë kombëtare të Episkopëve për secilin shtet.

Fundi, n'emnofshim në Sinodhin Shqiptar persona që kanë luftue kishën Autoqefale dhe shqiptarizimën deri sot, shpejt kemi me u pendue keq.

GJUHA E HUEJ NË KISHË

Për me pasë shqiptarët në përdorim për meshën e shenjtë dhe për ungjillin gjuhna të hueja, nuk asht e arsyeshme as për arsye filologjike as për arsye të misionit kishtar.

Filologjikërisht gjuha e jonë asht në gjendje me na shërbye për këtë punë.

Më 1872 u botue përkthimi i Ungjillit prej Konstandin Kristoforidhit Elbasanasit; përpara këtij patën botue dhe të tjerë përkthimin e sipërpërmendun; por si për këto përkthime ashtu dhe për ato që u botuen deri më sot, të Ungjillit dhe të meshës së shenjtë, nuk asht botue asnjë kritikë për me na njoftue të metat filologjike deri sot, me gjithë **kundërshtimet e rrepta** që ka pasë përdorim'i gjuhës shqipe ndër shërbime fetare kishtarë. Kështu kuptohet se gjuha shqipe asht në gjendje me dhanë kuptimin e duhun pikërisht për ungjillin dhe meshën, ashtu edhe ma mirë se gjuhnat Sllave, si dhe të tjera gjuhna me zhvillim analog filologjik si tona, në të cilat ndër kohna të hershme ungjilli dhe mesha janë përkthye si asht e ditun.

Pra në bazë të sa vërtetohen ma sipër duke marrë para sysh se misioni i ungjillit asht për me u kuptue ky prej të gjithë popullit, dhe duke marrë parasysh se sot asnjë komb orthodhoks nuk ka në botë i cili të përdori në meshë dhe për ungjillin gjuhën tjetër veç së vetës, vërtetohet se dhe populli orthodhoks shqiptar duhet të ketë në përdorim gjuhën e vet, SHQIPEN, për meshën, ungjillin dhe çdo shërbim fetar.

Shembëlla e përdorimit të gjuhës së vdekun Latine për shërbimin fetar nga ana e kishës Latine Romake, nuk mund të merret parasysh, jo vetëm për arsyenat e sipërtregueme por edhe se kisha katolike Romake nuk ka kisha të veçanta lokale kombëtare autoqefale për çdo shtet; por asht një kishë internacionale dhe me një kryetar të vetëm, Papën e Romës, dhe prandaj ka një gjuhë të vetën të përgjithshme kishtarë, gjuhën Latine, e cila, si gjuhë e vdekme nuk gjen pengime të ndryshme ndër konkurenca të ndryshme kombëtare të qëllimeve të veçanta Shtetnore në shekullin e sotçëm. Por me gjithë këtë Papa ka lejue për shërbimin fetar ndër vende të ndryshme edhe gjuhna të ndryshme, duke mos dashtë të jetë në kundërshtim me qëllimin e dijenisë së gjithë gjuhëve, që i dha Krishti me anë të Shpirtit të shenjtë apostujve të vet ditën e **Pendikostisë**.

Sa për përdorimin e gjuhës arabe në shërbimin fetar të muhamedanëve edhe kjo nuk mund të merret parasysh për orthodhoksët; jo vetëm se i përket një feje krejt tjetër, por edhe se muhamedanizma në çdo shtet përdor gjuhën arabe në shërbimin fetar. Por sot edhe muhamedanizma ka fillue në disa vende kombëtarisht me përdorue gjuhën kombëtare për shërbime fetare, duke dashtë dhe kjo të lehtëjë misionin e fesë së vet duke i dhanë me kuptue ma lehtë popullit fenë e vet.

GJUHA E HUEJ NË SHKOLLAT SHQIPTARE

Kjo asht një çashtje krejt arsimtare dhe pedagogjike. Për këtë punë parimet shkollare, shtetnore dhe kombëtare janë sheshit të qarta dhe pa përjashtim janë në veprim në çdo shtet si dhe në Shqipëri.

Arsimi në Shqipëri asht laik si dhe në çdo shtet modern, dhe feja dhe fetarët nuk mundën me u përzie aspak në dreksionin arsimor. Pra si mundet, vetëm në Shqipëri, një komunitet Fetar, ose një person, i brendshëm ose i jashtëm, cilido me qenë, të përziehet në punët shkollare të shtetit, sidomos të paguej veçanërisht mësionjës dhe profesorë për një gjuhë të huej në shkollat laike shtetnore? Por as fuqia ligjëbamëse nuk asht e mundun me krijue një privilegj të tillë për një gjuhë të huej dhe për hir të një pjese vetëm të popullit shqiptar, për një element fetar, mbasi edhe principi i njisisë kombëtare e ndalon këtë vepër, por edhe parime të tjera dhe sidomos parimi pedagogjik.

Fëmijtë e shkollave fillore në vend që të përparonin, do lodhnin trutë e vet dhe do hutoheshin me një gjuhë së cilës as ata vetë por as prindët e tyre nuk i dinë asnjë fjalë; dhe të huejt do habiteshin me ne.

Nuk themi edhe se duhet me e shporrë gjuhën e huej edhe prej shkollave të mesme. Por flasim për shkollat fillore.

Ne na duhet ma shumë fëmijtë tanë të lodhen për një gjuhë Europiane të gjallë, ke e cila mund të gjejmë mjetet e ditunisë Fiziko-Matematike, agrikulturale, etj. të specialiteteve të tilla, se sa të këndojnë Homerin dhe Virgjilin në gjuhën origjinale si në Gjermani, Angli e vende të tjera të mëdha dhe të përparueme. Por dhe atje gjuhnat e vjetra si greqishtja dhe latinishtja, nuk mësohen në shkollat fillore, as në licenat reale, përgjithësisht.

Por flitet se duhet të mësojnë një gjuhë të posaçme nxansit dhe nxanset shqiptarë për dy shkaqe: Për me dijtë gjuhën Fetare dhe për me zhvillue kështu një simpathi dhe dashuni, me një shtet dhe komb të huej të cilit duhet me i pasë miqësinë dhe relacionet e mira. Por atëhere ne duhet të zgjedhim për këtë punë gjuhën Frëngjishte, Inglishte ose Italishte dhe Gjermanishte. Mund të thotë kush se ma mirë do t'ishte gjuha Greqishte ose Latinishte. Mirë, por këto dy gjuhna të klasicizmit për Shqiptarët janë në radhën e fundit, se: Populli ynë ka ma shumë nevojë për gjuhnat e gjalla Europiane, ku përparimi material dhe fizik asht zhvillue aq shumë. Dhe Shqiptari ka nevojë për mësimë ma shumë praktike, reale, se sa për klasicizëm, si thamë. Jeta ka nevojë praktike; dhe bukurinat e klasicizmit janë lukset tona, dhe janë ma shumë për një popull të një shteti të organizuem, të zhvilluem dhe të civilizuem.

Por për ne asht edhe një shkak ndalues tjetër, përveç principeve që thamë. Ne po të nderojmë f.v. greqishten duhet medoemos të nderojmë dhe turqishten për shkaqet e dituna që i kemi trashëgue natyrisht; por atëhere dhe rumanishtja nuk do duronte të mbetej prapa, n'asht se nuk do t'i prishej qejfi edhe një fqinje tjetër n'asht se nuk do t'i nderonim gjuhën edhe asaj si të shoqevet të veta në shkollat shqiptare; këto janë punë fatkeqsisht si natyrale për Shqipëri. Por atëhere merret vesh se çfarë brezi i ri do trashëgonte Shqipërinë tonë.

Murmurohet andej –këtej se gjuha fetare duhet të jetë në gjithë shkollat shtetnore. Kjo asht një fjalë që nuk meriton asnjë përgjegjësi prej pjesës “GJUHA E HUEJ NË KISHË” merret vesh se kur asht e mundur të përdoret shqipja për Ungjillin dhe Meshën, si nuk qenka e mundur dhe e dobishme me u përdorë gjuha jonë edhe për mësimin e fesë Orthodhokse në shkollë? Gjithë librat fetare shkollare, Historia e Shenjtë, Katekizmi etj janë botue në gjuhën shqipe, dhe ato që kanë me qenë të nevojshme për klasat ma të nalta fort lehtë dhe shpejt mundin me u botue. Me këto nuk due të them se në Seminaret e nalta (shkollat Kishtare) nuk duhet nxansit të mësojnë gjuhën në të cilën asht shkruar origjinali i BIBLËS së shenjtë, e cila për të krishtenët asht Hebraishtja, Greqishtja dhe Latinishtja. Seminaristët duhet të mësojnë edhe kto tri gjuhna mirë dhe n’asht e mundur si gjuhën e vet.

21. V – 10. VI. 1926

Çashtje politiko-religjoze **Konstandinopoli -Tiranë**

Prej:

Episkopit Visarion Xhuvanit

Theollog me Diplomë t'Universitetit t'Athinës
Ish Senator i Elbasanit dhe ish Deputet i Durrësit

**Botohet me rastin e bisedimevet përkatëse që janë
duke u bamë kto ditë në Tiranë.**

Pjesa e II-të:

LANDA

- 1) As Koloni as Protektorat
- 2) Përgjegjësia
- 3) Mbrojtja e Kishës Orthodhokse dhe Patriarhia e Konstandinopojës
- 4) Shtypi Shqiptar dhe bisedimet Kishtare
- 5) Nacionale Shpirtnore. Përfundime Orthodhokse
- 6) Çashtja Kishtare

Koston një (1) koronë

LAJMËRIM

Asht tash nën shtyp dhe librëza jonë **“Kujtim vepre dhe intrige”** në të cilën përmbledhen disa dokumenta historike të proklamimit të Kishës Autoqefale të Shqipnisë, Statuti i saj, Rregullorja e saj, disa vendime të tjera historike të Kongresit Kishtar të Beratit dhe të komuniteteve të ndryshme si dhe disa shpjegime përkatëse të Çashtjes Politiko-religjoze të Shqipnisë. Ka me u shitë në çdo librari të Shqipnisë.

TIRANË

Shtypshkronja “Tirana”

1926

Kjo pjesë e II-të e kësaj veprës së vogël i dedikohet shqiptarëvet atdhedashës të Bullgarisë me të cilët filluem punën Kishtare nën rreziqe vdekje atje.

AS KOLONI AS PROTEKTORAT

Flitet se ka me u hap bisedim dhe mbi pikën:

- 1) **Kishë koloniale orthodhoksija e Shqipnisë;**
- 2) **Nuk mundet me pasë kishë autoqefale Shqipnia, mbasi orthodhoksët e saj janë në pakicë fetarisht.**

Dhe prandaj kanë me thanë se Shqipnija, duhet të ketë kishë autonome, dhe jo autoqefale.

Nuk besojmë të hapet ky bisedim edhe në Shqipni prej delegatit Patriarkal, si u hap në Konstandinopojë zyrtarisht kur ishte atje komisioni i kishës shqiptare më 1923 dhe prozheja (projekti) e një kishë Autonome shqiptare, jo autoqefale, u botue edhe në organin zyrtar të Patriarkisë “Ekklesiastiçi Alithia”. Por, sido që të jetë puna po pregatisim një përgjigje të shkurtër lakonikërisht.

Koloni orthodhoksët e Shqipnisë nuk janë, se këta janë Autoktonë, d.m.th. janë vendës q’prej shumë shekujsh, ose ma mirë, janë vendësit parë të Shqipnisë, dhe nuk kanë ardhë prej shteteve të tjera, si kolonitë greke, rumune, bullgare etj, që gjenden në vende të ndryshme të botës, dhe si kolonitë shqiptare që gjenden në shtete të ndryshme.

Gjithësecila koloni orthodhokse që gjindet në çdo vend, fetarisht sundohet prej sinodhit të vet, që asht prej një kombësie me koloninë; f.v kolonia rumune e Parizit sundohet fetarisht prej Sh. Sinodhit Rumun etj.

Por, se kur të ishte koloni orthodhoksia e Shqipnisë, sa do që nuk asht aspak,- atëhere cili sinodh njikombas dhe i të cilit shtet do ta sundonte?

Prandej arësyeja dhe logjika fare e natyrshme urdhënon që Shqipnia të ketë një kishë më vehte autoqefale dhe Sh. Sinodi i saj të sundojë edhe ata që janë me të vërtetë koloni Shqiptare; dhe koloni Shqiptare janë si thamë orthodhoksët shqiptarë të Amerikës, të Rumanisë dhe të vendeve të tjera, ku ka koloni shqiptare. Dhe për arsyenat kanonike kishtarë që kemi paraqitë në **pjesën e parë** të kësaj librëze, Shqipnia duhet të ketë vetëm **Kishë Autoqefale dhe jo Autonome**.

Dhe sa për pretendimin se, Shqipnia nuk mundet me pasë kishë Autoqefale mbasi orthodhoksët janë në pakicë në Shqipni, kundrejt një feje tjetër, Muhamedanizmës, për këtë kemi këtë përgjigje:

Historikisht deri sot vërtetohet se edhe më një shtet ku shumica e popullsisë asht jo Kristiane, edhe atje ka kishë autoqefale.

Dihet se Roma kishte kishë autoqefale edhe kur shumica e shtetit Romaik ishte pagane, politheike. Bizanti, Konstandinopoli, kishte kishë autoqefale edhe kur shumica e tij ishte gjithashtu jo Kristiane. Sot ka kisha autoqefale në shumë vende ku shumica e popullit nuk asht orthodhokse, si në Aleksandri. Asht e ditun se, shumica e shtetit Egjiptian (të Misirit) nuk asht kristiane, por ka edhe ka pasë gjithë motin kishë autoqefale në Aleksandri. Dhe sa për vende të tjera si në Poloni etj, asht e tepërt të ripërmendim se ka kishë autoqefale të njoftëme edhe prej Patriarhisë së Konstandinopojës me gjithë që shumica nuk asht orthodhokse.

Ne nuk duem të zgjatemi duke përmendë një nga një kishat autoqefale të të gjitha kohnavet të moçme si edhe ato që janë edhe sot në veprim, në çdo vend ku shumica nuk asht kristiane, edhe orthodhoksia asht në pakicë si në Andiohia të Sirisë etj.

Pra nga cilado pikpamje me e marrë çashtjen, Shqipnia vetëm kishë Autoqefale ka të drejtë me pasë dhe jo Autonome, pse nuk asht shtet Autonom as nën proktektorat, por Independent plotësisht.

PËRGJEGJËSIA

Për paraspjegim parashënojmë përsëri se: më 1923 u emnuen në Episkopatat, të Durrsit Imzot Fan Noli, të Korçës Imzot Jerotheu dhe të Beratit Imzot Kristofori. Dhe Episkopata e Gjinokastrës **vetëm** mbeti pa Episkop si asht edhe sot. Dhe ne që prej asaj date e deri më 2-V-1925 ishim pa u dorzue Episkop, si edhe pa detyrë aktive kishtare si jemi edhe sot pa detyrë të tillë.

Durimi i tepërt i qarqevet nacionaliste, Filoparia, interesi personal dhe antishqiptarizma janë shkaqet e të mos formuemit të Sinodhit Episkopal deri sot.

DOBIA POLITIKE

Por edhe oportunitizmi, dobia politike e partinavet ose e personave që merren me politikë në Shqipni, dhe kjo asht një shkak i të mos formuemit të sinodhit Episkopal; se edhe politikanët Shqiptarë janë përzie shumë në çështjen Kishtare, duke përkrahë miqtë ose **edhe anmiqtë** dhe duke luftue **miqtë besnikë** të vet (qiveritarët për me kënaqë opozitën, me shpresa të ndryshme, kot, por opozita vetëm duke luftue pro-qeveritarët), sipas rastit dhe kuptimit që i kanë pasë dhanë politikanët tanë punëve POLITIKO-RELIGJOZE të Shqipnisë, tash shtatë vjet rresht q'prej vitit 1920 deri sot.

FILOPARIA

I asht dhanë formimit të Sinodhit Episkopal në Shqipni një kuptim dhe randësi kurdoherë në pikpamjen e ambicionit; filoparisë dhe të interesit personal; dhe randësia e qëllimit social dhe Atdhetar e fetar të Kishës Orthodhokse Shqiptare nuk asht marrë para sysh me mënyrë ideale aspak, nga ana e atyne që kanë pasë fuqinë në dorë për punët Kishtare, ose nga ana e atyne që kanë pasë në dorë influencën mbi zhvillimin e punëve të ndryshme të kishës autoqefale tash pesë vjet me radhë q'prej proklamimit të saj.

Mosplotsimi vetëm i **nji** dioqeze Episkopale, me Episkopin e duhun, ka qenë edhe asht **i vetmi** shkak i mosformimit të Sinodhit Episkopal deri sot.

Por ky mosplotsim ose mosemnim asht edhe e vetmja arsye që sheshit spiegon se, po të emnohej edhe Episkopi i katërt, atëhere do zgjidhej definitivisht medoemos edhe çështja e kryetarit të Kishës Shqiptare, edhe kështu, ata që dëshirojnë ofiqin, titullin e kryesisë së Kishës Orthodhokse të këtij populli të mjerë, do të humbnin një herë e për gjith motin shpresën e të fituemit të kësaj kryesie.

Prandaj të interesuemit kanë punue që të mos emnohet Episkopi i duhun për Episkopatën e katërt; dhe i ruente kështu gjithsecilit shpresën e fitimit për përmbushjen e qëllimit të vet.

INTERESI PERSONAL

Po të emnohej Episkopi i katërt, atëhere si thamë, pas statutit Kishtar, ishte i formuem vetvetiu Sinodhi Episkopal. Dhe ky, Sinodhi Episkopal, kishte me qenë paria ma e naltë e kishës Shqiptare; dhe atëhere, nuk do të vepronte ma Këshilli i Naltë i soçmi, se vendin e tij kishte me e zanë rregullisht doemos Sinodhi i përmendun sipas Statutit të Kishës sonë Autoqefale. Dhe vetvetiu kuptohet se, në mos të gjithve antarëve të Këshillit të Naltë Kishtar, por të paktën njanit ose disave prej këtyne, ndofta i prishej interesi personal.

Mosemnimi i Episkopit të katërt, përsëri asht i vetmi mjet për anmiqtë e kishës sonë autoqefale kombëtare, që t'ja mbërrijnë një ditë qëllimit të tyne.

ANTISHQIPTARIZMA

Kisha Orthodhokse e Shqipnisë pa Sinodh Episkopal dhe pa Episkop kryetar, nuk ishte e mundun të vijë në marrëdhanie as private, të veçanta, me kishat autoqefale të botës.

Nji kishë e tillë pa kryesi Episkopale dhe pa Sinodh Episkopal kompetent, nuk mundej me u organizue si duhej, as nuk mundej me pasë influencën as randësinë e duhun mbi popullin, dhe kështu përgatitesh shkatërrimi vetvetiu dhe anarkia Kishtare e pashembëllt e soçmja, - të cilën kemi përshkrue në librezën: **kujtim vepre dhe intrige**, - dhe Shqiptarët – Nacionalistë karakterizoheshin të pazot për me rregullue nji Kishë Autoqefale. Ky çnderim i kishës kombëtare ka qenë qëllimi i antishqiptarizmës dhe asht, se kështu kjo shpresonte, si thamë të gjejë ditën e dobishme për me e përmbysë Kishën tonë Autoqefale ose të paktën me e ba këtë vegël të qëllimeve të ndryshme për dobi të vet dhe për damin e Shqiptarizmës.

NJERËZIT E ZOT

Nji ose ma shumë kompetentë si duhet, dhe me mish e me shpirt antarë të patundun të Kishës Autoqefale, besnikë dhe të provuem mirë prej shum kohje dhe në çdo rast, për këtë punë, deri sot, si dhe për misionin NACIONAL-FETAR të Kishës sonë Orthodhokse, ishin dhe janë në dorë të Kishës sonë autoqefale, dhe me të vërtetë nuk i mungonte asnji herë nji njeri i tillë kësaj, por kjo, nuk i përdori për shkaqet që thamë ma sipër, por përkundrazi edhe i luftoi keq.

FITIMI I DAMSHËM

Dhe kështu qëllimet e ndryshme ndihmoheshin dhe fitonin nga mosplotsimi i Sinodhit, si dhe nga të qenunit jasht shërbimit fetar aktiv të nji pjese të njerëzvet të nevojshëm për misionin e kishës sonë, **dhe në nji kohë kur vendi dhe puna mbesin pa shërbyesin e nevojshëm, për dam.**

MJETI

Në një rast tjetër kemi me spjeguar edhe mënyrën e çuditshme dhe antinjerëzore, intrigën e paprajtme, me anë të së cilës mbeti deri sot Sinodhi Episkopal pa u plotsue për shkaqet e sipërpërmenduna.

QËLLIMI

Qëllimi i gjithë këtyre radhëve të sipërme nuk është tjetër por vetëm dëshira dhe detyra për me shërbye. Se edhe ata idealistë Shqiptarë që nuk janë në gjendje me ditë hollsinat duhet t'i mësojnë hollsinat dhe shkaqet e të metave të damshme, për me mundë me krye shpejt detyrën patriotike të përmirsimit. Ndryshe, sëmundja na dërgon në vdekje, direkt ose **indirekt**. Heshtja pa shkak në punë t'interesave të përgjithshme të popullit është krim.

Kur ka pasë të bajë puna me personin tonë, nuk kemi dashë të flasim botnisht, as nuk kemi folë, me gjithë që kemi pasë ma shumë mjete në dorë se sot, fletore, parlament etj. të cilat i kemi përdorë kurdoherë vetëm për mbrojtjen e interesave të Kishës Autoqefale.

Që më 1922 deri më 1926 sot nuk kemi folë as kur na u kanë shkelë dhe kur na u kanë rrëmbye të drejtat tona, as kur jemi luftue, edhe aq rreptësisht, si nuk ja merrte mendja njeriut, që do mbërrinte puna deri m'kët shkallë; dhe ktu kemi parasysh jo aq luftën që na bahet këto 14 muajt ç'prej dorzimit tonë Episkopal.

Kemi pasë shpresë se nuk do zgjatet puna kaq shumë, 5 vjet, deri sa t'ja mbërrijmë në gjendjen e ndryshme të sotme; këtu duem me thanë për pikpamjen e përgjithshme të Kishës sonë Autoqefale.

Shpresojmë se kemi me qenë të besuem dhe nuk do na zemërohet njeri kur të gjykojë me gjak të ftohtë dhe me drejtësi; se po të vazhdojmë t'i fshehim njani tjetrit gabimet, ato që kanë të bajnë me interesin e përgjithshëm, nuk ka me u ndreqë askurrë puna, po ka me shkue edhe ma zi.

NGA STATUTI KISHTAR

Nga vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit, merret vesh se Këshilli i Naltë Kishtar nuk ka pasë të drejtë të vazhdojë në fuqi ma shumë **se dy vjet, n'është se nuk gjenden dy Episkopët e nevojshëm për të**. Por n'është se këta gjendeshin atëhere Këshilli i Naltë Kishtar nuk ka pasë të drejtë as dy vjet me vazhdue në fuqi, por ka pasë detyrë **Kryesore** me formue shpejt Sinodhin Episkopal; Dhe ky duhej të mbledhë kongresin e ri Kishtar (të II të), brenda **tre muajsh** pas formimit të vet (Sinodhi Episkopal).

Dy Episkopët e nevojshëm shpejt u gjendën dhe erdhën këtu, pa ndonji mundim nga ana e Këshillit të Naltë Kishtar, dhe hynë në veprim dhe nën urdhën të Këshillit të Naltë Kishtar duke dorzue edhe Fan Nolin Episkop. Dhe Këshilli i Naltë Kishtar i plotsoi me Episkopë tri nga Dioqezat Episkopale, në vjeshtën e III. të vitit 1923. Atëhere kishte

detyrë të domosdoshme të plotsojë edhe Dioqezën (Episkopatën) e katërt, Gjinokastrën. Asnji pengim nuk pat për këtë punë.

Po t'ishte plotsue edhe kjo Episkopatë, nuk do kishte ma çashtje Kishtare në Shqipni sot.

NACIONALISTËT

Nacionalistët kur shkelej statuti tash pesë vjet rresht, në çdo rast heshtën duke besue sinqerisht se po të kritikonin, duke provokue veprime të rregullshme, ndofta kishin me u ba shkak dami të çeshtjes kishtare nacionale.

Ne jemi në pozitë ta vërtetojmë dhe të provoymë se nuk kishte me ardhë dam po dobi kombëtare në asht se do ishin kritikue veprimet e Këshillit të Naltë dhe në asht se do të ishin ruejtë të gjitha nyjet e statutit kishtar dhe të gjitha vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit. Por u gabuen të gjithë autoqefalistët prej mënyrave që përdorën prej shkaqeve që u përmendën në fillim të këtij artikulli.

MBROJTJA E KISHËS ORTHODHOKSE DHE PATRIARHIJA E KONSTANDINOPOJËS

Nuk duhet të na gabojnë fjalët as fantazia

Koha merr dhe jep tituj, nderime dhe të drejta

E vërteta praktike e punëve, duhet marrë para sysh

Ndjenjat e trashëgueme nuk na bien dobi

Logjika duhet të na udhëheqë

Mbrojtja dhe ndihma Patriarhale e Konstandinopojës për Orthodhoksët e Shqipnis, sot e paskëtaj nuk ka asnji randësi dhe asnji vleftë.

Patriarhia në fjalë nuk asht ma e zonja të mbrojë interesat e veta, por hiqet e përtëhiqet e mjera vetë, - dhe ne na vjen keq me të vërtetë, - dhe çnderohet prej një prifti, Papa Efthimit, tash shumë vjet me radhë si dhe sot. Nuk ka ma Patriarhia randësi as në qendrën e vet. Nuk ka ma të drejta të veçanta, pronopia, dhe nuk ka ma as mbi kishat e tjera autoqefale randësi; dhe shtetet Orthodhokse nuk e ndëgjojnë ma si në kohnat e hershme as e mbrojnë. Dhe në Shqipni dihet mirë se fjala e Patriarhisë së Konstandinopojës nuk ka asnji fuqi dhe asnji randësi. Kjo Patriarhi nuk sundon ma sot popullsinë e madhe Orthodhokse si ma parë; por as një të qintën e juridiksionit mbi vendet që ka pasë nuk ka ma sot. Kohja ose Patriarhia vetë asht shkak i dekadencës, prishjes, së saj.

Orthodhoksia e Shqipnis ka me përparue vetëm në asht se Orthodhoksët Shqiptarë interesohen për nderin e vet fetar, duke bashkpunue vllazënisht të gjithë Ungjillësisht dhe Shqiptarisht.

Nji nga ligjet e Statutit themeltar Panorthodhoks urdhënon:

**‘NDRYSHIMEVET POLITIKE LE T’JU VENË PAS
EDHE TË TILLA KISHTARE’**

“Tes politiqes metavoltes Akolluthisatosan qe Eklisiastiqe tiafte”.

SHTYPI SHQIPTAR DHE BISEDIMET KISHTARE

Për kujtim dhe për dije të atyne ZZ. kënduesve që nuk kanë pasë rast me këndue artikujt që pasojnë, po i ribotojmë këtu, mbasi i përkasin çeshtjes Politiko-Religjioze të ditës.

Na vjen keq se nuk na premtojnë mjetet financjare me botue edhe gjith artikujt e tjerë me randësi të Fletores “Koha” që u shkruen me shpirt kombëtar shumë të vlefshëm, dhe shtojmë se:

Nji pjesë e vogël e shtypit kombëtar nuk u muer aspak me këtë çeshtje Politiko-Religjioze, dhe nji pjesë tjetër e vogël u rrëfye në favor të vendimeve për të cilat bajnë fjalë artikujt e botuem ma poshtë.

ÇASHTJE KOMBETARO - FETARE. KONSTANDINOPOLI -TIRANË.

Nji Episkop Grek orthodhoks, Imz. Krisanthi, para disa ditësh duel në Durrës dhe tash gjindet në Tiranë në Hotelin Continental.

Dajti mbasi dëshiron me i dhanë kënduesve të vet nji spjegim mbi këtë ardhje për të cilën kanë fillue me u interesue disa qarqe, mundi me përmbledhë shënimet që pasojnë nga qarqet orthodhokse me randësi.

H.T. Krisanthi asht dërguem si delegat i Patriarhisë Greke të Stambollit. Qëllimi i ardhjes së tij asht për me njoftë gjendjen Kishtare Orthodhokse të Shqipnisë, e për me i ba me ditë Patriarhisë së vet, e cila flitet se po mendon me e njoftë dhe Kishën Autoqefale të Shqipnisë, që asht këtu në veprim që prej vitit 1922. Episkopi Grek duket se ka me ba fjalë për Kishën Orthodhokse të Shqipnisë me qeverinë tonë. U fol se dëshiron me vizitue gjith qytetet tona. Deri tash dhjetë ditë që ka ardhë ka pasë marrëdhanie të shpeshta me legasionin (legatën) Grek dhe qarqet politike orthodhokse të Gjinokastrës. Nji Komision Parlamentar flitet se bisedon me H. T bashkë me kompetentët.

Por me klerin dhe popullin orthodhoks Shqiptar ka ardhë rasti ashtu që mos me pasë Peshkopi marrëdhanie. Asnji deklaratë Imzot Krisanthi nuk ka ba; por as kryesia e Kishës Autoqefale si dhe asnji zyrë, as qark fetar kompetent, nuk ka ba ndonji shpallje mbi këtë çashtjen me randësi të përgjithshme kombëtare për çdo Shqiptar. Murmurohet andej këtej se disa pleq të nji krahine të vogël të Shqipnisë kanë me dëshirue me i dhanë peshkopit të ardhun nji përshtypje se u intereson të dy anëve, Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipnisë edhe Patriarhisë Greke të Stambollit, që kjo e fundit të ketë disa të drejta mbi Kishën Autoqefale Shqiptare. Por kleri e populli orthodhoks dhe çdo shqiptar jemi në gjendje me deklarue se dëshiron me qenun për gjith motin gjendja e kishës orthodhokse në Shqipni gjithashtu si tash asht edhe në çdo shtet tjetër ku ka popullsina orthodhokse, si në dy fqijt tanë tokzorë etj.

Dëshirojmë të besojmë se H. T. përfaqësuesi patriarhik, i cili gjindet këto ditë si mysafir ndër ne, ka me dashë me njoftë mirë të vërtetën dhe ka me mendue e raportue seriozisht në themel të gjendjes së krijueme tash afër pesë vjet këtu, dhe në bazë të kanoneve në fuqi pan-orthodhokse të botës.

Në këtë rast përgëzojmë me gjithë zemër qëndrimin patriotik shqiptar të popullit bujar të Durrsit i cili diti në raste shumë interesante të mos bahet vegël e qëllimeve të ndryshme këto ditët e fundit; dhe veçanërisht përhirojmë të përnderçmin famulltarin e Durrsit At Anastasin për veprimin e tij kombëtaro-fetar, dhe iniciatorët përkrahës të lëvizjes atdhetare kishtarë në Durrës.

(Flet. "Dajti", Nr. 118, d. 13 maj 1926)

NACIONALO - SHPIRTNORE. PËRFUNDIME ORTHODHOKSE

Delegati Patriarhik po viziton gjithë qytetet tona duke fillue nga Vlona, kështu marrim vesh prej qarqevet të ndryshme; gjithashtu lajmërohemi se komisioni parlamentar Orthodhoks i dha fund bisedimeve që bani me Imz. Krisanthin. Dhe me sa mundën me hetue marrëveshja përfundoi me pranimin e Episkopëve që gjenden në shërbim të huej sot, të cilët kanë me u emnue prej Patriarhisë së Konstandinopojës për Episkopatat e Kishës së Shqipnisë të cilat prej katër formohen në pesë. Ndërmjet pesë Episkopëve dy kanë me qenë Jerotheu dhe Kristofori. Këta u pëlqyen prej delegatit Patriarhal mbasi veprimet e tyre të derisoçme u karakterizuen të mira në pikpamjen patriarhale në Shqipni. Tre të tjerët kanë me ardhë për së shpejti në Shqipni pasi të marrin emnin e Patriarhisë Helenike të Stambollit. Nga këta një ose dy janë civila dhe kanë me u ba Episkopë përnjiherë, por në Stamboll, prej Patrikut të sipërpërmendun. Me sa mundëm me marrë vesh këta janë: Episkopi i Paramithisë së Greqisë Ioaqimi, i Tërhallës së Greqisë Polikarpi, Profesori filolog në Greqi Z. Evllogjios Korillas dhe një i tillë që gjendet në Dedeagaç të Greqisë; të gjithë këta sot janë nënshtetas Grekë dhe banuesa prej shumë vjet në Greqi pa ardhun aspak në Shqipni. N'asht se ndonji prej këtyne ma sipër nuk ka me e pranue, në këtë vend ka me qenë ish profesori i gjimnazit grek Z. Pandeli Kotoku i cili tash 10 vjet gati që asht mbyllë gjimnazi i Korçës, dhe nuk ka pranue me marrë asnjë shërbim në Shqipni. Flitet se edhe pesë civila kanë me marrë pjesë në formimin e Sinodhit Episkopal, por me kompetencë vetëm për çeshtjet financiare; u vendos që gjuha kishtarë të mbesi në përdorim ajo që asht sot d.m.th Greqishtja (statuskuoja). Dhe Patriarhisë ka me iu dhanë një shum'e posaçme të hollash për shpërblim t'atyne të ardhunave që ka pasë kjo në kohë të sundimit turk në Shqipni prej disa Monastireve që gjenden sot në shtetin tonë dhe në duer të disa privatëve.

Të pesë Episkopët e sipërpërmendun janë prej rrace shqiptare dhe shpresohet se paskëtaj do punojnë si nacionalista të flaktë shqiptarë dhe misionarë të shqiptarizmit në Shqipni. Detyra e tyre me të vërtetë asht tepër me randësi se do të përmbledhin dhe do të organizojnë popullin Orthodhoks dhe do ta bashkojnë në një ideal edhe në një shpirt, të cilin ata që po vijnë natyrisht duhet ta kenë në zemrën e tyre të pastër e të flaktë shqiptare. Prej udhëheqjes shpirtnore të këtyne pesë episkopëve të sipërpërmendun varet udhëheqja dhe frymzimi i brezit të ardhshëm të ri, djelmënisë shqiptare, si dhe mendimi fetar dhe shpirti kombëtar i Orthodhoksëve të soçëm të Republikës sonë.

Le të provojmë pra edhe këshillin e ri të naltë kishtar Orthodhoks (Sinodhin Episkopal) si provuem deri tash filluesit e parë të lëvizjes nacionale kishtarë për të cilët sot për sot mbet për shpërblim moral mirënjohjtja nga ana e shqiptarëve të mirë dhe të pa intrigue, dhe ngushëllimi se kanë ba detyrën e tyre, duke ditë se shpërblimi i një inisiatori të drejtë asht shumë herë vdekja ose përjashtimi që iu ba Aristidhit të moçëm. Pun'e cila

për popullin shqiptar nuk asht aq e çuditshme, por gjanë edhe shumë shpesh sado të mëdha e të vlefshme me qenë theroritë dhe mundimet e bame për një ideal nacional Shqiptar të shenjtë.

Por me gjithë këtë asnjë nuk duhet me humbë shpresën se nuk dihet se ç'ngjan nesër.

Mjaft asht që ka histori edhe në Shqipëri. Dhe nacionalizma rron.

Dajti mbasi nuk asht shumë kompetent mbi këto çështje të veçanta, arsyenat e vendimeve të këtyre ditëve mbi çështjen kishtarë dhe kompetencën ose moskompetencën e atyne që biseduen edhe venduen, nuk e përket sot, mbasi nuk ka pasë rast me e shkoqitë këtë çështje mirë me kompetentët që duhet. Vetëm uron që këto punë të dalin të dobishme për Shqipërinë, Atdheun tonë të dashun, dhe për nder të atij Presidenti të naltë që asht mbrojtësi i interesave të Shqiptarizmit sot për fat të bardhë të popullit mbarë.

(Flet. "Dajti", Nr. 122, d. 9 Qershor 1926)

ÇESHTJE KISHTARE

E tërë kjo javë ka shkuar me bisedime të nxehta midis gjithë patriotëve dhe klerikëve kombëtarë, mbi çështjet e varura të Kishës Autoqefale dhe përsa po bisedon komisioni në Tiranë me të dërguarin e Patrikanës Peshkop Krisanthin.

Bisedimet rrjedhin vetëvetiu se duke ditur se ky institut kombëtar përbëhet prej një Këshilli me një Kryetar në krye, ka vazhduar punërat e saj të gjertanishme të mëfura mbi nyjat e Statutit Kishtar i cili statut ka shkuar nga parlamenti dhe është pranuar si një ligj.

Në këtë javë kanë ardhur shumë veta nga Kryeqyteti, si deputetë e të tjerë intelektualë Korçarë, ku na gëzonin shumë mbi çështjen Kishtarë duke thënë se: kjo çështje po ecën shumë mbarë në favorin tonë duke u nderuar pikërisht gjithë nyjat e statutit Kishtar.

Sado që nuk mundën këto fjalë që të inkurajonin popullin porsa, se kjo kryesi gjer më sot akoma nuk është përfillur, që të gjithë i dëgjonin këto fjalë si ëndërra të ëmbëla dhe mundoheshim me të pahir që të tregonim veten të gëzuar si fitimtarë të çështjes. Ndërgjegja që fshehtazi na shtynte buzën më helm, duke thënë vetëdija se asnjë nga këto nuk është e vërtetë, edhe vërtet. Kur po mundonim trupin tonë që ta bëjmë të gëzuar, në atë çast po dëgjohej të tjera bisedime prej patriotëve duke thënë; Juve të cilët u munduat edhe dërsitë që të dëboni prej Korçe Jakovin e Durrësit edhe të kombëtarizoni Kishën, sot po ju dërgon Patrikana tre Jakovër më të këqij se ay i Durrësit që të çrrënjosin punimin tuaj të gjer më sotmë!

Ky lajm ishte një rrufe se zuri të vërtetohet prej shumëve të cilët po i tregonin të nxehta dhe të dëgjuara freska prej telefonit nga Kryeqyteti. Që të gjithë u mbuluam në vrer dhe hidhërim duke pritur përfundimet zyrtare. Po axheba Kryetari i këtij instituti ç'qëndrim do të mbajë kundrejt popullit? A e di që është responsabël kundrejt atij populli që e nderoi dhe i la në duart e tij fatin e Kishës Kombëtare? Jemi fare të bindur se do ta mbushë këtë detyrë andaj do të presim përfundimet.

(Flet. "Koha", Nr. 270, d. 5 Qershor 1926)

Kujtim vepre dhe intrige

Prej:

EPISKOPIT VISSARION XHUVANIT.

**Teolog me Diplomë t'Universitetit t'Athinës
Ish Senator i Elbasanit dhe ish Deputet i Durrësit**

**“Kritika dhe opozita e nderçme dhe pa intriga,
asht ruejtësi i interesave të popullit”.**

**“Njoftimi i sëmundjes,
i të metave dhe i gabimevet
asht fillim i mjekimit dhe i përmirësimit”**

**TIRANË
Shtypshkronja “Tirana”
1926**

**Kjo librëzë e vogël i dedikohet
Respektërisht
Shqiptarizmës fisnike të bashkëqytetasve tonë të dashun Elbasanas,
Që na kanë kuptue dhe na kanë nderue kurdoherë.
VISSARION**

Përmbajtje

- 1) Nji letër e Fan Nolit
- 2) Proklamimi i Kishës Autoqefale Orthodhokse kombëtare në Tiranë më 1921.
- 3) Nji letër-përfaqësimi i Delegatëve për Kongresin Kishtar të Beratit.
- 4) Proklamimi i Kishës Autoqefale në Berat më 1922.
- 5) Statuti i Kishës Shqiptare.
- 6) Rregullorja e Kishës Shqiptare.
- 7) Formimi i Këshillit të Naltë Kishtar.
- 8) Kundra vendimevet të Kongresit Kishtar të Beratit.
- 9) Veprime për të ruejtunin e Statutit Kishtar.
- 10) Spjegim.
- 11) Caktimi i kohës së vazhimit të Këshillit të Naltë Kishtar.
- 12) Populli i Tiranës, Elbasanit dhe i Pogradecit kërkon Mitropolit të vetin.
- 13) Gjendja e Kishave në Shqipëri dhe shkaqet e dorzimit tonë Episkopal në Savinë të Kastelnovës.
- 14) Vërejtje.
- 15) Vazhdim.
- 16) Betimi i bamun në Manastirin e Hirshëm të Savinës.
- 17) Vendimi i Elbasanit pas dorzimit tonë Episkopal.
- 18) Disa nga telegramet pas dorzimit tonë Episkopal.
- 19) Shtypi i Elbasanit dhe Mitropolia e Durrësit.

VEPRAT PATRIOTIKE PA REKLAMË T'ELBASANIT BAJNË PËRSHTYPJE TË LAVDËRUESHME N'AMERIKË

Nji letër e Fan Nolit
më 1920, kur nuk ishte intrigue

Boston, Mass 7 Mars 1920.

Fort i Përnderçim Arkimandrit dhe i dashur vëlla më Krishtin.

Një zonjë Amerikane e kryqit të kuq, e cila arriu këto ditë në Boston, më dha lajmën gazmore që jini vendosur në Elbasan, që meshoni shqip, që përpiqeni t'a çlironi kishën tonë nga zgjedha e huaj, që kini fituar simpathinë dhe përkrahjen e popullit për veprën tuaj fisnike, dhe shumë gjëra të tjera të mira, të cilat e ngrenë nderin tuaj dhe të Elbasanit shumë lart. Po kjo nuk është hera e parë që e dëgjonj emrin tuaj për të mirë. Miku ynë Z. Kristo Luarasi më shkroj gjërë gjatë nga Sofja për ju dhe për meshën që bëtë atje. Letra e tij u-botua në gazetën "Dielli" dhe i gëzoj pa masë besnikët e kishës shqipe përkëtej Oqeanit, të cilët shohin në fytyrën tuaj një nga ushtarët më të mirë të ungjillit në Shqipëri. Dëshëronja t'ju shkruanja prej kohe, po nuk dinja ku ndodheshit, dhe kjo është hera e parë që dëgjonj që arritët shëndoshë e mirë në Shqipëri dhe që i jini përveshur punës së shenjtë për të ndriçuar popullin tonë të mjerë. Ju lutem shumë të kini mirësinë të më lajmëroni hollësisht si vete misioni juaj dhe cilat janë ndjenjat e popullit për kishën kombëtare aqë në Elbasan sa dhe kudo gjetkë në Shqipëri. Këtu s'marrim lajme nga Atdheu veç fare rrallë, dhe që kur krisi lufta, Zonja amerikane, për të cilën ju fola më sipër, më solli të vetëmin dhe të parin oshtim të lëvizjes kishtarë s'andejmi. Po tani, me ndodhjen tuaj në Elbasan, kam shpresë të dëgjonj më dendur, më tepër dhe më mirë dita me ditën.

Ju përshëndosh vllazërisht dhe mbetem shërbëtor dhe vllaj juaj në Krishtin.

F.S. Noli
Peshkop i Amerikës veriore

Fort të përnderçimit Arkimandrit Vissar. Xhuvanni
Elbasan. Albanie.

PROKLAMIMI I KISHËS AUTOQEFUALE ORTHODHOKSE KOMBËTARE NË KISHËN E TIRANËS MË 28-XI-1921

Pas një iniciativës sonë
me shumë mundime dhe therori
u ba ky vendim:

VENDIM

28 Vjesht' e III të vitit 1921

Gjithë klerit të shenjtë Orthodhoks, Pleqësisjave të nderçme
dhe popullit Fisnik Orthodhoks të Shqipnisë.

VLLAZËN,

Shohim nevojën e madhe për një bashkim të plotë të të Krishtenëve Orthodhoksë të gjithë Shqipnisë. Marrim parasysh edhe kuptojmë interesat e vërteta për jetën, mirësinë, përparimin dhe nderin fetar të popullit Orthodhoks të Shqipnisë, sikurse ngjan edhe në mbretinjtë e tjera. Duem të jemi edhe nënshtrë të nderçim si mirëdashës e përkrahës të Shtetit tonë Kombëtar. Kështu kemi plotësisht dëshirë të madhe dhe gjithë nomet e Orthodhoksisë edhe ata ma të vegjël. Po edhe duem të jemi gjithë motin të bashkuem me Patriarkun Ekumenik të shenjtë si janë të bashkuem gjithë milionat e Orthodhoksëve, të Rusisë, të Greqisë, të Rumanisë, të Serbisë etj.

Prandaj kemi për themel të patundun edhe gjithë nomet e patundun e të përjetshëm të Apostujvet të Shenjtë e të lavdueshëm si edhe të Sinodhevet Ekumenike të Shenjta të cilat me një za thonë dhe urdhënojnë, urdhënat që shënojmë ma poshtë, të cilët janë shtimun në veprim prej gjithë botës Orthodhokse, që duen të riejnë titullin e shenjtë Orthodhoks të drejtë, të vërtetë dhe të pazgrymun, dhe urdhënimet tepër të shenjta të Orthodhoksisë janë këto:

“Eteras vasilias (kratus) Eklisia mi dhiatatestho ta tis eteras Vasilias”. Dhe “Elefthera Eklisia en Elefthero Krati”. Dhe “tes Politiques metavoles akolluthisato-san qe Eklisiastiqe tiafte” d.m.th. “Një kishë e një Shteti tjetër të mos i japë urdhën një kishë të shtetit tjetër”. “Një kishë e lirë me një shtet të lirë”. Dhe “ndryshimevet politike le t’u venë pas dhe ndryshime Kishtare”. Nga gjithë këto punë me randësi të madhe u mblodhëm, biseduem, pëlqyem dhe vendosëm premas simbas propozimit të Hirësisë së Tij Arkimandritit tonë theollogut z. Visar Xhuvanit Elbasanasit këto që pasojnë:

I) Pranojmë dhe shpallim prej ditës së soçme vet-qeverimin Kombëtar të Kishës së shenjtë Orthodhokse të Shtetit Shqiptar.

II) Pranojmë që sa ma shpejt të mbajmë një mbledhje të përgjithshme pan-Orthodhokse Kishtare m’atë qytet në të cilin ka me e pamun t’arsyeshme Ministria e nderçme e Punëve të Mbrendëshme.

III) Ndë këtë mbledhje të përgjithëshme të përfaqësohet gjithë Kleri dhe populli Orthodhoks (dhe dhimigjerondiat) i Prefekturave dhe nën Prefekturave të shtetit tonë me nga një, dy ose tre përfaqësues fuqplotë.

IV) Këta përfaqësues të kenë të drejtë (plireksusiotita) për me bisedue e me vendue e për me përfundue vendime kishëtare të patundme fuqiptotë dhe vepruese (telesidhikus apofasis ametaklitus).

V) Këtyne vendimeve kanë me iu bindun plotësisht gjithë Kleri Orthodhoks, pleqësiat (dhimogjerondiat) dhe populli orthodhoks për çeshtje fetare dhe administrate Kishtare. Kjo mbledhje kishtare dhe e përgjithshme ka me zgjedhë një këshill të përherëshëm veprues që ka me administrue fetarisht, mbas rregullavet të caktueme gjith klerin, pleqësiat dhe popullin orthodhoks të Shqipnisë. Dhe ky këshill do të ketë paskëtaj lidhje dhe bashkim të plotë vetëm Dogmatik me Patrikanën (bashkim feje të plotë), kështu dhe me gjithë orthodhoksinë e botës.

VI) Ky kryekëshill i naltë i përgjithëshëm kishtar orthodhoks dhe kombëtar ka me zgjidhun gjithë çeshtjet kishtare me Patrikanën dhe ka me qenë shtyll' e patundme rrejtëse e orthodhoksisë së Shqipnisë dhe i njoftun zyrtarisht prej gjithë botës dhe rregullisht.

VII) Në kishën tonë orthodhokse të Tiranës paskëtaj priftënijtë në meshët të shenjtë dhe në shërbime të tjera kanë me lutun: "PISIS EPISKOPIS ORTHODHOKSON" "gjithë episkopët Orthodhoksë" në vend të Jakovit, dhespotit të dëbuem dhe antikombëtar, deri sa të hypi në fron Arhiepiskopi tonë kanonik.

VIII) Hirsisë së Tij Arhimandrit Theollog, Visar Xhuvanit, i lutemi të veprojë më çdo vend dhe për çdo punë që duhet për realizimin e vendimevet të sipërshënueme, tue lypë përkrahjen morale dhe materiale për gjithë këto punë me randësi fetaro Kombëtare.

Kemi nderin me ju lutë Qeverisë së nderçeme të shtetit tonë, të ketë mirësinë me i pasë në vërejtje të mirë këto vendimet tona; kështu i lutemi dhe gjithë klerit dhe pleqësisjave, si dhe popullit orthodhoks, me pasë mirësinë të pëlqejë e të përkrahë gjithë këto vendime të shenjta.

Me përqaftime vëllaznore

Zavendësi i Mitropolitit në Tiranë:

Stefan Tirana (Mima)

Parësia:

Kozma Lasku, Stef. Ath. Koja, Spiro Zhava, Spiro Janku, Leonidha Nishku, Pavllo Koja, Stefan Buçani.....(Pasojnë edhe tanë emnat e popullit të Tiranës)

Këshilla jeratike:

Kryetari: Arhimandriti i Orthodhoksëvet

Dr. Vissar Xhuvani

Antarët: prifti:Papa Jorgji Rusi, prifti: Papa Simon Athanasi.

Vërtetojmë nënshkrimet dhe vendimet e popullit të Tiranës

Krye-plaku: Spiro Zhava.

Rroftë kisha e shenjtë orthodhokse vetëqeverimtare kombëtare e Shqiptarëvet.

Në Kishën katedrale të Evangjelizmosë të Tiranës, 28 Vjesht' e III të vitit 1921.

NJI NGA LETËR-PËRFAQËSIMET E DELEGATËVET PËR KONGRESIN KISHTAR TË BERATIT

Sot më 9 të Gushtit (d. e vjetër) 1922, mbledhja e përgjithshme e Orthodhoksëvet të Durrësit, tue marrë parasysh se Hirsia e Tij Kryetari i Mitropolisë Arhimandrit Z. Vissar Xhuvani, foli për mbledhjen në Berat t'orthodhoksëvet të Shtetit tonë Shqiptar, zgjodhën përfaqësues fuqiplotë 1. Hirsinë e Tij Arhim. Vissar Xhuvanin, Theollog dhe Deputet i Durrësit dhe Kryetar i Mitropolisë së Shenjtë të Durrësit. 2. Gjergj Manushin tregtar, për me proponue, bisedue dhe me votue në kongresin kishtar të sipërpërmendun që Kisha Kristjane Orthodhokse e Shtetit Shqiptar: a) Të qeveriset mbas rregullavet (kanonevet) t'apostujvet të shenjtë dhe mbas të 7 sinodhevet Ekumenikë. b) Të jetë gjithmonë në marrëdhnje me Patriarkanën Ekumenike Orthodhokse për hollsinat që i përkasin (Dogmës). c) Të jetë e qeverisun si gjithë Kishat Orthodhokse të gjithë Shtetevet Orthodhoksë. ç) Të jetë e qeverisun mbas nomevet të Shtetit tonë Shqiptar dhe d) çdo paratypij që ka ndodhë në kishën orthodhokse të Shqipëtarvet të vi në udhën e rregullshme, kësilloj i nepet fuqiplotsi këtyne dy zotnivet, përfaqësuesvet të sipërpërmendun, si dhe për çdo hollësi që ka të bajë me punët e sipërshenjueme. Këta dy delegatë të venë dhe të vinë me shpenzimet e veta dhe do kenë nga një kopje të këti vendimi, i cili ka me iu komunikue Kryetarit të Bashkisë Z. Arkitektit, Kostë Paftali, iniciatorit të Mitropolisë së shejtë të Durrësit. Dhe kështu u kompozue ky vendim (proces-verbal) dhe u këndue në ndëgjesën e të gjithëve, u pëlqye dhe u nënshkrue prej gjithë popullit dhe klerit orthodhoks të Durrësit, si dhe prej Pleqsisë (Dhimogjerondisë).

Durrës 9 Gusht 1922.

(Pasojnë nënshkrimet e klerit dhe të popullit si dhe vërtetimi i pleqsisë).

Vërtetohet se asht një me origjinalin.

Për kryetarin e Mitropolisë së Shenjtë të Durrsit.

V. Rusi

Durrës 12-8-1922

PROKLAMIMI I KISHËS AUTOQEFALE NË BERAT

Kryetari i Kongresit hapi mbledhjen dhe tha shkurt se qëllimi i mbledhjes asht për të proklamue Kishën Autoqefale Orthodhokse Kombëtare mbas kanonevet apostolike të shtatë Sinodhevet të shenjtë ekumenikë të Kishës së madhe Orthodhokse të Krishtit dhe urdhënioni e bisedoni.

Pas Kryetarit muer fjalën delegati i Durrësit, atëherë Arqim. Visar Xhuvani, dhe spjegoi hollsisht çeshtjen tue përfundue kështu:

Prandaj pra, të gjithë ne të autorizuemit Delegatë të Kongresit, Klerikë e Laikë, me një za dhe entuziazëm në emnin e të gjithë klerit e të popullit orthodhoks të Shqipnisë, tue u bazue që Shqipnia u njoft prej gjithë shtetevet të botës si një shtet Independent dhe Sovran dhe mbi këtë bazë, mbas kanonevet të shenjta të kishës orthodhokse, në shtet independent, kishë independente e të tjera.

Tue pasun për shembëll kishat autoqefale që vijojnë:

Kishë e Rusisë më 1771, Kishat Orthodhokse të Austrisë 1740, të Bukovinës më 1873, të Greqisë më 1833, të Serbisë më 1880, të Rumanisë më 1856 dhe ma së fundi të Bosnjës Ercegovinës 1908, proklamuen, në emnin e trinisë së shenjtë të njëqenëshme dhe të pandame (enonomati tis Agjias omousiu qe adhieretu Triadhos) autoqefalinë e Kishës Orthodhokse Kombëtare të Shqipnisë edhe de fakto se de jure ka qenë që prej ditës së shpalljes së independencës politike të shtetit shqiptar, tue mbajtur lidhje spirituale dogmatike dhe apostolike plotësisht me Mamën Kishën e Patrikanës së Shenjtë Ekumenike dhe me Patrikanat dhe kishat e tjera orthodhokse autoqefale të botës, por administrativisht Independent, pra,

Rroftë Kisha Autoqefale.

Të gjithë thirrën rroftë tue u ngritur në kambë për nderim. Dhe pas 5 minutash pushimi nënshkruen deklaratën e sipërme me mënyrën që pason:

Korça – At Josifi, Dhorë Havjari.
Pogradec- At Vasil Marko, Thanas Kërkhalli.
Bilisht - At Jorgji, Anastas Çekrezi.
Kolonja – Oshënar Sofroni, Dhimitër Ndini.
Leskovik – At Vangjel Çamçe, Thomo Prifti.
Përmet – Dr. Stathi Kondi, Vasil Zoto.
Tepelenë.....
Kavajë– Pal Xhumari, Andre Ikonomi.
Tiranë – Papa Simoni, Mark Hobdari.
Elbasan – Vasil Llapushi, Simon Shuteriqi.
Shpat– Taq Buda, Dhimitër Papparisto.
Dibër – Leonidh Nishku, Kostë Paftali.
Berat – Perikli Kona, Taq Tutulani.
Vlonë – Tol Arapi, Jani Skrame.
Fier – Lon Xoxa, Mit Qilica.
Lushnjë– Tun Gjergji, Llazar Boxhja.
Durrës – Arhimandrit Vissar Xhuvani, Jorgj Manushi.

Libohovë – Spiro Kati.
Shkodër - Rist Gjybabiq, Gjok Nikolliqi.
Gjinokastër - Doktor Kondi.
Delvinë - K.Thomaj
Përfaqësuesi i Prefekturës: Llazar Puli
Komisari i posaçëm i Qeverisë
Harilla Dhosi d.v. Berat 13-9-1922

STATUTI I KISHËS SHQIPTARE

Neni 1. -Kisha Orthodhokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së shenjtës Kishë të përgjithshme Autoqefale të të gjithë ortodoksëve, përbëhet prej banorëve të shtetit shqiptar që i besojnë Krishtit dhe pohojnë simbolin e shenjtë të fesë dhe pranon gjithë ata sa pranon Kisha e Shenjtë e Krishtit Ortodokse Lindore, themelonjësi dhe kryezoti i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jesu Krishti.

Kjo kishë sundohet prej Episkopësh kanonikë duke ruajtur pa ndryshim, si dhe gjithë kishat e tjera ortodokse të Krishtit, Kanonet e shenjta Apostolike e Sinodike si dhe gojdhënat e shenjta.

Neni 2. Në shtetin shqiptar paria më e lartë Kishtare do të jetë sinodi i përhershëm i përbërë prej Episkopësh kanonikë nën kryesinë e një Mitropoliti. Ky sinod do të ketë titullin: Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe do të qëndrojë në kryeqytet.

Neni 3. Mitropoliti do të zgjidhet ndër pesë Episkopata duke qenë të bashkuar me pesë laikër. Këta laikër do të zgjidhen në çdo Episkopatë nga zgjedhësit e dytë të Episkopatave, dhe zgjedhësit e dytë do të jenë të zgjedhur mbas popullsisë në 2000 (dy mijë) frymë një. Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë deri sa të mbarojë gjithë sa përmbledh nyja e dytë do të sundohet prej një Këshilli të përbërë prej katër Klerikësh dhe Laikësh nën kryesinë e një kleriku që do të ketë titullin Kryetar i Këshillit të Lartë, Sundimtari i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Ky Këshill do të qëndrojë në Korçë dhe do të ketë vulën e vet me Kryqin në mes dhe dy degë dafinash për anash e rrotull shkronjat: Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe viti 1922.

Neni 4. Anëtarët klerikë të Këshillit të përzier do të jenë de fakto zëvendës të rregullshëm të qendrave e Mitropolive të Korçës, Durrësit, Beratit dhe Gjirokastrës të emëruar nga kongresi. Kryetari i Këshillit të përzier dhe laikët do të zgjidhen prej Kongresit.

Neni 5. Këshilli i lartë i Kishës do të hyjë në marrëveshje (negociata) me Patriarkinë e Shenjtë Ekumenike dhe në nevojë me patriarkitë e tjera e me Kishat Autoqefale Ortodokse për njohjen e Kishës sonë zyrtarisht si bijë dhe motër Kishë Ortodokse Autoqefale.

Neni 6. Këshilli i lartë do të përkujdeset për të sjellë brenda 2 vjetëve të paktën 2 Episkopë Shqiptarë të pëlqimit të saj kanonik nga Patriarkia Ekumenike ose nga Kishat e tjera motra.

Neni 7. Këshilli i lartë do të kontrollojë dhe do të rregullojë gjithë pasuritë e Kishave, të Manastireve e pasuritë e lëna për qëllim mirëbërësie.

Neni 8. Anëtarët Klerikë të Kishës së lartë, të mbështetur në të drejtën Kanonike e në rregulloret në fuqi të Kishës së madhe, do të kenë gjithë ato të drejta që ka një sinod. Sa për administratën e për të zgjedhurit e Episkopëvet kjo punë u lihet anëtarëve Laikë të bashkuar me anëtarët Klerikë.

Neni 9. Episkopët që kanë për të ardhur do të jenë de jure anëtarë të Këshillit të lartë, pasi të bëjnë benë para Këshillit të lartë në këtë mënyrë: **“Beto hem me ndërgjegje Kryepriftërore para Perëndisë që do të jem besnik i Shtetit shqiptar dhe i statutit të**

tij dhe i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare duke ruajtur kurdoherë ligjet e Shtetit dhe kanonet apostolike e sinodike të Kishës së Madhe Ortodokse”.

Këta Episkopë do të vendosen nëpër ato Episkopata ku e sheh me udhë Këshilli i lartë kishtar.

Neni 10. Gjuha e Kishës është Shqipja, por meqenëse disa nga kleri e nga Horët nuk janë stërvitur në gjuhën Kishtare dhe m’ anën tjetër na mungojnë mjetet e duhura u jepet e drejta të vazhdojnë mësimin me gjuhën e deritanishme, duke u përkujdesuar me sa është e mundur në gjuhën e Kishës këto: 1- Paqësoret, të cilat përmbledhin dhe lutjet e shtetit e për Kishën. 2- Ungjillin, Apostullin dhe predikimet ndër ta. 3-Ati ynë dhe sa mund të shtojnë mbi ta.

Neni 11. Këshilli i lartë Kishtar do të bashkojë me Episkopatat më të afërme të gjitha ato vise që mbeten brenda kufirit të shtetit shqiptar e që kanë qenë pjesë mitropolirash të tjera të mbetura jashtë kufirit.

Neni 12. Pagat mujore të Kryetarit të Këshillit të lartë, të anëtarëve dhe të personelit tjetër të nevojshëm, si edhe të prishurat e zyrave që do të ketë ky Këshill do të ekonomisen dhe do të caktohen sipas një rregulloreje të veçantë.

Neni 13. Librat shqipe kishtare që janë përdorur gjer më sot do të përdoren prap deri sa të trajtohet sinodi Episkopal, i cili do të vendosë për vazhdimin e përdorimit të tyre. Këta libra do të kenë vulën e Këshillit të lartë Kishtar. Sa për librat e reja që do të mund të botohen deri sa të trajtohet sinodi, këto do të përdoren me pëlqimin e përkohshëm të Këshillit të lartë Kishtar.

Neni 14. Ky statut, përveç nyjeve 1 dhe 11, do të jetë në fuqi deri sa të trajtohet Sinodi Episkopal i përbërë prej 4 Episkopësh që brenda 3 muajsh do të mbledhë Asamblenë Kishtare dhe do të bëjë statutin e përhershëm mbi bazën e popullsisë duke u mbështetur në një rregullore të posaçme për zgjedhjet.

Berat më 17-9-922

RREGULLORJA E KISHËS SHQIPTARE

Neni 1.-Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë përbëhet prej të katër Episkopatave: të Korçës, Durrësit, Beratit dhe të Gjirokastrës, me kufijtë që kanë pasur gjer më sot me titullin Mitropoli. Viset që janë shkëputur nga Mitropolitë e tjera që gjenden jashtë kufirit të Shqipërisë dispozohen simbas nenit 11 të statutit.

Neni 2.-Këto Episkopata do të sundohen pas rregulloreve të Patriarkisë Ekumenike Ierarqikisht, kështu që Zëvendësit për sa u përket çështjeve të rrethit të tyre do të drejtohen prej zëvendësve të përgjithshëm ose Episkopëve dhe këta prej Këshillit të Lartë Kishtar.

Neni 3.-Detyrat e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar janë këto: 1. Të përkujdeset për mbarëvajtjen e Kishës duke ruajtur e duke mbrojtur gjithë kanonet e shenja të Apostujvet, e të mbledhjeve Ekumenike, të ligjeve të armonopolit të dhikonemisë dhe të nomollogjisë të Patriarkisë Ekumenike, si edhe për të gjitha ato çështje të cilat sipas ligjit veprues të shtetit janë në kompetencën e gjykatoreve Kishtarë. 2. Mbledhjet i kryeson Kryetari, në mos u ndodhtë ky, vendin e tij e zë ai që vjen pas nga shkalla hierarkike e Episkopatave. 3. Mbledhja që të jetë legale do të ketë më tepër se gjysmën e anëtarëve.

Neni 4.-Vendimet janë ligjore e të fuqishme kur merren me shumicën e votave, në rast njëvëtësie fiton ana e Kryetarit.

Neni 5.-Këshilli Kishtar do të mbledhet doemos dy herë në vit, në gjashtë muaj një herë, Shënmitrit e Shëngjergjit dhe jashtëzakonisht kur ta shohë të nevojshme Kryetari.

Neni 6.-Një anëtar i Këshillit të Lartë që nuk ndodhet për shkak të arsyeshem në dy periudha me radhë quhet i rrëzuar dhe në vend të tij zgjidhet tjetër prej popullsisë së Episkopatës që përfaqëson.

Neni 7.-Arkëtarin ka të drejtë ta zgjedhë Këshilli duke marrë garanci prej tij. Zgjedhja e personelit tjetër do të jetë në dorë të Kryetarit. Arkëtarin nuk ka të drejtë të paguajë pa nënshkrimin e Kryetarit, si edhe Kryetari nuk ka të drejtë të urdhërojë pagesa jasht buxhetit pa vendimin e Këshillit.

Neni 8.-Çdo Episkopatë paguan në arkën e Këshillit Kishtar nga: fr. ari për shtëpi në vit. Mënyra e të mbledhurit i lihet Këshillit.

Neni 9.-Kryetari do të paguhet për çdo muaj 400 fr. ari, anëtarët Klerikë nga 300 fr. ari, anëtarët Laikë do të paguhet vetëm në periudhat e mbledhjeve, kështu: anëtarët laikë që banojnë në qendër nga 250 fr. ari, ato të Episkopatave të tjera që janë jashtë qendrës nga 350 fr. ari, veç shpenzimeve të udhëtimit me konditën që paga të fillojë me të nisurit për udhë; dhe muajin e fundit do ta marrin të plotë edhe në qoftë se nuk e kanë përmbushur. Kryeshkronjësi do të paguhet 300 fr. ari, shkronjësi i dytë 200 fr. ari, ftuesi 100 fr. ari, shërbëtori 60 fr. ari, për shpenzime zjarri, drite, të mobiluar dhe të tjera të papandehura, si dërgimi i Komisionit të Patrikanës ose gjetkë 15.000 fr. ari (vazhdojnë nënshkrimet e Delegetëve).

Berat, 17-9-922.

FORMIMI I KËSHILLIT TË LARTË KISHTAR VENDIM I KONGRESIT KISHTAR TË BERATIT

Për Këshillin e Lartë të Kishës Autoqefale Kongresi emëroi: Atë Vasil Markon kryetar, atëherë Arqimandrit Vissarion Xhuvanin anëtar Klerik dhe zv. Mitropolit i Dioqezës së Durrësit, Atë Josifin anëtar Klerik dhe zv. Mitropolit i Korçës, Atë Anastasin anëtar Klerik dhe zv. Mitropolit i Beratit. Dhe një anëtar tjetër Klerik zv. Mitropolit i Gjirokastrës, i cili u vendos që të zgjidhet prej Gjirokastrës për arsytet që u paraqitën në Kongres posaçërisht prej V. Xhuvanit.

Edhe katër anëtarë të tjerë laikë (civila) u emëruan prej Kongresit për Këshillin e Lartë të Kishës Autoqefale, dhe këta janë: zz Dhosi Havjari mësues, për Korçën, Dr. Kondi për Gjirokastrën, Simon Shuteriqi mësues, për dioqezën e Durrësit, dhe Tol Arapi polic, për Beratin. Dhe kështu Këshilli përbëhet prej 9 personash sipas artikullit përkatës të Statutit të sipërm.

Vendimin e sipërm u vendos prej Kongresit që të mos ketë asnjë komunitet dhe asnjë njeri të drejtë për ta prishur as për ta kundërshtuar.

KUNDËR VENDIMEVE TË KONGRESIT KISHTAR TË BERATIT

Kundër vendimeve të sipërpërmendura të Beratit dhe sidomos kundër njëjës së posaçme të Statutit Kishtar që thotë: “Anëtarët Klerikë të Këshillit të përzier do të jenë de fakto zëvendës të rregullshëm të qendrave të Mitropoliave Korçë, Durrës, Berat, Gjirokastrë, TË EMRUAR NGA KONGRESI”, shpejt, një javë pas Kongresit Kishtar të Beratit, para se të mblidhej për herën e parë Këshilli i Lartë Kishtar, iu dërgua prej Korçe ky telegram komuniteteve të Dioqezës së Durrësit, pa filluar ne akoma detyrën e ngarkuar prej Kongresit Kishtar të Beratit.

TELEGRAM

Dhimogjerondisë,
Zgjidhni antarin klerik, Zv Mitr. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit tjetër në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit.
Simon Shuteriqi.

Përgjigjja qe:

TELEGRAM.

Kryesisë së Kishës. Korçë.
Në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit kemi zgjedhur Papa Dhimitrukën anëtar Klerik të Këshillit të Lartë Kishtar si dhe për Zv. Mitrop. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit.
Dhimogjerondia.

Durrsi qe Komuniteti i fundit qe u përgjigj, se më parë u përgjigjën komunitetet e tjera të Dioqezës së Durrsit. Që të pestë komunitetet e Dioqezës (Episkopatës) së Durrsit dërguan po atë kopje të telegramit të sipërm.

Për këmbimin e telegramevet të sipërm u muar vesht se kishte qenë bërë një marrëveshje e fshehtë vetëm prej tre personash me z. **Simon Shuteriqin** dhe Kryetarin e Këshillit Atë Vasil Markon, për hatër të atyre tre vetave dhe për qëllime vetjake të ndryshme, se po të kishin ndonjë shkak do ta kishin paraqitur në Kongres në mbledhje të posaçme ose kur Deputeti dhe delegati i Elbasanit Z. Taq Buda pati mirësinë dhe na propozoi për anëtar të Këshillit të Lartë Kishtar duke hapur bisedim të posaçëm si duhej. Dhe Kongresi po të donte votonte kundër ose na emëronte në ndonjë Dioqezë tjetër.

Shënim: Po të pyeteshin të gjitha Dhimogjerondiat ose i gjithë populli ortodoks ishte punë e sigurtë, kujtojmë, se asnjë nga anëtarët e Këshillit L. K, as kryetari i soçëm nuk kishte për t' u zgjedhur. Por delegatët fuqiptotë na zgjodhën dhe zgjedhja e tyre është e pakundërshtueshme sipas rregullave të gjithë botës.

Në bazë të emërimit tonë prej kongresit dhe në bazë të statutit Kishtar ne në ditën e caktuar vajtëm në Korçë për të filluar detyrën; por Kryetari i Këshillit Atë Vasil Markoja nuk na la të marrim pjesë në Këshill duke dashur të mbështetet në telegramin e krijuar si më sipër. Sado që ne ishim proqeveritarë, Qeveria, për hatër të opozitës së vet, nuk e mbrojti atëherë tezën tonë, as statutin Kishtar në këtë çështje, as deputetët; por e lanë të shkelet sado që e kishin pranuar zyrtarisht duke e botuar edhe në fletoren zyrtare statutin.

Prandaj populli bëri protestimet që pasojnë. I pari nga këto u bë kur ne ishim akoma në Korçë duke u munduar për të mos u shkelur të drejtat tona si dhe që të mos merren nëpër këmbë statuti dhe vendimet e Kongresit, që janë ligji dhe baza e detyrueshme dhe e patundshme për Kishën Autoqefale, dhe sidomos pse kishim frikë se një artikull i Statutit po të prishej ishte punë e lehtë për armiqtë e Autoqefalisë sonë që t'i prishin një nga një të gjitha. Dhe prandaj nuk u ankuam as nuk kritikua botërisht. Por edhe miqtë tanë ndër komunitete të tjera i bëmë që të mos bëjnë asnjë veprim publik etj. Por edhe ne vetë atëherë si deputet që ishim nuk e bëmë çështje sado që ishim me shumicën e Parlamentit, por as në fletoren tonë pasandaj nuk folëm.

Të interesuarit për të shtënë në dorë telegramin e sipërbotuar, disave nga Z.Z Dhimogjerondët i thanë se ne nuk e dëshirojmë edhe se nuk mundemi ta kemi atë detyrë Kishtarë për shkak të Statutit të Shtetit me gjithë që kur ishim ne deputet, atëherë nuk ishte bërë zgjerimi i statutit shtetëror, i cili po të na ndalonte ne ishim të detyruar të jepnim dorëheqjen nga njëra ose tjetra detyrë.

Dhe për çudi, popullit ja mbajtën të fshehtë vendimin e telegrameve të sipërm. Vetëm pleqsisë së Shpatit, së cilës kishin nevojë t'i merrnin vulat, i thanë gënjeshttrat që dëshmohen në telegramin e poshtëbotuar të Zavalinës dhe Jeronishtit të Shpatit.

Shënim: Komuniteti i Durrësit, kur u bënë intrigat e sipërpërmendura, nuk qe shkaktar, as pjestar, se populli i Durrësit pati mirësinë dhe na emëroi zëv. Mitropolit aktiv të Durrësit, na dorzoi me kënaqësi atëherë Mitropolinë më 1922 dhe na dërgoi si delegat të vetin në Kongresin Kishtar të Beratit.

Por, qysh ngjau konflikti pasandaj më 1925 ndërmjet nesh dhe 3-4 antarëve të pleqsisë kishtarë, do ta shpiegojmë sinqerisht në pjesën II të kësaj libërze. S'ka faj Durrësi.

Nga populli fisnik i Durrësit kemi kujtime më shum mirnjohëse, pse na emëroi dhe më 1919 predikonjës të vet dhe pasandaj na zgjodhi dhe Deputet për në Parlament. Dhe na paguante.

Dhe kur mori Fan Noli Mitropolinë e Durrësit më 1923, Dhimogjerondia e at-hershme pati mirësinë vullnetarisht dhe i propozoi gradimin tonë në mbledhjen e parë që bëri nën kryesinë e Fan Nolit në Durrës.

Por edhe si erdhëm ne prej Savine të Kotorrit, i dorëzuar Episkop, qenë gati të bashkpunojnë me ne Dhimogjerondia e Durrësit në është se nuk do të kishin ndërmjetësuar të interesuarit.

VEPRIME PËR TË RUEJTUNIN (RUAJTJEN) E STATUTIT KISHTAR, QË U SHKAKTUEN PREJ DY TELEGRAMEVET TË BOTUEME NË F. 20 E ORIGJINALIT

Fletores “Post’ e Korçës” t’interesuemit
Telegramën e faq. 20 të Dhimogjerondisë
ja paraqitën si protestim duke rrejtë kështu shtypin.

KRYESISË SË KËSHILLËS KISHTARE, KORÇË

Pamë në gazetën “Post’ e Korçës” që shkruente se Elbasani ka protestuemun zgjedhjen e Arkimandrit Xhuvanit si zavendës i Përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit. Kjo nuk asht e drejtë se Dhimogjerondia e lagjes Kala nuk përfaqëson edhe lagjen e Shinkollit e Krahinën e Shpatit, të cilat pas vendimit të Kongresit Kishtar të Beratit në nyjën 4 të statutit pranojnë si zavendës të përgjithshëm të Mitropolisë së Durrësit Arqimandrit Xhuvanin

Kryeplaku i Gjinarit (Vula).

Për Kryeplakun e Shtërmenit

Trifon Mema

Kryeplaku i Fikasit (Vula)

Kryeplaku i Mëlizës

Jan Soti

Kryeplaku i Kodrës Bujarit

Ilia Tollumi

Kryeplaku i Pashtreshit (vula)

Kryeplaku i Stërstanit

Kostanin Balla

Për Kryeplakun e Shelcanit

Antar

Saku

Kryeplaku i Kryezjarrit (Vula)

Kryeplaku i Karakullakut (Vula)

Kryeplaku i Kuqanit (Vula)

Për Kryeplakun e Terpshanishtit

Kostantin

Pleqësia e lagjes Shinkoll t’Elbasanit

Kosti Haxhi Nikolla

Kryeplaku i Shinkollit

Avraam

Anastas Paparusi

Jorgji Beça

18-XI-922.

KRYESISË SË KËSHILLËS SË NALTË KISHTARE NË KORÇË

Pamë në gazetën “Post’ e Korçës” se populli Orthodhoks i Elbasanit ka protestuemun zgjedhjen e Hirsisë së Tij Vissar Xhuvanit për zavendës të përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit që e zgjodhi Kongresi Kishtar i Beratit. Ky protestim nuk asht i vërtetë dhe ne të nënshkruemit populli Orthodhoks i lagjes Kala t’Elbasanit qëndrojmë në vendimin e Kongresit të Beratit dhe njofim për zavendës të përgjithshëm Mitropolitit të Mitropolisë sonë të Durrësit Hirsinë e Tij Arkimandrit Vissar Xhuvanin dhe as ndonji pleqësi (Dhimogjerondi) etj, nuk njofim kompetent për me veprue kundra këtij emnimi të Arkimandritit të përmendun dhe këtë kemi vendosë edhe më 1919; dhe vazhdimi në detyrën e sipërme të Arkimandritit V. Xhuvani asht dëshira jonë.

Elbasan Vjesht’ e III. 1922.

Jeftimi A. Buda

Jorgj Pavli

Mihal Xhufka

Dhimitër Kapidani

Mihal Kallupi

Dhimitër Taja

Simon Moisiu

Harallamb K. Caku

Vasil Kallupi

Risto Papajani

Vasil K. Sulkuqi

Jorgji Santo

Kol Boçi

Lazi Gorasi

Kostandin Gjoni

Stefan Doko

Profesor V. Qirjaku

Vasil Sulkuqi

Ili K. Subashi

Dhimitër Bici

Jan Mihal Janko

Vasil Çerekja

Kol Mullisi

Stefan Balla

Dhimitër Paparistja

Mir Popa

Simon J. Papajani

Petër Gignasi

Llam Dodbiba

Gaqi Xhaja

Venemin Cilia

Kost LLulla

Dhimitër Çarmaku

Kostandin Pina

Stas Papajani
Dhimitër K. Prapaniku
Nikoll Nushmama
Kostandin Çerekja
Pandeli Kallupi
Jorgj Fullani
Petër Kostandin Caku
Athanas Vasil Dilja
Jorgj Haxhimima
Venemin Xhufka
Stefan Papajani
Giga Buda
Kozma Millonaj
Athanas J. Caridha
Nikoll Bibaja
Anastas Paparistja
Llazar H. Belicari
Vasil K. Guhaku
Thoma Dashi
Jan Banushi
Vangjel K. Dako
Pavli Papajani
Miri Papajani
Stas Çerekja
Iftimi Paparistja
Josif Mihal Bardhi
Mina Kaçameli
Dhimitër Millonaj
Simon Gega
Llazar Dedja
Fot Papajani
Spiro J. Lazri
Kov Skënderi
Jan Cilia
Aleks K. Papnikolla
Jan K. Nosi
Lef Kallupi
Spiro Ndrija
Simon Ndrija
Jon Ruci
Miri K. Caku
Kost Jorgj Naqi
Spiro Haxhimima
Kol Ili Robja
Dhimitër Popa
Kostandin Sulkuqi

A. Xhuvani
Josif J. Caridha
Kol Xhufka
Jorgj Dashi
Andon Xhaja
Sif Guhaku
Sotir A. Sarandari
Nikoll Leka
Thoma Vasil Tere
Athanas Mullisi
Sava Nushmama
Grigor Bici
V. Haxhi Jakovi
Mihal M. Popa
Jorgj A. Leka
Jan N. Papajani
Jorgj Gignasi
Sif P. Janko

“Jam antar i të ruejtunit të Statutit të Beratit pikë për pikë: Petër Ndrija.
Vërtetohen nënshkrimet. Antarët e Pleqsisë së lagjes: Iftimi Buda, Iftimi
Paparistja

KRYETARIT TË KËSHILLËS SË NALTË, AT VASIL, KORÇË

Gjith Enoria e Shtërmenit të Shpatit nuk njofin Papadhimitrukën as Zavendës Lokal si ka qenë pas telegrafit tuej as me ndonji mënyrë. Vetëm pas statutit të Kongresit të Beratit duhet Arqim. Xhuvani të emnojë zavendës lokal, lutemi respektërisht përkrahjen dhe bekimet e Shejtënisë suej, qëndrojmë në Kongresin.

Mirënjoftës dhe bindës.

Antar	Antar	(Vula)
(Vula)	(Vula)	Kryeplaku i
Braka	Epitropi	Shtërmenit
	Trifon Mema	J. Rasa

Për Enorinë e Gjinarit dhe Enorinë e Zavalinës, Seltës dhe Jeronishtit.

Jorgj Boduri
(Gjishti)

KRYETARIT TË KËSHILLËS SË NALTË, AT VASIL, KORÇË

Njofim në veprim për Zav. Mitropolit të Durrësit vetëm Arqim. V. Xhuvanin pas vendimit të Kongresit Kishtar të Beratit.

Vulat tona na i kanë marrë me gabim dhe na gënjyen duke thanun se i kërkon Korça për Zotni dhaskal Dhimitër Papariston. Sa për Zavalinën dhe sa për Jeronishtin na thanë se do vulosim që t'i jepet rrogë Papanautit dhe nuk na thanë se zbresim Arqim. V.

Xhuvanin nga Zav. i Përgjithshëm i Mitropolisë së Durrësit dhe do hypim Papadhimitrukën.

Kryeplaku i Zavalinës (Vula)

Kryeplaku i Jeronishtit (Vula)

KRYETARIT TË KËSHILLËS SË NALTË, KORÇË

Telegramin e muerëm por gjithë Enoria e Shelcanit, Shpatit nuk njofin Papadhimitrin zavendës lokal si ka qenë me asndonji mënyrë. Vetëm pas statutit të Kongresit të Beratit duhet Arqimandrit Xhuvani të emnojë zavendësin lokal, pra lutemi respektërisht përkrahjen dhe bekimet e Shejtënisë Suej se do qëndrojmë doemos. Me bindje dhe mirënjoftje.

Për Epitropin e Kishës

Jorgj Boduri I. Sotiri

Kryeplaku i Shelcanit Kryeplaku i Tudanit

(Vula) (Vula)

Anëtar i Shtërmenit

Për Epitropin e Kishës

Jorgj Boduri

Kryeplaku i Mëlizës

(Vula)

Jakov Sotiri

Për Enorinë e Shtërmenit

Epitropi i Shtërmenit:

Trifon Mema

Për Enorinë e Gjinarit dhe Enorinë e Zavalinës, Sheltës dhe Jeronishtit

Jorgj Boduri

KRYESISË SË KËSHILLËS SË NALTË KISHTARE, KORÇË

Jemi të bashkuem me Shpatin dhe me asndonji mënyrë nuk njofim as zav. lokal si ka qenë Papadhimitrin po duem Arqim. Xhuvanin të emnojë zavendësin lokal si urdhënon statuti dhe rregullorja e Kongresit të Beratit.

Me nderime dhe bindje lutem për përkrahjen dhe bekimet se do qëndrojmë në Kongresin Kishtar.

Enoria e Shijonit

Kryeplaku Antar

i Shijonit Ndreka Ndinit

(Vula)

Elbasan 25-XI-1922.

Spiegim:

Gjithë këtyne kërkesavet të popullit asnji përgjigje nuk i dha Kryetari i Këshillit N. Kishtar At Vasil Markoja. Por edhe at Dhimitrukën nuk e thirri të fillojë detyrën si

antar, as nuk e urdhënoi me fillue veprimet si Zv. Mitr. i përgjith. i Dhioq. së Durrsit. Vendi de fakto mbeti pa njeriun e duhun. Dhe kështu Këshilli i Naltë K. në asnji mbledhje të vetin nuk pat antar Klerik të Episkopatës sonë si edhe ne nuk muerëm asnji përgjigje definitive me anën e së cilës të mirresh vesht se jemi i pushue nga detyra në të cilën na emnoi Kongresi Kishtar i Beratit.

Kështu ç'prej 26-X-1922 deri më 1-I-1924 Mitropolia e Durrësit mbeti pa Zv. Mitropolit të përgjithshëm si dhe pa Mitropolit.

T'interesuemit për me justifikue veprimet e tynë të ndryshme të sipërme intriganisht përhapën fjalë ndër qarqe nacionaliste se nuk kanë besim në ne mbasi gjoja ne ishim Grekofil. Me gjithë që e dishin mirë se çfarë mendojmë ne për greqizmen dhe çfarë veprimesh ishin duke bamë, si dhe në çfarë konflikti t'egër kishim mbërri me Helenizmen, si do spiegojmë në një rast tjetër.

N'at kohë dashamirët tonë nuk kishin mundë akoma me shpikë ose me shpifë mjetin e pastajshëm, për me na luftue Serbofilinë, të cilën tash kto dy vjetët e fundit e përdorin me tërbim kundra nesh, sa do që edhe për këtë e dinë mirë se nuk mundën me ja mbërri qillimit.

Gjith sa u banë për antarin e klerit të Episkopatës së Durrsit kundra statutit dhe vendimeve të Kong. K. të Beratit u banë dhe për antarin klerik të Gjinokastrës.

VENDIM I KONGRESIT KISHTAR TË BERATIT

ZGJEDHJA E MITROPOLITIT TË DURRSIT

Pas këtyne vendimeve kryetari i Këshillit të Naltë Kishtar të kishës autoqefale, At Vasil Markoja, tha: “Kongresi Kishtar i Beratit duke marrë parasysh sa për Arqi. Vissar Xhuvanin, shërbimet e mëdha që i bani proklamimit së Kishës Autoqefale si në përgatitjen e mendimevet për vendimet e mbledhjevet të këtij kongresi, ashtu edhe në mbledhjet zyrtare të kongresit, duke zhvillue dhe duke bindë për vendimet dhe proklamimin e kishës autoqefale, gjithashtu edhe mundimet dhe veprimet dhe theroritë që ka ba për përgatitjen e këtij kongresi historik, propozoj të zgjedhi dhe të vendosi ky kongres për Mitropolit definitiv të dhioqezës së Durrsit, H. e T. Vissarion Xhuvanin, mbasi ky i ka të gjitha cilësinat e lypuna për këtë detyrë të naltë; dhe dy Episkopët që do gjinden ta dorzojnë Episkop për së shpejti”.

Mbledhja e kongresit e pranoi unanimisht me gëzim propozimin e sipërm dhe me propozim po të At Vasilit të sipërpërmendun, të gjithë delegatët u ngritën në kambë, për shenjë nderimi për vendimin e zgjedhjes së Episkopit të parë, dhe antarët klerikë me propozimin dhe udhëheqjen po të ati kryetari, At Vasilit, kënduen një tedeum (dhoksollogji) dhe një ceremoni të posaçme fetare për zgjedhjen e Episkopit të Durrsit në personin e H. T. Visar Xhuvanit dhe në këtë ceremoni të posaçme At Vasil Markoja, bashkë me delegatët klerikë, kënduen edhe titullin (fimin) e Mitropolisë së Durrsit për Vissarionin e sipërpërmendun, si Mitropolit të zgjedhun definitivisht për këtë Mitropoli, dhe kjo ceremoni nga ana e kongresit asht deklarue (u karakterizue) si edhe asht kanonikërisht, **Ceremoni e deklarimit të zgjedhjes Episkopale zyrtarisht për Vissarionin** e sipërpërmendun (d.m.th: mega minima, nareçenje); dhe ceremonija e sipërme në pikpamjen kanonike kishtarë barazohet me një fakt, vepër të domosdoshme, pas së cilës pa fjalë vjen dorzimi (hirotonija Episkopale).

(Dhe urimet e përgëzimet iu banë të zgjedhunit të sipërpërmendun nga ana e delegatëve të kongresit si edhe nga ana e popullit që u ndodhën pranë si dëgjues dhe dëshmonjës në kongresin historik).

Dhe kështu mbetej që të gjindeshin dy Episkopët për me ba dorzimin (Hirotoninë) Episkopal për Episkopin e zgjedhun Vissarionin për Dhioqezën e Durrsit, e cila përmbledh në juridiksionin e saj: Durrsin, Tiranën, Elbasanin, Kavajën, Shpatin, Pogradecin, Shkodrën dhe Dibrën.

Shënim: Popullsia Orthodhokse vetëm e QYTETIT Durrës asht gati 1/10 e popullsisë Orthodhokse të Dioqezës (eparhisë) Kishtarë të Durrsit.

Shënim:

Edhe vendimin e Kongresit Kishtar për emnimin tonë si ma sipër, të botuem në faqe 18 [46], nuk e respektoi dhe nuk e futi në veprim Këshilli i Naltë Kishtar i Kishës sonë Autoqefale abuzimisht. Mjeti dhe mënyra për me mos e vu në veprim janë po gjith ato që përmeden së spjegimin e f. 17 [45]; por shkaqet janë: filoparia, interesi personal, dobia partizane politike dhe antishqiptarizmi që zhvillohen në artikullin **Përgjegjësia**, të pjesës së II-të të librezës sonë Politiko-Religjioze.

CAKTIMI I KOHËS SË VAZHDIMIT TË KËSHILLIT N. KISHTAR KONGRESI I RI, I II-TË, KISHTAR

Kongresi K. i Beratit për kohën e vazhdimit të Këshillit të Naltë Kishtar vendosi kështu:

Po të vinë 2 Episkopët e parë të dorzojnë shpejt edhe dy të tjerët, një Visar Xhuvanin dhe një tjetër të pëlqimit të Këshillit të Naltë Kishtar, dhe kështu të formohet sinodhi Episkopal dhe 3 muaj pas formimit të tij të mbledhet kongresi i ri për formimin e statutit të përhershëm.

Por n'asht se mbrenda dy vjet, ç'prej proklamimit të Kishës Autoqefale nuk gjinden dy Episkopët e duhur për formimin e Sinodhit Episkopal, për dorzimin (hirotoninë) e duhur, ahëre Këshilli i Naltë Kishtar asht i detyruem medoemos mbrenda 2 vjetve pas datës së proklamimit të Autoqefalisë, të thërresi kongresin e ri për me marrë ky masat e duhuna më 1924.

SHËNIM: por tash kanë kalue jo 2 por 5 vjet dhe asgja nuk asht ba prej këtyne që urdhënon kongresi sa do që Episkopët kanë 5 vjet që kanë ardhë. Prandaj u shkaktuen vendimet dhe veprimet që përmbledhen në dy pjesët e libërës sonë: Politiko-Religjioze, si dhe marrëveshja Greko-Shqiptare Kishtare (me Patriarhinë).

POPULLI I TIRANËS, ELBASANIT DHE POGRADECIT KËRKON MITROPOLIT TË VETIN ME KËTO VENDIME:

VENDIM I TIRANËS PARA DORZIMIT EPISKOPAL.

Sot më 19-III-925 të nënshkruemit me dëshirë vllaznore si pas vendimit t'Elbasanit D. 8-III-925 dhe Pogradecit d. 14-III-925 vendosën sa vijon:

Tue marrë parasysh nevojat fetare të qytetit tonë Tiranës dhe tue marrë parasysh cilsinat e duhuna të Hirësisë së Tij Arqimandritit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop t'Episkopatës sonë.

Zaharijas Jorgoni

Joan Prosi

Vangjel Shundi

Hrisant Janku

L. Nishku

Gavril Lasku

Spiro Leka

Jorgj Pano

Pavlo Koja

Toni Çoma

Mihal Shani

Stefan Tirana

Spiro Janku

Nikoll Pano

Llazar Pjeshkazini

Filip Pano

Mihal Gjorgji Dimroçi

Aleks Nikoll Zaharija

Anastas Nikoll Zaharija

Llazar Petro Sena

Athanas M. Koja

Dhimitri Kaçila

Kosti Filip Pano

Buranotçi

Todori Vasil Myzeqari

Jovan N Gjoka

Mark N. Gjoka

Fot Koja

Llazar Andona

Kostandin Dimroçi

Leonidha Dimroçi

Mihal Dimroçi

Vangjel Dimroçi

Kopi Zoraqi

Veniamin Andona

Gjorgj Milla

Dhimitri H. Voilla
Vasil Fëndik
Vangjel Kos. Fëndik
Pandeli Korra
Perikli Joan Duçi
Dhimitër Dushi
Josif Pano
Andrea Zoraqi
Anastas Buneci
Kop Nushi
Prof Anxhari
Nikoll Martini
Petro Qirjaku Nonita
Gavril Pano
Mark Heba
Petro Korra
Gjorgji Korra
Jovan Korra
Vasil Janku
Gjorgj Çoka
Margariti L. Luarasi
Gjorgji Mihail Prosi
Timotheos P. Dhimitri
Kostandin Gj. Mara
Naun Shundi
Vangjel Stefan Mara
Jovan Kozma Myzeqari
A. Rusi
L. Heba
Mihal Zaharia
Jakov Skaka
Spiro Zhava
Nikolla Kafexhiu
Llaz Panteqi
Leonidha Kaçilja
Anastas Janku
Spiro Hanxhari
Kristo Myzeqari
Gjorgj Stavro
Dhimitri Puli
M. Çuli
Nikoll Jorgoni
Vasil Banata
Leonidha Goga
Jovan Andon Kona
Tokli Manastirli

Vangjel Mona
Grigor Zoraqi
Dhimitri Millano
Stefan P. Çuli
Nasti Çoka

Vërtetohen nënshkrimet e sipërshënuem të parisë dhe të popullit të komunitetit orthodhoks të Tiranës që përbahej prej një qind e tridhjetë familjesh.

Antarë: Toni Çoma, Spiro Leka.

Kryeplaku i lagjes

G. Zoraqi

Si pas dëshirës dhe vendimit të shpallun në shkresën e sipërme të nënshkrueme prej popullit të Tiranës, vërtetojmë se edhe ne Dhimogjerondija e zgjedhme prej këti populli po bashkëpunojmë rregullisht nën kryesinë e Zv. Mitropolitit të Përgjithshëm të Dhioqezës sonë të Durrsit H. e T. Episkop (1) Dr. Vissar Xhuvanin, dhe pëlqejmë sa janë shkruar ma sipër. Dhe kështu për vërtetim nënshkruhem.

Tiranë, 13 maj 1925.

Dhimogjerondija e Tiranës

(Pleqësia Kishtare)

Spiro Leka, L. Nishku, Gavril Lasku, Spiro Janku.

(1. Vërtetimi i fundit nga ana e Dhimogjerondisë, u bë pas dorzimit Episkopal).

VENDIM I ELBASANIT PARA DORZIMIT EPISKOPAL

Sot më 8 Mars 1925 u mbledh Dhimogjerondivja nën Kryesinë e Zavendës Mitropolitit Ikonom At Dhimitrukës, dhe pasi bisedoi gjatë e gjanë, vendosi me zana të përbashkëta, sa vijon:

Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit e të rrethit t'Elbasanit, të çfaqun edhe dy herë ma parë me vendime të posaçme, bamun në muejt Shtatuer e Nanduer të vitit 1919, si dhe propozimin e bamun në Kongresin Orthodhoks të Beratit, ashtu edhe cilsinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop për Episkopatën Tonë. Për me i mbërri këtij qëllimi, t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondivet të qytetevet tjera t'Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i u drejtue edhe ato Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë.

Elbasan, më 7-III-1925

Kryetari,

Ikonom At Dhimitri (d v)

Anëtarët

Th.Floqi (d v)

V. Buza (d v)

Dr. S. Popa (d v)

N. Dhimitri (d v)

F. Shuteriqi (d v)

Tokli Bebi (d v)

V. Llapushi (d v)

Sekretari

V. Haxhijakovi (d v)

VENDIM I POGRADECIT PARA DORZIMIT EPISKOPAL

Sot më 14-III-925 u mbledh dhimogjerondia nën kryesinë të At Papa Grigorit dhe pasi bisedoi gjatë e gjanë vendosi me zana të përbashkëta sa vijon:

Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit tonë dhe të rrethit të Pogradecit dhe tue marrë parasysh cilësinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arqimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop i Episkopatës sonë. Për me i a mbërri këti qëllimi t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondinavet të qyteteve të tjera t' Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i-u drejtue së bashku Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë.

Pogradec 14-III-925.

Kryetari Z. V. Mitropoliti

P. Grigori

Anëtarët

Gaqi Petre

Gjoka Kristo

Koçi Shkurti

Vërtetohen nënshkrimet e zavendësit të Mitropolitit Papa Grigorit dhe të episcopëve të Kishës së Pogradecit.

Kryetari i Bashkisë

Gjoka Ndinka

Vula e Bashkisë së Pogradecit

Pogradec 14-III-925

GJENDJA KISHTARE NË SHQIPNI DHE SHKAQET E DORZIMIT TONË EPISKOP NË SAVINË

Mbasi,:

1) Shumica e Priftnavet t'Episkopatës së Gjinokastrës në Shqipni meshtojnë në Kishë n'emën të ish Mitropolitit të Gjinokastrës Vasilit, që Kongresi K. i Beratit e ka rrezue zyrtarisht si antishqiptar. Këtë përmendin për kryefetar rrethi i katundevet të Prefekturës së Gjinokastrës edhe sot.

2) Në Episkopatën e Beratit-Vlonë, Episkopi Em. Kristofori përmend (kujton) në meshë rregullisht Patrikun e Kostandinopojës edhe çdo Episkop t'Orthodhoksëvet deri sot.

3) Në Episkopatën e Korçës-Përmet, Episkopi Emz. Ierotheu meshton gjithashtu si i sipërmi në emën të Patrikut të Kostandinopojës, **dhe vetëm në emën të Tij.**

4) Në Episkopatën e Durrsit-Tiranë-Elbasan kleri meshton në emën të çdo Episkopie Orthodhokse (që do me thanë në emën të një kishe indipendente po pa Episkop kryetar dhe pa Episkop të kësaj Episkopate, të Durrsit).

5) Në Shkodër kleri meshton në emën të Patriarhut të Serbisë.

6) Në qytetin Korçë mbrenda At Vasil Markoja, një Prift që asht Kryetar i Kishës Orthodhokse Kombëtare Autoqefale të Shqipnisë (d.m.th. ka gradën e Patrikut, përveç titullit), dhe ky, kur meshton atje përmend edhe Episkop Ierotheun, i cili si thamë meshton në emën të Patrikut të Kostandinopojës.

7) Imz. Ierotheu dhe Imz. Kristofori a) erdhën në Shqipni, b) morën Episkopata të cilave Episkopë ishin të tjerë sipas pikpamjes kanonike të Patriarhisë së Kostandinopojës, - dhe c) dorzuen Episkop Fan Nolin, pa lejen e patriarhisë, kishës, nga e cila kur erdhën këtu urdhënoheshin, dhe nën juridiksionin e së cilës ishin kur erdhën këtu, si edhe sot prej Patriarhisë së Kostandinopojës njifen për Episkopë të asaj kishe.

Por ajo Patriarhi nuk bani asnjë veprim kundra tyre tash 5 vjet, sa do që Eksarhu, delegati Patriarhal Imz. Krisanthi, kto ditë në Shqipni tha se Patriarhia Imz. Ierothenë dhe Kristoforin i njëf për Episkopë që vepruen në Shqipni kundra rregullavet dhe kanonevet Ierarhike disiplinore.

8) Statuti i Kishës dhe vendimet themeltare të Kongresit Kishtar të Beratit, si u spjegue në këtë libër, u shkelën keq, sidomos nyji i 10-të që i përket gjuhës shqipe në Meshë.

9) Vendimi i Kongresit Kishtar të Beratit për zv. Mitropolit të Gjinokastrës dhe antar klerik në Këshillin e N.K. të asaj dioqeze u shkel prej Këshillit të Naltë Kishtar.

10) Vendimi i Kongresit K. të Beratit që na emnonte ne provizorisht Zv. Mitropolit të përgjithshëm të dioqezës së Durrsit dhe pasandaj për Mitropolit definitiv, si u spjegue në këtë libër, u shkel.

11) Mbasi Imz. Ierotheu, Imz. Kristofori dhe Këshilli i Naltë Kishtar e lanë Kishën 4 vjet pa Sinodh Episkopal pse nuk donin të dorzonin një Episkop të katërt që të mos formohet kështu Sinodhi Episkopal Shqiptar.

12) Nuk u interesue Këshilli i Naltë Kishtar për me krye misionin kryesor të saj kombëtar dhe predikonjës të kishës autoqefale, se as nyji i 10-të i statutit që ban fjalë mbi gjuhën Shqipe në meshë nuk hyni në veprim si duhesh, por as predikimi i ungjillit të shejtë nuk u ba as më një kishë, si edhe asnjë libër i ri kishtar nuk u botue në gjuhën tonë

deri tash, pesë vjet prej Këshillit të Naltë Kishtar sadoqë janë shpenzue shuma kolosale. Dhe kishat janë pa librat shqip që duhen, tash 5 vjet. Por edhe atje ke patën fillue me meshtue shqip pak nga pak pushuen së meshtuemi shqip. Asnji inisiativë për përmirsimin e gjendjes fetaro-kombëtare nuk u muer nga ana e Këshillit të Naltë Kishtar gati tash pesë vjet. Por edhe për koloniat shqiptare Këshilli i Naltë Kishtar asnji masë nuk mori, as për me u njoftë kjo prej atyne si edhe as për nevojat e tyne kishtarë, si ka detyrë me ba edhe si ban çdo qendër kishtarë e çdo kombi për kishat e kolonive të veta që gjinden në çdo shtet të huej.

13) Mbasi Këshilli i Naltë Kishtar ç'prej formimit të vet më 1922 deri ditën e dorzimit tonë Episkopal më 2-V-925 si dhe deri sot, ne aspak nuk na mbrojti të drejtat tona kishtarë si klerik i kësaj kishë që jemi, dhe nuk muer asnji masë ligjore të rregullshme për ne, as nuk na thirri një herë për spjegim ose gjykim tash pesë vjet rresht; por gjith motin na ka luftue me mënyra të ndryshme që janë të papajtueshme me shpirtin ungjillor, sa do që nuk munden me mohue shërbimet që i kemi ba kishës autoqefale para dhe pas themelimit të saj në çdo rast, si edhe në të dhanunin e ndihmës të 50.000 franga ari nga ana e Parlamentit kur ne ishim atëhere antar në parlament, si dhe në shtypin e jashtëm dhe të mbrendshëm ku i kemi ndihmue.

14) Nji muej para dorzimit tonë Episkopal, Imz. Ierotheu na deklaroi këtu se nuk duhet ma me dorzue kurrë Episkopë në Shqipni pa urdhnin e Patriarhisë së Kostandinopojës nga i cili urdhënohet; edhe Imz. Kristofori, po n'at kohë na deklaroi se nuk mundet me dorzue asnji Episkop pa bashkëmeshtimin e Ierotheut ose të ndonji Episkopi tjetër por t'urdhënuem vetëm prej Patriarhisë së Kostandinopojës.

15) Mbasi dy Episkopët e sipërpërmendun në Shqipni, sidomos në vitin 1925, ishin tyke u sjellë më një mënyrë e cila sheshit rrëfente se nuk e njofin qenien e Kishës sonë Autoqefale, se edhe në meshtim përmendshin vetëm Patrikun, punë që asht i vetmi fakt që rrëfen nga cila kishë dependon një Episkop, por edhe nuk muerën asnji prej tyne pjesë në asnji mbledhje të Këshillit të Naltë Kishtar deri sot etj. (Por vepronin si në kohë të Turqisë).

16) Mbasi ne nuk dëshironim me i dhanë rast dhe shkak Patriarhisë së Kostandinopojës të përzihet këtu, dhe po shifnim se Këshilli i Naltë Kishtar ashtu edhe dy Episkopët e vetëm që gjindeshin në Shqipni, si edhe të gjithë qarqet që interesoheshin për zgjidhjen e çeshtjes politiko-religjioze në Shqipni, tyke dorzue Episkopin e katërt për formimin e Sinodhit Episkopal të Kishës sonë, aspak, gati tash pesë vjet nuk po interesoheshin.

17) Dhe mbasi vetëm për një Episkop kishte nevojë Shqipnia për me formue sinodhin Episkopal pas statutit kishtar, se tre të tjerë ishin në personin e Imz. Ierotheut, Kristofor Kisit dhe Fan Nolit, që e kishin dorzue dy të parët dhe i cili kishte fillue detyrën Episkopale në Dioqezën e Durrsit në fillim të vitit 1924 (kur u dorzuem ne Fan Noli nuk ishte dënue politikisht).

18) Tyke marrë parasysh se kur një statut shkelet, çdo nënshtetas ose çdo antar i shoqnisë ose i komunitetit dhe grupit që e ka pranue atë statut ka detyrë kryesore ta mbrojë dhe me çdo mënyrë; mbasi si u spjegue mirë deri tash shkelja e vendimevet të kongresit kishtar dhe të statutit themeltar të kishës sonë u ba prej Këshillit N. K. Menduem se dorzimi i ynë Episkopal në mënyrën që u ba në Savinë **ekzekutonte dhe plotsonte** dhe nuk shkelte vendimet dhe statutin kishtar të Beratit, ose të paktën i ndihmonte indirekt formimit të Sinodhit Episkopal, të cilin si u muer vesht ma sipër

Këshilli i Naltë Kishtar ka pasë detyrë me e formue gati tri vjet para dorëzimit tonë Episkopal, tyke qenë e detyrueme me na njoftë ne dhe me na dorzue Episkop për Mitropolinë e Durrsit.

19) Por dhe mbasi gjendja e kishës sonë i jepte botës së mbrendshme dhe asaj së jashtmes të drejtë të thotë se Shqipnija nuk asht e zonja me e vue në veprim statutin kishtar dhe se nuk mundet me pasë, as me formue Sinodh Episkopal, mbasi u provue ndër këto katër deri pesë vjet, që kur asht proklamue kisha autoqefale, kurse kjo vazhdon me pasë në krye një këshill Prifto-civil; dhe nga të tre Episkopët që gjindeshin në Shqipni dy prej këtyne njofin Patriarkun e Kostandinopojës për të parë (se këtë përmendin në meshë) dhe i treti i fundit Fan Noli, që njëjte kishë autoqefale (se ky përmendte në meshë çdo Episkop t'Orthodhoksëvet), nuk asht ma në shërbim aktiv kishtar po u arratis prej Shqipnije.

(Prandaj kishin fillue bota e interesueme me thanë se Shqipnija që kur proklamoi kishën autoqefale nuk ka asnjë Episkop që të përmendi në meshë vetëm kishën autoqefale, d.m.th. Sinodhin e saj, ose Këshillin e N. K. Dhe vetvetiu merret vesht se një kishë e tillë nuk mund të quhet rregullisht kishë Orthodhokse Apostolike Episkopale, si janë të gjitha kishat Orthodhokse autoqefale të botës, por quhet si kishë prezviterjane, jo larg sistemit të tillë Ierarhik të një pjese të protestanizmës). Për dobi t'antishqiptarizmës.

20) Mbasi, dorzimi ynë Episkopal prej Episkopësh Orthodhoksë të tjerë Rusë etj, kishte me ba një tronditje, por shumë të dobishme, d.m.th kishte me ba Këshillin e Naltë Kishtar, dy Episkopët që gjenden në Shqipni si edhe politikanët Shqiptarë, ashtu edhe Patriarhia e Kostandinopojës, dhe popullin tonë kishte me i ba të gjithë t'interesohen, të mendojnë dhe të veprojnë ma mirë për dobi të kishës autoqefale dhe të largohen pak nga mënyrat e ndryshme, disa dhe të tjerë të veprojnë ma mirë për organizimin e kishës sonë për formimin e sinodhit Episkopal, për njohtjen e saj nga ana e Partiarhisë së Kostandinopojës; dhe veçanërisht kishte me ndihmue, dorzimi ynë, për me fitue këshilli i naltë autoritetin e fortë dhe randësinë e madhe të saj të ditëve të para, deri sa të formohej shpejt sinodhi Episkopal, por edhe për me u interesue edhe shtypi kombëtar dhe nacionalistët ma hollësisht edhe ma mirë, tyke provokue ekzekutimin e statudit dhe të vendimevet të kongresit kishtar të Beratit që asht baza edhe themeli i kishës sonë.

21) Mbasi, kishte me qenë punë shumë e dobishme me pasë Shqipnia të paktën një Episkop Shqiptar dhe autoqefalist me mish e me shpirt në dispozicion për çdo rast dhe orë të nevojshme, dhe ky të dorzojë Episkopët e duhun për sinodhin Episkopal Shqiptar nacionalist të kishës sonë, bashkë me ndonji Episkop tjetër nacionalist Shqiptar, ose të paktën në mungesë të tij, bashkë me ndonji Episkop tjetër të huej por dashamir të sinqertë të kishës Shqiptare dhe pa prapamendim.

22) Mbasi, dorzimi i një Episkopi Shqiptar me anë të një kishë tjetër Orthodhokse kishte me ba përshtypje me randësi në kishat që nuk na dëshirojnë ndofta të mirën sinqerisht dhe kishte me i dhanë të kuptojë botës se ka mjete të tjera krejt Orthodhokse kisha Shqiptare Nacionale dhe se nuk munden t'interesuemit me e tërheqë e përtëheqë kishën tonë, por se kjo mundet me krye nevojat e veta fetaro-kombëtare me ndihmë tjetër Orthodhokse ashtu si i intereson Shqiptarizmës dhe rregullës fetare, edhe kishte me i dhanë me kuptue botës se kishat e tjera nuk munden me i refuzue kishës sonë ndihmën morale shpirtnore për formimin e Sinodhit Episkopal Shqiptar me të vërtetë.

23) Me pasë Këshilli i Naltë Kishtar një Episkop krejt nën urdhën, si kishim me iu bindë ne edhe si iu bindëm me të vërtetë, me durimin pa kufi, nuk do të kishte ma bota

shkak me thanë se Shqipnija nuk ka asnjë Episkop nën urdhën direkt të kishës autoqefale, dhe prandaj nuk është kishë Apostolike Episkopale si gjithë kishat Orthodhokse të botës, por është kishë Presviterjane e cila ja përgjan kishës së tillë Protestante.

Prandaj,

24) Tyke pasë parasysh dhe opinionin publik sidomos atë të kësaj dioqeze, të Durrsit, nën të cilën përmblihet edhe Tirana, Elbasani dhe Pogradeci me Shpatin, që përbajnë 75% të kësaj Dioqeze, të cilët edhe pas dorzimit tonë u deklaruen të kënaqun për dorzimin tonë si merret vesht nga përgëzimet e botueme si edhe nga vendimi i Dhimogjerondisë së Tiranës, bamë më 13-V-25 pas dorzimit tonë Episkopal dhe që është botue në faqen 21 [48-52] të kësaj librëze.

Muerëm pëlqimin e nacionalistëve të Elbasanit privatisht, me të cilët ishim ma afër dhe të cilët na kishin kuptue mirë,

Muerëm pëlqimin e dreksionit të përgjithshëm të shtetit, privatisht,

Por, edhe pëlqimin e kryetarit të Këshillit të Naltë Kishtar At Vasil Markos, të cilit i spjeguem me anë të një telegrami të gjatë pak ditë ma para dorzimit tonë Episkopal dhe i lypëm edhe këti lejën tipike për dorzimin tonë me anë të Episkopëve Rusë, Emz. Hermogjenit dhe Emz. Mihailit, dhe si përgjigje që telegrami që muerëm prej Kryesisë së Këshillit të Naltë Kishtar Nr. 4529 F. 17 D. 2-V-1926, i cili telegram thotë pikërisht këto fjalë: “KRYETARI PËR SË SHPEJTI VJEN NË TIRANË PËR ME U MARRË VESHT GOJAZI”; fjalë të cilat dëshmojnë se direkt edhe At Vasil Markoja e pëlqente dorzimin tonë Episkopal të sipërpërmendun; ndryshe kishte me na u përgjegjë tyke refuzue kategorikisht, si me mënyrë kategorike në raste të tjera na ka pasë përgjegjë.

Dhe provë se e njofti të rregullshëm udhtimin dhe dorzimin tonë Episkopal është se dy javë plot pasi muer lajmin tonë për të kryemin e dorzimit tonë, si u kthyem ne prej Savine, dy javë rresht heshti të interesuemit me mënyra të ndryshme, atëhere vetëm na pru përgjigjet dhe na ndaloi veprimet tona administrative të zavendësisë së Mitropolitit, që na kishte njoftë pak ditë para dorzimit tonë Episkopal.

Vërejtje:

Sa për pikpamjen Patriarkale të Kostandinopojës Emzot Ierotheu dhe Kristofori janë të akuzuem për tri vepra antikanonike që përmblihen në f. 23 [53-55] të këti artikulli. Të sipërpërmendunit nuk u durzuen vetë, por dorzuen tjetër Episkop dhe sidomos Fan Nolin, dhe është një çeshtëje që shtie në dyshim heshtëja e Patriarhisë për këto punë.

Dhe sa për pikpamjen e statutit Kishtar të kishës sonë dhe pikpamjen e cilsisë dhe të misionit kombëtar të kishës autoqefale janë të akuzuem pse: a) nuk morën pjesë në Këshillin e Naltë Kishtar në asnjë mbledhje të saj sadoqë u thirrën dhe pas statutit kishtar të kishës autoqefale janë antarë të Këshillit N. K. (dhe pretendimi që mund të bajnë se nuk mund të merrnin pjesë mbasi kryetari ishte një Priift nuk ka randësi se dy Episkopët e përmendun e kishin pranue statutin e kishës autoqefale tyke e ditë mënyrën e formimit të Këshillit N. K. dhe kështu u emnue në dy dioqezat e tyre gjithsecili. Kur nuk do të merrnin pjesë në atë këshill dhe kur nuk kishin me e njoftë atë këshill pse pranuen emnimin e tyre të bamun prej atij këshilli dhe pse u betuen para At Vasil Markos?)

Mosmarrja pjesë rrëfen mosrespektim të ati autoriteti të naltë i cili u emnue prej kongresit K. të Beratit dhe përfaqson dhe sundon kishën autoqefale rregullisht tash pesë

vjet dhe zyrtarisht. Vetvetiu kuptohet se ky fakt i sipërpërmendun i dy Episkopëvet rrëfen se këta që nuk respektojnë dhe nuk bashkëpunojnë zyrtarisht me këtë autoritet nuk njofin dhe nuk respektojnë autoqefalinë, që reprezenton ai autoritet, as statutin as vendimet e kongresit K. të Beratit, as atë kongres, sa do që me fjalë mund të thonë të kundërtën por fakti asht fakt.

b) Se, Imz. Ierotheu dhe Kristofori tash katër vjet që gjinden në Shqipni nuk u interesuen me asnji mënyrë për plotsimin e Sinodhit Episkopal që ishte një detyrë kryesore e tyre sipas statudit dhe vendimevet të kongresit K. të Beratit. Dhe tash dy vjet që ka kalue koha e caktueme për formimin e Sinodhit, të sipërpërmendunit nuk banë asnji deklaratë dhe asnji apel në Këshillin e Naltë Kishtar as në komunitetet Orthodhokse të Shqipnisë për me provokue formimin e Sinodhit Episkopal, të cilin Episkopët e përmendun kishin me e formue tyke dorzue vetëm një Episkop që mungonte ose dy, në asht se Imz. Fan Noli nuk kishte me u njoftë ma për Mitropolit të Durrsit. Dhe kandidatë nuk mungojshin për Episkopatën vakant. Kjo vepër e tyre shkel nyjen 2, 3 e 9 të statudit K. të Beratit edhe rrezikon e çnderon qenien e Kishës autoqefale. Por dhe nyjen 5 të statudit e shkel.

c) Se, veprimet e tyre që përmblihen në 27 çeshtjet e këtij artikulli janë sheshit kundra parimit të Autoqefalisë dhe shkelin statutin e saj sheshit.

Por as kryesija e kishës autoqefale, as Këshilli N. K. asndonji organ tjetër, si dhe asnji autoritet tjetër shqiptar nuk protestuen, as nuk vepruen, as nuk morën asnji masë kundra veprimevet tepër me randësi që përmenden ma sipër në këtë verejtje dhe në artikullat e sipërme, për dy Episkopët e sipërpërmendun, as për meshtimin e tyre që bajnë si në kohë të Turqisë kur nuk kishte kishë Shqiptare.

Shënim: Ne vetëm u dorzuem Episkop në Savinë. Por për shkaqet dhe arsyenat e sipërpërtregueme, si edhe për qëndrimin tonë tyke iu bindë kryesisë së Këshillit të Naltë Kishtar edhe pasandaj dhe tyke e mbrojtë me gjith mjetet tona kishën autoqefale të Shqipnisë, deri sot kujtojmë se nuk kemi plotsue dhe kemi ekzekutue si thamë ma sipër vendimet e kongresit të Beratit dhe statutin kishtar për sa i përkiste edhe personit tonë, kurse Këshilli i Naltë Kishtar dhe dy Episkopët e sipërpërmendun nuk vepruen drejtësisht si merret vesht ma sipër edhe në çeshtjen e dorzimit dhe emnimit tonë Episkopal, që më 1922 deri më 2-V-1925 kur ne morëm gradën Episkopale prej dy Episkopëvet Orthodhoksë të Kishës së Shejtë Sllave, Ruse, e cila qe e para dhe e vetmja që bekoj dhe dorzoi Priftën Nacionalistë Shqiptarë n’Amerikë dhe Episkopë të tillë në Mbretninë fqije Serbo-Kroato-Slllovene, me qëllim përkrahjeje të Kishës Kombëtare Shqiptare Orthodhokse.

Vazhdim i artik. të sipërm

25) Këshilli i Naltë Kishtar ose ma mirë me thanë vetëm kryetari i tij emnoi për antar klerik dhe zavendës Mitropolit të përgjithshëm të dioqezës Durrës, Tiranë, Elbasan, Kavajë, Shpat dhe Pogradec, komisionarin Z. Vasil Rusin një civil, laik kundra nyjës së 4 të statudit kishtar tyke e shkelë kështu edhe një herë statutin dhe tyke i dhanë Këshillit të Naltë Kishtar dy antarë laikë në vend të një kundra statudit dhe tyke ba kryetar të gjykatoreve shpirtnore civilat, kundra rregullavet kishtarë orthodhokse.

Me anë të emnimit të të sipërpërmendunit asht tyke u shkelë tash shtatë muej edhe statuti i Republikës Shqiptare i cili urdhënon sheshit se deputetët nuk mundën me pasë

detyrë aktive fetare, dhe Z. Vasil Rusi asht tash shtatë muej deputet. Por pika e cila tërhek verejtjen, për çudi asht se kryetari i Këshillit të Naltë Kishtar At Vasil Mrkoja emnoi Zotni Vasil Rusin Zv. Mitropolit, kur se nuk kishin kalue dy javë edhe civili i sipërpërmendun Z. Vasil Rusi kishte kundërshtue kategorikisht një urdhën dhe emnim po të atij kryetari, At Vasil Markos, tyke rrëfye mosbindje antidisiplinore, se tyke qenë Zavendës Mitr. lokal i Durrsit i sipërpërmenduni z. V. Rusi refuzoi me dorzue arshivën e Mitropolisë, ati i cili ishte emnue për Zv. Mitropolit i përgjith. i dioqezës së Durrsit nga ana e kryetarit të Këshillit të N. K At Vasil Markos.

Dëshirojmë të jemi të besuem se personin e z. Vasil Rusit e çmojmë dhe e nderojmë plotsisht dhe me këto fjalë të sipërme nuk kemi qëllim tjetër, por vetëm me spjegue gjendjen e vërtetë të kishës sonë për me i ndihmue përmirsimit të saj. Se po nuk u muer vesht mirë sëmundja nuk interesohet kush për mjekun dhe farmacinë.

Mundet të thotë kushi se Z. Vasil Rusi nuk i dorzoi vitin e kaluem Mitropolinë të emnuemit prej kryesisë së kishës mbasi pleqsia kishtare ose populli i Durrsit nuk dëshironin pse i emnuemi nuk i pëlqente ose pse ishte i keq, por kjo nuk ka të bajë me bindjen jerarhike pse Zavendësia e Mitropolitit asht si dihet vetëm e drejtë dhe detyrë e komunitetit. Duhesh pra t'i bindesh emnimit dhe urdhënit të kryesisë së kishës; dhe populli ose pleqsia mund të bante sa dëshironte si kundër edhe bani.

26) Këshilli i Naltë Kishtar i kishës sonë autoqefale kombëtare që prej themelimit të saj më 1922, kur edhe si këshill u formue, e deri më sot gati në mbarim të vitit 1926, vetëm tri herë asht mbledhë tyke ba kështu një vepër shkelje të rregullores dhe të statutit kishtar, i cili urdhënon që këshilli në fjalë të mblidhet doemos dy herë në vit dhe jashtzakonisht sa herë të ketë ndonji punë me randësi të veçantë, si të cilat shum herë ka pasë kisha, por nuk asht mbledhë as në kohnat e caktueme, sadoqë nuk ka pasë asnjë pengim edhe mjetet materiale qeveria edhe populli nuk ja ka refuzue. Por edhe mbledhjen e tretë, të fundit që bani Këshilli i Naltë Kishtar, e provokuem ne. Kështu pra tash gati pesë vjet vetëm tri herë asht mbledhë Këshilli i N.K, për dam shum të madh të interesave të nalta të Orthodhoksisë.

27) Këshilli i Naltë Kishtar shkeli përsëri statutin e kishës pse pas nyjës 11 të tij të posaçme dhe pas vendimevet të kongresit kishtar të Beratit nuk mblodhi Asamblenë kishtare më 1924, as pasandaj, për votimin e statutit definitiv dhe për zgjedhjen e Mitropolitit, që kishte me qenë kryetar i Sinodhit Episkopal Shqiptar, sipas statutit dhe vendimevet të Kong. Kishtar.

Kjo punë e bani shtypin e huej të shkruiej se nuk ekziston Këshilli i Naltë Kishtar, as kishë autoqefale por vetëm një njeri që i thotë vetes kryetar i kësaj kishe në Shqipni.

Dhe kur filloi antishqiptarizma me folë kështu, ne vrapuem të parët edhe mbrojtëm publikisht kryesinë e kishës, Këshillin e Naltë dhe autoqefalinë, sadoqë këto ishin tyke na u sjellë aq keq kundra nesh, dhe prandaj atëhere, kur ishte një kohë tepër kritike dhe e rrezikshme, fletorja me të vërtetë kombëtare dhe e arsyeshme "KOHA" pati mirsinë me shkruie lavdërime për ne tyke na kurajue në detyrën e shejtë, më 1925.

Kështu pra, me dy fjalë mund të thohet se i gjithë aktiviteti, zotsia dhe puna e kryesisë së kishës dhe të Këshillit të Naltë Kishtar, si dhe e të dy Episkopëvet që ndodhen tash afër katër vjet në Shqipni, ka qenë që prej vitit 1922 deri sot, në korrik të vitit 1926: I) Dorzimi i Fan Nolit për Episkop, kundra principevet dhe kanonevet themeltarë panorthodhokse për një njeri i cili meshtoi dhe dorzoi priftëna si Episkop pa qenë Episkop.

II) Për me na luftue me çdo mënyrë dhe mjet ne.

III) Për me shkelë statutin e për me pru gjendjen kishtare që përshkruhet ma sipër.

IV) Për me shpenzue shuma tepër të mëdha prej napolonash ari pa asnjë dobi.

Dhe V) për me përdorë me mënyra të ndryshme forcën qeveritare për punët e sipërnumërueme.

Dhe të gjitha këto u banë me ndihmën e interesavet të nalta nacionale kishtare!, deri sa mbërriti puna, që të thohet se kleri i mbrendshëm i Shqipnisë nuk asht gja dhe për me shpëtue dhe për me e përmbajtë kishën e Shqipnisë duhet të biem Episkopë prej Greqije ku paska të tillë prej origjine Shqiptare. Por ne nuk jemi i këti mendimi të fundit. Prandaj kemi botue posaçërisht gjith sa duhen për me u organizue kisha jonë seriozisht dhe me mënyrë të vërtetë fetare orthodhokse por të pastër Shqiptare.

Shënim: Tyke vue kët librezën në shtyp lajmërohemi sigurisht se të përnderçmit Priftnat nacionalistë At Vasil Markoja dhe Arqimandrit Agathangjel Çamçja këto dy javë të fundit kanë fillue me meshtue të gjithë meshën e shenjtë në gjuhën amtare Shqipe në Korçë, ashtu si kanë pasë meshtue prej fillimit të ardhjes së tyne këtu deri në vitin e kaluem.

BETIMI I BAMUN NË MANASTIRIN E HIRSHËM TË SAVINËS

Në vendin e huej, Dalmacinë e Jugosllavisë, lutemi për Kishën dhe shtetin Shqiptar dhe në gjuhën shqipe.

Betimi që bamë në minutin e dorzimit tonë Episkopal në Kishë, para Episkopëve dhe të gjithë popullit. Pasi kënduem dëshminë kanonike të besimit thamë:

“Kam me qenë ruejtës besnik i të gjitha dogmavet, kanonevet dhe rregullavet të shenjta të Kishës Orthodhokse që përmbliidhen në Shkrimet e Shenjta, në gojdhonat e Hyjnueshme dhe në vendimet e shtatë sinodhevet Ekumenike, si dhe në mësimet e Etënve të Shenjtë të Kishës së Shenjtë Orthodhokse, dhe siguroj me ndërgjegjen Time fetare se kam me qenë gjith jetën Time besnik i Kishës Autoqefale Orthodhokse kombëtare të Shqipnisë të kryesueme sot prej Këshillit të Naltë të saj; dhe nuk kam me iu përulë asnji fuqie që mund të kërcënohet ndonjiherë kundra detyrave të mija të Shenjta Episkopale, si pjestar i Kishës së sipërmërmendun.

I Lutemi Përendisë për Këshillin e Naltë Kishtar të Shqipnisë, për Republikën Shqiptare, si dhe për paqen e gjithë botës dhe bashkimin e të gjithëve.

Lavdi qoftë mbi të madhin Perëndi”.

Shënim: Në meshtimet e bame për dorzimin tonë, pjesën liturgjike tonën ne e thamë atje në gjuhën Amtare Shqipe, para komisionit të posaçëm shqiptar që pat ardhë për nderim.

VENDIM I ELBASANIT PAS DORZIMIT EPISKOPAL

Sot më 19 Qershor 1925, u mbledh Dhimogjeronjia e Elbasanit dhe mbasi bisedoi mbi bazë të vendimevet të saj, dhanun ma parë, si dhe tue marrun para sysh dëshirën e gjithë popullit të qytetit e të qarkut bashkë me atë të krahinës së Shpatit, vendosi me zana të përbashkëta, që të kërkojë nga kryesia e Kishës, njohjen e Hirsisë së Tij Episkop Vissarion Xhuvanit si Episkop dhe emnimin e Tij për Mitropolit t'Episkopatës sonë. Dhe për këtë qëllim vendosi që n'emnin e kësaj Dhimogjeronjije, t'i drejtohet Kryesisë së Kishës kjo lutje telegrafike:

“Të shtyemun nga dëshira e gjithë popullit Orthodhoks të qytetit e të qarkut së bashku me krahinën e Shpatit, i paraqisim rishtazi Qendrës sonë Shpirtnore lutjen për me pranue në gji të Kishës së Shenjtë Episkopin Vissarion Xhuvani, tue e emnue Mitropolit t'Episkopatës së Durrsit”.

Elbasan më 19 Qershuer 1925.

Për Kryetarin

V. Haxhijakovi (d.v)

Antarë,

Th. Floqi (d.v)

Dr. Petraq Popa (d.v)

V. Buza (d.v)

V. Llapushi (d.v)

Tokli Bebi (d.v)

Nikoll Dhimitri (d.v)

Filip Shuteriqi (d.v.)

PËR KUJTIM BOTOJMË DISA NGA TELEGRAMET E PËRGËZIMIT

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Elbasani Nr. 2258

Bashkija e Elbasanit ju uron për titullin e Shenjtë që muerët dhe me sigurim të madh beson se veprat përkatëse t'asaj shkalle do t'i kryeni si e kërkon nderi i Kishës Autoqefale dhe interesi kombëtar.

Kryetari Bashkisë

Kasem Sejдини

Episkopit tonë Imzot Vissarit

Për Tiranë prej Elbasani Nr. 2234.

Fjalë 50. Data 9-V ora 9.

Dhimogjerondija me gaz e kënaqsi të madhe muer lajmin gazmor të dorzimit tuaj. Ju përgëzojmë nga thelbi i zemrës e urojmë punë të mbarë e me fryt për të mirën e Krishtenimit e të shtetit. E gëzofshi kunorën e artë.

Sekretari i Dhimogjerondisë

Haxhijakovi

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Durrsi Nr. 6220. Fjalë 28. Data 10, ora 11.30

Mbi lajmin gazmor të kunorëzimit të Shejtë Episkop pranoni ju lutem, urimet e mija të thjeshta Vllaznore.

Papa Anastasi

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Elbasani Nr. 2263

Nga thelbi i zemrës urojmë kunorën e shejtë.

At Grigori

Peshkop Vissar Xhuvanit

Për Tiranë prej Elbasani 18.V.1925 Nr. 2267

Urime të përzemërta.

Vërlaci.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Pogradeci Nr. 758

Urojmë për dorzimin Episkopal, lyp bekimet e Hirësisë.

Zavendësi i Mitropolitit

Hieromonah Grigori.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Pogradeci Nr. 763

Për dorzimin Episkop urojmë tyke lypur bekimet e Hirësisë suaj.

Epitropët e Kishës Gaqi Petra, Gjoka Kristo

Emzot Episkop Vissar Xhuvanit
Për Tiranë prej Elbasani, 24.V.1925
Lutemi pranini urimet tona ma të thjeshta.
At Hristostomi.

Emzot Episkop Vissar Xhuvanit
Për Tiranë prej Kavaje, 11.VI.1925
Ju paraqesim urimet e përzemërta, e gëzofshi kunorën e artë të shenjtë.
I Hirësisë Suej
At Jorgji.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani, Nr. 2264
Përgëzimet e përzemërta detyrës së Shenjtë.
At Naum Peçini.

Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2220
Ju urojmë nga mezi i shpirtit për dorzimin, punë të mbarë për të mirën e Kishës.
Gjermanos.

Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2257
Lutemi pranoni urimet tona ma të sinqerta për dorzimin e Hirësisë suej Episkop.
Lusim sukses në detyrë për përmirsimin e Kishave Autoqefale.
At Simon Athanasi

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2258
Lutemi pranoni urimet tona ma të sinqerta për dorzimin e Hirësisë suej Episkop.
Lusim sukses në detyrë për përmirsimin e Kishës Autoqefale.
At Jovan Toda

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani, Nr. 2240
Ju uroj kunorën e artë me shërbime të shkëlqyeme për Kishën e atdheut.
Lef Nosi.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2244
Lutemi pranoni urimet e mija nga zemra për dorzimin tuej si mitropolit i ri për shërbimin kombëtar të Kishës sonë Autoqefale.
Aleksandër Xhuvani

- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Për Tiranë prej Elbasani Nr. 9241, Fjalë 18. Data 9-V, ora 10.
Pëlqeni ju lutem urimet e sinqerta për Hirotoninë tuej.
Parashqevi.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2238
Kunorën e shejtë urojmë shpirtnisht, jemi gëzue tepër, trashëgim, jetë ju dhantë
Perëndija.
Marthe Papajani
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Praj Elbasani Nr. 2227
Urime të përzemërta me rastin e dorzimit si Episkop.
Nikoll Andoni
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2230
E gëzofshi kunorën e artë, urimet e përzemërta.
Fot Papajani
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2255
E gëzofshi kunorën e artë, urimet e përzemërta.
Dhimitër Papatistja
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2340
E gëzofshi kunorën e artë, urimet e përzemërta.
Mihal Xhufka
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Për Tiranë prej Pogradeci Nr. 752 Fjalë 18 data 11-925 ora 12.
Përunjësisht gëzohemi dhe ngazëllohemi për dorzimin Episkopal tuejin, presim
bekime, Zoti ju nxjerrtë faqebardhë.
Dr. Lipi
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2855
Urime dhe përgëzime të sinqerta për dorzimin tuej Peshkop, që me dorzimin e
Hirsisë suej të sigurohen themelet e Autoqefalisë Kishtare.
Petër Ndrija.

Emzot Episkop V. Xhuvanit
Për Tiranë prej Durrsi 23-V-25
T'urojmë kunorën e naltë të artën tande.
Zarik Dumi

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2973
Përgëzimet e përzemërta detyrës së shenjtë.
Dhama Prokop, Psalti

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2270
Përgëzime të sinqerta me urime të përzemërta për sukses të detyrës së shenjtë.
Buza.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2271
Përgëzime të sinqerta me urime të përzemërta për sukses të detyrës së shenjtë.
V. Llapushi.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Për Tiranë prej Pogradeci Nr. 765. Fjalë 26. Data 15, ora 12.
Me informimin për kunorëzimin e kunorës së shejtë me jetë e me ymër e me
kismet para Krishtit; presim bekimet.
Pandi Kërzhalli

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Pogradeci Nr. 766
Me informimin për kunorëzimin e kunorës së shejtë me jetë e me ymër e kismet
para Krishtit; presim bekime.
Llambi Kërzhalli

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 1890
Lutemi pranoni urimet tona të sinqerta për dorëzimin Episkopal.
Për djelmëninë Kristjane
Sif Papatistja

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Për Tiranë prej Elbasani Nr. 2280. Fjalë 19. Data 11. Ora 8.
Lutemi pranoni urime të sinqerta për fronëzimin tuaj si Episkop, sukses në
dioqezë.
Filip Leci

- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2226. Fjalë 17. Data 8. Ora 19.10
E gëzofshi kunorën e artë, urime nga mesi i shpirtit.
Simon Shuteriqi
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2380
Urime të përzemërta e ma të sinqerta për dorzimin Episkop.
Koçi Qemeri.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2228.
Me rastin e dorzimit Episkop pranoni urimet ma të përzemërta.
Jan Deliana.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2236.
Ju përgëzoj nga zemra për Hirotoninë Episkop.
Spiro Ndrija.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2230.
Me gëzim urojmë Hirotoninë.
Jorgji Pavlit.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2270
Me gëzim ju uroj nga zemra kunorën e Shejtë, e trashëgofshi me jetë.
Dhimitër Popa.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2279
Gjith shije me gëzim urojmë kunorën e Shejtë.
Stasi.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2276.
Kunorën e artë e gëzofshi për jetë me sukses e lehtësi në përmbushjen e porosivet
të shejtit mësues. U puth dorën.
Kol Koci.
- H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit
Prej Elbasani Nr. 2231.
Me gëzim urojmë Hirotoninë.
Llazri Bibaja.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Elbasani Nr. 2274

Ju përgëzojmë nxehtësisht për Hirotoninë e kunorën e Shejtë që kini vue.

Stas Papa Risto

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Elbasani Nr. 2280

Urime të sinqerta për Hirotoninë e meritueshme, me shpresë se Hirësija juej do të ketë fatin të sigurojë themelet e Kishës sonë Autoqefale. Nderim.

M. Popa.

H. T. Emzot Peshkop V. Xhuvanit

Prej Elbasani Nr. 2235.

Lajmëroni ditën dhe orën e nisjes t'Episkop Vissarit për këtu si dhe mjetet që do të udhtojë për me përgatitë pritjen e meritueshme.

Haxhijakovi.

SHTYPI I ELBASANIT PËR MITROPOLINË E DURRSIT

(marrë nga Fletorja “Elbasani” N. 41/4. D. 19 Qershor 1925)

Populli Orthodoxoks i Elbasanit kërkon Emnimin e
H. Tij Episkop V. Xhuvanit për Mitropolinë e Durrsit

Informohemi se sot Dhimogjerondija e komunitetit Orthodoxoks t’Elbasanit, në bazë të një vendimit, dhanun simbas dëshirës së gjithë popullit Orthodoxoks të qytetit e të qarkut t’Elbasanit e të krahinës së Shpatit, i ka drejtue një lutje telegrafike Kryesisë së Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë, me anën e së cilës i lutet që të pranojë në gji të saj Hirsinë e Tij Episkop Vissarion Xhuvanin me e emnue Mitropolit të Episkopatës së Durrësit.

Përgëzojmë Dhimogjerondinë e Elbasanit për këtë vendim e propozim tepër të meritueshëm për Hirsinë e Tij Episkop Vissarion Xhuvanin dhe aq ma tepër i interesuem për mbarëvajtjen e sigurimin e Autoqefalisë së Kishës Orthodoxokse Kombëtare, dhe lusim pranimin e realizimin e këtij propozimi nga ana e Kryekishës.

Shpresojmë që edhe gjithë populli i ndershëm i qyteteve të tjera t’Episkopatës së Durrësit, i cili ka ushqye gjithë herët një simpathi për Hirsinë e Tij Episkop Vissarionin, dhe e ka përkrahë në çdo rast e me çdo mjet dhe veçanërisht populli fisnik i Durrësit-pa marrë para sysh mosmarrëveshjen që pati ranë me Hirsinë e Tij, e cila besojmë se nashti do të jetë çdukë, nuk do t’ja kursejë edhe këtë rast ndihmën morale, tue e preferue ma fort si bashkatdhetar e bir të kësaj Episkopate.

Episkopata e Durrësit, e cila ka pasë fatkeqsinë po thuej se, që prej shumë kohësh të mbetet pa një prijës feje me gjithë kuptimin e fjalës, me Hirsinë e Tij Mitropolit, do të hyjë në rregullimin e përparimin e duhun, në çdo pikpamje.

Hirsija e Tij, si Mitropolit i Episkopatës së Durrësit, do të ketë një shesh punimi mjaft të gjanë, për me i vjeftë popullit, Shtetit e Kishës: Dhe si i tillë do të dijë ta kryejë misionin e naltë që ngarkohet, për të mbarën e të mirën e popullit, me paqe e dashuni, se vetëm kështu mund të dali faqebardhë dhe të sigurojë t’ardhmen e vet.

Kryesija e Kishës, tue marrë para sysh cilsinat e Hirsisë së Tij, dhe tue çmue shërbimet që i ka bamun çeshtjes Kishtare, që për këto meriton të quhet me të drejtë një nga shtyllat e Kishës Autoqefale Kombëtare, për të cilat nuk asht shpërblye veç se me durimin që ma në fund e kaloi kulmin të shpresojmë se nuk do të vonojë ma për me e pranue në gji të saj, tue e vendosë Episkop të Episkopatës së Durrësit.

Kjo shpresë na shtohet aq ma tepër, kur çeshtja ka të bajë ma fort me një Kryetar Kishë, si Hirsija e Tij At Vasil Marko.

Falenderim

Në këtë rast i dërgojmë falenderimet tona të përzemërta dhe mirënjohjen tonë gjithë shkaktarëvet edhe ndihmëtarëvet fisnikë të dorëzimit tonë Episkopal, që u ba me qëllim përkrahjeje të sinqertë për kishën nacionale autoqefale Orthodoxokse të Shqipnisë.

FORMIMI I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE NGA PIKËPAMJA JURIDIKE DHE KANONIKE

NJI FUSHATË E PADREJTË DHE PA VEND KUNDREJT SHQIPNISË

Duke marrë pretekst prej formimit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, shtypi helenik, i inspiruem prej qarqeve t'interesueme, asht duke vazhdue fushatën e tij aq çpifëse, sa edhe të padrejtë kundrejt Shqipnisë dhe Kishës Ortodokse Shqiptare.

Ky qëndrim i shtypit dhe i disa qarqeve helenike t'interesuem asht për t'u vajtuem, për arësye se rrëfen vazhdimin te fqinjët tanë të një mendësie të pashërueshme, e cila s'don të dijë ligjet e paevitueshme t'evolucionit njerzor.

Sa për çpifjet dhe insinuatat fyese të shtypit helenik nuk kujtojmë të meritojnë përgjigje nga ana e jonë; jemi në mendje që një përgjigje e tillë s'do t'ish e dënshme për një fletore që respekton veten. Por nga ana tjetër, të frymzuem prej dëshirës t'i shërbejmë së vërtetës dhe, njikohësisht, të ndriçojmë edhe opinionin publik, kujtojmë që do t'ish një mungesë detyre patriotike të mos përpiqemi të rrëzojmë argumentat tendencioze dhe sofistike të përdoruna prej qarqeve Patriarko-helenike, disa nga të cilët gjetën vend edhe në disa organe me randësi t'opinionit të përbotshëm.

PËRBALLË TEKSTESH KUNDREJT NJI ARSYETIMI TË RREMË

Këtij arsyetimi të rremë do t'përpiqemi t'i bajmë ballë me argumenta të shëndosha dhe të parrëzueshme si nga pikëpamja juridike ashtu dhe nga ajo kanonikja, marrun nga veprat e auktorve grekë ma të çquem. Gjuha e teksteve asht aq elokuede prej vedit, sa që do t'na mjaftojë me përshkruem disa pjesë për t'u hapun sytë atyne, të cilët për qëllime të njoftuna refuzojnë të shofin e të pranojnë të vërtetën. Por, nuk u kemi mëni: asht një gja tepër e vështirë dhe tepër e bezdishme për njerinë të gjindet ball për ball me të vërtetën, sidomos kur asht i ushqyem prej vjetësh me një ideologji të vjetrueme e të përbame krejt prej paragjykimesh të rranjosuna. Por, u lutemi miqve tanë të Jugut të mos na e marrin për keq: fati nuk asht i joni, por i bashkatdhetarit të tyne, të famshmit shkrimtar Korais, i cili, në kohën kur plasi kryengritja greke më 1821, duke iu adresue popullit helenik, ja ç' shkruente: "Kleri i Greqisë së lirë s'duhet të njofi si Kryetar Eklesiastik Patrikun e Stambollit deri sa Kryeqyteti i Turqisë të vazhdojë të jetë i infektuem prej tiranit të paligjshëm. Kisha jonë duhet të qeveriset prej një Sinodi të zgjedhun lirisht prej klerikalëve e prej laikëve, siç i-qeveriste Kisha e vjetër dhe siç qeveriset edhe Kisha e bashkëfetarëve tanë Rusë. Do t'ish një gja jo e denjshme për Klerin e Helenve të lirë e të pamvarun t'u shtrohen urdhënavet të një Patriku të zgjedhun prej Tiranit dhe të detyruem t'i bindet një Tirani".

Kjo tezë u përkrah ma vonë edhe prej Presidentit të parë të Greqisë Kapodhistrias, duke u zhvilluem ma pastaj në një mënyrë shkencore edhe prej shum grekëve të çquem në shkencë e në politikë, si Saripolos-ati, Farmaqidhis, Trikupis, Qiriakos etj.

KONFLIKTI MIDIS GREQISË DHE PATRIARKUT; MENDIMI I PROF. SARIPOLOS

Duke aplikue këtë princip, Kleri i Greqisë për sa kohë vazhdoi lufta kundra Turqisë e pat prëmë krejt çdo marrëdhanie me Patrikun e Stambollit. Nga ana tjetër, Statuti i votuem prej asaj Asambleje helenike në Nauplië konsakronte në artikujt 6-12 Autoqefalinë e Kishës helenike.

Tani, po të marrim në dorë tekstin e së Drejtës Kostitucionale të N.Saripolos, Profesor në Fakultetin e Drejtësisë në Athinë dhe që formon autoritet në çeshtjet juridike, do t'gjejmë përveç tjerave, në kaptinën 8, faqe 316, vëllimi i 3 i veprës së tij magjistrale, pasazhin që pason, të cilin po e përshkruajmë tekstualisht: “Formimi i një Kise Autoqefale Greke të pamvarun nga pikëpamja administrative prej Patrikut të Stambollit, formon jo vetëm një të drejtë absolute të popullit helenik sypran, por asht dhe një akt shumë kanonik, konform me kanonet, sidomos me kanonin 17 D të Sinodit Ekumenik, i cili thotë: “I tis ek vasilikis eksoussias ekenisthi polis i afthis kenisthii, tis politikis ke dhimosiis tipis ke ton eklesiastikon parikion i taksis akolouthito”. Kisha Ortodokse Orientale, me gjith që nga pikëpamja dogmatike asht një dhe e bashkueme, nuk ka një kryetar nga pikëpamja administrative si Kisha Katolike, por përbahet prej Kishave të ndryshme Autoqefale, të pamvaruna njana prej tjetrës nga pikëpamja administrative”.

Duke vazhdue zhvillimet e tezës së tij Z.Saripolos shton: “Ma në fund, më 1850, Kisha e Madhe e Stambollit me dorëzimin e Tomit Sinodik të 29 Qershorit 1850 e njofti Kishën Autoqefale Greke si *kanonikisht të pamvarun*. Por, Kisha e Greqisë (të mos harrojmë që flet gjithmonë Saripolos) ishte *dëjure* kanonikisht e pamvarun para dorëzimit të Tomit të 1850, sepse njoftja e pamvarësisë së saj nga ana e Patrikut, siç thamë, nuk ishte e nevojshme nga pikëpamja juridike dhe kanonike”.

Shtojmë se ky argument ka pasë qenë zhvillue edhe ma parë me shumë forcë dhe dijani prej Farmaqidhit, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Sinodit Grek, njeriu ma i aftë dhe ma liberal i Klerit Grek. Ky në kritikën e ashpër që i ban Tomit të 1850 midis tjerave thotë: “Kisha Autoqefale Greke asht formue *shumë kanonikisht* dhe për këtë arsye njoftja e saj kanonike nuk u-kërkue”. Prej këtyne fjalëve rrjedh se njoftja e pastajme nga ana e Patrikut nuk i shtoi kurrëgjia legalitetit dhe kanonicitetit *dëjure* të fituem të Kishës Autoqefale helenike. Ky princip aq i qartë gjindet në bazë të formimit të gjithë Kishave Ortodokse Autoqefale që ekzistojnë.

NGREHJA [NGRITJA] KANONIKE DHE LIGJORE E KISHËS ORTODOKSE TË SHQIPNISË

Kisha Autoqefale Ortodokse e Shqipnisë, duke aplikue edhe ajo këtë princip, s'bani veçse të përdorë një të drejtë të padiskutueshme nga pikëpamja kanoniko-legale, e drejtë që forcohet prej aq precedentesh.

Gazeta e Re, viti I, Nr. 191, e enjte, 20 qershor 1929

Kishës Ortodokse dhe Shtetit të Shqipnisë

REFERATE MBI KRIZËN POLITIKO-FETARE TË KOMUNITETIT ORTODOKS TË SHQIPNISË KËTO DITË.

Pjesa e I-rë

Me përjashtim të Patriarkisë Greke, prej gjithë Kishave të botës Kisha Autoqefale e Shqipnisë asht e njoftun dhe asht bekue si provohet në aktet e secilës prej tyne që janë botue edhe në Shtypin Shqiptar, por duhet të njifet edhe nga Kishat Greke.

Dhe që të njifet Kisha Autoqefale e Shqipnisë edhe nga Kishat Greke, si Patriarkia e Istambullit dhe Kisha Autoqefale e Greqisë dhe që të marri çfaqjen e bekimeve formale të tyne, asht një punë e mirë, e pëlqyeshme shumë dhe mjaft e dëshirueshme aqë sa edhe Ne në dorëheqjen tonë nga Kryesia e Kishës këtë punë e kemi theksue si shkak të parë nga ato ma me randësi si e deklaruem edhe botnisht. Por që të shpërblehet kjo njoftje Kishtare Greke me tri punë të një randësie të papërshkrueshme dhe tepër të damshme, si janë: interesi i naltë i Shtetit, dinjiteti i Regjimit dhe i Kombit dhe komprometimi i ndërgjegjes dhe i interesave të gjithë popullit Ortodoks të Shqipnisë, asht e palejueshme dhe asnjë arsye, nevojë dhe shtrëngatë nuk e justifikon një veprim të tillë.

Mirëpo, jemi informue prej burimesh të sigurta se Shteti dhe Kisha jonë kanë pranue që dy vendet vakante të Sinodit të Shenjtë nga të katër vendet që e përbajnë këtë, të plotësohen me dy episkopë, të cilët do të marrin gradën Episkopale jashtë Shqipnisë dhe prej Kishave Greke si nga Patriarkia e Istambullit etj.

N'asht se kjo punë ka me u krye në këtë mënyrë, përfundimi ose pema e kësaj pune ka me qenë me doemos:

1) Shlymja ose çdukja e pahijshme dhe e padrejtë sado në mënyrë heshtjeje, e gjith atyne punëve Historike, që u banë në vitin 1929 zyrtarisht dhe panegjericisht për zgjidhjen e çeshtjes Ortodokse Kishtare Shqiptare dhe për të cilat ngjarje dhe punë themelore politiko-kishtare u votuen dhe u dekretuen edhe ligje të posaçme të Shtetit dhe Statute e rregullore të Komunitetit Ortodoks.

2) Njoftja zyrtare nga ana e Shqipnisë si me të vërtetë **antikanonike** sado që u pranue, u dekretue, u reklamue dhe u mbrojt me çdo mënyrë si **kanonike** zgjidhja e çeshtjes Kishtare në fjalë, si brenda dhe jashtë Shqipnisë, si edhe n'atë vetë Këshillin e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, me rastin e ankimit t'Episkop Jerotheut, ku Shqipnia duel për këtë çeshtje fituese atëhere.

3) Shteti dhe Komuniteti Ortodoks duket sikur u tall ose i bani si një punë teatrale gjithë sa u banë në vitin 1929, si formimi i Sinodit të Shenjtë të parë Shqiptar, ashtu edhe Statuti dhe rregullorja e Kishës etj., vendime këto të pashlyeshme Shtetnore dhe Sinodike.

4) a) Influenca e huej e eleminimit do të ristabilizohet dhe do të përtërihet me gjithë fitoren e vet në shpirtin e pakicës ose të shumicës së popullit, dhe një reaksion psikologjik ndjenjash dhe mendimesh të vjetra asht frika se ka me u zhvillue me një herë në shpirtin e të gjithë elementit Ortodoks.

b) Ka me u zhvillue me një herë në shpirtin e të gjith elementit Ortodoks sidomos n'atë të pjesës intelektuale dhe patriotike dhe ka me u pa në rastin e parë edhe nga elementet e tjera të Shqipnisë, jo vetëm n'atë Ortodoks si edhe ndër t'huejt, një përbuzje ironike kundrejt Shtetit dhe Kishës Shqiptare dhe veçanërisht kundrejt faktorëve zyrtarë dhe ma kryesorë të naltë që e banë dhe e pranuen Sinodin e parë Shqiptar ose e kryen zgjidhjen e çeshtjes Kishtare në vitin 1929 në mënyrën e ditun thjesht Nacionale Shqiptare; dhe nga këto, faktorët ma kryesorë janë: N.M. e Tij Mbreti, Kryeministri i soçëm që ishte dhe atëhere Kryeministër dhe Ministër i P. të Mbrendshme, Z.Koço Kotta, Ministri i Atëhershëm i Drejtësisë dhe Kryetari i Parlamentit të atëhershëm Z.Pandeli Evangjeli, gjith anëtarët e Kongresit pan-Ortodoks Shqiptar të Korçës të vitit 1929, si edhe e gjithë paria lokale e popullit Ortodoks të gjithë Shqipnisë, nga i cili asnji nuk protestoi dhe n'asnji mënyrë dhe i cili popull për tash **tetë (8)** vjet rresht me qetësi dhe rregull të plotë dhe me devocion të hijshëm përdori atë mënyrë zgjidhjeje të çeshtjes Kishtare dhe pranoi gjithë shërbimet fetare shpirtnore që u banë prej Jerarkisë, Episkopëve të Sinodit Shqiptar, punë kjo që po vazhdon si u tha deri sot për plot **tetë (8)** vjet.

5) Po të dorëzohen jashtë Shqipnisë kandidatët për plotësimin e vendeve që janë vakante me rastin e dorëheqjes së Kryetarit të Kishës dhe për shkak të vdekjes së të ndjerit Episkopit të Gjinokastrës, Imzot Ambrozit.

a) Do të vërtetohet botnisht se Shteti dhe Regjimi gjinden në një shtrëngatë aq të randë sa që mohojnë gjithë sa patën pohue e deklarue deri tash për zgjidhjen definitive të çeshtjes Kishtare, të bame atëhere zyrtarisht dhe me deklarata e dekretime Mbretnore, dhe që u mbrojtën edhe në shtypin e jashtëm.

b) Do të duket se populli Ortodoks qe i shtypun keq prej Regjimit dhe tash për **tetë (8)** vjet rresht nuk munda me çfaqë dëshirën e vet por i përdhunuem dhe i shtrënguem pranoi vetëm sa për sy e faqe zgjidhjen e bame në vitin 1929 të çeshtjes Kishtare, dhe

tash gjeti rastin dhe mënyrën t'i imponohet Regjimit Shtetnor dhe të bajë atë që dëshiron, dhe të shpëtojnë nga ajo që përdhunisht gjoja e pranoi atëhere, punë të cilën nuk kishte se ç'bante, dhe pa dashë e toleronte.

c) Paskëtaj në çdo rast dhe për çdo punë Kishtare sidomos, gjithsecili do të ketë guxim me intrigue dhe me qëndrue dhe do të shpresojë për me i u imponue Shtetit, dhe ka me e vu këtë në pozitë të ngatërrueshme dhe të mërzitshme ose dhe të rrezikshme, sado që qëndrime të tilla të parisë ose të popullit kanë me qenë edhe me të vërtetë në dam të Kishës ose të Komunitetit relativ.

6) Gjithë Kishat e tjera dhe opinioni publik i jashtëm sado padrejtësisht, por do të binden se në Shqipni influenza Fanariote asht e pafikun dhe e pathyeme, dhe do të konsiderohet elementi Ortodoks i Shqipnisë me të vërtetë me shpirt të vjetër të huej, **mbasi**, dihet mirë nga Historia e re, se as vetë Grekët e Mbretnisë së Greqisë nuk banë asnji sakrificë për njoftjen e Autoqefalisë së Mbretnisë së tyne sado që Autoqefalia Kishtare ishte e domosdoshme për Helenizmin, se Episkopët nga Mbretnia Greke, në rast nevojë, nuk i linte Turqia që të transferoheshin në një vend ose Episkopatë të Perandorisë Otomane; por me gjithë këtë punë që ishte në interes të Patriarkisë së Konstantinopolit, Grekët nuk banë asnji sakrificë për njoftjen e Autoqefalisë së tyne, por, pritën gati 30 vjet deri kur deshi vetë Patriarku dhe e njofti Autoqefalinë e Greqisë pa asnji kondicion dhe koncesion; por Shqipnia e Shqiptarëvet priti vetëm **tetë (8)** vjet prej vitit 1929, që u formue Sinodi i parë Shqiptar ose 16 vjet ç'prej vitit që u proklamue Kisha Autoqefale në Berat, por kjo, Shqipnia, pas **tetë (8)** ose **16 vjet** kthehet prapë dhe ban zyrtarisht një ritiratë kolosale dhe të çuditshme politiko-religjioze (socialo-morale) dhe po ata personalitete që e kanë pasë njoftë deri tash legale dhe në çdo mënyrë si të tillë gjendjen Kishtare Ortodokse të tashme në Shqipni, e karakterizojnë tash këtë ilegale, antikanonike dhe pretendimevet të Fanarit dhe të Athinës, që i kanë pasë karakterizue të padrejta, tash u përulen atyne dhe i njofin të drejta, tue dërgue në Kishat Greke dy kandidatët e rinj për Kishën Shqiptare për me u gradue atje këta Episkopë për Shqipninë që asht sot si dhe atëhere më 1929 dhe 1922 politikisht indipendente dhe kishtarisht Autoqefale.

Diht se për me gradue një person me gradën e Episkopit, duhen 2 Episkopë të tjerë dhe të shumtën 3; por në Shqipni sot janë katër Episkopë, dhe një i tillë asht jashtë Shqipnisë, dhe bahen pesë (5); dhe nga këta 2-3 që duhen për me ba një ose ma shumë Episkopë të rinj, janë edhe në shërbim të Kishës brenda në Shqipni: Episkopi Kristofor dhe Episkopi Agathangjel, si dhe Episkopi Evgjen përveç Vissarionit, Kryepiskopit në pension; pra, nuk asht nevojë që kandidatët për Episkopë të gradohen jashtë tue komprometue kështu Historinë e Kishës Nacionale Shqiptare, ose tue çkombëtarizue (denacionalizue) indirekt këte.

7) Në politikën e jashtme në çdo lëvizje dhe ngjarje të papritun politike në t'ardhmen, kjo ritiratë ose ky fakt do të përdoret prej të huejve kurdoherë në disfavorin e Shqipnisë, si një dokument i papërgënjeshtreshëm i Fanariotizmit në popullin Ortodoks të Shqipnisë së gjithë, sado që ky karakterizim nuk asht i vërtetë ose i drejtë.

8) Brenda në vendin tonë do të hapet një kaos, do të forcohet një përçamje në mes t'elementavet që do të mbrapsi shumë bashkimin kombëtar, pse, do të karakterizohet elementi Ortodoks i gjithë Shqipnisë gati si ay elementi që vajti pas Haxhi-Qamilit për dashurinë e babës (Halifatit) dhe të Sheh-Hyl-Islamit, kështu do të thonë edhe për popullin Ortodoks të Shqipnisë se nuk duron dot pa pasun uratën e babës (të Patrikut Grek), dhe pasi e harruen këtë ç'prej vitit 1922 zyrtarisht dhe pasi e zavendësuen këtë me

nji Sinod Episkopësh Shqiptarë më 1929, si gjithë popujt e tjerë Ortodoksë të Ballkanit, tash po e kujtojnë, po mallëngjehen me mall të madh për 'te, dhe po e ngjallin përsëri, sado që kjo akuzë, kjo vërtetë nuk ka me i u ba me të drejtë popullit Ortodoks të Shqipnisë se asnjë prej tij nuk asht i tillë.

9) Disa persona do të mburren dhe ndofta me të drejtë, se i dhanë popullit Ortodoks të Shqipnisë uratën e babës dhe do të ngjallet ndër ta jo vetëm influenca Fanariote për në vendin tonë por edhe influenca personale do të rritet me të vërtetë në personin e këtyne disave sado të pakët fare në Shqipni; do të ngjallen influencat personale ndër 'to mbi popullin Ortodoks që mund të ketë efekte edhe në gjinin e Komuniteteve të tjerë, mbasi këto persona do të reklamohen si shkaktarë e të zotët për prumjen në Shqipni t'uratave nga Fanari, si ndofta ndër një nga ato periodat e feudalizmit të vjetër; por ka edhe më të rrezikshëm; disa persona të tjerë do të reklamohen tue thanë se "Ne kemi marrë dorë drejt për drejt nga baba" (Patriku i Stambollit), Ne jemi me shpirt të Shenjtë dhe gjithë të tjerët qenë **falls**, si dhe të gjitha punët fetare që kryen brenda në tetë (8) vjetët si: meshtime, pagëzime, vorrime, kunorëzime, gradime laikësh në Priftni, kungime etj. nuk kanë qenë gja tjetër veç se punë qesharake, por me gjith atë, ne do të thonë, me uratën që merret tash nga baba, do t'i legalizojmë edhe këto, do t'i quejmë edhe këto të vlefshme për hatër të popullit. Punë kjo që asht një skandalizim i ndërgegjes së popullit, një trubullim i mendjes, një diskreditim dhe një sigurim për një kohë shumë të gjatë ose një provokim i fanatizmave fetare antishqiptare t'influencave të hueja dhe ndasisë s'elementeve të Shtetit sado që Shteti ka detyrë t'i çduki këto, por Shteti vetë po ngjall tash përsëri një situatë të vjetër të tillë.

10) Në politikën e brendshme shtohet edhe një diskreditim tjetër me marrjen e gradës Episkopale tash nga jashtë: pranohet i vlefshëm mallkimi i Patriarkisë së Stambollit për gjith ata burra nacionalistë, prelatë, që për të mirën e Komunitetit Ortodoks të Shqipnisë dhe për interesat e nalta të Shtetit, dhe për arsye dhe për shkak të tradicioneve, të kanonicitetit dhe të Historisë së Ortodoksisë së përbotshme, pranuen të jenë të mallkuem ose të quhen të mallkuem nga Patriku dhe Sinodi i tij Grek i Fanarit të Stambollit; këta Episkopë burra shqiptarë, tash deklarohen zyrtarisht edhe nga ana e autoriteteve eprore Shtetnore, gjoja me të vërtetë si të mallkuem ose të dënuem, ose të ekskomunikuem, të përjashtuem nga dinjiteti i gradës fetare, kur njifet, sado në heshtje ose indirekt, se këta nuk paskan vleftë shpirtnore dhe posibilitet fetar të bajnë Episkopë të rinj, d.m.th. të gradojnë në gradën Episkopale ata dy civilat që nuk dimë se kush i ka zgjedhë për me qenë Episkopë në Kishën e Shtetit Shqiptar; sheshit, Shteti Shqiptar me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë i pranon këto parime dhe këto impresione kur kërkojnë ose pranojnë edhe që Patriarkia e Stambollit të heki mallkimin ose dënimin nga ata klerikë që i kanë shërbye deri tash vendit, me gjith sa i që e mundun atyne, dhe këta shërbime i kanë bërë, me dashjen e popullit dhe me dëshirë të tij të plotë dhe jo tue i u imponue me asnjë mënyrë dhe asnjë mjet; po këto parime dhe impresione do të duken edhe, tue mos u dorëzue prej Episkopëve Shqiptarë në Shqipni dy Episkopët e rinj kandidatë, nga të cilët njani ka 17 vjet që rri pa punë, sado që nuk ka asnjë mjet për jetesë si dihet, dhe tjetri ka më se 25 vjet që sillet gjithashtu udhëve edhe ky pa punë edhe pa mjete si dihet, dhe asnjani prej tyne tue qenë në moshë lart nga 50 vjet, nuk ka mujtë deri sot t'i paraqisi opinionit botnuer asnjë aktivitet dhe vepër as për dobi sociale të popullit as për dobinë Shtetnore të Shqipnisë, as në Greqi ku kalojnë më shumë kohën e tyne, por as

edhe në Shqipëri ku ka pasë fushë veprimi për gjithë ata që kanë dëshirue me rrëfye një zotësi ose një shërbim në çdo karrierë dhe kompetencë.

Prandaj nuk asht e drejtë që Kisha ose Shteti Shqiptar të kërkojë të bisedojë ose të pranojë ngritje ose çdukje dënimesh fetare të jashtme, punë të cilat as Shteti as Kisha as populli ynë nuk i ka konsiderue aspak dhe kurrë deri sot për kaç vjet, si nuk i konsideruem as Kishat as Shtetet e tjerë për veten e tyre as për ne: Patriarkia e Stambollit në qoftë se ka ba të tilla dënime, mundet t'i heki vetë këto dhe e ka për detyrë ta njoftojë ajo vetë gabimin e saj që ka ba, në qoftë se ka ba mallkime etj. që radikalizojnë pushtetin e saj fetar; nuk jemi në anakronizma të errëta; ne besojmë në fuqinë e veprimeve shpirtnore fetare, por kur këto janë të drejta dhe jo për interesa politike, kur bahet vegël autoriteti fetar në favor të një Shteti dhe për disfavor të një tjetër Shteti, d.m.th. mallkime dhe dënime për shkaqe politike, janë anakronizma të shëmtueme; asnjë Kishë Ortodokse Autoqefale në Historinë deri sot nuk shofim dhe nuk ka, që të jetë proklamue dhe fronësue Sinodi i saj vetëm pas lejes ose aprovimit të Fanarit; klerikët e Fanarit për interes dhe nder të tyre mundën ta çdukin vetë çdo masë që të kenë marrë kundra cilitdo kleriku Shqiptar dhe këtë punë dinë si ta bajnë; tue e lanë në heshtje, dhe tue hy në marrëdhënie shpirtnore me klerikët në fjalë Shqiptarë, në një mënyrë që i përshtatet jo vetëm së drejtës së Shqiptarëve por edhe dritës së kohës së sotme, por edhe deri diku në mënyrën e duhur edhe prestigjit Fanariot, por jo ta shpërblejmë në këtë prestigj me përlujtje të turpshme si këto që po përgatiten të bahen nga ana e Shqipnisë; në qoftë se na trembin me ndonji veprim të padëshirueshëm nga ana e elementit Grekofon të Shqipnisë, kjo nuk asht punë që ja përngjan çeshtjes shkollore të gjuhës t'atij minoriteti; në çeshtjen e Autoqefalisë dhe të mosnjoftjes së saj nga ana e Patriarkisë së Stambollit Grekofonët tanë nuk kanë as mund të kenë ndonji pretendim, por vetëm kanë të drejtë të administrojnë punët e Kishës, sidomos ato të pasunive të tyre Kishtare, ashtu si dëshirojnë, punë që e kanë sigurue me ligj dhe me vendime të Shtetit dhe me Statute e rregullore të Kishës, së cilës ata janë pjestarë jo sipas dëshirës së cilitdo por sipas kanoneve dhe rregullave të përgjithshme të Kishave Ortodokse të botës; edhe Kishat e tjera Autoqefale të Ballkanit dhe ajo vetë e Greqisë kanë minoritete në gjinin e tyre, dhe Shqipëria nuk mundet t'i japë minoriteteve ma shumë të drejta kishtare dhe privilegje se sa i kanë dhanë dhe i kanë sigurue Kishat e tjera minoriteteve të tyre për sa i përket punëve kishtare; përse të hutohemi ne, pra, për të tilla punë? Çeshtja e Autoqefalisë së Kishës Shqiptare dhe mosnjoftja e saj nga ana e Patriarkisë së Konstantinopolit në asnjë mënyrë nuk mund të bisedohet më paskëtaj as brenda as jashtë Shqipnisë; se si u përmend edhe dihet, edhe n'atë vetë Lidhjen e Kombevet asht mbyllë një herë e përgjithmonë kjo çeshtje. Prandaj nuk ka përse të disponojmë lutje dhe sakrifica për hir të politikës së Fanarit, as përse të tolerojmë lëvizje dhe bisedime mbi çeshtjen kishtare ortodokse, në lidhje me Patriarkinë e Fanarit.

Edhe m'atë keq: asht punë e sigurtë se asnjë fitim dhe përkrahje morale dhe materiale të vlefshme nuk ka me qenë e mundun me pasë as elementi Ortodoks Shqiptar as Shteti, por edhe as ata vetë Grekofonët e Shqipnisë, nga njoftja e Autoqefalisë ose nga dorëzimi i Episkopëve të rinj nëpërmjet Patriarkisë; dhe Greqia për të cilën ajo Patriarki punon dhe sakrifikohen nuk ka me na b'atë në realitet asnjë ndihmë serioze dhe të dobishme; Ortodoksia e Shqipnisë gabohet n'asht se shpreson edhe m'atë të paktën dobi, punë që nuk shpresojmë se ka kush nga populli që e shpreson; n'asht se dikush do të thotë se do të marrin paskëtaj vit për vit nga 100.000 fr.ari prej Greqisë, sikurse flitet jashtë, kjo

do dali pa themel, ose do të jetë një punë fare për një kohë të shkurtër; Shteti dhe populli që harxhojnë në vit nënt nga 20.000.000 fr.ari mundet edhe duhet ta shpenzojë atë këtë shumë (100.000 fr.ari) në vit; të huejt po të na japin këtë shumë që e kanë lanë Shqiptarët në Greqi për Komunitetin Ortodoks të Shqipnisë dhe janë të drejtat legale të Ortodoksisë Shqiptare, pse? pa ba sakrificat e sipërpërmenduna Shqipnia kundrejt Fanarit, nuk na i japin ato të holla? d.m.th. se kanë një interes vital prej përvuljes dhe sakrificave tona, pse, bota nuk asht aq e humbun sa që të na sigurojë shuma të përvitshme të mëdha të hollash pa u shpërblye në mënyrë tjetër si i intereson.

Zavendës Kryetarit të sotshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë, Hirësisë së Tij Kristofor Kisit, që në të gjitha Dioqezat e Shqipnisë ka shërbye tue kalue si titullar i tyre ose ad-interim, këtij, thuhet se do t'i shtohen edhe dy të tjerë shokë ose bashkëpunëtorë, të cilët nuk i njofim, ose shumë pak njerëz i njofim këtu ose jashtë; këta të dy do të marrin gradën Episkopale jashtë Shqipnisë për me shërbye pasandaj brenda në Shqipni; këta janë që bashkë me Hirësinë e Tij Agathangjel Çamçen do t'i japin sadsifikacion dhe do të plotsojnë gjithë nevojat e komunitetit Ortodoks për Kishën Shqiptare; këta do të na sjellin bekimin e Fanarit sidomos; por po t'ishte nevoja për këtë bekim dhe me domosdo, dhe të marrun sidomos me sakrifica të tilla, do ta kishin marrë dhe Kishat e tjera po me sakrifica njoftjen e Autoqefalisë, si ajo e Greqisë, e Rumanisë, e Serbisë, e Polonisë dhe e Bullgarisë, por gjithsecila prej këtyne priti 25-65 vjet dhe nuk u përul, sa bani sakrifica si këto që duen të bajnë këta 2-3 personat e naltpërmendun për llogari të Kishës Shqiptare; mohimi i bekimit ose mallkimi i Patriarkisë së Stambollit sidomos mbasi ishte bamun pa të drejtë, nuk i damtoi as Kishat as Shtetet Ballkanike që përmendëm ma sipër si edhe neve nuk na ka bamun asnjë dam mosnjoftja nga Patriarkia e Stambollit, dhe as kemi me pasë dam, n'asht se, sikurse vazhduem deri tash me nder qëndrimin tonë Kombëtar dhe Kanonik Kishtar, do ta vazhdojmë edhe disa vjet të tjera deri sa t'i mbushet mendja Patriarkisë së Stambollit për me na njoftë ajo vetë dhe pa asnjë kompromis dhe komprometim nga ana e Shtetit as nga ana e popullit Ortodoks as nga ana e Hierarkisë së Kishës, sidomos mbasi edhe nuk kemi me të vërtetë asnjë dobi prej të njoftunit nga Patriarkia në fjalë; ajo asht vetë pa asnjë fuqi dhe pa asnjë lloj influence si asht e ditun, por edhe nga Kisha Autoqefale e Greqisë nuk kemi dhe as duhet të shpresojmë ndonji ndihmë; ajo vazhdon tash kaq vjet në tronditje e sipër të madhe të mbrendshme për shkak të Kalendarit, për shkak të politikës së mbrendshme Greke, për shkak të zhvillimit të propagandës s'Unitizmit atjé dhe për shkak të gjendjes mizerable të shumicës së Klerit të saj famulltar; nuk mundet as materialisht ajo me na ndihmue, mbasi dhe ajo bashkë me Shtetin e vet nuk janë në gjendje për me mbajtë me dinjitet Patriarkinë e Stambollit dhe Kishat e tjera Greke, n'Azit dhe n'Afrikë, por ndihmohen këto edhe prej Patriarkanave të Shteteve të tjera Ortodokse; por edhe Shteti Grek nuk mund të na ndihmojë edhe pas çdo sakrifice që do të bajmë, se vendi ynë nuk asht pa zot dhe ndihma e huej nuk mund të mshifet ashtu si edhe në çdo Shtet tjetër, nuk mund të lajë Shqipnia që Kleri të lidhet materialisht me Shtete ose Institute të hueja, se Kisha Ortodokse në çdo Shtet asht kombëtare dhe lokale dhe jo si Kisha Romano-Katolike, internacionale.

Krijimi i një situate të kritikshme dhe të një reaksioni politik ose social që do të vijë n'elementin Ortodoks me përbuzjen e Episkopëve Shqiptarë dhe që ndodhen tash me shërbim ose jo mbrenda Shqipnisë, përbuzje dhe diskreditim që deklarohet sheshit me marrjen e gradës Episkopale jashtë Shqipnisë, për ata kandidatë që do të zenë vendet vakante në Shqipni dhe posaçërisht fronëzimi dhe instalimi në krye të punëve shpirtnore

në dioqezat shqiptare të njerëzve të panjoftun mirë dhe të pamësuem në punët e Shqiptarizmit, këto punë bajnë që të mendohet gjithsecili që don paqen dhe independencën e Shqipnisë dhe bashkimin Kombëtar dhe sidomos të mirën e popullit Ortodoks të Shqipnisë, jo vetëm që të mos i pranojë Shteti as Kisha këto mënyra veprimi ose këto mënyra zgjidhjeje të panevojshme ose të kota për vendin tonë, por duhet t'i pengojë dhe t'i luftojë; koha asht tash e tillë që duhet të dyshohet edhe nga mâ e vogla lëvizje dhe të ruhet njeriu nga çdo responsabilitet i dyshimtë; punën nuk e kemi aqë në dy kandidatët sa në mënyrën e ardhjes së tyre në shërbim.

Nuk asht harrue edhe se Episkopë ishin edhe ata të cilët në Gjinokastër, në Korçë dhe në Durrës që përgatitën revolucionin kundra Princ Vedit dhe copëtimin e Shqipnisë për formimin e Qeverisë së Zografit, Vorio-epirotikën dhe marrjen pjesë të tyre në tânë Shqipnin e Jugut dhe që mbuellnë përçamjen dhe zjarrin në mes të elementëve në Shqipni dhe banë që populli Ortodoks të mos konsiderohet ashtu si duhet edhe si ka të drejtë, në shumë raste deri sot, për sa i përket bashkëpunimit të sinqertë me elementat e tjerë të Kombit.

Mund të thuhet se nuk asht veç se një punë formaliteti pa rëndësi dorëzimi i Episkopëve kandidatë të rinj jashtë Shqipnisë për dy dioqezat vakante në Shqipni, dhe se kjo punë nuk ka asnjë randësi, asht vetëm një gja formale; mirëpo atëhere ne themi: pse të huejt e interesuem direkt ose indirekt me anën e kandidatëve në fjalë kërkojnë dhe insistojnë që këta të mos marrin gradimin Episkopal në Shqipni, por ndër Kishat Greke? Ne shtojmë edhe se, pse të nguli kambë Patriarkia Greke, ose psë, kjo, me anën të kandidatëve të kërkojë me doemos që Hierarkia, Kleri, Populli Ortodoks dhe Shteti Shqiptar të pranojë se, vetëm në aktin e faljes ose t'amnitisë ose të bekimit të Patriarkut Grek të Fanarit, do të jetë kanonike dhe legale Kisha e Shqipnisë? Ajo Patriarki prej nesh nuk ka shpresa fitimi të hollash dhe për prestigjin e saj nuk punon e lufton, se e ka humbun me kohë dhe asht e ditun se vetëm Emni i ka mbetun Ekumenik, emën që asht ba pothuejse radikal, por vet-vetiu kuptohet dhe fare lehtë se, insiston për hir të politikës Greke që ka bamun kurdoherë për favor të Helenizmit. Dhe Kishat e tjera Ortodokse nuk kanë me i dhanë ndonji privilegj Patriarkisë së Stambollit po të imponohet në Shqipni, si dhe as Shteti Turk nuk ka me e konsiderue mâ shumë se sot, por sigurisht vetëm politika Greke dhe sidomos rrymat vorio-epirotike të Greqisë.

Shënojmë me shumë seriozitet se influenca shpirtnore sidomos fetare ndër popuj që janë pak a shumë primitivë si yni, tash, nuk asht si çdo punë tjetër politike dhe shoqnore e cilitdo Shteti dhe Kombi qoftë, por asht e vërtetueme mirë prej punëve të Historisë deri sot, se, këto janë punë të rrezikshme për popullin dhe për Shtetin dhe nuk mund të çduken veç se me shekuj, se ngatërresat ose mentalitetet fetare krijojnë një shpirt më vehte në popull që as luftnat nuk e çdukin dot, por luftna prej tyre shkaktohen; fjala sidomos asht për në Ballkan.

Me kohë shpesh herë u tha se Patriarkia e Stambollit për me njoftë Autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipnisë nuk ka asnjë pretendim tjetër veç se kërkimin e një farë ndjese nga ana e atij Prelati që e bani dhe e kryesoi Sinodin e Parë Shqiptar; kjo ndjesë u kërkue haptazi prej Tij, Kryetarit të Kishës, me anë të një telegrami në vitin 1935; mâ vonë u tha se nuk mjaftohet me këto por duhet dorëheqja e Kryetarit të Kishës, këtë dënim mâ të randin nga të gjitha që mund të bahesh dhe që as nuk shpresohesh të bahesh, e pa politika e Fanarit dhe Kryet e Kishës Shqiptare, i Pari Krye i Saj Historik ra, dhe pushoi krejt nga çdo shërbim prej Kishës Shqiptare, që të merrte sadisfaksion Patriarku

Greke dhe të denjonte me e përshëndetë Kishën e Shqipnisë; por shkoi afër një vit prej kësaj ngjarjeje prej këtij sakrifici Historik Shqiptar, dhe Patriarkia kërkon edhe të tjera sakrificë; le t'ja japin që të vërtetojmë vetë, me dorën t'onë, se gjykojmë, ndjejmë dhe qëndrojmë krejt ndryshe nga sa gjykojnë, ndjejnë dhe qëndron gjithsecili popull i Ballkanit, dhe responsabiliteti nuk është i popullit Ortodoks, as që po kërkon ky të bajë ndonjë sakrificë të pahijshme dhe të pameritueshme kundrejt Fanarit ose kundrejt megalomanive të botës, por vetëm 2-3 persona që ndodhen jashtë, të huej, që nuk kanë tjetër mundësi dhe mjet që t'imponohen në qëllimet e tyre personale por vetëm merren me çështjen kombëtare Shqiptare Ortodokse. Këta njerëz po e komprometojnë, po e rrezikojnë, po e turpnojnë dhe po e rrejnë popullin ortodoks, Shtetin dhe Mbretin, dhe i premtojnë popullit ortodoks fitime morale dhe materiale fantastike të përealizueshme dhe në të vërtetë vetëm po e ngacmojnë dhe po e alarmojnë kot; këto janë punë që të fitojnë qëllimet e tyre vetëm dy deri 3 (2-3) politikanë grekë ose shqiptarë; por se e fusin popullin në belë, ata nuk duhen me ditë, se, ato mjaftohen me ba vetëm politikë për interes të vehtes së tyre vetëm.

Kur i thamë popullit të vërtetën, atëherë më 1929 apo tash më 1937?

Prova se, jo vetëm populli ortodoks shqiptar, por as Grekofonët e Shqipnisë nuk kanë pasë ndër mend të çelin në këtë mënyrë që është çelë këto ditë një çështje kaqë e rëndë politiko-religjioze, prova është se: po t'ishte populli ortodoks, qoftë edhe ay Grekofon, që të dëshironte anulimin e zgjidhjes së çështjes kishtarë të bame në vitin 1929 dhe zgjidhje të ré Fanarioto-Athinaike si kjo që po bahet tash dhe që po i inspirohet parisë së popullit ortodoks dhe sidomos atyne të pakteve që janë mbledhë këto ditë në Tiranë dhe të cilët, përveç disave, të shumtët me të vërtetë por edhe n'asnjë pikpamje formale të legalitetit nuk përfaqësojnë ndjenjat dhe mendimet e elementit ortodoks të Shqipnisë, prova është se, kur u çel prej Grekofonëve çështja e shkollave minoritare vitin e kaluem me aqë bujo, guxim dhe sakrificë nga ana e tyre dhe t'elementeve të hueja, sigurisht atëherë do t'ishte bërë çështje dhe për prishjen e statu-quos kishtarë ose për ndryshimin e gjendjes së stabilizimeve legalisht tash 15 vjet plot në Shqipni në punët e Kishës; por atëherë nuk u ba as fjalë dhe asnjë çështje por tash u ngacmuen prej dy deri tre personave të huej që duhen të peshkojnë n'ujna të turbullta dhe që po e bajnë këtë çështje serioze, për dam, si u spjegue më sipër, t'interesave vitale t'elementit ortodoks në Shqipni dhe jo vetëm për dam të këtij por edhe të Shtetit dhe të Kombit përgjithësisht. Ata që e shkaktuen, çeljen e një çështjeje të re kishtarë duhen dhe i duhet medoemos të rrëfejnë se banë diçka para popullit dhe prandaj sjellin kandidatë së jashtëmi dhe i dërgojnë këta atje për me i gradue.

Thamë se të gjitha këto bahen më shumë edhe nga nevoja që të plotësohen dy vendet vakante në Sinodin e Shejtë; mirpo, për këtë punë, përsë duhet gjithë ky alarm dhe trazim i mendimeve, ndjenjave dhe të Historisë? Asht e ditun se dy Episkopë të zotët për punë kishtarë dhe të provuem edhe në Shqiptarizmë, Shteti është tue i pague, dhe këta janë të lirë në shtëpinë e tyre, dhe këta, si dihet, janë: Imzot Visarion Xhuvani dhe Imzot Fan Noli; dhe mbrenda këtij mueji kanë me mbërrijtë në Shqipni dhe tre persona të diplomuem teologë, njerëz të pa-komprometuem dhe të moshës së duhur, 30 vjet e nalt, dhe të mentalitetit të ri, si duhet; njani prej Kavaje, njani prej Gjinokastre, shqiptarë, dhe tjetri prej Shkodrës, dhe ky shqiptar; përse, pra, të sjellin dy të tjerë që u mplakën në shërbime të pa-njoftuna mirë në vendin tonë? Dhe nga ata dy kandidatë, njani Z.Evlllogji Korillas, n'asht se nuk jemi të gabuem, nuk është as Teolog, as ka bamun studime n'asnjë Seminar dhe n'asnjë Fakultet teologjicë të botës; ne dimë se ky rasëmbajtës është marrë

vetëm me literaturë të skolastikizmit bizantin, këto punë kishtarë që po zhvillohen këto ditë komprometojnë ose duhet të dëshpërojnë jo vetëm qeverinë e sotme, parinë dhe popullin ortodoks, por edhe ata antarë të Këshillit Ministruer që zyrtarisht ndihmuen në vitin 1929 për zgjidhjen e çeshtjes kishtarë si edhe gjithë ata Ministra të kabinetëve të ndryshme, që, ç'prej vitit 1929 deri sot e kanë njoftë dhe e kanë përkrahë gjendjen kishtarë Sinodike si të rregullshme, kanonike dhe patriotike; Sinodet e Shejta të Kishave nuk ndërrohen dhe nuk përzihen në çdo rast dhe për çdo shkak si Këshillat Ministeriale që ndryshohen sipas nevojave politike të Shtetit, të brendshme ose të jashtme; kështu është zakoni, e drejta dhe realiteti dhe Historia e gjithë Kishës Ortodokse të Botës.

Në një vend të vogël si Shqipëria, nuk ka gjë më të randë dhe të damshme se sa konkurrenca e dy tendencave politiko fetare të hueja; me të hyn influenca e Fanarit, pak ose shumë greke, me anë të Kishës, prej Sarandë deri në Shkodër dhe në Dibër, ku, sado të pakët, por ka edhe disa ortodoksë që do t'administrohen fetarisht prej njerëzve, Episkopëve, të paprovuëm mirë për Atdhë-dashuninë shqiptare, me një herë Shtetet e tjera ballkanike t'interesoem që pretendojnë se kanë minoritete ose për me mos e çdukë influencën e tyre ballkanike krejt, edhe në mënyrën shpirtnore me anë të mentalitetit fetar, Shtetet e tjera ballkanike do të venë gjithë fuqinë e tyre për me sigurue për vete direktivat politiko-religjioze, kishtarë-sociale, për me balancue, të paktën me mentalitetin e Helenizmit ortodoks, influencën e Romës në Shqipëri; dhe Roma atëhere do të detyrohet me doemos me i ba ballë kësaj rryme në Shqipëri, se nuk është punë e zorshme të kuptojë se forcimi ose krijimi i një mentaliteti jo italo-fil ballkanik n'elementin e popullsisë ortodokse, që shtrihet në të gjitha viset e Shqipërisë, ka më shumë randësi se sa lidhjet zyrtare Shtetnore, të cilat, me një rast ose me një shkak të pa-pritun, mund të denoncohen, mund të prishen, mund të zhduken me një herë si kemi shumë shembëlla relative edhe në mes të Shteteve të mëdhej këto ditë.

Në këtë mënyrë, mirret vesht shumë mirë se, në Shqipëri do të zhvillohet me një herë ose pak nga pak një përpjekje në mes të dy pushteteve, t'atij Grek ose pan-ballkanik me atë të Romës; kjo konkurrencë sociale shpirtnore për një vend të vogël të ri dhe pak a shumë primitiv si vendi ynë, është kurdoherë një rrezik në gjinin e Shqipërisë për çdo eventualitet të papritun; kurse po të vazhdojë puna e thjeshtë shqiptare në Komunitetin ortodoks të Shqipërisë për sa i përket organizimit dhe zhvillimit të tij, ashtu ai po zhvillohet ndër vedi pa influenca dhe marrëdhënie të hueja, puna në Komunitetin Muhamedan të shumicës së popullsisë të Shqipërisë, në gjinin e të cilit nuk është tue u ba besimi më i pa-fuqishëm se ndërmyet elementit ortodoks sot, atëhere punët do të vazhdojnë pa asnjë frikë inkonvenientesh në Shqipëri dhe pa asnjë komprometim të dinjitetit dhe të bashkimit kombëtar.

Por puna nuk ka të bajë vetëm me ndonjë grindje që mund të supozohet se mund të ndodhi në gjinin e Elementit Ortodoks të Shqipërisë, tue u-përça ky në dy grupe; në t'ardhmen, shpejt ose vonë, në konservatorë ose nacionalistë ekstremë, por me të vërtetë ka të bajë me një mosmarrëveshje që do të zhvillohet sigurisht në mes t'elementit ortodoks të gjithë Shqipërisë dhe t'elementëve të besimeve të tjera, sidomos t'atij të shumicës së madhe; tue u-konsiderue prej këtyne punëve i dyshimtë elementi ortodoks edhe më shumë ky do të bahet natyrisht ndofta pak a shumë i ftofët kundrejt idealeve dhe kundrejt sakrificave për Atdhënë e përbashkët, për independencën dhe për regjimin e Shtetit, punë që të këqiat e përfundimeve kanë me qenë sigurisht të idhëta më parë edhe

mâ shumë për ata burra që kanë mbi vedi përgjegjësinë e sundimit të vendit, difikultetet mâ të mëdhaja dhe shtrëngatat për këta kanë me qenë.

Ne kujtojmë se janë të gabuem disa ose të gjithë ata persona të pakët, të cilët, n'emën të popullit ortodoks, po kërkojnë këtu sot zgjidhjen e çështjes Kishtare me anë të një Kongresi; e gjithë bota e din se **çështja Kishtare u-zgjidh një herë**, dhe nuk ka mâ se si të zgjidhet përsëri, mbasi dhe Shteti e ka vërtetue këtë punë njëherë dhe me çdo mënyrë, ashtu edhe populli ortodoks, si u-spjegue mâ sipër; prandaj populli ortodoks mund të kërkojë Kongresin ose Asamblenë e tij kishtare për çdo punë tjetër, përveç t'ashtu-të-quejtunës **zgjidhje të çështjes kishtare**; mund të kërkojnë si thamë, kongres të ri, por vetëm për ndonji përmirësim dhe modifikim të Statutit dhe të Rregulloreve që duhen për administrimin e mbrendshëm të Kishës, dhe jo të kërkojë zgjidhjen e çështjes Kishtare; se zgjidhja në fjalë nuk mund të zgjidhet aqë herë sa u teket, për ambicionin ose për interesat e këtyne 3-4 personave laikë dhe klerikë, as nevojat e shumta dhe fort të mëdha të Kishës Ortodokse Shqiptare plotësohen me të tilla veprime, por vetëm me sakrificat të mbrendshme të veçanta dhe personale, mbasi punët e Kishës ortodokse i-a përngjajnë punëvet intime familjare; dhe si nderi dhe interesa e familjeve ruhen, përparojnë dhe naltësohen vetëm prej vetë familjes së secilit, ashtu edhe punët e Kishës do të ruhen, të përparojnë dhe të naltësohen vetëm me sakrificat të mbrendshme nga ana e gjinit të Komunitetit Ortodoks dhe të Shtetit tonë, vetëm pa shpresa nga çdo anë tjetër qoftë.

Apo mos asht puna për me krijue një klikë lokale kishtare, një trup Episkopësh, një Sinod të tanë, të gjithë Kishës së Shqipnisë, të përbarun nga njerëz të një rrethi, për një oportunitet dhe qëllim të vetëm personal? Se, të gjithë kandidatët, ose mâ mirë me thanë i gjithë trupi episkopal, asht shënue sikurse me qëllim dhe asht përba tash vetëm prej një krahine të caktueme, dhe vetëm një person nuk asht prej atij origjini, por edhe ky mban titullin dhe punën po t'atij vendi dhe asht e ka qenë njeri po i atij rrethi.

Tue përfundue, çfaqim edhe keqardhjen tonë si Krye-At i parë shpirtnuer i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë, mbasi po shofim se influencat dhe mjetet e paprovueme si duhesh, nga cilado anë qofshin, por të cilat ne, me përpjekjet tona kolosale, brenda një kohe të gjatë prej 17 vjetve pune, i shporrëm jashtë Shtetit, me sakrificat tona personale tepër të randa; po këto influenca dhe mjete të ndryshme po hyjnë rishtas në gjinin e Kishës Shqiptare Ortodokse se mjaft u-kombtarizue, për me qenë - fatkeqësisht, sipas mendimit t'onë nga eksperiencia e gjatë - për me qenë kurdoherë Kisha Kombëtare në misionin e saj gjithmonë problematike.

Për deri sa të na njofi Patriarkia e Fanarit pa asnjë sakrificë dhe komprometim nga ana jonë, ne duhet të na mjaftojnë urimet dhe bekimet që na janë dërgue me akte zyrtare nga ana e Patriarkanave të tjera të Ballkanit si dhe nga ana e Kryetarëve të Kishave Autoqefale, me përjashtim të atyne Greke.

Sinqerisht i lutem secilit të ketë mirësinë dhe të na besojë se, kundrejt Patriarkisë së Stambollit dhe kundrejt shtetit Helenik dhe sidomos kundrejt popullit Helenik, kemi respektin dhe simpatinë mirënjohëse me të vërtetë ma të madhe dhe ma të sinqertë, dhe nuk kemi qëllim me prekë aspak këta dhe as ndonji person të mbrendshëm ose të jashtëm; si asndonjenin nga dy kandidatët e rinj për Episkopë. Kurrë nuk mund të mendojmë, as që mund të dëshirojmë, dhe nuk kemi, dhe as që kemi pasë për qëllim me paksue randësinë dhe çmimin ose vleftën e Patriarkisë së Konstandinopolit, as me pengue

kurrë dhe as veprën e duhun të njoftjes nga ana e kësaj, për sa i përket Autoqefalisë së Kishës shqiptare që ne e quejmë, ma të shumtën ose ma të paktën pjesë, vepër tonën personale dhe edhe nga kjo pikpamje e kemi për lavdi dhe kënaqësi, si dhe për nder dhe detyrë për neve personalisht njoftjen e saj, por jo tue ba për të therorinat që nuk lejohen, që nuk i interesojnë popullit ortodoks të gjithë Shqipnisë, as Atdheut, as Mbretit, si therorinat e sipërpërmenduna. Prandaj me shumë keqardhje nuk mundem me u rezervue për me ba këtë referat, sado që kjo asht kundër interesave të personit tonë, por e quej për detyrë me shkruë këtë referat dhe me deklarue, ndryshe do t'ishim tradhëtarë për nderin që na bani populli ortodoks, Shteti dhe Mbreti deri sot.

Fund i pjesës së I

Lutës ndaj Perendisë
Kryepiskopi
Vissarion
Ish Kryepiskop i gjithë Shqipnisë

AQSH, Fondi 536, dosja 1432, viti 1937

Shënim: Deri sot kemi gjetur në AQSH vetëm pjesën e parë të dorëshkrimit të daktilografuar të “Referateve mbi krizën politiko-fetare...”. (N.Xh. – P.H.)

PJESA E DYTË:
PËR VEPRËN E VISARION XHUVANIT

IMZOT VISARION XHUVANI PËR AUTOQEFALINË E KISHËS ORTODOKSE SHQIPTARE

Visarion Xhuvani ka lindur në Elbasan në lagjen Kala më një maj të vitit 1887. U rrit në një familje atdhetare dhe me bindje fetare. Në formimin e tij rol të veçantë ka luajtur shkolla e lagjes Kala dhe mjedisi i kishës së Shën Marisë. Në shkollën e lagjes Kala mësuesit ishin të gjithë atdhetarë të devotshëm. Ata ndiqnin traditën e Dhaskal Todrit dhe të K. Kristoforidhit. Krahas greqishtes, nxënësve u mësonin fshehurazi gjuhën shqipe. Në shtëpi djaloshi lexonte me dëshirë librat e Kristoforidhit, të cilat ia sillte daja, Papa Mina Bibaja, kleriku i nderuar dhe me autoritet i lagjes Kala.

Mësimet e shkollës, kujdesi i prindërve dhe veçanërisht mjedisi i kishës së Shën Marisë, shërbimet që kryente si fëmijë dhe ndjekja me kuriozitet e dëshirë e bisedave që bënin të moshuarit pas meshës, burrat e lagjes si Taq Buda, Simon Shuteriqi, Mit Papajani dhe ata që shërbenin në kishë, duke filluar nga Visari (plaku), Papa Dhimitri, Papa Minai e shumë të tjerë, kanë ndikuar në formimin e tij dhe kanë nxitur dëshirën për të vazhduar rrugën e tyre, për të futur gjuhën shqipe në shërbesat e kishës.

Kjo dëshirë nuk mund të realizohej pa pasur një formim të plotë fetar. Të afërmit dhe dashamirët u përpoqën për të realizuar dëshirën e djaloshit dhe e dërguan për të vazhduar shkollën e mesme teologjike në Athinë. Nga viti 1906 deri në 1911 studioi në shkollën e mesme fetare, të cilën e mbaroi me rezultate shumë të mira. Në këto vite bashkë me mallin për vendin e vet filloi të përmbushë ëndrrën e lartësimit të kishës së lagjes Kala. Ai në këto vite vazhdoi studimet e larta teologjike.

Në vitet 1911-1914 ndoqi studimet e larta për teologji në Universitetin e Athinës. Më pas vijoi studimet pasuniversitare me përfundimin e të cilave mori gradën “Doktor”. Në vitin 1918 u emërua Lektor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Athinës. Po në këtë vit u dorëzua në gradën priftërore nga Mitropoliti Jakov. Detyrën e lektorit nuk e vazhdoi gjatë, sepse në vitin 1919 Patriarkana greke e çoi në famullinë e Ankaralisë mbretërore në Sofje dhe e emëroi drejtor të kishës greke të atjeshme.

Në Bullgari u lidh me lëvizjen kombëtare shqiptare dhe filloi të meshojë në gjuhën shqipe. Meqenëse lëvizja atdhetare që më e organizuar në Rumani, në vitin 1919 shkoi atje për të organizuar besimtarët ortodoksë shqiptarë dhe filloi të predikojë në kishë në gjuhën shqipe.

Nëpërmjet kishës forcoi ndjenjat e atdhedashurisë dhe të unitetit të domosdoshëm për të përballuar përçarjen që kishte sjellë kisha greke. Me veprimtarinë e vet misionare u krijua mundësia e hirotonisjes në gradën episkopale. Kjo ishte edhe dëshira e shqiptarëve të Rumanisë. Çdo gjë u përgatit dhe u organizua mirë. Të gjitha përpjekjet shkuan kot, sepse dorëzimi u anulua në momentin e fundit prej intrigave të kurdisura nga ata që nuk e donin autoqefalinë e Kishës Shqiptare.

Nga mesi i vitit 1919 Visarioni erdhi në Shqipëri ku u prit shumë mirë nga banorët e Elbasanit, Tiranës, Kavajës, Pogradecit. Tek arkimandriti i ri ata panë plotësimin e dëshirës së tyre që meshimi të bëhej në gjuhën shqipe në kishë. Këtë dëshirë e kishin kultivuar nga Anonimi i Elbasanit (Papa Totasi) e deri te Dhaskal Todri e Kostandin Kristoforidhi. Kjo aspiratë liridashëse i shtyu ortodoksët e këtyre qyteteve që me anë të një peticioni t’i drejtohen Qeverisë së Durrësit dhe Atë Visarionit që të fillonte zyrtarisht punën për organizimin e kishave të këtyre krahinave. Në peticion shkruhej:

“Të ndershmes Qeverisë sonë të Durrësit, çdo zyre të çdo pleqësie të Elbasanit, Durrësit, si dhe çdo shqiptari si dhe shenjtëditunisë së tij Visar Xhuvani.

Nga ana e klerit dhe e popullit tonë njoftojmë se më 29-XI-1919 Atë Visarionin hypi në fronin e shenjtë dhe kështu u vendos të jetë Arqipeshkop i Elbasanit, Tiranës, Kavajës, Shpatit, Pogradecit dhe gjithë krahinave të tyre. Letrën e firmosin personalitetet e kohës. Sa thamë kemi besim se Atë Visarion Xhuvani do ta pranojë punën e sipërme për të mirën e vendit dhe të fesë sonë.

Kryetari i Pleqësisë
Z/mitropolit Papa Dhimitri”.

Idetë e peticionit u përhapën dhe u përkrahën në të gjithë Shqipërinë e Mesme. Lëvizja ortodokse shprehu dëshirat e të gjithë besimtarëve të kësaj dioqeze, prandaj Qeveria vendosi:

“Vendim

Tue marrë parasysh atdhetarinë e tregueme të Z Arkimandrit Visarion Xhuvani u vendos që zotnia e tij, sipas kërkesave të popullit të Elbasanit, Durrësit, Kavajës etj, të emnohet Arkimandrit i Ortodoksëve”. (*AQSh, Fondi 63, dosja 1011, viti 1921, faqe 9*).

Vendimi i janarit të vitit 1920, që mori Qeveria e Durrësit, shprehu realizimin e përpjekjeve të ortodoksëve të Shqipërisë së Mesme dhe e vendosi përfundimisht Visarionin në krye të kësaj dioqeze, që drejtohej nga dhespot Jakovi.

Pak muaj më vonë ortodoksët e Tiranës u mbledhën, biseduan dhe vendosën sipas propozimit të Hirësisë së Tij Arkimandrit Visar Xhuvanit të shpallin vetëqeverimin kombëtar të Kishës së Shenjtë Ortodokse të Shtetit Shqiptar dhe të organizohet sa më shpejt një mbledhje e përgjithshme panortodokse kishtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të gjithë klerit ortodoks. Këta përfaqësues do të marrin vendime kishtare të patundshme fuqiplota dhe vepruese. Këtyre vendimeve iu bindi i gjithë kleri ortodoks, pleqësitë dhe populli ortodoks shqiptar.

Banorët ortodoksë të Tiranës i kërkuan Hirësisë së Tij, Arkimandrit Visarion Xhuvanit, të vepronte në çdo vend dhe për çdo punë që duhej për realizimin e vendimeve të marra dhe të kërkonte përkrahjen morale e materiale për të gjitha punët me rëndësi fetaro-kombëtare. Banorët ortodoksë iu lutën qeverisë të merrte në konsideratë vendimet e tyre.

Për të qenë sa më i plotë vendimi, parësia e ortodoksëve të Tiranës caktoi edhe Këshillin Hierarqik me kryetar Arkimandritin e Ortodoksëve Dr. Visar Xhuvanit dhe anëtarë: Papa Jorgji Rusi, Papa Simon Athanasi. (*AQSh, F, 152, V 1921, Disja 111, fleta 138*).

Vendimet e marra dhe të miratuara në Elbasan më 29-XI-1919, vendimi i Qeverisë në janar të vitit 1920 dhe ai i ortodoksëve të Tiranës më 28-XI-1921, si dhe dëbimi i dhespotëve grekë bënë që të shpallet Kisha Ortodokse Shqiptare e shkëputur nga ana ekonomike dhe administrative prej Patriarkanës së Stambollit.

Visarionin filloi të organizojë kishën, të cilën e gjeti në gjendje kaotike. Çdo gjë duhej filluar nga e para. Dëshira për të vazhduar punën e filluar në Shqipërinë e Mesme bëri që të kapërceheshin pengesa shumë të mëdha. Literatura liturgjike ishte e pamjaftueshme, priftërinjtë dhe psalltët qenë të pastërvitur për të kryer ritualet kishtare në gjuhën shqipe. Ajo që pengonte më shumë ishte përçarja ndërmjet ortodoksëve shqiptarë, e cila sa vinte e shtohej edhe po të mos pengohej do të dëmtohej uniteti kombëtar. Pjesa atdhetare kërkoi t'i jepej fund kësaj përçarjeje. Banorët Ortodoksë të Tiranës në vendimin

e datës 29-XI-1921, sipas propozimit të Arkimandrit Visarion Xhuvanit, kërkuan të mbahej një mbledhje e përgjithshme gjithortodokse kishtare, ku të përfaqësohej i gjithë kleri dhe populli ortodoks dhe të merreshin vendime, të cilat do të ishin të detyrueshme për të gjithë klerikët dhe popullsinë ortodokse shqiptare.

Mbas një pune të lodhshme gati njëvjeçare u përgatit platforma e mbledhjes, u zgjodhën delegatët dhe u përgatit materiali teorik që do të paraqitej në mbledhje (Kongres). Mbasi u muar edhe miratimi i Qeverisë, më 12 shtator të vitit 1922 në Berat u mbledh Kongresi i Parë Pan-ortodoks, i cili mori vendimet përkatëse dhe shpalli Autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare.

ROLI I VISARIONIT NË PARLAMENT

Kongresi i Lushnjës (20-31 janar 1920) ka qenë ngjarje shumë e rëndësishme në historinë e shtetit shqiptar. Ai ishte vepër e atdhetarëve të shquar të kohës dhe mbështeti veprimtarinë atdhetare të Arkimandrit Visarion Xhuvanit, të cilin e zgjodhi anëtar të Këshillit Kombëtar (senator) dhe më vonë si deputet (1923). V. Xhuvani mori pjesë aktive në organizimin e shtetit të ri shqiptar dhe të Kishës Ortodokse Kombëtare Shqiptare.

Në Këshillin Kombëtar si përfaqësues i Elbasanit V. Xhuvani ishte mjaft aktiv. Ai kishte mendime të qarta për detyrën e këshilltarit, si dhe për rrugën nëpër të cilën duhej të ecte përparimi i vendit. Gjatë diskutimeve shprehu idetë se çdo gjë duhej të vendosej dhe të zgjidhej në të mirën e shtetit të ri dhe të kombit. Përparimin e Shqipërisë e shihte të lidhur me Evropën Perëndimore. Ishte i bindur se vendi do të përparonte kur të ishte i shkëputur tërësisht nga ligjet osmane, kur të forcohej ekonomia, kur të ngrihej niveli arsimor dhe kulturor i popullit. Aparati shtetëror duhej të ishte sa më pak i kushtueshëm dhe të drejtohej nga njerëz të aftë dhe të kualifikuar, të zellshëm dhe të ndershëm në kryerjen e detyrës. Rëndësi të veçantë V. Xhuvani i ka kushtuar politikës së jashtme. Ajo duhej të ishte e shkathët, të mbështetej në vendet ku kishte të mërguar shqiptarë. Vëmendje të veçantë i ka kushtuar gjithashtu marrëdhënieve me fqinjët, veçanërisht edhe me fuqitë e mëdha.

Si parlamentar e përqendroi vëmendjen në rolin e Parlamentit si organ ligjvënës. Në çdo shtet parlamenti ka rëndësi më të madhe se organet e tjera shtetërore, sepse ai vendos për ecjen përpara të vendit, nxjerr ligje dhe përcakton rrugët nëpër të cilat duhet të ecë qeveria.

Visarioni ka pasur kërkesa të mëdha ndaj parlamentarëve. Ata duhet të jenë të përkushtuar e në mbrojtje të kombit, të palodhur në kryerjen e detyrave dhe të gatshëm për të dhënë mendime me vlerë për përparimin e vendit. Deputeti duhet të propozojë projekte e punë të mira, të dobishme dhe të nevojshme për popullin, të kontrollojë dhe të kritikojë me arsye dhe në dobi të mbarëvajtjes së vendit. Deputeti nuk duhet të jetë avokat i ministrave e as i qeverisë, ai duhet të jetë avokat i palodhur për të drejtat dhe nevojat e popullit dhe për interesat e shtetit. (*Bisedime të Këshillit Kombëtar, mbledhja 45, faqe 144, 23.9.1920*)

Cilat ishin mendimet e Visarionit për shtetin e ri të porsaformuar? Për të mos rënduar popullin me taksa ai kërkonte që aparati shtetëror të ishte i thjeshtë dhe sa më pak i kushtueshëm. Këtë ide e shprehu në mbledhjen e 65-të të Këshillit Kombëtar më 30 shtator të vitit 1920 kur u diskutua për ngritjen e ministrive të Bujqësisë, Tregtisë dhe të

Luftës. Mendonte të mos kishte dy ministri, por vetëm një ministri për ushtrinë dhe xhandarmërinë. Ai kundërshtoi dhe vendimin për të pasur dy ministri, atë të Tregtisë dhe të Bujqësisë.

Visarioni i ndiqte me kujdes dhe me vëmendje të veçantë të gjitha problemet që shtroheshin në Parlament, por si klerik iluminist më shumë interesohej për problemet që i përkisnin Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Jashtme. Për të arsimit ishte pasqyra se në ç'shikallë gjendet ose më mirë do të gjendet nesër kombi, sepse ai përgatit bazat e së ardhmes, që janë baza dhe shpresa shtetërore. Lartësimin e kombit e sheh nëpërmjet arsimit të shëndoshë të të gjithë brezave, veçanërisht të femrave dhe nënave. (*Bisedime të Këshillit Kombëtar, mbledhja 50, faqe 111, viti 1920*)

Këto ide e shtynin Visarionin që të kërkonte nga shteti i ri të kujdesej për fëmijët e prindërve të emigruar në Rumani, Greqi, Bullgari e Turqi që të mësonin gjuhën shqipe, ndryshe ata do ta humbisnin atë dhe do të rumanizohen, greqizohen a turqizohen dhe do të humbin ndjenjat kombëtare. Këto ide të shprehura në vitin 1920 kanë edhe sot tingëllim të veçantë aktual. Janë këto bindje që e shtyjnë të bashkojë protestën e vet me revoltën e bashkëqytetarëve kundër ideve të Qeverisë dhe të Ministrisë së Arsimit për mbylljen e shkollës historike Normale të Elbasanit. Ai hodhi poshtë dredhinë e ministrit të Arsimit, që desh ta transferonte shkollën normale në Shkodër. Ai proteston dhe shprehet në Parlament: “Kjo shkollë nuk asht mbyllë as në kohën e sundimit të Esat Toptanit, as të Austrisë, as të Italisë e do të mbyllet sot në shtetin shqiptar. Tue dijtë se bashkimi i gjuhës kombëtare vjen prej shkollës, shtetet i kanë vumë fuqi të mëdha shkollave, tue pasë pranue se dialekti i Elbasanit asht gjuhë zyrtare, asht i domosdoshëm vazhdimi i shkollës normale, kjo u shërben banorëve të Elbasanit, që nuk kanë vaktin me i çue fëmijët në shkollat e Evropës. (*Bisedime të Këshillit Kombëtar, mbledhja 54, faqe 123, 7-10-1920*)

Protestën e vet e përsërit disa herë në Parlament dhe arriti të thirret në interpelancë ministri i Arsimit dhe të vihet në rendin e ditës çështja e shkollës Normale. Diskutimet e deputetëve të tjerë në përkrahje të Visarionit forcojnë idenë se Normalja është e vetmja urë që do të bashkojë dy dialektet. Frytet e asaj shkolle janë të dukshme, se të gjithë mësuesit e krahinave kanë dalë nga ajo shkollë. Mbas disa diskutimesh u vendos me shumicë votash që shkolla të mos mbyllej dhe u detyrua Ministria e Arsimit të merrte masa që ajo të vazhdonte rregullisht mësimin dhe të pajisej me kuadrin përkatës.

Idetë e Visarionit për shkollën dhe gjuhën shqipe lidhen me mbresat e tij të hershme të kultivuara në shkollën e lagjes Kala në diskutimet familjare. Ato janë vazhdimi i ideve të Kristoforidhit dhe të rilindasve të tjerë, ato janë ide iluministe të lidhura me dashurinë për atdhe. Për të vënë në jetë këtë bindje është i gatshëm të sakrifikoheshin një pjesë e fondeve të kishës. Ai thotë në parlament: “Shkollat janë me të vërtetë shumë të nevojshme dhe do të ishte me vend, që në vend të tre kishave të ketë një kishë, por të ketë shkolla për të qenë, sepse kishën mund ta bajë njeriu në shtëpinë e vet”. Ai propozon që fondet që vijnë nga kullotat e pyjet e vakëfeve të kalojnë në favor të arsimit.

Problemet e arsimit kombëtar i shihte si detyra shumë të rëndësishme. Ai mendon për domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës kombëtare, e cila do të sjellë njësimin e kombit shqiptar, kërkon zbatimin e detyrueshëm të së folmes së Elbasanit në të gjitha tekstet shkollore, këtë e mbështet në vendimet e Komisionit Letrarë shqipe të mbledhur në

Shkodër në vitet 1916-1917. Ai thotë: “Ministri i Arsimit që do të botojë tekste shkollore në dialekte të ndryshme do të ketë mallkimin e brezave që do të vijnë”.

Veç gjuhës në shkollë, Visarioni i dha rëndësi të veçantë cilësisë së dhënies së mësimit e në mënyrë të veçantë edukatës. Si klerik largohet nga mendimi i dhënies vetëm të edukatës fetare. Ai shprehet: “nxënësve duhet t’u japim një mësimit moral të vërtetë, të dinë të mirën dhe të keqen, këtë e kam për parim dhe e kam përdorë edhe në kishë”.

Visarioni e shihte punën e arsimit si një çështje jetike për shtetin, po të mos i jepej rëndësi kësaj çështjeje do të kryhej një vepër antishqiptare, antishtetërore. Gazeta “Agimi” e marsit të vitit 1923 botoi lajmin se në Durrës më 30 mars u bënë zgjedhjet për deputetë dhe fituan këta katër veta: 1-Shazivar Alltuni me 121 vota, Osman Myderrizi me 121 vota, Arkimandrit Visarion Xhuvani me 119 vota dhe Xhafer Ypi më 118 vota.

Me organizimin e parlamentit të ri Visarioni bëri këtë betim: “Betohe në emën të Perëndisë mbi nderin tim se kam për të rrujtun besnikërisht mëvetësinë e tanësisë tokësore të Shqipnisë, se kam për t’i ndenjün besnik Atdheut e për t’i dalë zot Statutit e ligjeve të shtetit, e se kam për të krye detyrën time me ndërgjegje të plotë për të mirën e përgjithshme pa u pengue aspak prej interesash të veçanta a krahine”.

Fjala e nderit e dhënë në Këshillin Kombëtar më 1920 dhe betimi i deputetit më 1923 u bënë kredo e jetës së Arkimandritit Visarion Xhuvani. Ai punoi për të mirën e përgjithshme duke qëndruar larg interesave krahinore e personale. Ai ishte mjaft aktiv, shumë i vëmendshëm dhe i kujdesshëm gjatë diskutimit dhe miratimit të vendimeve të Parlamentit, i cili me vendimet e veta po i jepte formë të plotë dhe të re shtetit shqiptar.

Gjatë diskutimit të kodit civil Arkimandriti Visarion kundërshtoi deputetët, të cilët e paraqisnin Mustafa Qemalin si shembull për t’u imituar e për të përshtatur ligjet tona sipas ligjeve të Turqisë. Një veprim të tillë e quan të dëmshëm se populli shqiptar ka historinë e vet, ka zakonet e veta të vjetra, ligje të pashkruara, të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me ato të Turqisë. Ai kërkoi që ligjet tona të jenë të ngjashme me ato të Evropës Perëndimore, me vendet më të përparuara të kohës.

Mendimet për një legjislacion të kohës me fytyrë nga përparimi evropian janë shprehur qartë kur në Parlament u diskutua për të drejtat e gruas. Ai kërkoi që në ligj të mos flitej vetëm për gratë, por edhe për burrat. Duke parë ligjin osman nga pikëpamja historike, i cili ishte i mbështetur në baza fetare, mendon që ne duhet të kemi ligje të ndryshme nga ligjet osmane, por të ngjashme me vendet e përparuara evropiane. Ai mbështet deputetët që kërkonin rrëzimin e ligjeve që kishin mbetur nga koha e Perandorisë Osmane, për shembull ligjin që nuk e paraqiste gruan të barabartë me burrin, ligjin e trashëgimisë sipas të cilit mashkulli merrte një pjesë ndërsa femra gjysmën, ligji që i jepte burrit të drejtën e ndarjes, kurse gruas nuk ia jepte këtë të drejtë.

Diskutimin e vet për këto probleme e mbyll me këto fjalë: “Ne duhet ta kemi për nder që na kanë rritë. Edukatën që kemi sot ua kemi borxh nanave tona. Gjendja e grave nuk asht aq e mjerueshme si mendojnë disa, sepse këto qenë ato gra të cilat nxorën Skënderbeun e njerëz të tjerë të famshëm që i dhanë nder Shqipnisë”. (Bisedime të Këshillit Kombëtar, mbledhja 467-viti 1923).

Kur diskutohej statusi i nëpunësit, Visarioni jep këto mendime: “Nëpunësi i Shtetit duhet të jetë i kualifikuem, me kulturë. Pagat e tyne të jenë të diferencueme dhe të varen nga shkalla e arsimit. Me pagën e vet nëpunësi duhet të përballojë jetesën kudo që të punojë. Kështu do të jetë ma pak i korruptueshëm. Nëpunësi i administratës asht

personi që e paraqet vendin para të huejve, prandaj ata duhet të jenë të aftë, të ndërgjegjshëm për punën e tyre dhe t'i trajtojnë shtetasit si të barabartë”.

Visarioni kishte mendime të qarta për ndarjen e pushteteve dhe kishte koncepte të drejta për kompetencat e tyre. Ai ishte për një shtet ligjor dhe respektonte me fanatizëm statutin themeltar, atë e quante të barabartë me librat e shenjtë, me ungjillin e kuranin. Kërkonte që në Shqipëri të veprime vetëm sipas ligjeve të mbështetura në statut (kushtetutë).

Në diskutimin për çështjen e Esat pashë Toptanit, mbasi dënon tradhëtinë e Esat Toptanit, e quan të padrejtë vendimin e parlamentit për konfiskimin e pasurive të Esatit, sepse një vendim i tillë nuk është marrë nga gjykata, dallon mirë pavarësinë e gjyqësorit ndaj Parlamentit apo Qeverisë. Vendimin e Qeverisë e quajti të drejtë në pikëpamje morale, por të paarsyeshëm në logjikë gjyqësore. Nëse kemi besim në gjykatoret tona duhet që çështja t'i dërgohet gjyqit. Pse duhet të kemi frikë a nuk është ky gjyq kombëtar?

Në mbledhjen e 43-të të Parlamentit më datën 21-V-1923 u diskutua ligji për tokën. Në këtë ligj dallon dy palë interesash, të pronarëve dhe të bujqëve. Ky ligj duhet të përmirësonte gjendjen e bujqëve, por të mos cenoheshin të drejtat e pronarëve. Detyra e klerikut e kish çuar Visarionin nëpër kishat e manastiret e fshatrave, kështu që kishte njohur mirë varfërinë e tyre, prandaj ai ishte më kërkues se të tjerët në mbrojtjen të interesave të fshatarësisë. Gjatë diskutimit të ligjit për ngritjen e një ferme nga englezi Erikson kërkoi që bujqit e atij çifligu ku do të ngrihej ferma të mos nxirreshin jashtë, por të punonin në fermë, sepse nesër mund të vinte një fermer tjetër, i cili mund t'i detyronte bujqit që të largoheshin nga tokat e tyre.

Gjatë diskutimeve në Parlament u jep rëndësi edhe gjërave më të vogla. “Si teolog nuk kam dijeni për të gjitha problemet, por si përfaqësues i kombit jam i detyruem të rrëmoj andej-këtej dhe të marr kuptime dhe dijeni edhe për disiplinat e tjera, sepse duhet të jap mendime dhe të votoj në parlament”. Ai diskuton për problemet e taksave doganore, përqendron vëmendjen në shtresat e varfëra, dëgjonte ankesat e tyre dhe ishte për uljen e taksave, ato të jenë të diferencuara, njëkohësisht kërkoi që të viheshin taksa për letrat e cigareve, pijet alkoolike etj, dhe paralajmëroi rrezikun e kontrabandës.

Si teolog ishte mbrojtës i vlerave kulturore kombëtare, të kishave të vjetra, veprave të artit që janë në to. Kjo ndjenjë e shtyn të mbajë qëndrim kritik në parlament ndaj marrëveshjes midis Francës dhe Shqipërisë për gërmimet arkeologjike në Shkodër, Durrës dhe Apolloni. Visarioni mbrojti interesat e vendit ndaj të huajve. Kërkoi që arkeologët e huaj t'i vlerësojnë njësoj si objektet që do të zbulohen dhe do të shkojnë për zbulimin e muzeumeve të Francës, dhe të objekteve të palëvizshme si tempujt e vjetër që janë ndërtuar disa shekuj para Krishtit. Ato kanë rëndësi për ne dhe në të ardhmen do të bëhen burim fitimi sepse do të vizitohen nga turistët e huaj dhe nga kureshtarët e vendit.

Në mbledhjen e 27-shtatorit të vitit 1923 Visarioni thotë: “Due që edhe unë të baj detyrën time, duke mos përdorun vetëm lavdërime, por sa të jetë e mundun edhe qortime të arsyeshme në mënyrë që plagës t'i gjendet shërimi, të ndihmohet shteti dhe të përmirësohen të metat”. Ai qortoi Ministrinë e Arsimit për mangësitë në punët e dikasterit dhe për mbylljen e disa shkollave. Kritikoi rëndë Ministrinë e Jashtme duke thënë: “Zotnij deputetë! Duhet ta dini se shumë herë nga një minutë, kur asht i zoti ministri i Jashtëm, varet ndriçimi ose errësimi i gjithë shtetit”. Nga ministri i Punëve të Brendshme

kërkon që t'i mësojë nëpunësit e administratës në qytet e në krahina të ndryshme të Shqipërisë që të mos kenë asnjë gram fanatizmi, por të veprojnë me urtësi dhe delikatesë. Ashpër kritikon Ministrinë e Luftës: “Më vjen keq që në shërbim të kësaj Ministrie gjenden njerëz që nuk do të ishin të zotë as me mbjellë pras, e janë oficerë e marrin rroga të bollshme”.

Si deputet ai u bën thirrje qeveritarëve që të pastronin shtetin prej atyre që janë duke shpërdoruar besimin dhe djersën e kombit. Të rregullohen oficerët e pagat si dhe nëpunësit e tjerë që i mbanin kot në mënyrë të pamërituar titujt dhe gradat. “Të kenë dhimsuni për djersën e popullit që nuk po fiton asgja me mundime të mëdha, t'i bindin ata se të gjithë janë një karshi shtetit, e njisoj gjithashtu para ligjës”.

Problemet e fesë zunë një vend të veçantë në seancat parlamentare. Në diskutimet e veta V. Xhuvani vuri theksin në çështjet më të rëndësishme dhe të veçanta për shtetin shqiptar, në të cilin vepronin tri fe të ndryshme. Në një nga diskutimet e veta të vitit 1925 ai thotë: “Të gjithë e dimë se çështjet fetare kanë qenë e janë të ngatërrueme këtu. Të gjithë e dinë sa i kanë kushtue shtetit. Mos dhantë Zoti që të bahen vegla për të ardhmen”. Meqenëse te ne ka tri fe, ato mund të bëhen vegla për shkatërrimin e shtetit, prandaj këto çështje duhet të rregullohen sa më parë dhe këtë rrugë rregullimi ai e shpreh mjaft qartë. Parlamenti nuk është duke rregulluar çështjen e feve nga pikëpamja e dogmës së besimit të fesë. Ai nëpërmjet qeverisë duhet të rregullojë veprimet e vendimeve administrative të kryetarëve të feve dhe të çdo sektit të tyre. Ne duhet të kemi një ligj, i cili i jep të drejtë qeverisë të përkrahë fetë. Por që qeveria të mund të kryejë detyrën e vet sa më mirë ka shumë rëndësi emërimi i kryetarëve të feve. Ata duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos cenohen interesat e kombit, sepse edhe sot më 1923, që kemi një shtet të tillë, nuk kemi shpëtuar nga intrigat e huaja me anë të feve. Qeveria duhet të jetë në brendësi të veprimtarisë fetare dhe të dijë detyrën e vet, këtë do ta bëjë në bazë të ligjit, vetëm kështu në rast se fetarët veprojnë kundër shtetit, ose në rast të mosmarrëveshjes fetare a të prishjes së qetësisë e ngjalljes së pakënaqësisë së popullit, shkaktarët të gjykohen ose të nxirren jashtë shtetit.

Visarioni kërkoi një ligj, i cili do të parandalojë dhe evitojë anarkinë fetare dhe ngatërresat kombëtare. Ky ligj duhet të jetë i thjeshtë e të ketë vetëm dy nene.

Neni i parë: - Cakton ritet fetare të çdo feje dhe dogme fetare. Qeveria duhet të njohë në veprime detyrat e tyre fetare. Në këtë mënyrë caktohen edhe cilësitë e fetarëve nga pikëpamja e interesit të shtetit, d.m.th të jenë nënshtetas shqiptarë dhe njerëz të njohur, sigurisht që nuk mund të punojnë kundër interesit të Shqipërisë. Këta duhet të kenë një dekret prej kryetarit të çdo qendre të naltë që gjendet në Shqipëri mbi çdo fe e dogmë fetare.

Neni i dytë: Të ketë një ligj Qeveria e sidomos gjykatorja e Shqipërisë, ku të dihet cilat janë kompetencat dhe të drejtat e çdo fetari dhe këshilli fetar që është rregulluar sipas Statutit të brendshëm të vet e të secilit komunitet fetar, të pranuar më parë nga Qeveria.

Miratimi i një ligji të tillë kërkonte që kleri i lartë të jetë patjetër prej race shqiptare, ndërsa Visarioni nënvizon se ata nuk mjafton të jenë prej race shqiptare, por do të ishte e nevojshme që të jenë figura të njohura edhe si patriotë, por të pranojnë edhe pozitën e Qeverisë. Pra kryefetarët medoemos të jenë prej race shqiptare brez pas brezi, për të tjerët kjo mjafton të jenë vetëm nënshtetas shqiptarë. Sa për klerin e shkallës së tretë e të katërt, si prifti, hoxha etj, nuk është nevoja të jenë prej race shqiptare, mjafton të

jenë nënshtetas shqiptarë. Por edhe për këta duhet të bëjmë kujdes se janë pikërisht këta që do të hyjnë në çdo shtëpi dhe mund të mbjellin farën e shqiptarizmit dhe të antishqiptarizmit.

Mbas shumë diskutimesh në parlament, në mbledhjen 52 të datës 31-V-1923 u vendos kjo formulë për klerin shqiptar:

a-Të jetë nënshtetas shqiptar.

b-Të dijë gjuhën shqipe.

c-Të gëzojë të drejta civile politike.

ç-Të jetë i racës shqiptare e prej tre brezash në Shqipëri.

Nuk mund të jenë ata që më 28 nëntor e këtej kanë luftuar çështjen kombëtare”.

Gjatë diskutimit për këto probleme, Visarioni, i nisur nga ideja se ortodoksia ka në frymën e vet nacionalizmin dhe se kleri i fqinjve ballkanikë ka ndihmuar dhe ka qenë iniciator i lëvizjes kombëtare, ata mund të vijnë për të na ndihmuar, por ai thekson në mënyrë të prerë: “Nëqoftëse ortodoksizmi do të kish frymë nacionaliste në organizimin e vet, kjo nuk do të thotë që t’u lemë dorë të lirë të huejve në kryesi të fesë për të përfitue nga ky shpirt. Ortodoksizmi shqiptar nuk do t’i lejë interesat kombëtare në dorë të të huejve, sepse do të dalin nga gjini i kombit tonë dhe prej zjarrit të votrës së shqiptarizmit e jo prej të huejve. Pse ata kanë punue për vendin e tyne nuk do të mbushim vendin tonë me fetarë grekë, sllavë e ku di unë”

Në Parlament Visarioni e përqendroi vëmendjen në dy probleme, në atë të pronave dhe të minoriteteve. Secila shoqatë, çdo komunitet, teqe, kishë, manastir të njihet si person moral (juridik) dhe të përfaqësohen sipas rregullave të tyre të brendshme të përcaktuara në statutin përkatës. Ndërsa çështjen e gjuhës së minoriteteve e sheh në dy plane. Së pari për minoritetet shqiptare që jetojnë jashtë atdheut çdo gjë të bëhet në gjuhën shqipe, ndërsa për minoritetet e tjera shprehet qartë: “Çdo minoritet fetar kombëtar organizohet dhe rregullon çështjen e fesë dhe të arsimit fetar ashtu siç do vetë”. Qëndrim të veçantë dhe shumë dashamirës mbajti ndaj vllahëve: “Ata mund të kenë kishat e tyne dhe të meshojnë në gjuhën e tyne, sepse ata fatet e tyne i kanë lidhun me ne, kurrë ndonjiherë nuk janë ba shkas ngatërresash, asnji dam nuk ka pa shqiptarizmi prej tyne, siç ka pa prej ndonji minoriteti tjetër. Vllahët nuk i konsideroj si të huej, i kemi pasun, i kemi dhe do t’i kemi vllazën, një bashkë me ne, në sofrën tonë do të shtrohen si kanë qenë shtruar, në të mirat dhe të këqijat tona dhe çdo gja që do ta kërkojnë me krahë hapun do t’ua japim, sepse e dimë që ata kurrë nuk kërkojnë gja në dam të shqiptarizmit. *(Bisedime të Këshillit Kombëtar, mbledhja 52, faqe 795, 31-5-1923)*

Të gjitha diskutimet e V. Xhuvanit në Parlament janë përshkuar nga objektiviteti dhe sinqeriteti, si klerik teolog kish dëshirë dhe u përpoq të ndihmonte shtresat e varfëra, nuk donte të dëmtohej shteti dhe synonte që të hynte kapitali i huaj, kryesisht ai perëndimor, që të kapërcehej varfëria dhe prapambetja ekonomike. Ishte i kujdesshëm që të mos cenoheshin interesat kombëtare. Përparimin e vendit e lidhte ngushtë me forcimin e kulturës kombëtare, me zbatimin e normave morale të bazuara në traditat e vlefshme kombëtare. Ai ishte përkrahës i kulturës evropiane perëndimore.

PËRPPJEKJET E ATDHETARËVE SHQIPTARË PËR AUTOQEFALINË E KISHËS ORTODOKSE SHQIPTARE

Dëshira e madhe e shqiptarëve për të përdorur gjuhën shqipe në liturgjinë kishtare e në shërbesat e veçanta ka qenë e hershme. Gjuha shqipe është parë si mjet i fortë dhe i domosdoshëm për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe për të shpëtuar nga trysnitë e huaja osmane, sllave, latine dhe greke.

Pararendës i këtyre përpjekjeve u bë kleri katolik duke filluar nga viti 1462 me Pal Engjëllin, me mesharin e Gjon Buzukut më 1555, me thirrjen për tolerancë fetare dhe për bashkim kombëtar nga Pjetër Budi (1566-1622) dhe më vonë me Pjetër Bogdanin (1625-1689).

E njëjta dëshirë dhe më e organizuar është shprehur nga kleri ortodoks në fillim me Naum Veqilharxhin (1797-1846), i cili në qarkoren e vet, veç të tjerash i jep rëndësi përdorimit të gjuhës shqipe në kishë dhe mësimin të saj nga fëmijët. Këtë dëshirë e konkretizoi Anonimi i Elbasanit duke përkthyer pjesë nga ungjilli që lexohen të dielave në kishë. Dhaskal Todri (1730-1805) e plotësoi duke shtuar përkthimet e liturgjisë kishtare. Autoriteti që vazhdoi të punojë për shqiptarizimin e kishës dhe që shtoi përkthimet, tani jo vetëm për liturgjitë kishtare, por edhe për edukimin e fëmijëve, është Kostandin Kristoforidhi (1826-1895).

Futja e gjuhës shqipe në shërbesat fetare është bërë me shumë vështirësi. Atë e kanë penguar trysnia osmane, intriga fanariote dhe megaliideja. Të gjitha këto, herë bashkë e herë të veçuara, herë me diplomaci dhe herë me forcën e kërbaçit apo të helmit kanë vepruar për të arritur qëllimin e tyre, denigrimin dhe pengimin e përdorimit të gjuhës shqipe. Martirë të parë u bënë Petro Nini Luarasi (1865-1911), që u helmua nga të huajt, Papa Kristo Negovani (1875-1905), të cilin e vranë me urdhër të dhespotit pse meshoi shqip, e më vonë disa klerikë të tjerë pësuan fatin e dy të parëve.

Për këto padrejtësi ka ngritur zërin dhe ka protestuar e përdyjavshmja “Lidhja Ortodokse” në vitin 1909. Lëvizja për pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare mori hov sidomos në kolonitë shqiptare (nga emigrantët ekonomikë) në Amerikë. F. Noli për atdhetarët shqiptarë të Amerikës më 1908 meshoi shqip, ndërsa në Bullgari dhe Rumani lëvizja kishte po ato pikësnyime. Në Rumani më 17 të vjeshtës së tretë të vitit 1909 At Harallambi nga Berati meshoi shqip. Këtë gjë bëri dhe Arkimandrit Ballamaçi, i cili i bëri thirrje Joaqimit III që të lejonte përdorimin e gjuhës shqipe në kishë. (*Lidhja Ortodokse – 1909*)

E gjithë kjo lëvizje dhe të gjitha këto përpjekje u bënë para vitit 1912, kur Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Ato ishin më të kufizuara dhe kisha shqiptare nuk mund të shkëputej nga ana organizative dhe ekonomike prej Patriarkanës së Stambollit.

Mbas vitit 1912 kur Shqipëria shpalli pavarësinë dhe u njoh si shtet sovran dhe i pavarur, lëvizja avancoi dhe mori karakter tjetër, tani në bazë të kanoneve të shenjta. Kisha Ortodokse Shqiptare kërkoi jo vetëm përdorimin e gjuhës, por autoqefalinë, ashtu si të gjitha kishat e tjera të Ballkanit.

Një sinjal i tillë ka qenë mosbindja e ortodoksëve të Pogradecit, të cilët në maj të vitit 1920, gjatë javës së madhe, edhe pse qenë të urdhëruar të këndonin greqisht, ata kënduan shqip dhe Atë Thanasi përktheu në shqip ungjillin pas çdo meshe. (*Gazeta “Kuvendi”, maj 1920*)

Gazeta “Koha” e 24 dhjetorit 1921 shkruante se Mitropolia e Korçës ka vendosur që “Komuniteti Ortodoks i Korçës që quhej “Komuniteti ortodoks grek” do të quhet Komuniteti Ortodoks Shqiptar”. Që sot çdo shkresë që hyn në zyrat e Mitropolisë do të shkruhet në gjuhën shqipe”.

Në këtë kohë lëvizja atdhetare-fetare ishte e përçarë, kishte mjaft dashamirë që mendonin ta linin të pandryshueshme gjendjen, pëlqenin dominimin e gjuhës greke, flisnin për mungesën e klerit të lartë kanonik, për paaftësinë e gjuhës shqipe që të sillte sa më të plotë fjalën e Zotit e të tjera pretendime të cilat nxiteshin nga propaganda shoviniste greke. Lëvizja ishte e paorganizuar. Dhespotët e huaj bënë propagandë antishqiptare dhe krijonin pengesa nga më të ndryshmet. Literatura liturgjike kishte mjaft mangësi, kleri i ulët (priftërinjtë) ishte i pastërvitur sa duhet. Dhimogjeronditë (pleqësitë) e dioqezave vepronin në mënyrë të pavarur sepse nuk kishin një sinod të përbashkët për t’i organizuar dhe për të paraqitur kërkesat e tyre duke u ndihmuar edhe nga shteti shqiptar. Ballafaqimi dhe kundërvënia ndaj propagandave të huaja përçarëse ishte e dobët dhe e paorganizuar mirë. Kjo përçarje ndërmjet ortodoksëve sa vinte e thellohej, ajo po bëhej e rrezikshme edhe për unitetin e shtetit të ri të porsaformuar.

Në këtë situatë Pleqësia e Tiranës pëlqeu mendimin e Arkimandrit Visarion Xhuvanit për të organizuar sa më shpejt një mbledhje të përgjithshme panortodokse kishtarë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjithë klerit ortodoks. Këta përfaqësues të kenë të drejtën të marrin vendime kishtarë të patundshme dhe fuqiplota. Këtyre vendimeve duhet t’i bindet gjithë kleri ortodoks, pleqësitë dhe populli ortodoks.

Gjatë viteve 1920-1923 edhe organet ligjvënëse, si Këshilli Kombëtar (i vitit 1920) dhe Parlamenti (i vitit 1923) i kushtuan rëndësi ligjeve për institucionet fetare, që ato të kishin frymë kombëtare dhe Kisha Ortodokse Shqiptare të futej në rrugën e pavarësisë. Që nga viti 1919 ortodoksët shqiptarë kërkuan të kenë një institut të pavarur dhe të miratuar nga Qeveria. Për realizimin e kësaj kërkesë punuan dy deputetët klerikë ortodoksë, Noli dhe Visarioni. V. Xhuvani atëherë shkeli gjithë Shqipërinë për të përgatitur opinionin e për të realizuar autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Për të shëruar plagën e përçarjes midis ortodoksëve, kryetari i Bashkisë së Durrësit u bëri thirrje ortodoksëve për t’u mbledhur në një kongres dhe për të përcaktuar rrugën në të cilën duhej të ecte Kisha Ortodokse e Shqipërisë. Më 10 shtator të vitit 1922 në Berat u mbledh Kongresi i parë i ortodoksëve shqiptarë. Peshën më të rëndë nga ana organizative dhe kanonike e mbajti Visarion Xhuvani, sepse ai qe i vetmi klerik teolog njohës i mirë i kanoneve kishtarë dhe njohës i ligjeve të shtetit si anëtar i Këshillit Kombëtar.

Kongresi i Beratit shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare dhe mori vendime të rëndësishme. Ai miratoi Statutin provizor dhe Rregulloren e drejtimit të kishës, zgjodhi Këshillin e Lartë, i cili përbëhej nga anëtarë klerikë kanonikë dhe laikë. Ky Këshill kishte atributet e Sinodit dhe do ta kishte këtë detyrë deri sa të formohej Sinodi Episkopal. Kështu u përcaktua rruga nëpër të cilën do të ecte Kisha Ortodokse Shqiptare.

Kongresi realizoi aspiratat e ortodoksëve shqiptarë, dëshirat e rilindasve dhe të martirëve të kishës, përdorimin e gjuhës shqipe në kishë. Librat e rinj liturgjikë do të miratoheshin nga Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Shqiptare.

Që Patriarkana e Stambollit të miratonte autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare duhej të hartohej Statuti legal i Komunitetit fetar. Për këtë arsye brenda dy

vjetëve duhej të dorëzoheshin episkopë kandidaturat e përshtatshme nga radhët e klerikëve shqiptarë.

Kongresi u miratua njëzëri nga të gjithë banorët e vendit, nga i gjithë populli shqiptar. Në fletoren zyrtare të Shtetit Shqiptar të vitit 1922 shpallja e Kongresit u quajt ditë historike.

SI U ZHVILLUAN NGJARJET PAS KONGRESIT TË BERATIT

Zbatimi i vendimeve të Kongresit të Beratit nuk eci me atë shpejtësi që kërkonte koha. Dy episkopët e ardhur për të ndihmuar (Jerotheu dhe Kisi) nuk përmbushën sa duhet dëshirën e ortodoksëve shqiptarë. Ata i dhanë shumë rëndësi zbatimit të parimeve kanonike si dhe porosive të Patriarkanës. Të dy më 21 nëntor të vitit 1923 bënë dorëzimin e Nolit si peshkop. Mbas kësaj date Kisha Kombëtare Shqiptare kishte tre peshkopë kanonikë. Këta të tre (Jerotheu, Kisi, Noli) mund të formonin Sinodin Episkopal, por nuk ndodhi kështu. Atëherë Jerotheu u largua në malin e Shenjtë, K.Kisi u mbyll në manastirin e Ardenicës, kurse Noli u bë Kryeministër.

Gjendja u keqësua. Zbatimi i vendimeve të Kongresit të Beratit po haste vështirësi të reja. Përçarja po thellohej. Në këtë situatë Patriarkana Ekumenike ndërhyri për të zbatuar planet e veta. Ajo e kundërshtoi hapur autoqefalinë. Shfrytëzoi mungesën e kuadrit të lartë klerikal, përgatitjen “e mangët” teoriko-teologjike dhe kërkoi që të kishte monopol të plotë në drejtimin e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Me largimin e Nolit (1923) mitropolia e Durrësit, që ishte më e madhja, kish mbetur pa titullar. Në këtë gjendje ishte edhe mitropolia e Korçës, sepse qe braktisur nga Imzot Jerotheu. Për të përballuar këtë situatë të rëndë Këshilli i Lartë i Kishës, me dekret nr. 686 të datës 28-3-1925, ngarkoi Visarionin të drejtonte mitropolinë e Durrësit. Ai e vlerësoi situatën dhe rëndësinë e fazës së re që po kalonte Kisha Ortodokse Shqiptare. Këtë e shprehu në qarkoren e parë që u drejtoi besimtarëve të dioqezës së vet, në të cilën parashtrioi dy kërkesa, e para me karakter fetaro-filozofik e patriotik dhe e dyta me karakter organizativ drejtues.

Në këtë qarkore u kërkoi besimtarëve që të punonin me shembullin e një kristianizmi të mirë e përparimdashës, me shpirtin e bashkimit e të vëllazërimit njerëzor. Të përfitojmë nga çdo qytetërim duke qëndruar larg çdo pseudoqytetërimi që është i dëmshëm për moralin dhe atdheun. Qarkorja nënvizonte domosdoshmërinë e një drejtimi të mirë dhe hartimin e një rregulloreje të përbashkët për të gjithë komunitetin ortodoks shqiptar. Zëvendësit e tij të mos kishin të bënë me asnjë veprim të papëlqyeshëm antikanonik dhe antihierarkik. Me çiltërsinë e vet V. Xhuvani ngjalli besim dhe u dha krahë besimtarëve dhe klerikëve shqiptarë.

Visarioni, që kish filluar të merrej energjikisht me organizimin e Kishës Ortodokse Shqiptare në Shqipërinë e Mesme që nga viti 1919, nuk mund të pajtohej me kërkesën për durim dhe përunjësi të ndonjë episkopi që kish ardhur për të ndihmuar. Koha kërkonte veprime të guximshme, sakrifica, punë të kualifikuar e respektim të kanoneve të shenjta.

Dëshira për të drejtuar Dioqezën e Durrësit në bazë të vendimeve të Kongresit Kishtar të Beratit dhe sipas detyrës së ngarkuar nga Këshilli i Lartë, e nxitën Visarionin që të mos u bindej qëndrimeve të Patriarkanës. Për këtë qëllim shkoi në Mal të Zi ku u

hirotonis peshkop më 3 maj të vitit 1925 dhe kështu mundi të drejtonte dioqezën pa pasur asnjë shkelje kanonike.

Ky veprim pati jehonë të dyfishtë. Për disa ishte shpresëdhënëse, ndërsa disa të tjerë prisnin zemërimin e Patriarkanës. Edhe disa anëtarë të Këshillit të Lartë ishin zemëruar, sepse sipas tyre V. Xhuvani nuk u kishte marrë leje. Ata deshën të mos ia njihnin gradën episkopale.

Ndërsa gazeta “Koha” në artikujt e 16 majit dhe të tetorit 1925 e ka vlerësuar në këtë mënyrë: “Lajmërohem gjysëm zyrtarisht se Arkimandrit Visarion Xhuvani u dorëzua episkop në Jugosllavi. Atje vajti pa marrë lejen e Këshillit të Lartë duke shkelur rregullat. Koha do ta kishte uruar, por prapë nuk dëshpërohem. Ai do të qëndrojë në një anë dhe do të presë pa marrë pjesë në kishë sa të vijë urdhrat e Kishës Hierarkike, që kundërshtarët të mos gjejnë rastin për të luftuar patriotizmin e Xhuvanit, i cili është ndër të parët që ka hedhur gurin e parë në themelet e Kishës Autoqefale Shqiptare. Fati i Visarionit është i lidhur me fatin dhe rregullin e kishës. Koka e falur nuk pritet. Hirësia pranoi dhe iu bind urdhërave të Kryesisë së Kishës dhe po qëndron si oshënar besnik. Të gjithë kanë bërë gabime, por ato u bënë për t’i shërbyer çështjes kishtare dhe Ai e bëri këtë gabim, sepse do që t’i shërbejë më mirë se ç’i ka shërbyer deri sot”.

Për të hetuar vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit, Patriarkana dërgoi Imzot Krisanthin. Ky do të ndiqte për një kohë të gjatë problemin e Autoqefalisë. Mbase u takua me Kryesinë e Kishës, me Mbretin e Shqipërisë dhe me shumë persona që favorizonin opinionin grekofon, bëri të mundur nënshkrimin e një marrëveshjeje, e cila mori emrin “Akordi i Tiranës”. Ky Akord nuk pati jetë të gjatë sepse në të vërtetë vuri kushte shumë të rënda dhe legalizoi ndërhyrjen në njëfarë mase në punët e brendshme të shtetit shqiptar. Akordi nuk u prit mirë nga qarqet ortodokse patriotike brenda dhe jashtë vendit. Kësaj ndërhyrjeje dinake i duhej kundërvënë në mënyrë bindëse me argumente kanonike, sepse vetëm kështu do të krijohej një opinion i shëndoshë brenda dhe jashtë vendit për të drejtën e ortodoksëve shqiptarë. Këtë detyrë e mori përsipër Imzot Visarioni. Ai shkroi dy libra me të cilat hedh poshtë pretendimet fanariote dhe disa artikuj në gazetën e kohës. “Gazeta e Korçës” në rubrikën “Çështja Kishtare” trajtoi temën e njohjes së autoqefalisë nga Patriarkana Ekumenike, të Sinodit Episkopal, të gjuhës kishtare dhe bisedimet me të dërguarin e Patriarkanës (më 30 qershor 1926). Në fletoren “Dajti” shkroi rreth çështjeve kombëtare-politike-Konstandinopol-Tiranë (13 maj 1926, Nr 13) dhe më 9 qershor shënimet nacional-shpirtërore dhe përfundimet ortodokse. Po në vitin 1926 përmbledhi artikujt dhe opinionet e kohës në veprën “Kujtim vepra dhe intrige”. Përfundimi i këtij dialogu fetaro-politik ishte edhe vepra me dy pjesë “Çështje politiko-religjioze Kostandinopol-Tiranë”.

Duke hyrë në polemikë me emisarin e dërguar nga Patriarkana, V. Xhuvani është i bindur se do të rritej zemërimi ndaj tij dhe dënimi do të rëndohej. Ai nuk u tremb si episkopët e tjerë të ardhur në Shqipëri për të ndihmuar, të cilët heshtën për këto probleme, sepse ishte i bindur se sado që të pengonte Patriarkana ajo nuk do të mund të pengonte kishat e tjera për të njohur autoqefalinë.

Në shkrimet e veta të vitit 1926 u ngrit me forcë kundër ndërhyrjeve të Patriarkanës së Kostandinopojës, e cila kërkoi të emëronte episkopët e vet në dioqezat shqiptare. Këtë veprim e quajti të paarësyeshëm dhe antikanonik sepse nuk ishte vepruar kështu as në Rumani, Serbi dhe në Poloni. Një veprim i tillë ishte antikanonik dhe për faktin se episkopi i Korçës, Imzot Jerotheu, Episkopi i Beratit, Imzot Kristofori dhe

Episkopi i Durrësit, Imzot Fan Noli, ishin kanonikisht në dioqezat e tyre. Ata kanë të drejtë të dorëzojnë episkopë të tjerë. Emërimi i episkopëve të huaj në Shqipëri prek dinjitetin nacional të Kishës Shqiptare dhe bëhet shkak për influenca të huaja.

Drejtimin e kishave ortodokse nga klerikë shqiptarë Visarioni e mbështeti në ligjet e shtetit shqiptar. Për ata kishte një ligj të posaçëm për komunitetet fetare të votuar në parlamentin shqiptar. Këto dispozita duhej të merreshin parasysh dhe të zbatoheshin bashkë me ato të Statutit Kishtar në fuqi të miratuar në Kongresin Kishtar të Beratit dhe të miratuar nga qeveria e asaj kohe.

Në përfundim të këtij dialogu, për këtë çështje ai shkruan: “Në emnofshim në Sinodin shqiptar persona që kanë luftue Kishën Autoqefale dhe shqiptarizmin deri sot, shpejt kemi për t’u pendue”.

Visarioni mbrojti me pasion e drejtësi, të bazuar në përvojën e kishave ortodokse të Ballkanit dhe në kanonet kishtarë përdorimin e gjuhës shqipe në liturgjinë fetare. Ai hodhi poshtë pretendimet fanariote që e paraqisnin gjuhën shqipe të paaftë për të plotësuar misionin e Ungjillit. Është i bindur se Ungjilli bëhet i kuptueshëm dhe plotëson qëllimin e vet kur është i përshtatur në gjuhën kombëtare: “Më 1872 asht botue përkthimi i Ungjillit prej Kostandin Kristoforidhit, por edhe para tij ka pasun përkthime të tjera, për këto nuk ka pasun asnjë kritikë. Kjo vërteton se gjuha shqipe asht në gjendje me i dhanë kuptimin e duhur ungjillit dhe meshës ashtu dhe ma mirë se gjuhët e tjera”.

V. Xhuvani theksoi se asnjë komb ortodoks në botë sot nuk përdor në meshë veç gjuhën amtare për çdo shërbesë fetare dhe për meshën e shenjtë. Në këtë vepër të vetën si edukator iluminist, që nuk e ndan nga edukimi atdhetar i brezave të rinj, kërkoi që fëmijëve në shkollë t’u mësohen gjuhët e gjalla si frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja, italishtja, sepse janë këto gjuhë që do t’u japin mundësi fëmijëve të njihen me përparimin e shkencave dhe do të kenë dobi për jetën e tyre.

Mendimet e shprehura në artikujt publicistikë në shtypin e kohës, si dhe librat e përmendur më lart, të shkruara dhe të botuara në vitin 1926, përbëjnë platformën teoriko-praktike në të cilën duhet të ecë kisha shqiptare. V. Xhuvani me anë të një polemike të çiltër, të argumentuar nga ana kanonike dhe patriotike iu kundërvu misionarëve të Patriarkanës, të cilët ishin kundër autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Ai përmbloodhi në mënyrë shumë lakonike mendimin atdhetar të ortodoksëve shqiptarë që mbronin idetë e shqiptarizmit.

FORMIMI I SINODIT DHE RËNDËSIA E TIJ

Një nga vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit ishte formimi i Sinodit episkopal me episkopë kanonikë brenda dy vjetëve. Nga viti 1922 deri në vitin 1929 kaluan shtatë vjet dhe ky vendim nuk u realizua. Mungesa e Sinodit komprometonte autoqefalinë e kishës dhe u jepte krahë qarqeve shoviniste greke që vazhdonin të kishin pozita dominuese në opinionin ortodoks shqiptar dhe në Patriarkanën Ekumenike. Gjatë këtyre viteve u krijuan dy tendenca, njëra drejtohej nga peshkopët e Korçës dhe të Beratit dhe ishte për një zgjidhje patriarkale e cila duhej të priste me durim deri sa të krijoheshin kushtet ashtu siç donte Patriarkana. Të dy mitropolitët punonin dhe nxirrnin lloj-lloj pengesash për të arritur qëllimet e tyre. Çdo ditë shtonin kërkesat dhe hartonin projekte, të cilat jo vetëm që nuk qenë kanonike, por ato edhe nuk u përshtateshin ligjeve kishtarë. Ato ishin të papajtueshme me interesat e kombit dhe me parimet shtetërore.

Tendenca tjetër, e cila mbështetej nga pjesa përparimtare e inteligjencies ortodokse shqiptare, kërkonte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Beratit. Ajo ishte për një zgjidhje të brendshme pa pritur urdhëra nga Patriarkana dhe drejtohej nga Imzot Visarion Xhuvani dhe mbështetej nga qeveria shqiptare.

Për të shpejtuar formimin e Sinodit sipas vendimeve të Kongresit të Beratit duhej njohur grada episkopale e Visarion Xhuvanit. Më 1 shkurt të vitit 1929 (katër vjet pas hirotonisjes) Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale, në marrëveshje të plotë me N.M e tij A. Zogun njohu gradën episkopale të Visarion Xhuvanit. Tani mund të formohej Sinodi Episkopal, por duhej vepruar me pjekuri, durim dhe guxim që të ruheshin kanonet e shenjta dhe të mos jepej shkas për keqkuptime, sulme apo denigrime, të cilat do të cenonin këtë veprim kishtar dhe patriotik. Pritja e mëtejshme do të ishte kohë e humbur, për këtë arsye u bë mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Ministrave e kryesuar nga Naltmadhnia e tij Mbreti Zog I. Këshilli i Ministrave ngarkoi Visarion Xhuvanin të gjente një ose dy peshkopë kanonikë të huaj për të dorëzuar kandidatët e mundshëm shqiptarë për peshkop.

Visarioni u nis për në Jugosllavi që të kërkonte ndihmën e Patriarkanës Serbe. Ai solli me vete Imzot Viktorin, Vikarin e Patrikut Serb dhe pa humbur kohë Visarioni dhe Imzot Viktori nga data 11 shkurt deri më 17 shkurt dorëzuan si peshkop Arkimandrit Çamçen dhe Ambrozin nga Elbasani dhe më 18 shkurt u formua Sinodi i Shenjtë, i cili zgjodhi Visarionin Kryepiskop.

Mbas shumë përpjekjesh më 25 shkurt të vitit 1929 u zgjidh nga pikëpamja kanonike dhe ligjore formimi i Sinodit të Shenjtë. Ai u betua para Mbretit dhe u miratua me dekret ligjor. Formimi i Sinodit ishte gëzimi i dytë pas Kongresit të Beratit. Episkopët pa humbur kohë vajtën në dioqezat e ngarkuara nga Sinodi. Ata u pritën me entuziazëm nga banorët pa dallim feje. Celebrouan meshë episkopale dhe tedeume. Në to mori pjesë paria e qyteteve përkatëse. Të gjithë banorët ortodoksë uruan formimin e Sinodit dhe shprehën dëshirën për të përkrahur vendimet e tij për shqiptarizimin e kishës. Ky entuziazëm mbarëpopullor dhe kjo mbështetje e njëzëshme ishte shprehje e miratimit të Sinodit të Shenjtë dhe garanci për të punuar pa u kursyer dhe për të vënë në jetë vendimet e Sinodit.

Gëzimi dhe entuziazmi popullor për Visarionin do ta angazhonin për punë të kualifikuar, të kujdesshme fetaro-kombëtare, që ta vinte Kishën Ortodokse Shqiptare në themele të çelikta, që mund t'u rezistonin viteve dhe intrigave të atyre që nuk e donin këtë përparim. Prandaj me urgjencë Visarioni organizoi komisionin që do të merrej me përkthimin e librave të shenjtë. Kujdes të veçantë i kushtoi organizimit të seminarit priftnor për plotësimin e shpejtë të kishave me kuadrin e nevojshëm që ata të meshonin në kishë tërësisht në gjuhën shqipe. Nisi jashtë disa studentë për të ndjekur studimet e larta teologjike që vendi të kish teologë shqiptarë.

Më 20 prill të vitit 1929 Sinodi i Shenjtë u dha fund punimeve. Ai shqyrtoi gjendjen e kishave dhe kërkesat e ngutshme të tyre, miratoi tekstet kishtarë që do të jepeshin për botim, vendosi futjen e rregullt të gjuhës shqipe në kishë, kreu reforma të rëndësishme sociale, psikologjike, shëndetësore, të cilat do të thellohen në të ardhmen. Çështjeve organizative dhe drejtuese u kushtoi vëmendje të veçantë. U dërguan katër qarkore, në të cilat udhëzohej si duhet punuar dhe ç'masa organizative duheshin marrë për të forcuar disiplinën dhe për t'u shërbyer më mirë besimtarëve.

Mbas krijimit të Sinodit zemërimi i Patriarkanës së Stambollit dhe i Patriarkanës greke u shtua shumë. Ata përdorën shtypin e kohës për të denigruar e demaskuar Kryetarin e Kishës, Visarionin, në disa artikuj Mbretin dhe anëtarët e Sinodit. Ata arritën deri aty sa t'u mohojnë gradat episkopale të dhëna në mënyrë kanonike dhe të miratuara me dekret mbretëror. U bënë thirrje ortodoksëve shqiptarë që të mos pranojnë asnjë urim e shërbesë fetare prej klerikëve të dorëzuar nga episkopët që formuan Sinodin Episkopal. Ky nënvleftësim dhe ky përçmim vazhdoi gjatë deri sa Patriarkana arriti qëllimin e vet. Këto shpifje të ulta u pasqyruan në disa shkrime edhe mbas viteve 1936-1937.

Detyra të tjera shumë të rëndësishme duhej të përmbushte Kryepiskopi i ri dhe Sinodi episkopal. Visarioni duhej të konsolidonte strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Me shpejtësi, pjekuri e burrimi, i mbështetur në normat kanonike, ai përballoi sulmet e kishës greke. V. Xhuvani nisi menjëherë përgatitjen e Kongresit të dytë panortodoks të Korçës, që do të ishte ngjarje e rëndësishme kombëtare dhe fetare. Ai tregoi kujdes për zgjedhjen e delegatëve, për përgatitjen e platformës, rishikimin e Statutit dhe të Rregullores provizore të miratuara në Kongresin e Beratit, për sigurimin e fondeve e për detyra të tjera që kërkonte Kongresi. Për këtë arsye u caktuan disa komisione dhe në krye vunë njerëzit më të devotshëm dhe të përgatitur.

Kohës së humbur me diskutime të gjata i erdhi fundi. Më 18-6-1929 në Korçë u mbledh Kongresi i dytë panortodoks kishtar shqiptar. Në të morën pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat e vendit. Mbas 15 ditë diskutimesh delegatët njëzëri firmosën vendimet e Kongresit, i cili shpalli Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare si pjesë të pandarë të Kishës së Shenjtë që është një e përgjithshme apostolike e përbërë prej të gjithë ortodoksëve të Shqipërisë. Ajo është e bashkuar kanonikisht dhe shpirtërisht me gjithë patriarkanat e shenjta dhe kishat autoqefale të gjithë botës. Gjuha zyrtare e kishës është gjuha shqipe. Kryepiskopi, Episkopët, zëvendësit e tyre lokalë, Ikonomi i madh Mitrofor dhe sekretari i përgjithshëm duhet të jenë prej gjaku dhe gjuhe shqiptarë dhe nënshtetas shqiptarë. Këto ishin disa nga vendimet e Kongresit II të Korçës.

Mbas miratimit të Statutit definitiv, më 20 korrik të vitit 1929 u miratua Rregullorja e Administrimit të Kishës. Kongresi panortodoks i Korçës e pajisi kishën me dy dokumentet më të rëndësishme në bazë të të cilave filloi puna operative për drejtimin e kishës.

Visarioni ishte i bindur se puna nuk mbaronte këtu, ajo sapo kishte filluar. Duhej punuar për ta pajisur atë me literaturën përkatëse liturgjike. Duhej vendosur disiplinë e fortë hierarkike, pasuria e manastireve duhej përdorur me nikoqirllëk. Shumë detyra të ngarkuara kërkonin të plotësoheshin me vullnet, sakrificë dhe me njohuri të thella teologjike. Këto nuk i munguan Kryepiskopit. Kongresi i dytë i Kishës Ortodokse Shqiptare i përgatitur me shpejtësi dhe kompetencë kanonike nuk u la shkas atyre që nuk e mbështetën që të shpifnin kundër tij. Ai ishte një përfundim i suksesshëm i një veprimtarie intensive serioze që e vendosi kishën tonë në një radhë me kishat e vjetra simotra të Ballkanit. Kongresi përcaktoi një strategji të qartë për të ardhmen.

Mbas Kongresit II të Korçës Visarioni në qarkoret dhe urdhërat e shumta shprehu idetë se shqiptarët janë të aftë të qeverisin dhe të organizohen vetë fetarisht, se solidariteti midis gjithë ortodoksëve përbën garancinë e bashkimit dogmatik fetar dhe atdhetar, se shpirti organizues dhe zotësia e pjesëtarëve klerikë dhe laikë do të gjejë mënyrat e përparimit edukativ, disiplinor dhe misionar të idealit të shenjtë fetaro-kombëtar.

Ndër vendimet kryesore të Kongresit ishte hartimi i buxhetit të kishës për vitin 1930. Ai kërkonte që të bëheshin kursime të mëdha, sepse ky buxhet do të përballonte shpenzimet e Sinodit dhe të personelit të tij për përkthime dhe për botimet e nevojshme për pajisjen e kishave me literaturën liturgjike të domosdoshme. Për zbatimin e këtyre vendimeve Visarioni ishte shumë i kujdesshëm. Ai u përpoq të bindë besimtarët dhe të nxisë klerikët e laikët të vepronin me nikoqirllëk dhe korrektësi ndaj detyrimeve fetare. Situata e vështirë ekonomike kërkonte që të bëheshin ndryshime edhe në organikat e dioqezave.

Masa të tjera të mbështetura në Statutin dhe në Rregulloren e Kishës forcuuan organizimin dhe drejtimin e Kishës, përdorimin e plotë të gjuhës shqipe në shërbesat fetare, ngritjen e koreve kishtarë, aftësimin e psalltëve, heqjen e ikonave të punuara nga piktorë të paaftë. Për të gjitha këto Visarioni ishte transparent dhe kërkues gjithmonë brenda etikës fetare, duke u përpjekur për të harmonizuar mirë punën metodiko-fetare për ngritjen cilësore të klerikëve me masa organizative administrative.

Kujdesi kryesor i Visarionit gjatë organizimit dhe drejtimit të kishës ka qenë shqiptarizimi i saj, duke ruajtur traditat e hershme dhe përdorimin e gjuhës shqipe në meshën e shenjtë dhe në shërbesat fetare. Për këtë qëllim deri më 25 mars të vitit 1931 nën kujdesin e kryepiskopit Imzot Visarionit u botuan librat më kryesorë të cilat do të përdorshin gjatë shërbesave fetare, si Ungjilli i madh i ndarë në 365 pjesë të përditshme, Apostulli i ndarë në 365 pjesë të përditshme, Libri i të Kremteve të mëdha, Libri i Shërbesës së vajit të bekuar etj. Po gjatë kësaj kohe u botuan 22 numra të revistës “Kisha Kombëtare” ku klerikët dhe populli gjenin mjaft materiale të shkruara nga Visarioni për meshtarët dhe psalltët për edukimin fetaro-kombëtar të ortodoksëve. Duke plotësuar literaturën kishtarë ai u përpoq ta shkëpusë kishën ortodokse shqiptare nga ndikimi shumëvjeçar i Fanarit dhe i Kishës greke.

Në disa qarkore radhazi V. Xhuvani shprehu pakënaqësinë e vet ndaj disa priftërinjve dhe psalltëve që nuk i përdorin në ceremonitë e përditshme fetare materialet e vëna në dispozicion të tyre sipas vendimeve të Sinodit Episkopal. Për këtë ai ka shkruar: “Asht vu re se disa prej mesharëve, sado që kanë në dorë librat e meshës së shenjtë në gjuhën amtare nuk i përdorin. Kjo punë shkaktohet vetëm nga moskujdesi dhe plogështia e klerit dhe e psalltëve. Kjo mungesë nuk u ban nder priftinijve dhe kishës nacionale”.

Kryepiskopi Visarion Xhuvani nuk u mbyll vetëm brenda mureve të kishës shqiptare. Ai zhvilloi një veprimtari të gjerë ndërkombëtare në të cilën e paraqiti denjësisht Kishën Ortodokse Shqiptare. Në vitin 1931 mori pjesë në Kongresin e Aleancës Ndërkombëtare për Paqe në Kembrixh të Anglisë. Në vitin 1932 u prit në audiencë nga Mbreti i Rumanisë Karoli II. Ka marrë pjesë në Konferencën e Bashkimit Botëror të Kristianizmit që u mbajt në Bukuresht, ku zhvilloi bisedime me Patrikun Miron, i cili shprehu simpati për Kishën Ortodokse të Shqipërisë. Në vitin 1933 Kryepiskopi Visarion mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Botëror për Miqësinë e Popujve në Sofje të Bullgarisë, ku u dekorua për paraqitjen dinjitoze dhe mbrojtjen e Kishës Shqiptare nga Mbreti Boris me urdhërin “Kryqi i Madh Kombëtar i Bullgarëve”.

Më 30 qershor të vitit 1935 Kryepiskopi Visarion mori pjesë në Konferencën e kishave të Ballkanit që u mbajt në Hercegnov të Jugosllavisë, ku referoi temën: “Gjendja aktuale e kishës me shtetin dhe influenza e kishës në shoqërinë kristiane të Shqipërisë”. Po këtë vit mori pjesë në Mbledhjen e Përbotshme të Kishave në Montreax të Zvicrës. Në sajë të këtij aktivizimi të Kryepiskopit Visarion filloi të ndryshojë qëndrimi i disa

kishave ortodokse, të cilat me rastin e Krishtlindjeve të vitit 1935 dërguan telegrame urimi.

Përkushtimi i Kryeepiskopit Visarion, hapat e tij të menduar dhe të mbështetur fort në kanonet kishtarë, vendimet në përputhje të plotë me udhëzimet e Sinodit dhe me ligjet e shtetit, forcimi organizativ, vendosja e disiplinës hierarkike, puna e kujdesshme për kualifikimin e klerikëve, pajisja e kishës me literaturën e nevojshme liturgjike, paraqitja në lartësinë e duhur e figurës së Kryeepiskopit në disa mbledhje dhe udhëtime ndërkombëtare ishin goditje për ata që nuk e donin autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Të gjitha këto dokumente nuk kanë as cenimin më të vogël të kanoneve të shenjta të Kishës Ortodokse, e cila i kishte plotësuar të gjitha kushtet për të qenë Autoqefale. Ajo vepronte në një shtet sovran e të lirë politikisht, kishte Sinodin Episkopial me episkopë kanonikë, funksiononte në bazë të një Statuti dhe Rregulloreje të miratuar në Kongres legal, ishte pajisur me literaturë liturgjike në gjuhën shqipe. Megjithatë Patriarkana e Kostandinopojës vazhdoi të mbajë qëndrim hezitues dhe disapprovimi i saj për autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare që i plotë.

VEPRIMTARIA PËR SHQIPTARIZIMIN E KISHËS ORTODOKSE

Përpjekjet e Kryeepiskopit të parë të Kishës Ortodokse Autoqefale ishin shumë frytdhënëse, ato u mbështetën në kanonet kishtarë dhe në interesat kombëtare. V. Xhuvani e shqiptarizoi kishën, e shkëputi nga diktati dhe hija e rëndë e Fanarit, e bëri të njohur në forumet ndërkombëtare të Kishave Ortodokse dhe e bëri të barabartë me simotrat e saj të Ballkanit. Vitet kur ishte në krye të Kishës Ortodokse Shqiptare Fortlumturia e Tij, përbëjnë periudhën më të lavdishme të saj, kur u shkruan faqe të ndritura të historisë sonë kombëtare shqiptare.

Patriarkana Ekumenike e kushtëzoi dhënien e Tomusit me largimin e Kryeepiskopit Visarion Xhuvani dhe me vendosjen e një Kryeepiskopi që dëshironte ajo.

Visarioni që punoi dhe sakrifikoi kaq shumë për të siguruar edhe Tomusin ishte i gatshëm të vetësakrifikohej vetëm që të plotësohej kjo dëshirë, së cilës i kushtoi gjithë fuqitë shpirtërore dhe fizike. Në maj të vitit 1936 në mbledhjen e jashtëzakonshme të Sinodit, Visarioni paraqiti dorëheqjen e detyrueshme nga funksioni i lartë i Kryeepiskopit të Kishës Ortodokse Shqiptare.

Shkaqet e dorëheqjes në mënyrë të përmbledhur i paraqiti kështu: “Nuk duhet të besohet se japim dorëheqje për këto arsye:

- 1-Pse gjoja na u imponue prej shtetit.
- 2-Pse gjoja na u imponue prej popullit.
- 3-Pse gjoja u frikësuem se do na vrasin të huejt po të mos japim dorëheqje.

Shkaqet që më kanë të jap dorëheqje janë këto:

- 1-Për lehtësimin e shtetit në punë politiko-religjioze.
- 2-Për të lehtësue marrëdhëniet dhe njohjen e kishës sonë prej kishave greke, siç asht Patriarkana e Stambollit.
- 3-Mbasi shpresojmë se kryetari i ri i kishës ka me qenë i ndihmuem ma tepër se ne dhe prej të gjithëve për mbarëvajtjen e kishës”.

Visarioni, mbas 19 vitesh pune të frytshme, të mbushura me lloj-lloj pengesash dhe intrigash, mundi të bëjë atë që nuk ishte bërë që nga krijimi i Kishës Bizantine prej Kostandinit të Madh, organizimin definitiv të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ai

kreu me sukses detyrën që i ngarkoi populli ortodoks i Elbasanit, Durrësit, Shpatit, Pogradecit dhe Tiranës, përmbushi detyrat e dy Kongreseve, të Beratit më 1922 dhe të Korçës më 1929.

Mbas 27 majit të vitit 1936, dita kur dha dorëheqjen, Visarionit iu dha pensioni jetik prej 500 fr. ar nga Qeveria me dekret të veçantë. Ai jetoi në pronat e veta të blera në vitin 1935 nga Hamdi Tabaku dhe Myftar Disha, që ndodhen në fshatin Shkozë te Kodra e Hajdarit, e cila sot quhet Kodra e Priftit. Me këtë emërtim populli i Tiranës përjetësoi vendin ku banoi Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Visarion Xhuvani. Banesa dhe pronat e tij tokësore janë të regjistruara në regjistrin hipotekor Nr. 42 datë 17 janar 1935, në të cilin figurojnë dy kulla (banesa) me anekset përkatëse të kufizuara në të katër anët me pronat e veta, si dhe në regjistrin hipotekor Nr. 12, datë 7 janar të vitit 1937 ku figurojnë 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) metra katrorë në fshatin Shkozë (Kodra e Priftit) me livadhe dhe zabele.

Në këtë vend të qetë teologu Visarion Xhuvani jetoi dhe studioi librat e shenjtë. Këtu krijoi miqësi shembullore me familjet myslimane të Dishajve, të Shkretajve etj.

Pas dorëheqjes së Visarionit si Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, presioni i unitizmit u shtua dhe gjendja u përkeqësua sidomos pas pushtimit fashist të Shqipërisë. Për të përballuar gjendjen Kryeepiskopi i ri ftoi Visarion Xhuvanin dhe në vitin 1942 e emëroi mitropolit të dioqezës së Beratit, Myzeqesë, Vlorës dhe Kaninës. Gjatë viteve 1942 deri më 1947 ai përballoi disa probleme të mprehta të kohës, kreu detyrën e tij pastorale, zbuti ndjenjat e hakmarrjes, krijoi unitetin e ri shoqëror sipas dogmës fetare kishtarë.

Misioni i ri i Visarionit u keqpërdor dhe u shfrytëzua për të ngritur akuza të rënda kundër tij. Ai u quajt kundërshtar i rrezikshëm, sepse sipas tyre kishte punuar për të minuar pushtetin popullor dhe kishte ngjallur pakënaqësi te besimtarët ortodoksë. V. Xhuvani u arrestua në Vlorë në vitin 1947 dhe mbas shumë torturash çnjerëzore Gjykata Ushtarake e Vlorës me vendim Nr. 512, datë 23-12-1947, në bazë të neneve 2,3,4 të ligjit Nr. 327 dt. 12-12-1946, e dënoi me 20 vjet privim lirie, me punë të detyrueshme dhe me humbjen e të drejtave politike për pesë vjet. Mbasi vuajti 15 vjet në burgun famëkeq të Burrelit, me dekretin 3602 datë 23-3-1962, në moshën 75 vjeçare i falet mbetja e dënimit por me kushtin e humbjes së të drejtave politike për pesë vjet. Dy vitet e fundit ka qenë i internuar në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Atje më 15 dhjetor të vitit 1965 u nda nga kjo jetë duke u bashkuar përjetësisht me frymën e shenjtë, së cilës i shërbeu me devocion gjatë kësaj jete shtegtare.

Imzot Visarion Xhuvani, klerik ortodoks i vërtetë, gjatë gjithë jetës sprovimtare, nuk rënkoi, nuk mohoi, nuk shau, nuk mallkoi, por vetëm uroi dhe fali. Këtë qëndrim ai mbajti ndaj shpifjeve. Fyerjeve të fletoreve greke ai iu përgjigj me urtësi: “Grekët në fletoret e tyre shpifin sipas fantazisë së bukur dhe të paimitueshme që karakterizon mitologjinë greke”. Shtypi grek ka sharë me arrogancë edhe të parët e fesë së vet. Ata nuk e kanë të zorshme të shajnë edhe të tjerët. Ndërsa xhelatët që e torturonin e i bërtisnin: Fol o qen! Visarioni me buzë të përgjakura foli ashtu i pafuqishëm nga pleqëria, i drobitur nga uria dhe nga torturat. Ky zë që i dobët aq sa torturuesit nuk e dëgjuan.

-Çfarë fole ashtu? Fol!

-Ju luta Zotit!

-Ju lute Zotit?

-Po.

-E çfarë i the? -pyetën ata kureshtarë
-Ju luta për ju që t'ju falë mëkatet që po bëni.

KONGRESI I BERATIT - NGJARJE E SHËNUAR HISTORIKE PËR KISHËN ORTODOKSE SHQIPTARE (10-11-IX-1922)

1. SI NISI LËVIZJA PËR SHQIPTARIZIMIN E KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE

Në vitet 1921-1922 u krijuan kushte më të favorshme për lëvizjen e shqiptarizimit të kishës, për shpalljen e saj autoqefale si të gjitha kishat e vendeve ballkanike. Njohja e kufijve shqiptaro-grekë sipas Konferencës së Londrës të vitit 1921 i kufizoi pretendimet shoviniste greke për Shqipërinë e Jugut. Organet ligjvënëse të shtetit, si Këshilli Kombëtar më 1920 dhe më vonë zëvendësimi i tij me Parlamentin, që në fillimet e veprimtarisë së tyre i kushtuan vëmendje të veçantë hartimit të ligjeve për institucionet fetare, sipas frymës kombëtare dhe futjes së Kishës Ortodokse Shqiptare në rrugën e pavarësisë. Ato shpallën lirinë e ndërgjegjes për komunitetet fetare e lejuan të organizohen shoqata fetare të pavarura nga njëra-tjetra.

Në këtë kohë dioqezat që drejtoheshin nga Episkopët Germanos, Joaqim dhe Jakov kishin mbetur pa mitropolitë, sepse ishin dëbuar nga banorët ortodoksë për punë të pakënaqshme. Qeveria dhe Patriarkana nuk i kishin zëvendësuar me episkopë shqiptarë. Pakënaqësitë dhe grindjet midis shqiptarëve ortodoksë, sidomos në qarkun e Korçës, qenë acaruar edhe më shumë. Secila palë kundërshtarë ngulte këmbë në argumentet e veta për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë.

Në Korçë, Pogradec, Elbasan e Vlorë kishat ishin me priftërinj shqiptarë dhe të gjitha shërbesat bëheshin në gjuhën shqipe. Debatet për problemet e mprehta të kohës u bënë më të fuqishme dhe kjo kërkonte që sa më parë të mbledhej një kongres dhe të vendosej shpallja e Kishës shqiptare autoqefale. Nismën për mbledhjen e kongresit e mori Kryetari i Bashkisë së Durrësit Kostë Paftali. I nisur nga qëllimi i mirë për bashkimin e ortodoksëve shqiptarë, ai kërkoi që të organizohej një kongres me pjesëmarrjen e të gjitha prefekturave shqiptare. Për këtë qëllim u dërgoi telegrame qarqeve ortodokse të prefekturave dhe nënprefekturave të Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit dhe Shkodrës. Në telegram shkruhej:

“I nënshkruemi tue marrë parasysh përçamjen dhe mosmarrëveshjet që po vazhdojnë ndërmjet vëllezënve shqiptarë ortodoksë mbi çështje që i përkasin kishës ortodokse, me që kjo gjendje po damton jo vetëm çështjen fetare ortodokse por damton rreptësisht edhe shtetin tonë shqiptar si dhe kombin, po marr leje me i propozue

vëllezënve shqiptarë që të formohet sa ma parë një kongres për me shërue këtë plagë të hapun dhe në mbrojtje të dinjitetit si komb e si fe”.

Korça kërkoi sqarime për platformën e kongresit, ndërsa Vlora kërkoi që në kongres të merrnin pjesë dy teologë. Elbasani kërkoi që qeveria të ishte në dijeni dhe të sigurohej ndihma e saj. Gjirokastra mendonte se çështjet kishtarë mund t’i zgjidhë qeveria, prandaj ngurronte për mbajtjen e kongresit.

Çdo rreth zgjodhi dy delegatë dhe u tregua kujdes i veçantë që ata t’i përfaqësonin denjësisht.

Më 10 shtator të vitit 1922, në sallën e shkollës së qytetit të Beratit u mblodhën delegatët e Kongresit kishtar që ishin dërguar nga ortodoksët e prefekturave dhe të nënprefekturave për të paraqitur letrat kredenciale. Për verifikimin e tyre u zgjodh një komision i posaçëm me kryetar Perikli Konën, sekretar Vasil Llapushin dhe anëtarë Atë Vangjel Çamçen, Stathi Kondin dhe Taq Budën.

Mbas verifikimit dolën këta delegatë:

- 1- Korça - Ikonom papa Josifin dhe Dhori Havjarin.
- 2- Pogradeci – Atë Vasil Markon dhe Thanas P. Kërxfhallin.
- 3- Bilishti – Atë Josifin dhe Anastas Çekrezin.
- 4- Kolonja – Oshënar Sofronin dhe Dhimitër P. Ninin.
- 5- Leskoviku – Atë Vangjel Çamçen dhe Thanas Priftin.
- 6- Berati – Perikli Konën dhe Dhimitër Tutulanin.
- 7- Fieri – Loni Xhoxhen dhe Dhimitër Qilicën.
- 8- Durrësi – Arkimandrit Visarion Xhuvanin dhe Gjergji Manushin.
- 9- Përmeti – Dr. Kondin dhe Vasil Kotën.
- 10- Vlora – Tol Arapin dhe Jani Seranin.
- 11- Lushnja – Tun Gjergjin dhe Llazar Bozon.
- 12- Kavaja – Pal Xhumarin dhe Andrea Ikonomin.
- 13- Tirana – Papa Simonin dhe Mark Hobdarin.
- 14- Elbasani – Vasil Llapushin dhe Simon Shuteriqin.
- 15- Shpati – Taq Budën dhe Dhimitër Papariston.
- 16- Dibra – Leonidha Nishkun dhe Kostë Paftalin.
- 17- Libohova – Spiro Katin.

Mbas një pune serioze dhe cilësore përgatitore, Kongresi i Beratit filloi punimet më 11 shtator të vitit 1922. Ai u kryesua nga delegati i Korçës dhe kleriku më i vjetër Ikonom Papa Josif Qirici. Mbas fjalës përshëndetëse të iniciatorit Kostë Paftali e mori fjalën përfaqësuesi i qeverisë Zenel Prodani, mbas tij Arkimandrit Visarion Xhuvani, që pat shkelur gjithë Shqipërinë për organizimin e Kongresit dhe ishte deputet e përfaqësues i Këshillit Kombëtar e mbas tij delegati i Pogradecit At Vasil Marko.

Kryetari i Kongresit shpalli Autoqefalinë e Kishës Ortodokse Kombëtare Shqiptare dhe kërkoi ndihmën e qeverisë që t’i bëhej kërkesë Patriarkanës për njohjen e Autoqefalisë dhe për emërimin e dy mitropolitëve shqiptarë sipas propozimit të Këshillit të Lartë.

Ndërkohë u njoftuan të gjitha mitropolitë e kishave simotra që të njihnin autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Deri në zgjedhjen e Sinodit definitiv, i cili duhej të zgjidhej pas dy vjetësh (sipas vendimeve të Kongresit të Beratit), Këshilli i Lartë do të quhej Sinod Provizor dhe do të kryente të gjitha funksionet e Sinodit sipas rregullores së miratuar në Kongres. Anëtarë të

këtij Këshilli të Lartë ishin zëvendësmitropolitët e Korçës, Durrësit, Beratit dhe të Gjirokastrës, ndërsa anëtarë të këtij Këshilli ishin edhe Dhosi Havjari për mitropolinë e Korçës, Simon Shuteriqi për mitropolinë e Durrësit dhe Stathi Kondi për mitropolinë e Gjirokastrës.

Mesha zyrtare u bë më 14 shtator 1922 dhe u kryesua nga Arkimandrit Visarion Xhuvani, Atë Vasil Marko e Papa Josif Qirici dhe klerikë të tjerë që morën pjesë në Kongres. Më 19 shtator mbas diskutimesh të shumta u shqyrtuan dhe u përmirësuan nenet e statutit dhe të rregullores. Këto me procesverbale të veçanta u vunë në dispozicion për t'u firmosur nga delegatët, të cilët i miratuan njëzëri dhe u vërtetuan me firmë nga Kryetari Ikonom papa Josifi, nënkryetari Pal Xhumari, sekretarët Dhimitër Petro Nini e Vasil Llapushi, nga përfaqësuesi i Prefekturës Llazi Pali dhe kanë datën: Berat 17 shtator 1922.

Statuti me të cilin do të funksiononte kisha ortodokse kombëtare deri në miratimin e Statutit Definitiv ka 14 nene.

Nyja (neni) I. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së shenjtës Kishë të përgjithshme Autoqefale të të gjithë ortodoksëve, përbëhet prej banorëve të shtetit shqiptar që i besojnë Krishtit dhe pohojnë simbolin e shenjtë të fesë dhe pranon të gjithë ata që pranon Kisha e Shenjtë e Krishtit Ortodokse Lindore, themelonjësi dhe kryezot i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jesu Krishti.

Kisha sundohet prej episkopëve kanonikë duke ruajtur pa ndryshim, si dhe gjithë kishat e tjera ortodokse të Krishtit, kanonet e shenjta Apostolike e Sinodike si dhe gojëdhënat e shenjta.

Nyja II. Në shtetin shqiptar paria më e lartë kishtare do të jetë Sinodi i Përhershëm i përbërë prej peshkopësh kanonikë nën kryesinë e një mitropoliti. Ky Sinod do të ketë titullin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe do të qëndrojë në kryeqytet.

Nyja III. Kisha Ortodokse Autoqefale gjersa të mbarohen gjithë sa përmbledh nyja II do të sundohet prej një Këshilli të përbërë prej klerikësh dhe laikësh nën kryesinë e një kleriku që do të ketë titullin: "Kryetar i Këshillit të Lartë sundimtar të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Ky Këshill do të qëndrojë në Korçë dhe do të ketë vulën me kryqin në mes, dy degë dafinash anash e rrotull, shkronjat Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe viti 1922.

Nyja IV. Anëtarët klerikë të Këshillit të përzier do të jenë de facto zëvendësit e rregullt të qendrave e mitropolive të Korçës, Beratit, Durrësit dhe Gjirokastrës të emëruar nga Kongresi. Kryetari i Këshillit të përzier dhe laikët do të zgjidhen prej Kongresit.

Nyja V. Këshilli i Lartë do të hyjë në marrëveshje negociate me Patriarkanën e Shenjtë Ekumenike dhe me Patriarkanat e tjera e me këshillat e tjerë autoqefalë ortodoksë për njohjen e Kishës sonë zyrtarisht si bijë dhe motër Ortodokse Autoqefale.

Nyja VI. Këshilli i Lartë do të përkujdeset për të sjellë brenda 2 vjetëve të paktën 2 episkopë kanonikë me pëlqimin e saj nga Patriarkana Ekumenike ose nga kishat e tjera simotra.

Nyja VII. Këshilli i Lartë do të kontrollojë dhe do të rregullojë të gjitha pasuritë e kishave e të manastireve dhe pasuritë e tjera për qëllime bamirësie.

Nyja VIII. Anëtarët Klerikë të Këshillit të Lartë të mbështetur në të drejtën kanonike dhe rregulloren në fuqi të Kishës së Madhe, do të kenë të gjithë ato të drejta në

Sinod. Sa për administratën e për të zgjedhurit e Episkopatave, kjo punë u lihet anëtarëve laikë të bashkuar me anëtarë klerikë.

Nyja IX. Episkopët që kanë për të ardhur do të jenë ipso-jure anëtarë të Këshillit të Lartë, por do të bëjnë be para Këshillit të Lartë në këtë mënyrë: “Betohe me ndërgjegje priftnore para Perëndisë se do të jem besnik i shtetit shqiptar dhe statutit të tij dhe të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë, duke rrujtun kurdoherë ligjet e shtetit dhe kanonet apostolike të Sinodit të Kishës së Madhe Ortodokse”.

Këta episkopë do të vendosen nëpër ato episkopata ku e sheh të udhës Këshilli i Lartë i Kishës.

Nyja X. Gjuha e kishës është shqipja, por meqenëse disa nga kleri e nga koret nuk janë të stërvitur në gjuhën kishtarë dhe në anën tjetër mungojnë mjetet e duhura, u jepet e drejta të vazhdojnë në gjuhën e gjertanishme (greqisht), duke u përkujdesur me sa është e mundur të këndohen në gjuhën e kishës (shqipe) këto: 1- Paqësoret, të cilat përmbledhin dhe lutjet për shtetin e për kishën. 2- Ungjillin, Apostullin dhe predikime për to. 3-Atinyë, dhe sa mund të shtojnë me kohë.

Nyja XI. Këshilli i Lartë Kishtar do të bashkojë episkopatat, në të ardhmen të gjitha ato vise që mbetën brenda kufirit të shtetit shqiptar e që kanë qenë pjesë mitropolitash të tjera të mbetura jashtë kufirit.

Nyja XII. Paga mujore e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar, e anëtarëve, shkronjësve dhe e personelit tjetër të nevojshëm, si dhe shpenzimet e zyrave që do të ketë ky Këshill do të ekonomisen dhe do të caktohen sipas një rregulloreje të veçantë.

Nyja XIII. Librat shqipe kishtarë që janë përdorur gjër më sot do të përdoren prap gjersa të trajtohet Sinodi episkopal, i cili do të vendosë për vazhdimin e përdorimit të tyre.

Këta libra do të kenë vulën e Këshillit të Lartë të Kishës. Librat e reja që do të botohen gjersa të trajtohet Sinodi, këto do të përdoren me qëllim të përkohshëm të Këshillit të Lartë të Kishës.

Nyja XIV. Ky statut, përveç nyjës 2 do të jetë në fuqi gjersa të trajtohet Sinodi Episkopal i përbërë prej 4 episkopësh, brenda 3 muajve do të mbledhë Asamblenë Kishtarë dhe do të bëjë Statutin e Përhershëm mbi bazën e popullsisë duke u mbështetur në një rregullore të posaçme për zgjedhjet.

Statuti u këndua para Kongresit dhe u pëlqye e u nënshkrua.

2. JEHONA E KONGRESIT KISHTAR DHE MIRATIMI I TIJ NGA QEVERIA SHQIPTARE

Kongresi i Beratit ishte hapi vendimtar i ortodoksëve shqiptarë për bashkimin e kishës së tyre autoqefale. Ai nuk ka qenë një mbledhje laikësh, sepse në të morën pjesë të zgjedhur nga rrethet shqiptare 7 klerikë, midis tyre dy teologë të diplomuar, katër ikonomë me përvojë të gjatë kishtarë dhe njohës të mirë të dogmës kristiane dhe një oshënar shumë i përgatitur. Pjesa tjetër më e madhe e delegatëve ishin intelektualë që i njihnin mirë kanonet fetare. Këta diskutuan dhe vendosën nenet e Statutit Provizor dhe përcaktuan rrugën e drejtë të Kishës së re Autoqefale Shqiptare.

Ata vendosën që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë të ishte pjesë e pandarë e Kishës së Shenjtë të Përgjithshme dhe Apostolike dhe e gjithë ortodoksëve shqiptarë që besojnë Krishtin dhe pohojnë simbolin e shenjtë të fesë.

Në Statut u përcaktua qartë se kisha do të drejtohet nga episkopë kanonikë dhe nga këshilli laik. Episkopët kanonikë drejtojnë anën shpirtërore, ndërsa këshilli laik kujdeset për ekonominë dhe financat e kishës. Në krye qëndron një episkop i zgjedhur nga episkopët kanonikë, i cili ka titullin: “Kryetar i Këshillit të Lartë sundimtar të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë”.

Këshilli i përzier zgjidhet nga Kongresi. Meqenëse atëherë mungonin episkopët kanonikë, Kongresi ngarkoi Këshillin e Lartë të përkujdesej që të sillte dy episkopë kanonikë nga Patriarkana ose kishat e tjera simotra. Ata do të ishin anëtarë të Këshillit të Lartë me të gjitha të drejtat e Sinodit. Para se të fillonin punën do të betoheshin: “Betohem me ndërgjegjen priftnore para Perëndisë se do të jem besnik i shtetit shqiptar dhe i statutit të tij, dhe të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë, duke ruajtur kurdoherë ligjet e shtetit dhe kanonet Apostolike të Sinodit të Kishës së Madhe Ortodokse”.

Statuti përcaktoi me hollësi të drejtat e anëtarëve të kryesisë, pagën e kryetarit e të anëtarëve dhe të gjitha shpenzimet.

Vendimi më i rëndësishëm që plotësoi aspiratat e disa brezave të shqiptarëve ishte përdorimi i gjuhës shqipe në meshën e shenjtë. Nga mungesa e botimeve kishtarë dhe e përvojës priftërore, për një farë kohe u lejua përdorimi i gjuhës së huaj greke, por u pranua që në gjuhën shqipe të këndoheshin: 1-Paqësoret. 2-Ungjilli. 3-Ati ynë, dhe sa më shpejt e gjithë mesha të bëhej shqip.

Librat kishtarë në gjuhën shqipe, të cilat janë përdorur deri në mbledhjen e Kongresit, do të përdoreshin prap, derisa të formohej Sinodi episkopal, i cili do të vendoste për përdorimin e tyre. Deri atëherë librat kishtarë do të kenë miratimin dhe vulën e Këshillit të Lartë.

Kongresi përcaktoi detyrat e ngutshme si formimin e Sinodit episkopal prej 4 episkopësh kanonikë. Këta brenda 3 muajsh duhej të mblidhnin Asamblenë Kishtarë, e cila do të hartonte Statutin Përfundimtar. Ai kërkoi që sa më parë të njoftohej Patriarkana Ekumenike dhe Kishat e tjera simotra për mbledhjen e Kongresit, për vendimet e tij dhe për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Kongresi zgjodhi kryetar të Këshillit të Lartë Atë Vasil Markon, delegat i Pogradecit. Barrën më të madhe për përgatitjen e Kongresit dhe për miratimin e vendimeve e mbajti Arkimandrit Visarion Xhuvani. Ai ishte teologu më i përgatitur, njohës i mirë i kanoneve kishtarë, por edhe njohës i mirë i ligjeve të shtetit, sepse ishte anëtar i Këshillit të Lartë (senator) dhe më pas deputet i Parlamentit të Shqipërisë.

3. PATRIARKANA E STAMBOLLIT BEKON KONGRESIN E BERATIT

Patriarkana e Stambollit nuk ishte indiferente ndaj Kongresit të Beratit. Ajo menjëherë dërgoi përfaqësuesin e vet për të verifikuar e kontrolluar punimet e Kongresit. Më 27 nëntor të vitit 1922 erdhi në Korçë i dërguari i Patriarkanës, Eksarku Jerothe, i cili kontrollloi dhe miratoi punimet dhe vendimet e Kongresit të Beratit.

Në letrën që i dërgoi Kryetarit të Këshillit të Lartë, Eksarku Patriarkal Jerotheu ka shkruar:

Fort i përndershëm!

Duke bekuar vendimet dhe statutin e Kongresit Kishtar që u mbledh në Berat në shtator të vitit 1922, sipas qarkores së imët që bëri kleri dhe populli ortodoks i Shqipërisë, si Eksark Patriarkal që jam i them dhe e shtyj Atërisht Këshillin Kishtar të përzier, që ndodhet në veprim dhe punon si e do puna me goditje, i them pra këtij Këshilli të shkojë me çapa të fortë e të sigurtë udhës që ka hapur Kongresi i Beratit me anën e Statutit, i cili u vërtetua plotësisht nga Qeveria e Ndershme Shqiptare.

Urime të dala nga thellësia e zemrës së Patrikut Ekumenik për forcimin dhe përparimin e Qeverisë Shqiptare dhe të Kishës Ortodokse të Shqipërisë u shfaqën dhe po shfaqen me anën time zyrtarisht si Eksark Patriarkal që jam dhe kam besim të patronditur se në kohën që e do puna Kisha e Madhe e Krishtit ka për ta njohur edhe Kishën Ortodokse të Shqipërisë, e cila sapo u lind duke e siguruar këtë plotësisht sipas zakonit me anë të Tomusit Kishtar sikundër urdhërojnë Kanonet e Shenjta.

Korçë 19.12.1922.

Urimtar i flaktë me Krishtin ndaj Perëndisë.

Eksarku patriarqik Jerotheu i Melitopojës (AQSh: Fondi 141, dosja 438, viti 1922)

Patriarkana nuk u kënaq nga raportimet e të dërguarit të vet, prandaj kërkoi që një delegacion i Kishës Shqiptare të shkonte për t'u sqaruar. Në mars të vitit 1923 delegacioni i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Lartë, Stavrofor Vasil Marko, i paraqiti Patriarkanës vendimet e Kongresit të Beratit. Patriarkana i miratoi këtij delegacioni një autonomi të pjesshme, por jo autoqefali.

Përfundimin e punimeve të Kongresit Kishtar të Beratit e vërtetojnë edhe këto dy dokumente zyrtare të Ministrisë të Brendshme të Qeverisë Shqiptare, A. Zogu:

1. Telegram:

Prefekturave e kryetarëve të bashkisë:

Sipas telegramit të Kryesisë së Kongresit Ortodoks ju njoftojmë se sot më 13 të këtij mueji Kongresi në fjalë prej 33 delegatësh vendosi deklarin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe për festimin e këtij vendimi janë hedhun topa në qytete. Pra u lutemi të gjitha prefekturave dhe nënprefekturave që të festohet një ditë, të hidhen topa dhe të stolisen qytetet me flamurë.

Ministri i Punëve të Brendshme

Ahmet Zogu

Tiranë, 24.9.1922 (AQSh, dosja 463, f.141, viti 1922)

2. Qarkorja e Këshillit të Ministrave:

QARKORE

Prefekturës së Korçës

VENDIM

Këshilli Ministrues me bisedën e soçme vendosi njohjen e vendimeve të Kongresit të Beratit, të cilat rrodhën nga shpirti i popullit ortodoks, pranimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të vendosun prej tij e të mbështetun plotësisht mbi parimin e independencës së Shtetit Shqiptar.

Për njoftim e veprim dërgojmë kopjen e sipërme të vendimit N.809, datë 18.9.1922 të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Punëve të Brendshme

Ahmet Zogu

Vendimi i Këshillit të Ministrave i datës 18.9.1922 si dhe letra e Eksarkut Jerotheu kanë miratuar Kongresin e Beratit dhe vendimet e tij. Kisha Ortodokse Shqiptare hyri në një etapë të re, e cila vazhdoi disa vite deri sa u miratua përfundimisht nga Patriarkana Ekumenike. Kjo është koha e përpjekjeve të mëdha për të përballuar ndërhyrjet e Patriarkanës së Stambollit.

Kongresi Kishtar i Beratit gjeti përkrahje mbarëpopullore si brenda Shqipërisë dhe jashtë saj. Shpallja e autoqefalisë u prit mjaft mirë edhe nga ortodoksët e kolonive shqiptare të Amerikës, Rumanisë, Turqisë etj. Ata jo vetëm që e përkrahën autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare, por edhe përballuan intrigat fanariote për të lejuar vetëm autonominë e Kishës Ortodokse Shqiptare dhe jo autoqefalinë e saj.

Gazeta “Shqipëria e re” më 25 mars të vitit 1923, në artikullin “Çështja e Autoqefalisë”, ka shkruar: “...meqë Fanari nuk na njeh edhe ne nuk e njohim atë”. Fanari ka pasur qëllim të krijonte mbi gërmadhat e Perandorisë Bizantine një perandori greke, prandaj e pengoi autoqefalinë e kishave të tjera ortodokse. Më vonë po kjo gazetë, më 15 maj 1923, në artikullin “Dualmë nga borxhi”, ka shkruar se neve nuk na mbetet gjë tjetër veç t’i përvishemi punës dhe t’ia kërkojmë të drejtat tona një kishë tjetër, ku jemi fare të sigurt se do të na pranojnë menjëherë. Patriku si përfaqësues i propagandës greke do të na përçajë e do të na sjellë ngatërresa, ai nuk mund të sakrifikojë për ne interesat e veta.

Ndërsa në artikullin e 27 majit të vitit 1923 Patriarkana për të mos miratuar autoqefalinë solli si argument se në Shqipëri ka disa fe dhe se ortodoksët janë pakicë dhe nuk mund të krijonin Kishën e tyre autoqefale. Më 10 qershor kjo gazetë ka shkruar se është detyra jonë të jemi të bashkuar, kështu do të arrijmë qëllimin tonë.

Më 20 maj “Shkëmbi i Frashërit” ka shkruar: “Ne do të na njohin kur të jemi të zot të drejtojmë punët tona. Na njohin ose nuk na njohin ne duhet të bëjmë punën tonë, e jo avash, se koha nuk pret”. Në artikullin e 30 qershorit të vitit 1923 është shkruar se autonomia nuk mund të pranohet sepse ajo rrezikon independencën tonë, duke i dhënë më shumë të drejta Patriarkanës. Për të përballuar situatën e krijuar u dërguan dy dhespotë, Jerotheu dhe Kisi, që të dorëzonin dhespotë priftërinjtë e rekomanduar prej Këshillit të Lartë. Këta dhespotë u dënuan për tradhëti dhe mosbindje në ligjet dhe interesat e shtetit shqiptar. Hirësive të tyre iu hoq vërejtje dhe të mos shkonin me paramendime por me zemër të hapur t’i shërbenin Atdheut.

Mihal Gramenoja në gazetën “Koha”, në shtator të vitit 1922 ka shkruar: “Kisha jonë e njohur fetarisht nga të gjitha kombet përveç Patriarkanës, është njohur nga Sinodi i Rusisë. Ata që themeluan Kishën tonë u bazuan në parimet që kisha jonë të përhapte sipas ungjillit vetëm fjalën e Zotit dhe të lutet vetëm për lumturinë e Kombit Shqiptar. Prandaj cilido që vepron kundër këtij qëllimi vepron kundër Atdheut” (gazeta “Koha” 20 shtator 1922).

Gazeta “Dielli” e 8 nëntorit të vitit 1922 dhe gazetat e tjera të Amerikës e kanë përshëndetur nxehtësisht Kongresin e Beratit. Ato kanë bërë argumentimin juridik duke shkruar: “Çdo vend që pushon të jetë pjesë e Perandorisë Osmane, pushon të jetë i lidhur edhe me Patriarkanën Ekumenike” (gazeta “Dielli”, 8 nëntor 1922).

Më 12 dhe 18 nëntor u mbajtën mesha në Boston për të kremtuar ditën e shpalljes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Festime për shpalljen e Autoqefalisë u bënë edhe në Rumani. Gazetat e Rumanisë shkruan: “Ashtu siç vepruan kishat e Serbisë, Rumanisë dhe Greqisë për formimin e Sinodeve të tyre, atë punë bëri dhe Kongresi i Beratit, i cili shpalli Kishën Shqiptare Autoqefale”.

4. SI ERDHI FRONËZIMI I FAN NOLIT SI PESHKOP I DURRËSIT

Për Kongresin e Beratit ka rëndësi edhe fjala e Patrikut Ekumenik nëpërmjet Eksarkut Patriarkal që punonte në Korçë: “Ndodhia e punëve dhe dëshira e gjithë klerit ortodoks duket qartë dhe kthjellët fare si në pasqyrë, se vendimet e shkruara dhe Statuti i Kongresit Kishtar të Beratit, ku përfaqësuesit e të gjithë ortodoksëve të Shqipërisë u mbledhën ligjërisht, kristalizuan dhe vërtetuan plotësisht dëshirën e ortodoksëve, të klerit dhe të mitropolitëve, se vendimet e Kongresit të Beratit u përgjigjen plotësisht kanoneve të shenjta” (gazeta e Korçës, 12 maj 1923).

Kongresi i Beratit u përshëndet nga të gjithë ortodoksët shqiptarë brenda vendit. Përshëndetja e Patriarkanës atëherë nuk ishte e sinqertë, sepse ajo u përpoq të realizojë synimet e veta me udhë të tjera diplomatike.

Edhe pse Eksarku Patriarkal ishte në Korçë dhe shprehu miratimin e vet, Patriarkana kërkoi që një delegacion të shkonte në Stamboll për të biseduar rreth kësaj çështjeje. Dy delegacione u paraqitën në Stamboll për të biseduar, por ato u kundërshtuan me argumentin se Kisha Ortodokse Shqiptare nuk kishte episkopë kanonikë (të cilët në të vërtetë shumë lehtë mund t’i sillte vetë) dhe se ortodoksët shqiptarë janë pakicë, prandaj nuk mund të kenë sinod të tyre dhe kishë autoqefale. Ky argument është i paqenë.

Mbas vitit 1923 ndryshoi gjendja e Kishës Ortodokse Shqiptare dhe argumentet e Patriarkanës nuk qëndronin më. Me ardhjen e Kristofor Kisit (episkop kanonik nga Berati) dhe me Jerotheun (episkop kanonik nga Çarshova), që u vendosën njëri në dioqezën e Korçës dhe tjetri në dioqezën e Beratit, Kisha Ortodokse Shqiptare kishte dy episkopë. Më 24 nëntor të vitit 1923, në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë, u bë dorëzimi dhe fronëzimi i Fan Nolit si Peshkop i Durrësit, Gorës dhe Shtatit, i cili e shpalli veten edhe si kryetar të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, por që të dy mitropolitët e mësipërm nuk e pranuan vetëshpalljen e Nolit.

Fan Noli u vendos në dioqezën e Durrësit, pa episkop mbeti vetëm dioqeza e Gjirokastrës. Këta tre episkopë e kanë pasur të hapur çështjen e dorëzimit të dy kandidaturave të Visarion Xhuvanit dhe të Agathangjel (Vangjel) Çamçes dhe kështu plotësohej vendi bosh në dioqezën e Gjirokastrës, sepse bëheshin katër episkopë dhe sinodi mund të formohej shumë shpejt dhe plotësohej kushti kryesor i krijimit të Sinodit të Përhershëm për njohjen e Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Por nuk ndodhi kështu.

Atëherë Imzot Jerotheu, që e shihte të largët dhe shumë të zorshme miratimin e Autoqefalisë, u largua nga detyra duke shkuar në malin e Shenjtë. Imzot Kisi ndoqi veprimtarinë kishtarë brenda dioqezës së Beratit. Ai qëndroi më shumë në manastirin e Ardenicës dhe nuk u kushtoi vëmendjen e duhur kërkesave dhe vendimeve të Kongresit të Beratit.

Këta dy episkopë shqiptarë, të rritur dhe të shkolluar jashtë vendit, mbajtën një qëndrim më të afërt me kërkesat e Patriarkanës së Stambollit dhe nuk u përpoqën për të vënë në jetë vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit. Ndërsa i treti, episkopi i ri, F. Noli, që për Kishën Ortodokse Shqiptare deri në vitin 1914 kishte përkthyer e përshtatur disa libra kishtarë, të cilët përdorëshin gjerësisht në kishat tona, nuk doli në ballë Kishës Ortodokse Shqiptare dhe nuk vlerësoi drejt vendimet që u morën në Kongresin Kishtar të

Beratit. Duke mos u bërë dorëzimi i kandidaturave të mundshme që do të shërbenin për plotësimin e episkopëve dhe për krijimin e Sinodit të Përhershëm, Fan Noli atëherë ia dorëzoi dioqezën e vet arkimandrit Çamçes, sepse vetë u muar gjerësisht me politikën e kohës, në fillim si deputet e pastaj si ministër i Jashtëm dhe Kryeministër kur doli ngadhënjimtar me Kryengritjen e Qershorit të vitit 1924. Ngjarjet politike të vitit 1924 e detyruan Fan Nolin të largohej përgjithmonë nga Shqipëria dhe të shkonte nëpër Evropë dhe në Amerikë.

VEPRIMTARIA E VISARION XHUVANIT PËR VËNIEN NË JETË TË VENDIMEVE HISTORIKE TË KONGRESIT KISHTAR TË BERATIT

Ndërhyrjet dhe sulmet e Patriarkanës për mungesën e kuadrit episkopal u bënë edhe më të fuqishme. Ato u përkrahën edhe nga disa shqiptarë që iu nënshtuan propagandës fanariote dhe greke. Këshillit të Lartë iu vështirësua veprimtaria kishtarë në Shqipëri. Kaluan gati tre vjet nga viti 1922-1925 që Këshilli i Lartë ishte në vështirësi të shumta. Për të dalë nga kjo gjendje e rëndë në vitin 1925 Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, me dekretin Nr. 686 të datës 28.2.1925, ngarkoi Visarion Xhuvanin për të drejtuar Dioqezën e Durrësit. Në qarkoren e parë si drejtues i Dioqezës së Durrësit Visarion Xhuvani kërkoi nga besimtarët që të ishin shembull i një kristianizmi të mirë e përparimdashës. Nga bashkëpunëtorët e vet kërkoi përkujdesje në shkallën më të lartë për mbarëvajtjen e punëve fetare, sepse Kisha Shqiptare kishte hyrë në lidhje me të gjitha kishat motra dhe me Patriarkanën e Stambollit. Ai kërkoi të ruanin e të zbatonin në mënyrë të plotë ritet e shenjta fetare për nder të Kishës e për të mirën e popullit shqiptar. Vëmendje i kushtoi domosdoshmërisë për lartësimin e edukatës, të diturisë dhe të gjendjes ekonomike të popullit dhe të klerit ortodoks shqiptar. Kështu Visarion Xhuvani u dha krahë dhe u ngjalli besim të gjithë besimtarëve dhe klerikëve shqiptarë.

Patriarkana atëherë kërkonte që kisha shqiptare të mbetej përgjithmonë e varur prej saj. Atëherë Visarion Xhuvani u preokupua në shkallën më të lartë për organizimin dhe drejtimin e Kishës. Kërkesa kanonike se nuk mund të kishte kishë pa episkopë, e shtyu Visarion Xhuvanin që pa lejen formale të Këshillit të Lartë Kishtar të shkonte në Mal të Zi për t'u dorëzuar episkop. Kështu ai do të kishte edhe të drejtën kanonike për të drejtuar dioqezën e Durrësit. Më 3 maj të vitit 1925 ai u hirotonis nga dy episkopë rusë të emigracionit dhe me miratimin e Patrikut serb, Dhimitri. (A.Q.Sh. f.251. 27-1-1932).

Visarioni nuk u pajtua me durimin dhe përunjësinë e disa klerikëve shqiptarë ndaj Patriarkanës Ekumenike. Koha kërkonte guxim dhe iniciativë, të cilat nuk munguan për të përmbushur aspiratën e hershme të ortodoksëve shqiptarë për një kishë autoqefale ashtu si dhe vendet fqinje të Shqipërisë dhe siç e urdhëronte dogma fetare. Akti i guximshëm i Visarionit pati jehonë në dy kahe krejt të ndryshme. Për disa ai ishte shpresëdhënëse se punët do të shpejtoheshin për vënie në jetë të vendimeve të Kongresit të Beratit. Në atë kohë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë u zemëruan, sepse Visarioni nuk kishte marrë leje të shkruar prej tyre dhe u përpoqën që ta pengonin njohjen e gradës episkopale e të mos e lejonin të mbante meshë episkopale. Ata këtë çështje kishtarë arritën ta bëjnë problem shtetëror duke ndërhyrë edhe pranë Qeverisë shqiptare.

Krejt ndryshe e vlerësoi aktin e guximshëm të Visarionit gazeta Koha në dy artikuj të botuar në maj dhe tetor të vitit 1925: “Lajmërohemi gjysmëzyrtarisht se

Arkimandrit Visarion Xhuvani u dorëzua episkop në Jugosllavi prej dy episkopësh rusë. Atje vajti pa marrë pëlqimin e Këshillit të Lartë duke shkelur rregullat. Koha do ta kish uruar por prap nuk dëshpërohem. Ai do të qëndrojë në një anë dhe do të presë pa marrë pjesë në kishë deri sa të vijnë urdhërat e kishës hierarkike që kundështarët të gjenin rastin për të luftuar patriotizmin e Visarionit, i cili është ndër të parët që ka hedhur gurin e parë në themelet e Kishës Autoqefale Shqiptare. Fati i Visarionit është lidhur me fatin dhe rregullin e kishës. Koka e falur nuk pritet. Hirësia pranoi dhe iu bind urdhërave të Kryesisë së Kishës dhe po qëndron si oshënar besnik. Të gjithë kanë bërë gabime, por ato u bënë për t'i shërbyer çështjes kombëtare dhe ai e bëri këtë sepse do që t'i shërbejë sa më mirë siç i ka shërbyer deri më sot” (Koha, 16 maj, Nr.258, viti 1925).

5. KISHA ORTODOKSE SHQIPTARE DHE PATRIARKANA E KOSTANDINOPOJËS

Ndërkohë mosmarrëveshjet midis ortodoksëve shqiptarë për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë, për durimin dhe bindjen ndaj urdhërave të Patriarkanës dhe të atyre që kërkonin me urtësi dhe arsye zbatimin e kanoneve të shenjta, po bëheshin gjithnjë dhe më të mëdha. Visarion Xhuvani eci me kujdes dhe maturi drejt pikësynimit kryesor, zbatimit të vendimeve të Kongresit të Beratit. Kishin kaluar gati tre vjet që ende nuk ishte formuar Sinodi Episkopal. Visarion Xhuvani mbeti i vetëm, i papërkrahur edhe nga ata që bënë shumë për Kishën Ortodokse Shqiptare por që ndodheshin larg atdheut në Amerikë, në Rumani e në vende të tjera.

Me hirotonisjen e Visarionit më 3 maj të vitit 1925 ndryshoi përbërja e klerit të lartë në Shqipëri, tani ata ishin tre, çdo dioqezë kishte episkopin e vet, Korça Jerotheun, Berati Kisin dhe Visarioni ishte në dioqezën e Durrësit. Mbeti pa episkop vetëm dioqeza e Gjirokastrës. Në këtë kohë fanari ndryshoi taktikën, sepse sipas kanoneve kishtare në Shqipëri kishte tre episkopë, pra ishte e ligjshme dhe autoqefalia që ishte mohuar deri atëherë. Patriarkana premtoi në vend të autoqefalisë një autonomi të kufizuar, duke ruajtur privilegjet e veta në caktimin e episkopëve grekë dhe në përdorimin e gjuhës greke në liturgjinë kishtare. Pranimi i këtyre kërkesave për ligjite përfundimisht varësinë e Kishës shqiptare nga Kisha greke dhe prandaj Këshilli i Lartë, klerikët atdhetarë si dhe shumica e ortodoksëve shqiptarë nuk u pajtuan me qëndrimin e Patriarkanës Ekumenike.

Për të nënshtuar dhe për të bindur klerikët dhe ortodoksët shqiptarë, në vitin 1926 Patriarkana dërgoi emisarët e saj: Eksarkun Krisanthos, episkopin më të përgatitur dhe njohësin më të mirë të problemeve të kishave ballkanike, dhe Kotokon, teolog korçar i përgatitur në shkollën e lartë greke, i cili pretendonte të vendosej në Dioqezën e Korçës. Ata e vlerësuan mirë gjendjen kishtare dhe u lidhën edhe me Qeverinë Shqiptare. Emisarët grekë kërkuan që të ruheshin privilegjet e mëparshme, ndikimi grek në Shqipëri dhe Patriarkana të ishte gjithmonë kujdestare e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Patriarkana e Stambollit kërkoi që të kishte të drejtën e vetos për emërimin e kryepiskopit, të miratonte propozimet për episkopë dhe në meshë e në shërbesat fetare të përdorej gjuha greke. Këto kërkesa ishin të papranueshme dhe në kundërshtim me vendimet e Kongresit Kishtar të Beratit. Emisarët e Patriarkanës së Stambollit ngjallën pakënaqësi dhe nervozizëm ndërmjet ortodoksëve shqiptarë, prandaj ishte e domosdoshme që propozimet e tyre të hidheshin poshtë edhe me argumentime të shëndosha nga pikëpamja kanonike e fetare.

Këtë punë duhej ta bënin në radhë të parë klerikët episkopë shqiptarë. Prej tyre vetëm Visarion Xhuvani guxoi t'u kundërvihet emisarëve të Patriarkanës. Ai shkroi disa artikuj në gazetën e përditshme, në të cilat vuri në dukje padrejtësitë e ndërhyrjeve të Patriarkanës Ekumenike. Këto shkrime janë dhënë në librin me titull: “ÇËSHTJE POLITIKO-RELIGJIOZE-KOSTANDINOPOL-TIRANË” (Prej Episkop Visarion Xhuvanit, teolog me diplomë t'Universitetit t'Athinës. Ish Senator i Elbasanit dhe ish Deputet i Durrësit), botuar më 15 maj të vitit 1926 në Tiranë.

Në kapitullin e parë të këtij botimi “Kisha Ortodokse Shqiptare dhe Patriarkana e Kostandinopojës” është argumentuar shpallja e Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare në vitin 1922 kur “Asnji delegat nuk votoi kundër, asnji kishë dhe asnji qytet nuk mungoi me u përfaqësue. Kanonet Apostolike të Statutit të Përgjithshëm Panortodoks urdhënojnë: 1-Nji kishë e një shteti tjetër të mos urdhënojë një kishë të një shteti tjetër. 2-Kishë e lirë në një shtet të lirë. Për këto arsena kanonike të patundshme ortodoksë e Shqipërisë kishin detyrë të krijojnë kishën e vet Autoqefale, e cila de jure, sipas kanoneve të masipërme, ishte Autoqefale që prej proklamimit të Indipendencës Politike të Shqipërisë në Vlonë”. (f. 3-4 e librit)

Më poshtë janë dhënë përmbledhtas marrëdhëniet e Kishës shqiptare me kishat e tjera ortodokse dhe të drejtat e Patriarkanës ndaj saj. Mosnjohja nga ana e Patriarkanës së Kostandinopojës nuk prishte asnjë punë dhe nuk e vinte në rrezik kishtar Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, e cila edhe de facto ishte në veprim si autoqefale prej vitit 1922. Prandaj asnjë kanon kishtar dhe asnjë arsye nuk mund të ndalojë vazhdimin e jetës autoqefale të Kishës Ortodokse Shqiptare.

Sipas rregullave kishtarë dhe kanoneve të ortodoksisë një kishë e një shteti po të ketë në krye një Sinod vetëm prej episkopësh, të cilët të paktën duhet të jenë 2-3, mund të jetë kishë e rregullt autoqefale. Pra edhe me një Sinod prej 3 Episkopësh duhet të njihet doemos prej kishave të tjera ortodokse të botës, pra edhe prej Patriarkanës së Stambollit.

“Detyra e parë e gjithë atyne që duen të mirën e kishës asht: Të formojnë Sinodin Episkopal të Kishës Autoqefale me shpejtësi dhe ngutësi të madhe, rregullisht dhe sipas vendimeve të Kongresit të Beratit. Dhe duhet të vemë themele jo vetëm për një kohë të shkurtër por të paravështrojmë edhe për nesër, për sinodet e paskëtajme të Shqipërisë, që kanë të bëjnë me interesat fetaro-kombëtare dhe të përparimit social të brezave të ardhshëm, që janë shpresa e artë e shqiptarizmit.

Kemi pra për detyrë me organizue e me rregullue vetë ne shqiptarët kishën tonë me Sinod Episkopal Shqiptar dhe jo të vrasim mendjen me bisedime kot me botën”. (f. 6 e librit).

Patriarkana Ekumenike nuk kishte asnjë të drejtë kanonike të emëronte episkopët e Sinodit të parë të Kishës Autoqefale të Shqipërisë, sepse këta i emëronte Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë sipas vendimeve të Kongresit të Beratit dhe sipas kanonit apostolik: “Nji kishë e një shteti tjetër të mos i japë urdhën një kishë të një shteti tjetër”.

Patriarkana nuk kishte të drejtë të ndërhynte edhe për këto arsye:

1-Eksarku i Patriarkanës Imzot Jerotheu në emër të saj i njohu të vlefshme, kanonike dhe i bekoji të gjitha vendimet dhe Statutin e Kongresit të Beratit dhe Patriarkana nuk e përgënjeshtroi dhe nuk protestoi ndaj deklaratës që bëri përfaqësuesi i saj më datën 19.12.1912 në Korçë.

2- Episkopët e Korçës, Imzot Jerotheu, i Beratit, Imzot Kisi, dhe i Durrësit, Imzot Noli, ishin në dioqezat e tyre sipas rregullave kanonike dhe se kishin të drejtë të dorëzonin episkopë të rinj.

3-Episkopët që ishin në Shqipëri Germanos, Joaqim dhe Jakov ishin larguar dhe ishin vendosur në dioqeza të tjera nga Patriarkana. Në vend të tyre prej Këshillit të Lartë të Kishës Autoqefale të Shqipërisë ishin emëruar Jerotheu, Kristofor Kisi dhe Fan Noli.

4-Në Rumani, Serbi dhe Greqi, por edhe në Poloni Patriarkana nuk ka emëruar episkopët e saj në sinodet e tyre të para, por i ka njohur ato ashtu siç i kanë zgjedhur vetë.

Me këto argumente Visarion Xhuvani iu kundërvu emisarëve të Patriarkanës dhe nuk pranoi që episkopët e Sinodit të parë që do të krijoheshin të ishin të dërguarit e Patriarkanës.

6. 1929, SI U KRIJUA SINODI I PARË I KOASH-IT

Ky sinod patjetër duhej të përbëhej e të krijoheshin nga episkopë shqiptarë, sepse prania e një episkopi të huaj prekte dhe prishte dinjitetin kombëtar të Kishës Ortodokse Shqiptare, ishte shkak konkurrence për ndikimet e huaja në Shqipëri, përziente keq politikën e jashtme dhe të brendshme të shtetit shqiptar dhe zhdukte karakterin kombëtar të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, të cilën e kanë të gjitha kishat e tjera ortodokse autoqefale.

Edhe pranimi i një episkopi me origjinë shqiptare, por me nënshtetësi të huaj është kundër traditave ligjore dhe kombëtare, por edhe kundër interesave shtetërore. Ai prek nderin kombëtar dhe dinjitetin e shqiptarëve, të cilët kishin katër teologë të merituar shqiptarë për të formuar Sinodin e parë Episkopal të Shqipërisë. Për kryefetarët ishte një ligj i posaçëm i shtetit shqiptar, ligji për komunitetet fetare i votuar në Parlament dhe dispozitat e këtij ligji ishin të detyrueshme ashtu si edhe ato të Statutit kishtar të miratuar në Kongresin e Beratit.

Një tjetër kërkesë e misionarëve të Patriarkanës ishte përdorimi i një gjuhe të huaj në kishë, pra i gjuhës greke. Edhe këtë kërkesë Visarion Xhuvani nuk e pranoi se gjuha shqipe ishte në gjendje të përdorej në meshën e shenjtë edhe nga pikëpamja filologjike. Më 1872 ishte botuar përkthimi i Ungjillit prej Kostandin Kristoforidhit, por edhe para tij ka pasur përkthime. Për ato që janë botuar nuk ka pasur asnjë kritikë për të metat filologjike, edhe pse ka pasur kundërshtime të rrepta përdorimi i gjuhës shqipe në kishë.

Gjuha shqipe është në gjendje të japë kuptimin e duhur për Ungjillin dhe për meshën më mirë se gjuhët sllave, si edhe gjuhë të tjera me zhvillim të ngjashëm filologjik me gjuhën tonë, në të cilat ndër kohë të hershme ungjilli dhe mesha janë përkthyer. Si çdo komb ortodoks, i cili përdor gjuhën e vet, edhe populli ortodoks shqiptar ka të drejtë të përdorë gjuhën e vet shqipe për meshën, ungjillin dhe për çdo shërbesë fetare.

Visarion Xhuvani ka mbajtur qëndrime të drejta për mësimin e gjuhëve të huaja dhe për arsimin laik në Shqipëri. Në çdo shtet modern feja e fetarët nuk duhet të përzihen në drejtimin e sistemit arsimor, sepse edhe ligjet nuk mund t'u japin privilegj të veçantë atyre. Fëmijëve shqiptarë duhet t'u mësojmë gjuhët evropiane, si anglishten, frëngjishten, italishten, sepse prej tyre do të kenë përfitime praktike dhe mundësi për t'u marrë me shkencë.

Edhe në pjesën e dytë: “As koloni as protektorat” Visarion Xhuvani u kundërvihet të dërguarve të Patriarkanës në Shqipëri dhe qëndrimeve të tyre të padrejta ndaj Kishës

Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Formimi i Sinodit të parë të KOASH-it ishte kushti kryesor për njohjen e autoqefalisë dhe dhënien e Tomusit. Mungesa e tij ishte një pretekst i Patriarkanës për të ndërhyrë në veprimtarinë kishtarë të ortodoksëve shqiptarë.

Nga viti 1922 deri në vitin 1926 pati polemika të forta për miratimin apo moslejimin e ndërhyrjeve patriarkale. Artikujt dhe librat e Visarion Xhuvanit, të mbështetura në kanonet apostolike, i quajtën të paarsyeshme dhe të palejueshme ndërhyrjet. Mendime të kundërta pati edhe për përdorimin e greqishtes në liturgjinë hyjnore. Vite të tëra ortodoksët shqiptarë kanë aspiruar për të dëgjuar në gjuhën shqipe fjalën e shenjtë. Këtë aspiratë mbështeti edhe Kongresi i Beratit me vendimet e tij të rëndësishme.

Ndërhyrjet dhe polemikat e shumta nuk i shërbenin as harmonisë midis ortodoksëve shqiptarë. Çdo ditë e më shumë shtoheshin edhe ndikimi i Kishës greke në Shqipëri. Kjo gjendje ishte e papranueshme edhe për shtetin shqiptar. Qeveria nuk lejoi kaosin midis shtetasve të vet dhe mbështeti vendimet e Kongresit të Beratit, Statutin e tij, duke u kërkuar drejtuesve të Kishës Ortodokse që të zbatonin gjithçka ishte vendosur më 1922 në Berat.

Krijimi i Sinodit të parë me episkopë kanonikë shqiptarë vështirësohej me polemika shterpe, megjithëse kushtet për formimin e tij qenë shumë të favorshme dhe kandidaturat për episkopë ishin të meritueshme dhe të përshtatshme. Trysnia e rëndë fanariote rëndonte dhe i pamundësonte episkopët e Korçës dhe të Beratit për të vepruar.

Jerotheu dhe Kisi atëherë mbështetën direktivat e Patriarkanës për të penguar formimin e Sinodit. Ata paraqitën pretekste absurde, të cilat nuk ishin kanonike dhe binin në kundërshtim edhe me interesat kombëtare. Gjithashtu ata nuk i zbatuan vendimet e Këshillit të Lartë dhe nuk bënë dorëzimin e episkopëve të rinj për formimin e Sinodit. Për të dalë nga kjo gjendje e rëndë, e cila krijonte përshtypjen se nuk do të formohej kurrë Sinodi Episkopal, Qeveria shqiptare me anë të Kryeministrit Koço Kota iu drejtua dy herë episkopëve të Korçës dhe të Beratit për të vepruar në mbështetje të vendimeve të Kongresit të Beratit. Këshilli i Lartë nuk mund të priste më dhe nuk u pajtua me sorollatjet e tyre.

Më 1 shkurt të vitit 1929 Këshilli i Lartë dhe Qeveria shqiptare njohën gradën episkopale të Visarion Xhuvanit (dekreti i Këshillit të Lartë Nr.687, datë 28.3.1925) dhe emëruan në Mitropolinë e Durrësit.

Pritjet e mëtejshme e dëmtonin rëndë autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Prandaj Këshilli i Ministrave në një mbledhje të jashtëzakonshme të kryesuar nga Naltmadhnia e tij Zogu I, thirri anëtarët e Këshillit të Lartë Atë Vasil Markon dhe Imzot Visarion Xhuvanin për të shpejtuar formimin e Sinodit Episkopal. Visarioni u ngarkua që të gjente dy episkopë kanonikë të huaj, të cilët do të dorëzonin kandidatët shqiptarë. Për të plotësuar këtë mision Visarionin e ndihmoi Patriku serb, i cili dërgoi një episkop kanonik për të dorëzuar bashkë me Visarionin episkopët e rinj shqiptarë. Ata vepruan me shumë kujdes dhe pa cenuar asnjë normë kanonike.

Nga data 11 shkurt deri më 17 shkurt u dorëzuan episkopët e rinj Agathangjel (Vangjel) Çamçja dhe Thanas Ambrosi dhe më 18 shkurt të vitit 1929 u krijua Sinodi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare i përbërë nga Imzot Visarion Xhuvani, episkop Agathangjel Çamçja, episkop Thanas Ambrosi dhe Imzot Eugjeni. Kjo ishte ditë feste e shënuar për të gjithë shqiptarët pa dallim feje.

Më 18 shkurt të vitit 1929 Kryesia e Këshillit të Lartë të Kishës Ortodokse iu drejtua me këto fjalë anëtarëve të Sinodit të Shenjtë: “Hirësive të tyre Imzot Visarionit, Çamçes, Ambrosit dhe Eugjenit. Në bazë të Statutit të Kishës Autoqefale Shqiptare, për mbarëvajtjen e Kishës dhe për dobi të interesave të Atdheut emërojnë: 1-Visarion Xhuvani, Mitropolit i Tiranës dhe i Durrësit. 2-Agathangjel Çamçe, Episkop i Beratit, Vlorës dhe Kaninës. 3-Thanas Ambrosi, Episkop i Gjirokastrës, Delvinës dhe Himarës. (Eugjeni ishte pa dioqezë dhe u caktua ndihmës i Kryeepiskopit).

Në këtë mënyrë deklarojmë formimin e Sinodit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe sipas dispozitave të Statutit njoftojmë dorëheqjen tonë e të gjithë Këshillit në fjalë. Sa më sipër u bë pasi u muar pëlqimi i plotë i Mbretit dhe i Qeverisë mbretërore.

Kryetari i Këshillit të Lartë

Ikonom Vasil Marko

Mbas vendimit të Këshillit të Lartë Visarioni mbledhi episkopët për të zgjedhur kryetarin e Sinodit. Këtë detyrë ia besuan Visarion Xhuvanit. Pas shumë përpjekjesh dhe një pune 7-vjeçare u formua Sinodi Episkopal, i cili zgjodhi Kryeepiskopin e Tij, Visarion Xhuvanin.

Mbas formimit të Sinodit Episkopal Patriarkana Ekumenike u shpreh me zemërim të thellë dhe me mallkime mesjetare i quajti anëtarët e Sinodit puçistë, të paaftë, injorantë etj. Megjithatë ata nisën të punojnë me kujdes për të fituar kohën e humbur dhe për të organizuar sa më parë Kongresin e dytë panortodoks shqiptar ku do të miratohej Statuti i Përhershëm dhe do të përcaktohej udha e mëtejshme për veprimtarinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

KRIJIMI I SINODIT TË SHENJTË TË KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE

(Me rastin e 75-vjetorit të tij).

Dëshira e ortodoksëve shqiptarë për të pasur një Kishë të pavarur është e hershme. Atë e morën me vete ata që mërguan jashtë atdheut, në Amerikë, Rumani, Bullgari, Egjipt, ku gjetën truall të përshtatshëm shenjat e gjallërimit. Me shpalljen e pavarësisë (1912) dhe me formimin dhe konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar më 1920 (Kongresi i Lushnjës), kjo dëshirë erdhi duke u gjallëruar, forcuar dhe mori trajta më konkrete.

Ortodoksët shqiptarë, të udhëhequr nga kanoni kryesor "Kishë e lirë në shtet të lirë", kërkojnë që të gjitha ritualet fetare të bëhen në gjuhën shqipe, në gjuhën amtare. Ata duan që gjithë gëzimin e lindjes së foshnjës, së cilës nëna i drejtohet me fjalë të bukura të zemrës, babai vetë t'i bëjë urimet e çiltra, gjyshi dhe gjyshja t'i zgjedhin fjalët më ledhatuese që të mos rrëzohet dhe kur foshnja e tyre merr bekimin e parë nga kleriku i kishës ditën e pagëzimit.

E bukur është atmosfera e dasmave. Këngët me fjalët më të bukura u këndohen nuses dhe dhëndrit, gëzimi dhe hareja e shoqëron çiftin për në altar. Gëzimi i prindërve gjithnjë shoqërohet me urime për fëmijët e tyre që të trashëgohen dhe të bëjnë jetë të lumtur. Të gjitha këto zbehen kur në kishë nuk përdoret gjuha shqipe, por një gjuhë tjetër e pakuptueshme. Dhëndrit dhe nuses kur vënë kurorat mbi kokat e tyre u bëhet urimi martesor me fjalë zemre, i cili mbetet i pakuptueshëm për ta kur jepet në gjuhë të huaj.

E rëndë dhe shumë e hidhur është vdekja. Në eposin shqiptar janë dhënë shumë fjalë prekëse për të. Nëna derdh lot hidhërimi, miqtë e dashamirët shprehin trishtim të thellë. Kur të afërmit përpiqen të gjejnë ngushëllim, s'ka pse kleriku t'i bëjë lutjet e përmortshme në një gjuhë të pakuptueshme për njerëzit që i japin të dashurit të tyre lamtumirën e fundit.

Organizimin shpirtëror në bazë të kanoneve të shenjta, zyrtarizimin dhe miratimin e tij është e nevojshme ta bëjë në radhë të parë shteti. Këtë nismë e mori Kostë Paftali, prefekti i Durrësit. Ai njoftoi telegrafisht prefekturat në vitin 1922 për domosdoshmërinë e organizimit të një tubimi për këtë qëllim të rëndësishëm. Çdo prefekturë do të zgjidhte nga dy delegatë, midis tyre kishte edhe klerikë shumë të njohur, si Arkimandrit Visarion Xhuvani, Arkimandrit Agathangjel Çamçja, Ikonom Vasil Marko, Papa Harallambi, Papa Josifi etj.

Qeveria shqiptare u tregua mjaft e interesuar për çështjen shpirtërore dhe fetare të popullit të saj. Ajo i dërgoi një qarkore prefekturave dhe nënprefekturave për të

mbështetur zgjedhjen e njerëzve atdhetarë, të cilët do të përkrahnin idenë e një kisha autoqefale shqiptare. Kundërshtarët e autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare përhapën gënjeshtër, sikur organizatore e mbledhjes së Kongresit të Parë Kishtar të Beratit ishte qeveria. Ahmet Zogu, atëherë ministër i Brendshëm, i hodhi poshtë këto shpifje. Qarkorja drejtuar prefekturave dhe nënprefekturave më 5-09-1922 dëshmon se shteti nuk ka qenë inisiator i këtij Kongresi dhe se nuk është përzier në çështjet fetare të ortodoksëve shqiptarë, por është munduar të ndihmojë në zgjidhjen e autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare, sepse kjo i shërben gjithë vendit.

Kongresi kishtar ortodoks e shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare duke u mbështetur në kanonet apostolike dhe të sinodeve të lidhura shpirtërisht, dogmatikisht dhe apostolikisht me Kishën e madhe të Krishtit, me Patriarkanën e Stambollit. Ky Kongres plotësoi aspiratat e ortodoksëve shqiptarë sepse vendosi përfundimisht të drejtën e ligjshme të shqiptarëve ortodoksë për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë.

Me vendimin Nr. 807 të datës 18-09-1922 Këshilli i Ministrave bëri njohjen zyrtare shtetërore të vendimeve të Kongresit të Beratit dhe i miratoi ato plotësisht sepse ishin mbështetur në parimin e pavarësisë së shtetit shqiptar (A.Q.Sh. fondi 251, dosja 1254, viti 1922).

Ahmet Zogu, ministër i Brendshëm, u interesua drejtpërdrejt për mbarëvajtjen e Kongresit Kishtar të Beratit. Ai mori pjesë në gëzimin mbarëpopullor, urdhëroi që në të gjitha prefekturat të bëhej qitje me top për të shprehur harenë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme për të gjithë Shqipërinë.

Këshilli i Lartë i zgjedhur në Kongres njoftoi të gjitha patriarkanat dhe kërkoi miratimin e Patriarkanës Ekumenike të Stambollit, e cila nuk e miratoi autoqefalinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Dy delegacione njëri pas tjetrit shkuan në Stamboll dhe u takuan me Patriarkun. Në delegacionin e dytë morën pjesë deputetë, klerikë të shquar, personalitete të njohura të vendit, si At Vasil Marko, Dhosi Havjari, Vasil Avrami, deputeti Thoma Orolloga, Atë Harallamb Torca, Dhimitër Kacimbra, Simon Shuteriqi e Kristo Kirka. Me gjithë kërkesën e argumentuar bindshëm, Patriarku nuk u tërhoq nga qëndrimi i tij i mëparshëm, duke vepruar me diplomaci për njohjen e pavarësisë së Kishës dhe jo për njohjen e autoqefalisë.

Për njohjen e pavarësisë, pra theksojmë jo të autoqefalisë, Patriarku i Stambollit vuri këto kushte:

- 1- Peshkopët që do të zgjidhen prej popullit shqiptar duhet të jenë miratuar më parë prej tij.
- 2- Patriarkana ka të drejtën e vetos në miratimin e Kryepiskopit.
- 3- Gjuha e vjetër e dëshirueshme e kishës, greqishtja, të zërë vendin e parë në Kishë.

Këto kërkesa të Patriarkanës së Stambollit hidhnin poshtë vendimet kryesore të Kongresit Kishtar të Beratit dhe opinioni atdhetar nuk u pajtua me këto kërkesa. Ndërkohë diskutimet u bënë të ashpra dhe kontradiktat ndërmjet atyre që ishin për autoqefalinë dhe atyre që i quanin të mjaftueshme propozimet e Patriarkut të Stambollit erdhën duke u thelluar. Zbatimi i vendimeve të Kongresit të Beratit u bë ngadalë sepse edhe dioqezat kryesore ishin pa titullarët e vet. Gjithashtu edhe gjendja financiare e kishave ishte shumë e dobët. Për të krijuar një gjendje më të favorshme Visarion Xhuvani më 1923, kur atëherë ishte deputet, kërkoi nga Parlamenti ndihmë financiare prej 50.000

franga ari. Ai iu drejtua Parlamentit me këto fjalë: " Kështu edhe një herë ky Parlament t'i marri parasysh gjithë nevojat dhe gjendjen delikate të Kishës Autoqefale Kombëtare dhe të mos kursejë një dhuratë të vogël që ka me primum njisimin dhe shqiptarizimin e ortodoksëve, punë që ka aq vlerë për interesimin ma të naltë të shtetit në kohën e ardhme, sa nuk mund ta shpjegoj me kohën e pakët që kemi"(Bisedime të Këshillit Kombëtar, faqe 221, viti 1923).

Mbas disa diskutimesh Ahmet Zogu tha: "Asht e ditun se këto ndihma do të jepen jashtë buxhetit dhe një shumë prej 50.000 frangash ari nuk asht gja e madhe. Qeveria pra, me gëzim e pranon dëshirën e komisionit të financave, që kjo shumë t'i dhurohet Këshillit të Naltë të Kishës Kombëtare" (Bisedime të Këshillit Kombëtar, faqe 221, viti 1923). Në këtë rast Ahmet Zogu shprehu për herë të dytë vullnetin e mirë për të ndihmuar Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ai mbajti po këtë qëndrim në përkrahje të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare edhe në raste të tjera që do t'i shohim më poshtë.

Ndihma e miratuar në Parlament i dha udhë zgjidhjes së problemeve të ngutshme të kishës sonë, por mungesa e Sinodit të Shenjtë me dhespotë kanonikë, të cilët do të drejtonin veprimtarinë kishtarë për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të Beratit, ishte pengesë e madhe. Mitropolitët kanë qenë: Jerotheu në Korçë, Kristofori në Berat dhe Noli në Durrës. Me veprimet e tyre këta titullarë u treguan të mefshtë dhe nuk plotësuan kërkesën e Kongresit të Beratit për të dorëzuar dy kandidaturat e mundshme, që atëherë ishin V. Xhuvani dhe A. Çamçja.

Kaluan tre vjet nga Kongresi Kishtar i Beratit dhe zgjidhja po dukej disi e largët. Ndërkohë dioqeza e Durrësit mbeti pa Mitropolit. Për të plotësuar këtë post të rëndësishëm kishtar dhe për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të Beratit, Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare ngarkoi Visarion Xhuvanin që të drejtonte Mitropolinë e Durrësit sipas dekretit Nr. 686 të datës 28.3.1925.

Visarioni e filloi detyrën dhe nëpërmjet qarkores së parë kërkoi nga besimtarët që të punohej me shembullin e një kristianizmi përparimdashës, me shpirt vëllazërimi e bashkimi kombëtar, të përfitohej nga të mirat e qytetërimit duke qëndruar larg çdo pseudoqytetërimi, që është i dëmshëm për moralin dhe atdheun. Më poshtë ai ka shkruar: "Do të gëzohemi dhe do të nderojmë Krishtin, shpirtin tonë dhe Atdheun në rast se do të referojmë kurdoherë vllaznim e dashuni në punë për të gjithë bashkëkombasit dhe për ata që nuk janë në dogmë të një feje me ne".

Nga klerikët dhe bashkëpunëtorët e vet Visarioni kërkoi që të ruajnë dhe të zbatojnë në mënyrë të plotë kanonet e shenjta për nder të kishës dhe për të mirë të popullit. Plotësimi i kësaj detyre kërkonte që Mitropolit i Durrësit të kishte gradë episkopale. Visarioni nuk mund të priste deri sa të zbutej zemërimi i Patriarkanës së Stambollit dhe nuk u pajtua me plogështinë, durimin dhe përunjësinë e ndonjë dhespoti tjetër. Ai ishte i bindur se Patriarkana dëshironte që kisha shqiptare të mbetej e varur përgjithmonë prej saj. Ishte koha për të vetëvepruar me guxim dhe me sakrificë. Atëherë pa mbështetjen e Këshillit të Lartë, Visarion Xhuvani shkoi në Mal të Zi dhe më 3 maj të vitit 1925 u dorëzua në gradën episkopale.

Akti i dorëzimit të Visarionit pati jehonë të dyfishtë. Disa mendonin se punët do të shpejtoheshin për formimin e Sinodit, të tjerë e quajtën shkelje disiplinore. Midis tyre kishte dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të cilët nuk e njihnin si Mitropolit dhe e ndalonin që të celebronte Meshë Episkopale. Madje ata arritën të kërkojnë që të merreshin masa disiplinore ndaj tij. Përplasjen e Episkopit të ri me Këshillin e Lartë e zgjidhi ministri i

Punëve të Brendshme, A. Dibra, i cili, në përgjigje të letrës së dërguar nga Prefektura e Elbasanit më datën 24.2.1927, ka shkruar: " Meqenëse Sinodi i Shenjtë është në formim e sipër, të ruhet statuskuoja dhe problemi të zgjidhet prej Sinodit" (AQSh f. 152, dosja 20, viti 1927).

Në vitin 1926 Patriarkana e Stambollit ndërmori një veprim tjetër diplomatik për të mposhtur qëndresën e atdhetarëve shqiptarë dhe për të bindur Qeverinë dhe Presidentin e shqiptarëve. Ajo dërgoi në Shqipëri Eksarkun Krisanthos, Mitropolit i Trapezundës dhe laikun P. Kotoko. Misionarët grekë ngulën këmbë përsëri për ruajtjen e privilegjeve të Patriarkanës së Stambollit. Ortodoksët shqiptarë atëherë u ndanë në dy grupe: në përkrahës të idesë së autoqefalisë dhe në përkrahës të kërkesave të Patriarkanës. Ndërkaq ortodoksët e Vlorës me Tol Arapin në krye i dërguan këtë telegram Atë Vasil Markos më 10 qershor të vitit 1926: "Krisanthi vjen në Korçë, kini kurajo patriotike dhe mos bini viktimë e dhëlpërive fanariote. Kemi lindur shqiptarë, rrojmë dhe do të vdesim shqiptarë. Statuti i Beratit për të cilin jemi betuar nga ana jonë nuk cenohet" (Gazeta Koha, qershor 1926).

Protestën e ortodoksëve vlonjatë e mbështeti fuqishëm Visarioni, i cili me argumente teorike dhe kanonike shkroi disa artikuj në gazetat e kohës dhe botoi në vitin 1926 "Çeshtje politiko-religjioze Kostandinopol-Tiranë" në dy pjesë. Visarion Xhuvani është mbështetur në kanonet apostolike të Statutit të Përgjithshëm Panortodoks: "Një kishë e një shteti tjetër të mos urdhërojë një kishë të një shteti tjetër" dhe "Kishë e lirë në një shtet të lirë".

Mbas vitit 1922 pikërisht këto kanone kishtarë hapën udhën e jetës autoqefale të Kishës Ortodokse Shqiptare. Në këto dy vepra u vlerësua antikanonike kërkesa e Patriarkanës së Stambollit për të emëruar episkopët e vet në dioqezat shqiptare, në një kohë kur ajo nuk kishte vepruar kështu as në Rumani, Serbi, Poloni dhe Greqi. "Prania e një episkopi të huej në Shqipni prek dinjitetin nacional të kishës shqiptare, bahet shkak për influenca të hueja, përzien keq politikën e jashtme të Republikës sonë dhe trazon politikën e brendshme duke humbun karakterin kombëtar të cilin e votoi Kongresi i Beratit".

Duke iu kundërvënë misionarëve të Patriarkanës, Visarioni kërkoi që të veprohej shpejt pa humbur kohë me bisedime të kota. Kërkohej që sa më shpejt të formohej Sinodi Episkopal dhe të viheshin themele të forta për të ardhmen fetaro-kombëtare të Shqipërisë dhe për përparimin social të brezave të ardhshëm. Prandaj që tani le të mendojmë dhe për zgjedhjen e sinodeve të pastajme të Shqipërisë. Për mbarëvajtjen e punëve duhet të largojmë nga shpirti ortodoks ambiciet dhe dëshirat që pengojnë të mirën e kishës, të formojmë Sinodin Episkopal që do të udhëheqë kishën dhe të sigurojmë përkrahjen e sinqertë të shtetit. Këto ishin disa ide të shprehura në librat dhe artikujt e V. Xhuvanit.

Visarioni doli në ballë të përpyekjeve që kundërshtonin ndalimin e gjuhës shqipe në liturgjinë fetare. Vënien e gjuhës greke nuk e quajti të logjikshme edhe për arësye filologjike, sepse pjesa më e madhe e librave liturgjikë ishin përkthyer e përshtatur në gjuhën shqipe nga njerëz me kompetencë profesionale. Kontradiktat midis intelektualëve për këtë çështje të rëndësishme të Kishës Ortodokse Shqiptare i zgjidhi Mbreti Zogu i Parë, i cili me vendosmëri ka deklaruar: "Aq më ban ç'mendon Patriarkana. Në Shqipni jam zot vetë dhe komandoj unë" (70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale, Tiranë 1993, faqe 71).

Krijimi i sinodit me episkopë kanonikë shqiptarë u bë një çështje gjithnjë dhe më e ngutshme, sepse vetëm ai do ta fuste kishën në rrjedhën e kishave të tjera ballkanike. Vetëm sinodi i ortodoksëve shqiptarë, i mbështetur në kanonet kishtarë dhe në parimet e së drejtës kombëtare, do t'u bënte ballë qarqeve shoviniste greke që dominonin në Patriarkanën e Stambollit. Krahu atdhetar shqiptar kërkoi zgjidhje të brendshme të Sinodit Kishtar. Më 13 nëntor të vitit 1929 Kryeministri i qeverisë shqiptare, Koço Kota, iu drejtua me dy shkresa Mitropolitëve Jerotheu dhe Kisi që ishin që të dy në Korçë, dhe shfaqti dëshirën që dy kandidatët për peshkopë (Çamçe dhe Ambrosi) të dorëzoheshin sa më parë dhe me këtë mënyrë të plotësoheshin kushtet për formimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Katër muaj kaluan pa u bërë asgjë. Qeveria kërkoi zgjidhje të brendshme të sinodit, ndërsa ata që nuk e përkrahën këtë ide kërkuan zgjidhje tjetër. Kërkesat e tyre jo vetëm që nuk qenë kanonike, por qenë dhe të pamundshme për interesat kombëtare të ortodoksëve shqiptarë dhe për parimet shtetërore. Për formimin e Sinodit u interesua në mënyrë të veçantë Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale, i cili u mbështet në vendimet e Kongresit të Beratit, në kanonet e shenjta dhe te qeveria shqiptare e kohës. Në shkurt të vitit 1929 Kryetari i Këshillit të Lartë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë njoftoi Visarion Xhuvanin: "Në bazë të vendimeve të Kongresit të Beratit për mbarëvajtjen e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, kjo kryesi, në marrëveshje të plotë me Sovranin August, Naltmadhnië e tij mbretin e shqiptarëve Zogu I dhe me Qeverinë mbretërore, ju njuh gradën episkopale Hirësisë Suaj, ju emëron Mitropolit të Durrësit me juridiksionin kishtar të gjitha pjesët e tjera të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare të caktuara në dekretin e votuar në Kongresin e Beratit.

Kryetari i Këshillit të Lartë Atë Vasil Marko" (AQSh. fondi 251, dosja 850, viti 1929).

Detyra e re që iu ngarkua Visarionit u miratua menjëherë nga Qeveria Shqiptare. Kryeministri i dërgoi një letër Visarion Xhuvanit: "Sipas drejtimit të bamun nga Kryesia e Këshillit të Lartë të kishës, pëlqejmë emërimin që ju është ngarkuar me shkresën e asaj kryesie Nr/ekstra 1.2.1929. Lutemi që misioni i sipërthënë brenda një kohe të shkurtër të kryhet prej Hirësisë suaj me sukses.

Kryeministri Koço Kota" (AQSh. fondi 251, dosja VI-337, vit 1929).

Çdo pritje e mëtejshme do ta dëmtonte rëndë autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare, prandaj në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, të kryesuar nga Naltmadhnia e Tij, Mbreti Zog I, në të cilën morën pjesë Koço Kota, Pandeli Evangjeli, Hiqmet Delvina, ndërsa nga Këshilli i Lartë Kishtar At Vasil Marko dhe Imzot Visarioni. Ky i fundit u ngarkua që të zgjidhte dy episkopë kanonikë të huaj të cilët do të dorëzonin kandidatët shqiptarë.

Nga 11 shkurti deri më 17 shkurt të vitit 1929 u bënë hirotonisjet e episkopëve dhe më 18 shkurt do të formohej Sinodi. Këto qenë ditë festive për ortodoksët dhe për myslimanët shqiptarë. Meshat që u mbajtën atëherë ishin ngjarje të shënuara në historinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Mbretin në to e përfaqësoi Kolonel Zef Seregji, mori pjesë kryeministri Koço Kota, ministri i Drejtësisë Hiqmet Delvina, Xhafer Vila, Yzedin Beshiri, Abdurrahman Kroi, Dr. Basho, Tefik Mborja etj. (Gazeta e Re, Nr 85, 12.2.1929).

Diskutimet e gjata shtatëvjeçare për zgjedhjen e Sinodit të Shenjtë morën fund. Gazeta e Re atëherë shkroi: "Më në fund ideja kombëtare ngadhënoi si gjithnjë sepse ajo

buron nga shpirti i kombit dhe asht besue në duer të forta patriotike" (Gazeta e Re. Nr 85, 12.2.1929).

Më 18 shkurt të vitit 1929 Kryesia e Këshillit të Lartë iu drejtua anëtarëve të Sinodit të Shenjtë: "Hirësisë së tyre Imzot Visarionit, Agathangjelit, Ambrosit dhe Eugjenit. Në bazë të statutit të Kishës Autoqefale Shqiptare, për mbarëvajtjen e Kishës dhe për dobi të interesave të Atdheut, emërojmë:

- 1-Visarion Xhuvanin, Mitropolit të Tiranës dhe të Durrësit.
- 2-Agathangjel Çamçen, Episkop të Beratit, Vlorës dhe të Kaninës.
- 3-Thanas Ambrosin, Episkop të Gjirokastrës, Delvinës dhe të Himarës.

Në këtë mënyrë deklarojmë formimin e Sinodit Episkopal të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe sipas dispozitave të statutit njoftojmë dorëheqjen tonë e të gjithë këshillit në fjalë. Sa më sipër u bë pasi u muar pëlqimi i plotë i Mbretit dhe i Qeverisë Mbretërore.

Kryetari i Këshillit të Lartë.
Ikonom Vasil Marko”.

Menjëherë pas këtij vendimi Mitropoliti Visarion mblodhi episkopët për të zgjedhur kryetarin e Sinodit, të cilët ia besuan këtë detyrë Visarionit. Pas shumë përpjekjesh u formua Sinodi Episkopal, i cili zgjodhi kryepiskopin e parë, Fortlumturinë e Tij, Visarionin. Me këtë rast Sinodi Episkopal iu drejtua Kryeministrit Koço Kota:

“I shkëlqyeshëm Kryeministër!

Sipas vendimit të marrun më datë 18 shkurt 1929 nga ana e hierarkisë shqiptare dhe në bazë të kanoneve kishtarë, si dhe në konformitet të plotë me statutin kishtar të votuem në Berat, u formue Sinodi i Parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Kini mirësinë me pranue nderimet tona të nalta.

Kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit, Fortlumtunia e Tij, Visarioni” (AQSh. fondi 251, dosja VII 337, viti 1929).

Në emër të Sinodit, Kryepiskop Visarioni falenderoi Patrikun Serb dhe njoftoi të gjitha Patriarkanat për formimin e Sinodit të Parë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, duke shprehur solidaritetin e bashkëpunimit digmatiko-fetar me të gjithë ortodoksët e botës. Për t’u quajtur plotësisht i ligjëruar sipas Statutit kishtar dhe ligjeve në fuqi, më 26 shkurt të vitit 1929 paria e lartë e kishës bëri betimin para Naltmadhnisë së Tij, Mbretit Zog. Në mbarim të kësaj ceremonie solemne e mori fjalën Mbreti, i cili ndër të tjera theksoi: “Shqiptari lirinë e ka aq të nevojshme dhe të shtrenjtë sa dhe jetën e tij. Si gjithë bota edhe shqiptari lirinë e ka fitue me mundime të çmueshme. Në këtë vepër të randësishme duket edhe munda i priftnave shqiptarë. Bota le ta dijë se shqiptari, i cili me modesti të plotë respekton të drejtat e popujve të tjerë, nuk lejon dhe nuk i ulet asnjë forcë në botë që do të dhunojë të drejtat që ia ka falë natyra. Mos harroni se në kohën e detyrës së shenjtë, për të cilën jeni ngarkue, para çdo gjaje dhe mbi çdo send duhet të jetë Atdheu”.

Fjalës së Mbretit iu përgjigj Visarioni: "Sinodi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare e ndjen veten shumë të lumtur dhe në thellësi të shpirtit asht tepër mirënjohës për këtë nder të madh historik që ka në këtë minutë. Si shqiptar dhe duke ndjekun gjurmët e stërgjyshëve tanë, na e ka anda shumë lirinë dhe jemi tepër të gëzuem jo vetëm të predikojmë, por edhe dëshmorë të biem për lirinë tonë kombëtare kur ta dojë nevoja dhe kur të urdhënojë Naltmadhnia Juej.

Sinodi asht tepër i lumtun të deklarojë botnisht para Naltmadhnisë Suej se nuk do t'i përulet asnji fuqie në botë, e cila mund të kishte për qëllim t'i sjellë çfarëdo pengimi misionit tonë fetar kombëtar dhe sidomos misionit të veçantë shtetnor. Kisha Ortodokse Autoqefale asht një krijim i shkëlqyeshëm i dorës së fortë dhe shpëtimtare tuejën, tue fillue qysh prej Kongresit të Beratit në vjeshtën e vitit 1922 e tue përfundue në rregullimin definitiv të sotëm.

Nji i vetëm simbol ka me qenë gjithmonë udhëheqësi ynë paralel me detyrat tona shpirtnore për naltësimin e Atdheut. Me mbajtjen e stemës historike të Mbretit të Shqiptarëve Zogu I jemi të sigurtë se do të mbërrimë realizimin e misionit tonë të naltë dhe me gjithë zemër thërrasim: "Rroftë Mbreti i Shqiptarëve" (Gazeta e Re. 2.3.1929).

Mbas formimit të Sinodit u shtua shumë zemërimi i Patriarkanës së Stambollit dhe i Patriarkanës greke. Të dyja bashkë dhe veç e veç ato e rritën trysninë dhe i shtuan sulmet ndaj Sinodit dhe veçanërisht ndaj Kryeepiskopit Visarion, ndaj mbretit Zog dhe Qeverisë shqiptare. Për të përballuar këto shpifje, të cilat mund të arrinin në formë ankese deri në Lidhjen e Kombeve, Këshilli i Ministrave me vendim Nr. 218 të datës 21.3.1929 vendosi të formojë një komision, të përbërë prej ministrit Fuqiplotë Mehdi Frashëri dhe Dhimitër Pogës, drejtor politik pranë kësaj Ministrie për të ndjekur veprimet e mundshme dhe për të mbrojtur interesat e shqiptarëve, për t'u bërë ballë situatave në rast se Qeveria greke do ta shtronte çështjen e Autoqefalisë së Kishës Ortodokse në Lidhjen e Kombeve (AQSh. fondi 251, dosja 850, viti 1929).

Pa u tutur ndaj presioneve të brendshme dhe shpifjeve të jashtme, Sinodi, me Visarionin në krye, punoi në mënyrë intensive për të përgatitur Kongresin e dytë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Korçë. Edhe për këtë veprimtari kujdesi i Qeverisë dhe i Naltmadhnisë së Tij, Mbretit Zogu I, ishte në lartësinë e duhur, duke përballuar edhe një pjesë të shpenzimeve financiare.

Kongresi do të miratonte Statutin definitiv dhe rregulloren e brendshme të administrimit të kishës. Më 19 qershor të vitit 1929 të 46 delegatët përfaqësues të klerit dhe të popullit të Shqipërisë u mblodhën në Korçë për punimet e Kongresit të Dytë Panortodoks.

Në fillim u lexua përshëndetja e Mbretit për Kongresin: "Nuk duhet me harrue se mbi të gjitha duhet të mbretnojë ideali i kombit dhe plotësimi i Atdheut". Mbas përshëndetjes e mori fjalën Kryeepiskopi Visarion, i cili parashtroi parimet e hartimit të statutit dhe të rregullores:

- 1- Do të merret për bazë ungjilli i shenjtë, gojëdhanat e hirshme, rregullat e vendosuna nga Sinodet Ekumenike.
- 2- Principi i dytë asht interesi kombëtar.
- 3- Organizimi ekonomik e financiar i pasunive kishtare.
- 4- Vendosja e një disipline të fortë që i jep dinjitetin e duhur kishës (Gazeta e Re. Nr 190, 16.6.1929).

Kongresi historik i Korçës miratoi njëzëri dokumentet bazë të Kishës dhe mjaft vendime të tjera, duke e vendosur Kishën Shqiptare krahas kishave të tjera ortodokse ballkanike, evropiane e botërore. Në darkën madhështore për nder të kongresistëve morën pjesë i dërguari i posaçëm i Mbretit, kolonel Gjilardi, konsujt e Italisë dhe të Jugosllavisë, prefekti, myftiu e të tjerë. Kolonel Gjilardi mbajti një fjalim dhe ngriti dolli për kryetarin e Sinodit të Shenjtë të KOASH-it, Visarion Xhuvanin dhe për të gjithë pjesëmarrësit e Kongresit. "Në emën të Mbretit tonë uroj dhe lus fatbardhësi të

plotë për të gjithë ju dhe për popullin, të cilin me meritë të plotë keni fatin e madh ta përfaqësoni”. Pastaj myftiu në fjalën e tij theksoi shpirtin e vëllazërimit midis besimtarëve të ndryshëm në Shqipëri.

Urimeve që bënë të ftuarit Visarioni iu përgjigj: “Për herë të parë në historinë e përbotshme ngre dolli për lulëzimin dhe përparimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare një katolik dhe një kryetar mysliman. Kjo tregon edhe një pikë të naltë që Kisha Shqiptare asht institut i thjeshtë kombëtar”. Pastaj Kryepiskopi foli për rolin e fesë për pajtimin e kombit: “Kisha do të organizohej, do të formohej, do të disiplinohej dhe do të ishte mjet i zhvillimit e i naltësimit të kombit shqiptar dhe të Mbretnisë”.

Vlerësimi i punës së kryer nga Sinodi dhe besimtarët ortodoksë, harmonia fetare e mirëkuptimi midis besimtarëve të feve të ndryshme u dha në letrën që Naltmadhnia e Tij, Mbreti Zog I, i dërgoi Kryeministrit më 19 qershor të vitit 1929:

“Zoti Kryeministër!

Mundimet e rrjedhuna prej traditave të gabueshme, ngatërrimet e nxjerruna prej autoriteteve hyjnore i përballonte vetëm vullneti i patundun e dashunia, që populli shqiptar ka për lirinë. Më 1922 kur unë isha ministër i Punëve të Brendshme e ju prefekt i Beratit, iu arrit qëllimit për me u mbledhë Kongresi i Parë i KOASh-it në Berat. Mundimet që ju hoqët në këtë periudhë, ashtu dhe koha e çmueshme që ju bjerrët me dërgim delegacionesh në Kostandinopol dhe ma pastaj diskutimet e papërfundueshme me përfaqësuesit e Patriarkanës në Tiranë, janë shembulla të paharrueshme që kanë hjekë vllaznit ortodoksë për këtë qëllim.

Tue pa kundërshtimet e randa që ju bajshit, Shqipëria vërtet nuk kish rrugë tjetër: O me u përkulë e me hjekë dorë prej një të drejte që i ka falë natyra, ose me veprue kështu si veproi. Veprimi i bamun asht aq legal dhe i drejtë, njisoj ka qenë edhe në shtetet e tjera. Asht sovraniteti i popullit që i jep fuqi legale çdo krijimi sado i naltë dhe i shenjtë që të jetë. Shteti shqiptar nuk ndahet në ortodoksë, katolikë e myslimanë, por asht një i pandamë, shtet i lirë, nuk ka shumicë dhe pakicë, nuk ka një fe zyrtare, por të gjitha fetë i mbron dhe i nderon. Megjithkëte nuk lejon në asnjë mënyrë e prej kërkujt që feja të përdoret si mjet cenimi i këtij vllaznimi të një gjaku e të një gjuhe. Madhështinë e kësaj vepre do ta ndjejnë gjeneracioni që vjen ma mirë.

Falenderoj Ju personalisht, klerin ortodoks për qëndrimin patriotik, ashtu edhe gjithë shtypin kombëtar, i cili diti ta mbrojë tezën e tij” (Gazeta e Re. 20 qershor 1929).

Kryeministri Koço Kota dha këtë përgjigje: “Në emër të Qeverisë që kryesoj ju falenderoj për ndjenjat e sinqerta që shfaqni duke ju siguruar se Qeveria nuk bëri gjë tjetër, përveçse realizoi një nga pikat e idealit kombëtar dhe do të vazhdojë pa pushim për plotësimin e çdo qëllimi të shenjtë që lartëson prestigjin e shtetit dhe siguron mbarëvajtjen e kombit” (Gazeta e re. 20 qershor 1929).

Për realizimin e misionit fetaro-kombëtar Visarion Xhuvanin e mbështeti Naltmadhnia e Tij, Zogu I. Kur Visarioni u burgos nga regjimi komunist (nga viti 1948 deri më 1962) një nga bashkëvuajtësit e tij, Beqir Ajazi, për ndihmën e pakursyer që dha Naltmadhnia e Tij, Zogu I, në librin “Nga zhgaba me kurorë deri te drapri me çekan” shkruan: “Kishte vdekur Patriku i Bukureshtit dhe i gjithë Rumanisë. Siç e duan kanonet varrimi i tij do të zhvillohej me ceremoni madhështore ku do të ishin jo vetëm klerikët e lartë të vendit, por edhe përfaqësuesit zyrtarë nga kishat e vendeve të tjera, ndër të cilat bënte pjesë edhe Shqipëria, që dilte për herë të parë si autoqefale. Meqë vdekja e Patrikut

kishte qenë e befasishme dhe kur përfaqësuesi i kishës shqiptare, Visarioni, duhej të ishte patjetër, Naltmadhnia e Tij, Zogu I, kishte porositur një takëm ceremonial për meshë, të thurur e të qëndisur krejt prej ari. Vetëm kamillafi i rëndë (mitra) dhe skeptri kishin kushtuar më se 400 napolona ar.

Linja ajrore për në Bukuresht atëherë kalonte Tiranë-Athinë-Sofje-Bukuresht. Kështu që veç vizës së tranzitit të Bullgarisë duhej edhe ajo e qeverisë greke. Kjo e fundit kishte refuzuar dhënien e vizës për Visarionin, sepse Imzot Visarioni ishte “persona non grata” atje dhe i dënua për shkak të veprimtarisë që kishte kryer me rastin e autoqefalisë. Dukej sheshit se autoritetet greke po bënin çmos për ta penguar kishën tonë që të paraqitej në një ceremoni botërore, siç qe ajo e varrimit të Patrikut të Rumanisë. Për t’ua hedhur në ajër planin e sabotimit të tyre, Naltmadhnia e Tij, Zogu I, kishte porositur aeroplan të posaçëm, duke e kaluar Visarionin në Itali dhe s’andejmi në Rumani.

Sipas rregullave të protokollit i kish takuar Visarionit që të ishte i pari në krye të kësaj ceremonie. Pjesët e tjera, pamjen, veshjen dhe aftësitë kishtarë i kishte vetë Visarioni, i cili kishte korrur atje një simpati të madhe për kishën tonë, për veten e vet dhe për Shqipërinë. Në lidhje me këtë veprimtari Gjergj Bubani më ka thënë se gjatë ceremonisë mijëra gra shqiptare të Bukureshtit ndërprenin herë pas here kortezhin për t’i dalë përpara Visarionit, duke brohoritur me devocion: “Jetë të gjatë o dhespoti ynë”.

Visarioni për të kryer misionin fetaro-kombëtar dhe për të zvogëluar pengesat që dilnin përpara në plotësimin e detyrës, si në planin dogmatik dhe në planin kombëtar, për forcimin e moralit herë i drejtohet një ministri, herë një tjetri. Më 20.3.1929 ai iu drejtua ministrit të Drejtësisë (AQSh. Fondi 151, dosja 484, viti 1933). Në qershor të vitit 1935 iu drejtua Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Drejtësisë përsëri më datë 6.10.1935 (AQSh Fondi 155, dosja 721, viti 1935), Ministrisë së Punëve të Brendshme (AQSh. Fondi 152, dosja 721, viti 1935) etj.

Ai ka shprehur pakënaqësinë edhe për disa nëpunës të lartë e për ndonjë deputet, të cilët nuk jepnin ndihmën e duhur për nevojat e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe ndaj Kryetarit të Shtetit Shqiptar. Prej tij kërkoi të merreshin masa të menjëhershme sepse situata mund të rrëshqiste me shpejtësi në dëm të punëve të kryera nga Sinodi dhe klerikët ortodoksë shqiptarë. Ai iu drejtua me letër Naltmadhnisë së Tij, Zogut I dhe i kërkoi që organet shtetërore të ndihmonin, të mos tregoheshin indiferente se kjo pakujdesi do të dobësonte moralin. Letra përfundonte me mendimin se gjendja ishte tepër serioze, prandaj i lutej Naltmadhnisë së Tij, që ta peshonte këtë punë sa më shpejt si mbret, si bashkëpunëtor i vjetër në fushën politike. I vetmi qëllim ishte parandalimi i çdo rreziku që mund t’i vinte atdheut, personit të tij ndaj të cilit do të ishin gjithnjë besnikë dhe lutës të sinqertë.

Mbas kësaj letre Visarioni në fund të janarit të vitit 1935 u prit në audiencë në pallatin mbretëror nga vetë Naltmadhnia e Tij, Ahmet Zogu, ku bisedoi gjatë me çiltërsi dhe dashamirësi. Bashkëbisedimi vazhdoi për tri orë.

Revista kishtarë “Predikimi” në Nr. 43 të 17 janarit të vitit 1935 ka botuar deklaratën e Kryepiskopit, në të cilën është shkruar se kohët e fundit kanë filluar të duken disa përmirësime, shpresohet se e shumta deri në shtator do të kryheshin të gjitha çështjet që iu parashtruan sovranit tonë. Atëherë Kisha Shqiptare kishte arritur organizimin e plotë, funksiononin 720 kisha dhe paraklise dhe 400 priftërinj që në kushte të rënda ekonomike predikonin mjaft me zell. Kisha ishte pajisur me literaturën fetare për të gjitha shërbesat. Ajo përfaqësohej denjësisht në kongreset ndërkombëtare të kishave

ortodokse. Kisha shqiptare kishte arritur fizionominë e plotë të kishave ballkanike dhe e meritonte njohjen edhe nga Patriarkana e Stambollit.

Në këtë kohë Naltmadhnia e Tij, Mbreti Zog, kërkoi njohjen e autoqefalisë nga Patriarkana, duke dërguar Koço Kotën e Josif Kedhin në krye të një delegacioni pranë Patriarkut për t'i dhënë Tomusin Kishës Ortodokse Shqiptare.

Kërkesave të Patriarkanës iu shtua edhe një kusht tjetër: largimi i Visarionit nga detyra e Kryepiskopit. Visarioni, që dha kaq shumë për kishën tonë, vendosi të vetëflijohej dhe në Sinodin VII pranoi të jepte dorëheqjen. Në aktin e dorëheqjes Visarioni ka shkruar se nuk jepte dorëheqje për këto arsye:

- 1- Pse gjoja m'u imponue prej shtetit
- 2- Pse gjoja m'u imponue prej popullit
- 3- Pse gjoja u frikësua se do të më vrasin të huejt po të mos jap dorëheqje.

Në shkresën A të aktit të dorëheqjes Visarioni ka thënë se jep dorëheqjen për këto arsye:

- 1- Për lehtësimin e shtetit tonë në punët politiko-religjioze për interesat e përgjithshme të kombit.
- 2- Për me lehtësue marrëdhëniet ose të njohunit e kishës sonë nga kisha greke siç asht Patriarkana e Stambollit, që ka me lehtësue ndofta organizimin sa ma mirë ose zbatimin e organizimit të plotë të kishës sonë, sepse do të lejojë të vinë pranë kishës sonë gjithë ata persona që i duhen dhe janë kompetentë, që prej disa vitesh janë larg dhe nuk ndihmojnë.
- 3- Mbasi shpresojmë se kryetari i kishës do të ndihmohet ma shumë se ne prej të gjithëve për mbarëvajtjen e kishës. Ne, të ndihmuem nga Mbreti, bamë organizimin definitiv që nuk ka qenë nga krijimi i kishës bizantine prej Kostandinit 1700 vjet ma parë.

Mbas 27 majit të vitit 1936, dita kur dha dorëheqjen Visarioni, e deri më 12 prill të vitit 1937, pati veprimtari të dendur diplomatike për të bindur Patriarkun e Stambollit që të miratonte Tomusin. Ai nuk lëvizi nga kërkesat e veta, vetëm se i zbuti ato dhe ia përshtati diplomacisë së kohës, miratoi Tomusin dhe në krye të Kishës Shqiptare erdhi Imzot Kristofor Kisi.

Edhe më vonë Naltmadhnia e Tij, Ahmet Zogu, tregoi vëmendje të veçantë për mbarëvajtjen e Kishës Ortodokse Shqiptare. Dhënia e Tomusit nga Patriarkana e Stambollit për Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare u bë më 12 prill të vitit 1937. Kjo erdhi pas punës këmbëngulëse që bënë klerikët shqiptarë me Kongresin e Beratit, të Korçës dhe pasi formuan Sinodin e tyre.

Mbas 15 vjetësh (nga Kongresi i Parë i Beratit më 1922 e deri më 12 prill të vitit 1937) Patriarkana e Stambollit njohu më në fund autoqefalinë e shpallur në Kongresin e Parë Kishtar të Beratit. Kjo qe udha e gjatë e njohjes zyrtare të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Kjo njohje u arrit pas një pune të madhe e të përkushtuar të themeluesve të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare me Visarion Xhuvanin në krye, të cilët paraqitën denjësisht para opinionit të ortodoksëve të Ballkanit e të botës kërkesën e ligjshme të ortodoksëve shqiptarë.

Kjo duhet t'i nxitë ortodoksët shqiptarë e të dinë se Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare ka në kujtesën e saj e të historisë kishtarë disa data të shënuara për të përkujtuar, si 10 shtatorin e vitit 1922, ditën e mbledhjes së Kongresit të Parë Kishtar të Beratit, 18 shkurtin e vitit 1929, ditën kur u formua Sinodi i Parë Episkopal, 19 qershorin e vitit 1929, kur filluan punimet e Kongresit të Dytë Panortodoks të Korçës dhe 12 prillin

e vitit 1937, ditën kur Patriarkana e Stambollit dha Tomusin për Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Nga të gjitha këto data të shënuara, me këtë rast veçuam për të përkujtuar 75-vjetorin e krijimit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Tiranë, më 30 gusht 2004

KONGRESI I DYTË GJITHORTODOKS I KORÇËS E VURI KISHËN MBI BAZA KANONIKE E KOMBËTARE (16.VI - 29.VI.1929)

I. HISTORI E FSHEHUR E KONGRESIT TË DYTË TË K.O.A.SH-IT

Kongresi i dytë gjithortodoks i Korçës u mbledh pas Kongresit të Beratit. Ai është vijim i vendimeve të Kongresit të Beratit dhe plotësoi ato mangësi që vinin nga rrjedha historike e Kishës Ortodokse Shqiptare. Këto mangësi shfrytëzoi Patriarkana Ekumenike për të mos miratuar vendimet e Kongresit të Beratit dhe për t'i quajtur ato të pavlefshme.

Patriarkana e quajti të paligjshëm dhe antikanonik Këshillin e Lartë të dalë nga Kongresi i Beratit dhe nuk miratoi funksionet e tij në emër të një sinodi episkopal të përbërë prej episkopësh kanonikë. Pra Patriarkana Ekumenike nuk e njohu në atë kohë autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare, por pranoi ta kënaqte atë me një farë autonomie dhe ta mbante përgjithmonë në tutelën e saj.

Një nga vendimet kryesore të Kongresit të Beratit ka qenë që brenda tre muajve të krijoheshin kushte për formimin e sinodit episkopal të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili në bazë të kanoneve kishtarë do të merrte drejtimin dogmatik të kishës. Nga thashethemet dhe intrigat e shumta, si edhe nga përçarja e brendshme midis ortodoksëve shqiptarë, në një farë mase nga mungesa e përvojës dhe nga interesa vetjake krejt të njëanshme, ky vendim u vonua prej vitit 1922 deri në vitin 1929.

Në vitin 1923 u fronëzua Fan Noli në Korçë nga dy episkopë kanonikë të dërguar nga Patriarkana. Kështu u krijuan kushtet kanonike për organizimin kishtar të Kishës Ortodokse në Shqipëri, sepse me tre episkopë në tri dioqezat kryesore mund të krijohet Sinodi i Shenjtë. Imzot Jerotheu në dioqezën e Korçës, Imzot Kisi në dioqezën e Beratit dhe Imzot Noli në dioqezën e Durrësit atëherë ishin në krye të detyrës kishtarë. Pa episkop ishte vetëm dioqeza e Gjirokastrës. Në qoftë se dy prej tyre do të ishin treguar të kujdesshëm për të dorëzuar episkop njërin prej dy kandidatave të mundshme, Visarionin ose Çamçen, atëherë Sinodi do të formohej në mënyrë të rregullt sipas kanoneve kishtarë ortodokse.

Gjendja ndërmjet ortodoksëve shqiptarë në lidhje me qëndrimin ndaj Patriarkanës Ekumenike dhe zgjidhjes së çështjes madhore të autoqefalisë erdhi duke u acaruar çdo ditë dhe më shumë dhe po shkohej edhe drejt cenimit të mirëkuptimit e të harmonisë

kombëtare. Disa mendonin se duhej pritur me durim urdhri i Patriarkanës, të tjerë kërkuan rrugë të brendshme dhe të mos i nënshtroheshin pritjes së kërkuar qëllimisht nga Patriarkana. Pala e dytë, me propozimin e Naltmadhënisë së Tij, Mbretit Zogu I, nuk ngurroi për të formuar Sinodin Episkopal dhe për këtë dha ndihmën e vet i dërguari i Patriarkanës së Serbisë.

Në javët e para të shkurtit të vitit 1929 me Imzot Visarionin dhe Imzot Eugjenin në krye të ceremonisë kishtare u dorëzuan dy episkopë, Agathangjel (Vangjel) Çamçja dhe Thanas Ambrosi. Më 18 shkurt 1929 u formua Sinodi i Shenjtë, i cili zgjodhi Visarionin kryetar të tij. Kështu filloi një etapë e re në jetën e Kishës. Dioqezat kishin episkopët e tyre kanonikë, Berati Imzot Çamçen, Gjirokastra Imzot Ambrosin, Tirana dhe Durrësi Imzot Visarion Xhuvanin, i cili përkohësisht do të ishte dhe ad interim për Korçën.

Në Te Deum-in e zhvilluar në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë më 25 mars të vitit 1929 Atë Vasil Marko i dorëzoi Hirësisë së Tij, Visarionit, Kryqin historik të Kongresit të Beratit. Kjo ishte shenja simbolike e dorëzimit përfundimtar të kryesisë së kishës. Ky veprim e vuri para përgjegjësisë Kryepiskopin Visarion për të organizuar Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë duke u mbështetur në vendimet e Kongresit historik kishtar të Beratit.

Patriarkana e Stambollit si dhe Patriarkana greke nuk e pritën mirë formimin e Sinodit të Shenjtë. Ato u vërsulën menjëherë për të shprehur kundërshtimin e tyre, sajuan fyerje të rënda për Sinodin, por më shumë për Visarionin dhe Mbretin Zog. Shpifjet nuk e mposhtën Kryepiskopin Visarion Xhuvani. Zemërimi i Patriarkanës Ekumenike mbushi gazetatat më në zë të Greqisë. Atëherë kreu i ortodoksëve shqiptarë vazhdoi me qetësi shembullore dhe me durim mbledhjet e Sinodit në Korçë për të përmirësuar punët kishtare dhe për ta ngritur Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në nivelin e kishave të tjera të Ballkanit.

Në këtë situatë duhej fituar koha e humbur dhe duheshin marrë vendime të rëndësishme. Kjo veprimtari e shquar përbën platformën kishtare të Kongresit të dytë gjithortotoks në Korçë, i cili duhej të organizohej e të mbledhej sa më parë.

Atëherë pengesat shtoheshin çdo ditë me diskutime shterpe të intriguara nga jashtë e të shumëfishuara nga ortodoksë shqiptarë që e kishin shitur shpirtin tek të huajt. Sinodi i kryesuar prej Kryepiskopit Visarion u mblodh çdo ditë në Mitropolinë e Korçës. Mbledhjet kanë qenë të hapura, në to mund të merrte pjesë kushdo dhe të jepte mendime. Pjesëmarrja masive e dashamirëve e besimtarëve ortodoksë të Kishës sonë bëri që pengesat të kapërceheshin një nga një dhe me dinjitet.

Organizimi i Kongresit kishte nevojë për fonde dhe ato në pjesën më të madhe u siguruan nga shteti shqiptar i kohës. Kujdes i veçantë u tregua edhe për zgjedhjen e delegatëve. Me këto detyra, veç Kryepiskopit, i cili kudo që shkoi u mor me organizimin e pleqësive të kishave, u tregua mjaft përkujdesje për zgjedhjen e delegatëve në të gjitha rrethet ortodokse shqiptare. Në Kongres u zgjodhën intelektualët e shquar të vendit, klerikë me merita kishtare, tregtarë dhe zanatçinj, të gjithë bij të bindur dhe besimtarë të aftë për të mbrojtur Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në Kongres morën pjesë 10 klerikë, ndërmyet tyre 3 episkopë, 2 ikonomë mitroforë dhe 5 klerikë të moshuar me përvojë kishtare. Midis delegatëve laikë kishte 7 intelektualë me gradën shkencore Doktor në fusha të ndryshme të dijes.

Listën e të gjithë delegatëve të Kongresit të dytë kishtar të Korçës, po e japim të plotë:

Delegatët e këtij Kongresi qenë:
Delegat i Tiranës *Kryepeshkop Visarioni* d.v.
Delegat i Tiranës *Dr Athanas Shundi* d.v.
Delegat i Tiranës *Dr Zoi Xoxa* d.v.
Delegat i Shpatit *Taq Buda* d.v.
Delegat i Shkodrës *Atë Velisha Popoviq*
Delegat i Shkodrës *Naim Plevneshi* d.v.
Delegat i Shkodrës *Mitro Llazareviq* d.v.
Delegat i Korçës *Ik. i M. Mitrofor Atë Vasil Marko* d.v.
Delegat i Korçës *Stavraq Ballauri* d.v.
Delegat i Korçës *Thoma Turtulli* d.v.
Delegat i Korçës *Vasil Avrami* d.v.
Delegat i Korçës *Sotir Kotta* d.v.
Delegat i Përmetit *Dhimitri Kacimbra* d.v.
Delegat i Gjinokastrës *Thoma Papapano* d.v.
Delegat i Gjinokastrës *Kostandin Lito* d.v.
Delegat i Gjinokastrës *Episkop Ambrosi* d. v.
Delegat i Gjinokastrës *Ikonom Papavlashi*
Delegat i Libohovës *Dhimosthen Haxhoglu* d.v.
Delegat i Leskovikut *Andon Kito* d.v.
Delegat i Lushnjës *Llazar Bozo* d.v.
Delegat i Vlorës *Kristaq Ikonomi* d. v.
Delegat i Vlorës *Atë Isaia* d.v.
Delegat i Vlorës *Kristo Karbunara* d.v.
Delegat i Delvinës *Mihal Maksakuli* d.v.
Delegat i Sarandës *Apostol Dhima* d.v.
Delegat i Konispolit *Loli Qesko* d.v.
Delegat i Durrësit *Kristaq Zaguridhi* d.v.
Delegat i Durrësit *Vasil Bakalli* d.v.
Delegat i Durrësit *Moisi Popa* d.v.
Delegat i Kavajës *Kleanth Mineu* d.v.
Delegat i Himarës *Dr Mihal Cane*
Delegat i Beratit *Episkop Imzot Agathangjel* d.v.
Delegat i Beratit *Dr Nikolla Haxhistasa* d.v.
Delegat i Beratit *Ikon. Atë Theodhor Brisku* d.v.
Delegat i Fierit *Jovan Xoxa* d.v.
Delegat i Mallakastrës *Ikonom Atë Polizoi* d.v.
Delegat i Kolonjës (Ersekë) *Petro Prodani* d.v.
Delegat i Bilishtit *Petro Ilia* d.v.
Delegat i Tepelenës *Dhimitër Mole* d.v.
Delegat i Elbasanit *Kostaq Cipo* d.v.
Delegat i Elbasanit *Kov Deliana* d.v.
Delegat i Elbasanit *Dhimitër Papajani* d.v.
Delegat i Pogradecit *Spiro Naço* d.v.

Delegat i Dibrës *Stavrofor Ik. Josifi* d.v.

Delegat i Dibrës *Dr Filip Papajani* d.v.

Delegat i Dibrës *Gavril Lasku* d.v.

Komisioni i Qeverisë pranë Kongresit Panorthodhoks Shqiptar në Korçë:

Vasil Bidoshi d.v.

Platforma kishtare e Kongresit u përcaktua me kujdes të madh nga Visarion Xhuvani. Në të u parashikuan vendimet e pritshme, detyrat e komisioneve për organizimin e Kongresit, ceremonitë festive për jehonën e tij. Bazën kryesore të Kongresit e përbënte zgjidhja e drejtë e interesave fetaro-kombëtare, sigurimi i indipendencës dhe i tërësisë territoriale të vendit. Vendimet e tij duhej të mos lejonin në të ardhmen asnjë veprim që të binte ndesh me interesat kishtaro-kombëtare dhe brezat e rinj të ishin syhapur e të kujdeseshin për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në të gjitha materialet e Kongresit vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të kanoneve të shenjta dhe të dogmës fetare, që Patriarkana Ekumenike të ndërpriste sulmet e mëtejshme kundër Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Gazeta e Re në Nr. 190, të datës 19.06.1929, ka botuar tekstin e platformës së Kongresit.

“1-Do të merret për bazë Ungjilli i Shenjtë, gojëdhënat e hirshme, rregullat e vendosura prej Sinodeve Ekumenike dhe përgjithësisht rregullat që pasojnë Kishën Ortodokse Autoqefale dhe patriarkike ortodokse, në të cilat Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë është lidhur dogmatikisht.

2-Principi i dytë është interesi kombëtar, i cili është marrë në kujdes të veçantë në bazë të kanonit “Kishë e lirë në shtet të lirë”.

3-Organizimi ekonomik financiar i pasurive kishtare, në mënyrë që kishës t’i sigurohet jetesa nga pikëpamja ekonomike.

4-Vendosja e një disipline të fortë që i jep dinjitetin e duhur kishës”.

Korça e priti me madhësi të paparë mbërritjen e anëtarëve të Sinodit dhe të Visarionit. Për pritjen e tyre autoritetet kishtare dolën deri në Plasë. Midis tyre kanë qenë: Ikonomi i Madh Vasil Marko, Kryetari i Bashkisë, drejtori i gazetës “Zëri i Korçës”, deputeti Llambi Bimbli etj. Ikonomi Atë Josifi përshëndeti me një fjalë të shkurtër. Në qytet kish dalë për t’i pritur i gjithë populli pa dallim feje. Në pritje qenë rreshtuar edhe ushtria, nxënësit e shkollave, kleri ortodoks dhe mysliman, banda e bashkisë. Pati mjaft thirrje “Rroftë Kisha Autoqefale”. Në qytet u shkëmbyen fjalimet e rastit. Për këtë pritje Imzot Ambrosi tha: “Pritje të tilla u bëhen vetëm mbretërve” (Gazeta e Re, Nr. 119, 24.03.1929).

Në qytetin e Korçës mbretëroi atmosfera e gëzimit, e entuziazmit, sepse diçka e mirë pritej për kishën e gjithë vendin. Në Mitropoli mbizotëroi përkushtimi, puna e palodhur, e kujdeseshme dhe shumë e disiplinuar, e cila iu përgjigj me shumë dinjitet haresë dhe gëzimit mbarëpopullor.

Sinodi i Shenjtë kishte vendosur që Kongresin e dytë ta drejtonte kjo pari: Kryetar Imzot Visarioni, nënkryetar Vasil Avrami, kryesekretar Dr. Zoi Xoxa dhe kujdestar Thoma Papapano. Të ngarkuarit me detyra kishin grupet e punës për organizimin dhe drejtimin e Kongresit. Më 16 qershor të 46 delegatët përfaqësues të klerit dhe të ortodoksëve shqiptarë u mblodhën në Korçë për të filluar punimet e Kongresit të dytë kishtar, që kishte rëndësi të veçantë historike.

Në fillim u lexua përshëndetja e Mbretit: “Nuk duhet me harrue se mbi të gjitha duhet të mbretnojë ideali i Kombit dhe plotësimi i Atdheut” (Gazeta e Re, Nr. 190, 16.09.1929).

Në fjalën e tij Imzot Visarioni parashtroi përmbajtjen kryesore të Statutit dhe të Rregullores së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, parimet e përgjithshme që frymëzuan Sinodin e Shenjtë për hartimin e Statutit, të cilat janë: “Baza kanonike e Statutit është Ungjilli i Shenjtë, gojëdhënat e hirshme, rregullat e vendosura prej Sinodeve Ekumenike, me të cilat Kisha Ortodokse Autoqefale është lidhur dogmatikisht”.

Statuti sanksionoi Autoqefalinë e deklaruar në Berat më 12 shtator 1922, duke qenë dogmatikisht e bashkuar me patriarkitë e shenjtë dhe me kishat e tjera ortodokse autoqefale, por administrativisht mbetej krejt më vete nën flamurin kombëtar.

Imzot Visarioni, i mbështetur në Statutin legal të komuniteteve fetare të miratuar në Kuvendin e vitit 1924, theksoi dhe kërkoi që gjuha zyrtare e Kishës të jetë gjuha shqipe, sepse kjo i ka të gjitha aftësitë e veta dhe kurorëzon përpjekjet shekullore më të hershme dhe të rilindasve. Një artikull i veçantë përcaktoi pavarësinë e kishës në mënyrë të prerë: “Kryepeshkopi, Peshkopët, Zëvendësit e tyre lokalë, Ikonomi i Madh Mitrofor, Sekretari i Përgjithshëm i Sinodit... duhet të jenë prej gjaku e gjuhe Shqiptarë, si edhe të kenë nënshtetësinë Shqiptare”.

Ky është artikulli 16 i Statutit që u diskutua gjatë në Kongres, u shqyrtua edhe modeli i kishave të tjera. Ai kishte për qëllim të ruante mirëkuptimin e harmoninë shoqërore të brendshme dhe të mbylleshin përgjithmonë mospajtimet e ndryshme që sjellin vetëm ndarje në shtetin shqiptar.

Kongresi vazhdoi punimet 15 ditë. Në fund, mbasi miratoi statutin në parim, vendosi të krijojë një komision të posaçëm të përbërë nga: Mitrofor Vasil Marko, Vasil Avrami, Dhimitër Kacimbra, Taq Buda, Vasil Bakalli, Athanas Shundi, Llazar Bozo, Nikolla Haxhistasa, Kristaq Ikonomi, Thoma Papapano, Mihal Cane, Milto Maksakuli dhe Dr. Zoi Xoxa, të cilët do t’i jepnin statutit formën përfundimtare. Mbas 15 ditë diskutimesh, në orën 7.30 të datës 29 qershor të vitit 1929, të gjithë delegatët firmosën dokumentet për t’u miratuar në statut përfundimtar (definitiv). Ky Statut e vuri në themele të qëndrueshme Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Atë Vasil Marko në letrën që i ka dërguar ministrit të Brendshëm më 27-09-1922, ka shkruar: “Ne ju bëjmë të njohur se çështja kishtarë vete shumë mirë. Ne këtu jemi në themele të çeliktat thjesht kombëtare, nuk tundemi, por vetëm një gjë na pengon, ajo është financa”. (AQSh. Koleksion fondesh. D. 1519. viti 1922). Amaneti i Kongresit Kishtar të Beratit u përmbush më së miri në Kongresin e dytë kishtar gjithortodoks të Korçës më 29 qershor të vitit 1929.

II. SI ZGJIDHEJ KRYEPESHKOPI ORTODOKS NË BAZË TË STATUTIT

Për lexuesin e sotëm po e japim të plotë tekstin e këtij Statuti, sepse ai ka vlera shumë të çmueshme edhe për ditët tona.

*STATUTI I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË
KORÇË 1929*

Gjithë kleri dhe populli Ortodoks i Mbretërisë Shqiptare, i përfaqësuar prej Delegatëve fuqiptotë të mbledhur në Kongresin e Dytë që u mbajt në Korçë, voton me një zë statutin definitiv të Kishës Orthodhokse Shqiptare, të proklamuar Autoqefale në Kongresin e Beratit më datë 12 Shtator 1922.

KAPTINA I KISHA

Art. 1. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së Shenjtës Kishë të Përgjithshme dhe Apostolike, përbëhet prej tërë banorëve të Mbretërisë Shqiptare që i besojnë Krishtit dhe pohojnë Simbolin e Shenjtë të Fesë Ortodokse (to simvolon tis pisteos) dhe ruan të patundshme gjith sa pranon Kisha e Shenjtë Lindore e Krishtit, Themelonjës e Krye i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jesu Krishti.

Art. 2. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë është e bashkuar dogmatikisht dhe shpirtërisht me të gjitha Patriarhit' e Shenjta dhe me Kishat Ortodokse Autoqefale dhe ruan, pa ndonjë ndryshim, si të gjitha Kishat e tjera Ortodokse të Krishtit, burimet e besimit, shkrimet e shenjta dhe gojëdhënat e Hirshme (Again Grafën qe Hieran Paradhosin) si dhe kanonet e Shenjta Apostolike dhe Sinodike.

Art. 3. Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja.

Art. 4. Autoriteti më i lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare është Sinodi i Shenjtë Peshkopal i përbërë prej Peshkopëve aktivë të çdo Dioqeze, prej Ikonomit të Madh Mitrofor dhe i kryesuar prej Mitropolitit të Qendrës, Kryepeshkopit të gjithë Shqipërisë.

Titulli zyrtar i Sinodit është: "Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë". Peshkopata e Qendrës merr titullin "Mitropoli" dhe titullari i saj quhet Mitropolit i asaj Dhioqeze dhe Kryepeshkop i gjithë Shqipërisë, Peshkopët e tjerë mbajnë titullin Peshkop dhe Dioqezat e tyre Peshkopata.

Art. 5. Kisha Orthodhokse Shqiptare është person juridik dhe trashëgon të gjithë titujt dhe të drejtat e komuniteteve Ortodokse të gjertanishme.

KAPTINA II SINODI I SHENJTË DHE DETYRAT E TIJ

Art. 6. Sinodi i Shenjtë: Rregullon Kishën Autoqefale të Shqipërisë për sa i përket besimit, adhurimit (Latria), disiplinës Kishtare, organizimit dhe administrimit të brendshëm të Kishës në bazë të dogmave dhe të kanoneve të Shenjta dhe në konformitet me Ligjet e Shtetit;

Ushtron kontrollimin mbi veprimet e Peshkopëve dhe të organeve të Kishës, sipas rregullave Kishtare; themelon dhe mban Shkolla Fetare;

Harton programet e tyre dhe i mbikëqyr me anën e Peshkopëve;

Përkujdeset për edukatën fetaro-Kombëtare, për kulturën dhe për të kryerit e detyrave të Klerikëve e të Murgjve;

Kujdeset për edukatën fetare të popullit Ortodoks me anën e predikimeve Kishtare, të mësimave Fetare edhe të redaktimit e të botimit të librave dhe të revistave Fetare.

Art. 7. Asnjë libër nuk mund të përdoret në Kishë pa pëlqimin zyrtar të Sinodit, kështu dhe në shkollë për mësimet e fesë Ortodokse pa pëlqimin zyrtar të Sinodit dhe të Ministrisë s'Arësimit.

Art. 8. Librat e Kishës që janë përkthyer do të këqyren prej Sinodit, i cili e ka për detyrë të kujdeset sa më shpejt për përkthimin dhe botimin e atyre librave të Kishës që mungojnë.

Art. 9. Sinodi i Shenjtë detyrohet të vejë re që çdo vepër e paraqitur me anë botimesh, gravurash, çfaqjesh teatrale ose kinematografike dhe konferencash publike të mos cenojë ose çnderojë dogmat dhe dispozitat e Ortodoksisë ose përgjithësisht Klerin si dhe format e tij dhe, n'e paftë t'arsyeshme të kërkojë ndërhyrjen e autoritetet në konformitet me ligjet e Shtetit.

Kryesia e Sinodit me pëlqimin e anëtarëve vendos t'u japë diploma merite atyre që i kanë shërbyer çështjes Kishtare.

MBLEDHJA E SINODIT TË SHENJTË

Art. 10. Sinodi mbledhet rregullisht dhe medoemos një herë në vit. Koha e mbledhjes është ipso fakto data 1 Tetor. Mbledhja do të mbajë jo më pak se 15 ditë dhe jo më tepër se një muaj. Kryepeshkopi, për nevoja të domosdoshme dhe me pëlqimin e shumicës së anëtarëve, provokon dhe mbledhje të jashtëzakonshme të Sinodit. Kryetari çel dhe mbyll mbledhjet.

Art. 11. Sinodi ka kuorum kur ndodhen prezentë gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Po kurdoherë mbledhje legale mund të bëhet vetëm kur përveç Kryepeshkopit ndodhen dhe dy anëtarë të tjerë.

Në mungesë të Kryepeshkopit, në rast që ky është pushuar, Sinodi kryesohet prej më të vjetrit në dorëzim; në raste të tjera Sinodi kryesohet prej Peshkopit t' autorizuar nga Kryetari me kompetencë të caktuar.

Art. 12. Vendimet e Sinodit merren me shumicë votash.

Në rast njësie provokohet një mbledhje e dytë, në të cilën, në qoftë se ka përsëri njësi votash, paravlen ana e Kryetarit.

Art. 13. Sinodi ka dhe një Sekretar të Përgjithshëm, i cili proponohet prej Sinodit dhe emërohet me dekret të Kryepeshkopit. Cilësit'e Sekretarit të Përgjithshëm caktohen në Rregulloren e Administrimit të përgjithshëm.

KAPTINA III PESHKOPATAT

Art. 14. Kisha Ortodokse Autoqefuale e Shqipërisë ndahet në katër Peshkopata:

- a) Peshkopata e Korçës, Përmetit, Voskopojës, Leskovikut dhe Kolonjës.*
- b) Peshkopata e Durrësit, Tiranës, Shkodrës, Kavajës, Elbasanit, Shpatit, Gorës, Mokrës, Pogradecit dhe Dibrës.*
- c) Peshkopata e Beratit, Vlorës, Myzeqesë dhe Kaninës.*
- ç) Peshkopata e Gjinokastrës, Delvinës, Dropullit, Pogonit dhe Himarës, me kufijtë që ka pasë gjer më sot gjithsecila prej këtyre.*

Kufijtë e Peshkopatave mund të ndryshohen me proponimin e Sinodit, me pëlqimin e Qeverisë dhe me dekret Mbretnor.

Qendra e Kishës Autoqefale caktohet me dekret mbretnor. Gjersa të dalë dekreti relativ Kryesia e Kishës qëndron në Korçë.

Peshkopë pa Dioqezë nuk mund të jenë më tepër se dy.

Art. 15. Kryepeshkopi zgjidhet prej Sinodit për gjithë jetën e tij. Në rast që Kryepeshkopi i zgjedhur prej Sinodit nuk pëlqehet prej Mbretit, Sinodi detyrohet të zgjedhë një tjetër, të cilin i a paraqit Mbretit për pëlqim dhe dekretim. Të gjithë këto veprime për zgjedhje, proponim dhe refuzim mbahen sekrete.

Gjithë në këtë mënyrë zgjidhen dhe Peshkopët e tjerë.

CILËSITË E PESHKOPËVE

Art. 16. Kryepeshkopi, Peshkopët, Zëvendësit e tyre lokalë, Ikonimi i Madh Mitrofor, Sekretari i Përgjithshëm i Sinodit, si dhe ndihmësit e Zëvendësit Klerikë të Kryepeshkopit dhe të Peshkopëve, duhet të jenë prej gjaku e gjuhe Shqiptarë, si edhe të kenë nënshtetësinë Shqiptare.

Art. 17. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorëzohen, përveç cilësive t'Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanonet e Kishës, si dhe të kenë mbaruar një Fakultet Teologjie.

Në rast nevojë, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, mund të dorëzohet Peshkop edhe ai që ka diplomë fakulteti drejtësie, filologjie ose të një Seminari Ortodoks në gradë Liceu.

Art. 18. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e tjerë më parë se të fillojnë në detyrën e tyre detyrohen të bëjnë betimet e shënuara më poshtë, një përpara Mbretit, një përpara Sinodit të Shenjtë.

Betimi përpara Mbretit është:

Betohem dhe premtoj mbi nderin t'im (si Kryepeshkop ose Peshkop) përpara Perëndisë se do të jem kurdohërë besnik i Mbretit të Shqiptarëve, i Atdheut dhe i Statutit të Mbretërisë. Detyrohem të vë në be në këtë mënyrë dhe gjithë Klerikët që do të dorëzohen prej meje.

Betimi përpara Sinodit është:

Betohem mbi ndërgjegjen time (Kryepeshkopale ose Peshkopale) përpara Perëndisë se do të ruaj besnikërinë kundrejt dogmave, kanoneve dhe rregullave Kishtare që përmbajnë bashkimin dogmatik fetar dhe soildarësinë me Patriarhitë dhe Kishat Ortodokse Autoqefale të botës.

TRANSFERIME

Art. 19. Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut.

Art. 20. Peshkopët mund të transferohen me vendimin e Sinodit dhe pas pëlqimit e dekretimit Mbretënor.

PUSHIME

Atr. 21. Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëvevet dhe i Ikonomit të Madh Mitrofor bëhet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinare dhe për arësye ekstraordinare.

a) Për faje të rënda dogmatike e kanonike gjykohen prej një këshilli dymbëdhjetë vetash, përveç Kryetarit, të përbërë prej gjithë anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, përveç të akuzuarit prej Peshkopëve Titullarë dhe prej graduatësh Klerikë gjer në numrin e sipërcaktuar, gjashtë prej të cilëve i zgjedh i akuzuari. Vendimi jepet me tri të katërtat e votavet e me vota të fshehta, pasi të dëgjohet më parë apologjia e të akuzuarit.

b) Për faje ordinare Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi Madh Mitrofor pushohen në rast dënimi kundër lirisë personale në një ndëshkim më tepër se një vit dhe sikur këtij ndëshkimi të mos i jetë shtuar ndalimi nga ofiqet publike; dhe kur dënohen me burgim të rëndë, ose me dënime të fajeve relative për falsifikim, vjedhje, mashtrim, keqpërdorim besimi dhe atentate kundër zakoneve të mira.

Në këto raste dhe Sinodi detyrimisht vendos pushimin e tyre.

c) Për arsye ekstraordinare, të shpjeguara drejt për drejt e me dekret mbretënor Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për veç rasteve të përmendura në paragrafin e sipërm, largohen me një herë nga detyra me dekret mbretënor.

Në rast dekretimi largimi prej detyre i Kryepeshkopit, ky zëvendësohet me një herë prej Peshkopit më të vjetër në dorëzim; në rast dekretim largimi të një Peshkopi, Kryepeshkopi emëron me një herë Zëvendësin e përgjithshëm.

Në rast pushimi të tillë brenda dyzet ditëve ipso fakto, mblidhet Sinodi i cili bashkë me pushimin e të larguarit, vendos zgjedhjen e Peshkopit për përmbushjen e Dioqezës vakante.

Në rast pushimi të Kryepeshkopit, për çfarëdo arsye, ky ka të drejtë të marrë një rrogë të përmuajshme prej pesëqind frangash ari.

Gjithashtu në rast pushimi për çfarëdo arsye të Peshkopëvevet dhe të Ikonomit të Madh Mitrofor, këta marrin nga një rrogë të përmuajshme prej 300 fr. ari.

Art. 22. Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodit, i cili vendos. Po Sinodi mundet edhe motu proprio të shfaqë mendimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodit vetë, dy prej të sëmurit dhe një prej Drejtorisë së P. të Shëndetësisë.

Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk japin dorëheqjen brenda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodi me një herë emëron një ndihmës Peshkop, i cili merr përsipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonitë e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin asnjë pjesë aktive n'administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërinë e tyre, ata japin dorëheqjen duke marrë nga arka e përgjithshme e Kishës një shpërblim të përmuajshëm për Kryepeshkopin gjashtëqind franga ari dhe për Peshkopët katërqind fr. ar.

DETYRAT E PESHKOPËVE

Art. 23. Kryepeshkopi dhe Peshkopët në Dioqezat e tyre janë autoriteti Kishtar dhe ushtrojnë të gjitha detyrat që janë caktuar në kanonet e Shenjta, në rregulloret Kishtare dhe në këtë Statut. Ata janë në juridiksionin e Sinodit dhe ekzekutojnë vendimet dhe urdhërat e tij, sipas dispozitave të këtij Statuti.

Për çdo kundërvajtje ose pakujdesi në detyrat e tyre Kishtare janë përgjegjës përpara Sinodit. Në gusht të çdo viti janë të detyruar të paraqesin një raport të veprimeve të tyre dhe të gjendjes së Peshkopatës. Ky raport këndohet përpara Sinodit dhe mosparaqitja e tij konsiderohet si një shkelje detyre.

Art. 24. Kryepeshkopi dhe Peshkopët në Dioqezat e tyre, si në Qendër ashtu dhe në rrethet e saj, ushtrojnë të gjitha detyrat e imponuara prej kanoneve Kishtare; celebrjnë Misteret e Shenjta; predikojnë fjalën e Shenjtë; konsakrojnë Kishat e Shenjta; përkujdesen që të përmbushin të gjitha shërbesat fetare, sipas dispozitave tipike relative; përkujdesen për zbulimin e hijshëm të Kishave si dhe të Ikonave të Shenjta, vendosja e të cilave kërkon autorizimin e tyre të mëparshëm; përkujdesen për enët e petkat e Shenjta dhe për çdo gjë tjetër që përdoret në Kishë.

Art. 25. Kryepeshkopi dhe Peshkopët detyrohen të shëtisin një herë në vit nëpër Dioqezat e tyre për përmbushjen e detyrave Peshkopale.

Kryepeshkopi për Dioqezën e tij mund t'ia ngarkojë këtë detyrë ndihmësve Peshkopë ose në mungesë Zëvendësit të tij.

Art. 26. Asnjë Peshkop nuk mund të largohet prej Dioqezës së vet pa marrë leje nga Kryetari i Sinodit dhe gjithashtu nuk mund të qëndrojë në Peshkopatën e një peshkopi tjetër pa autorizimin e këtij.

Art. 27. Kryepeshkopi dhe Peshkopët emërojnë Zëvendësit e Tyre në konformitet me Artikullin gjashtëmbëdhjetë (16) të këtij Statuti.

Art. 28. Ikonomi i Madh Mitrofor është i detyruar të kryej çdo mision që i ngarkohet prej Sinodit dhe merr pjesë në të me të gjitha të drejtat e çdo anëtar.

Në rast se mbetet vakant vendi i Ikonomit të Madh Mitrofor, nuk zëvendësohet me tjetër person dhe ky ofiq suprimohet.

KAPTINA IV MASA DISIPLINORE

Art. 29. Kryepeshkopi dhe Peshkopët, për gabime të lehta Kishtare të Klerikëve dhe të Murgjve që ndodhen në juridiksionin e tyre, pasi të dëgjohet më parë i akuzuari, kanë të drejtë të ndëshkojnë në mënyrë të prerë dhe pa tjetër formalitet procedure:

a) me qortim;

b) me pezullim (argji) nga çdo shërbim fetar gjer më pesëmbëdhjetë ditë.

Për këto ndëshkime Peshkopi mban një procesverbal, i cili ruhet në arkivat e Peshkopatës.

Art. 30. Në qendrën e çdo Peshkopate ekziston një Këshill Kishtar disiplinor, i cili gjykon fillimisht për faje fetare Klerikët dhe Murgjit që ndodhen në juridiksionin e saj ose qëndrojnë në atë Peshkopatë. Këshilli Kishtar përbëhet prej Peshkopit vetë si kryetar dhe prej katër Priftërinjve si anëtarë. Këta emërohen dhe pushohen prej Peshkopit dhe emërimi ose pushimi i tyre i njoftohet Sinodit.

Kryepeshkopi dhe Peshkopët mund të formojnë Këshillin Kishtar disiplinor edhe jashtë Qendrës. Vendimet merren me shumicë votash. Kur Kryepeshkopi dhe Peshkopët

ndodhen të penguar, vendin e tyre e zënë zëvendësit Klerikë. Këshilli përbëhet kurdoherë prej pesë anëtarësh dhe plotësohet në mungesë me ndonjë prej tyre.

Art. 31. Këshilli Kishtar ka të drejtë të japë këto ndëshkime:

- a) Qortim*
- b) Pezullim (argji) nga çdo shërbesë fetare jo më tepër se një vit;*
- c) Prerje rroge të shoqëruar me ose pa pezullim gjer në një vit.*

Ndëshkimet me qortim dhe me pezullim (argji) gjer më 40 ditë janë të prera; të tjerat janë të apelueshme nga ana e t'akuzuarit përpara Këshillit disiplinor të përhershëm në qendrën e Kishës.

Në qoftë se një klerik akuzohet për një faj të rëndë që provokon skandal, Kryepeshkopi ose Peshkopi mund ta ndalojë këtë me një herë nga shërbesa fetare po jo më tepër se dy muaj.

KAPTINA V KËSHILLI DISIPLINOR I PËRHERSHËM

Art. 32. Në qendrën e Kishës krijohet një Këshill Disiplinor i përhershëm që përbëhet prej Kryepeshkopit si Kryetar dhe prej katër anëtarëve, Peshkopë ose Klerikë graduatë, të zgjedhur prej Sinodit. Ky zgjedh katër anëtarë suplementarë për të zëvendësuar anëtarët në rast mungese.

Kur Sinodi ndodhet i hapur, detyrën e këtij Këshilli e përmbush ai vetë.

Të gjitha vendimet e Këshillit Disiplinor të përhershëm merren me shumicë votash.

Art. 33. Këshilli Disiplinor i përhershëm gjykon:

a) Apelisht dhe definitivisht vendimet e apelueshme të këshillave disiplinore të Peshkopatave;

b) Fillimisht fajet e rënda të cilat, pas vendimit të Këshillit Disiplinor Peshkopal, sjellin dënime më të mëdha se ato të shënuara në artikullin 30, si dhe fillimisht çgradimin definitiv (katheresin).

Vendimet e dhëna fillimisht prej Këshillit Disiplinor të përhershëm apelohej përpara Sinodit.

Art. 34. Apeli i vendimeve të dhëna prej Këshillit Disiplinor të peshkopatave dhe të Këshillit disiplinor të përhershëm bëhet brenda 30 ditëve prej datës në të cilën i komunikohet të dënuarit vendimi. Ky komunikim do t'i bëhet të interesuarit brenda 15 ditëve prej datës së vendimit.

Kërkesa e apelit i dorëzohet Kryetarit të Këshillit që dha vendimin, i cili brenda 15 ditëve e dërgon në Këshillin Disiplinor të përhershëm.

Art. 35. Sinodi gjykon a) Apelisht dhe definitivisht të gjitha vendimet e dhëna prej Këshillit Disiplinor të përhershëm; b) Peshkopët dhe Ikonomin e Madh Mitrofor për faje të lehta.

Vendimet e dhëna prej Këshillit Disiplinor me pezullim zbatohen menjëherë.

Art. 36. Kryepeshkopi për faje të lehta dhe të rënda Kishtarë gjykohet përpara Këshillit të formuar sipas artikullit 21 a.

Art. 37. Të gjitha vendimet që sjellin pushimin e Kryepeshkopit, të Peshkopëve dhe të Ikonomit të Madh Mitrofor i paraqiten Mbretit për dekretim.

Art. 38. Ekzekutimi i dënimit për çgradim (katheresis) të klerikëve bëhet sipas kanonevet Kishtare dhe i dënuari me çgradim detyrohet të nxjerrë petkat fetare dhe shenjat e tjera të ofiqit, për ndryshe dënohet në bazë të artikullit 214 të Kodit Penal.

KAPTINA VI ORGANIZIMI I ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Art. 39. Kishat, Manastiret dhe pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme si dhe ato të komunitetit Orthodhoks janë të siguruara në komformitet me ligjet e Shtetit.

Art. 40. Burime financiare të Kishës janë:

a) Të ardhurat e Kishave dhe të Manastireve si dhe të pasurive të komunitetit Orthodhoks;

b) Subvencioni i dhënë prej shtetit për ndihmën e kishës;

c) Pagesa fakultative si dhe çdo farë dhurate ose ndihme e dhënë prej Shqiptarëve.

Art. 41. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e çdo Dioqeze kanë të drejtë të mbledhin ndihmat fakultative të zakonshme për dobinë e Kishës ose personale të tyre nga çdo familje Orthodhokse, siç do të caktohet në rregullore.

Art. 42. Asnjë pasuri e patundshme kishtare ose manastiriale si edhe e komunitetit Orthodhoks nuk mund të jetërsohet pa vendimin e Këshillit Mikst, përndryshe jetërsimi është i pavlefshëm.

Mënyra e administrimit dhe e shfrytëzimit të pasurive të tundshme dhe të patundshme si edhe mënyra e shitjes së pasurive të tundshme të Kishave, Manastireve dhe komuniteteve Ortodokse caktohet në Rregulloren e përgjithshme të administrimit.

Art. 43. Autoritetet e Kishës Autoqefale detyrohen t'i paraqesin kur të kërkohen, inspektorit të Ministrisë së Drejtësisë të gjitha llogaritë e t'ardhurave e të të prishurave. Në rast që konstatohet se është bërë abuzim, kundërvepronjësit dërgohen në gjyq prej Ministrisë së Drejtësisë dhe dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

KAPTINA VII KËSHILLI MIKST

Art. 44. Për administrimin dhe kontrollimin e pasurive të Kishave, të Manastireve, të komuniteteve Orthodhokse, të çdo lloji dhurate dhe ndihme si dhe të subvencionit të shtetit krijohet në Qendrën e Kishës një këshill me emrin "Këshilli Mikst" i përbërë prej të gjithë anëtarëve të Sinodit dhe prej katër Laikësh, një për çdo Dhioqezë, nën kryesinë e Kryepeshkopit.

Të zgjedhurit e Laikëvet në fjalë dhe kompetenca si dhe të drejtat e tyre do të caktohen në Rregulloren e administrimit të Kishës Ortodokse Autoqefale.

Për këtë herë katër anëtarët laikë zgjidhen prej kongresit.

Rregullorja e administrimit të përgjithshëm do të elaborohet prej Këshillit Mikst të cilit do t'i shtohen edhe katër anëtarë laikë një prej çdo Dioqeze të zgjedhur po prej këtij kongresi. Në Rregullore do të caktohen rrogat dhe shpërblimet e Kryepeshkopit, Peshkopëve dhe Ikonomit të Madh Mitrofor si dhe të nëpunësve të tjerë klerikë dhe laikë; do të formulohet mënyra e zgjedhjeve të Pleqësive Kishtare (Dhimogjerondive) dhe të kujdestarëve të Kishave e të Manastireve.

Kjo Rregullore do të elaborohet prej Këshillit Mikst, të formuar si më sipër, brenda gjashtë muajve pas datës së dekretimit të këtij Statuti.

Art. 45. Këshilli Mikst harton për çdo vit buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës, një kopje e të cilit i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë për veprimet e parapara në dispozitat e Rregullores së përgjithshme t'administrimit.

Art. 46. Pasuritë e tundshme dhe të patundshme që u janë lënë komunitetetve Ortodokse, Kishave ose Manastireve me një qëllim mirëbërës të caktuar, ndodhen nën kontrollimin e Kishës e cila përkujdeset për të kryerit e qëllimit dhe për ekzekutimin e dëshirës së dhuronjësit.

Art. 47. Pranë Kryekishës krijohet Arka e përgjithshme në të cilën hyjnë të gjitha të ardhurat e Kishës sipas artikullit 40 dhe prej kësaj bëhen pagesat sipas Rregullores së administrimit.

Art. 48. Çdo zëvendës lokal bashkë me Pleqësinë Kishtare harton Buxhetin preventiv të përvitshëm për të gjitha të ardhurat dhe të prishurat të juridiksionit të tij për pasuritë e komunitetetve Ortodokse dhe për pasuritë dhe të ardhurat e Kishavet. Ky buxhet i dërgohet Peshkopatës kompetente gjer më një gusht. Peshkopata, pasi të mbledhë buxhetet e të gjithë Dioqezës së saj, me vërejtjet e duhura, ia dërgon Qendrës brenda 30 ditëve.

Art. 49. Për çdo Manastir hartohet një buxhet i veçantë, i cili më një gusht i paraqitet Peshkopatës dhe kjo ia dërgon Qendrës me vërejtjet e duhura dhe bashkë me buxhetet e tjera për aprovim.

Art. 50. Viti financiar i Kishës fillon më një janar dhe buxheti preventiv i dërgohet çdo Peshkopate përpara kësaj date.

Buxheti konsumativ hartohet brenda muajit mars për të ardhurat dhe të prishurat e vitit të shkuar. Ky buxhet, bashkë me tepricën e t'ardhurave, i dërgohet çdo Peshkopate brenda muajit mars. Teprica e t'ardhurave të Manastireve i dërgohet Qendrës në çdo 6 muaj.

Art. 51. Në qendrën e Kishës ndodhet një Këshilli ekonomik i përhershëm që përbëhet prej Kryepeshkopit dhe katër laikëve. Këta të fundit zgjidhen prej Këshillit Mikst dhe detyrat e tyre caktohen në Rregullore.

Art. 52. Në Arkën e Përgjithshme të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë nuk mund të mbahen më tepër se katër mijë fr. ari, teprica depozitohet në një nga Bankat Shqiptare n'emrin e saj dhe tërhiqet sipas dispozitave të Rregullores s'administrimit.

Art. 53. Rregullorja e administrimit të përgjithshëm për të hyrë në fuqi, duhet të aprovohet nga Ministria e Drejtësisë.

KAPTINA VIII

Art. 54. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë detyrohet në çdo meshë të bëjë lutje për Mbretin, për gjithë Kombin Shqiptar dhe për ushtrinë.

Art. 55. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë n'asnjë mënyrë nuk mund të pranojë, në çdo emër qoftë, dhurata nga një fuqi e huaj dhe veprimi i kundërt shkakton zbatimin e dispozitave të ligjës mbi fajet politike.

Art. 56. Sinodi do të veprojë për përmirësimin që kërkojnë konditat shoqërore të sotme mbi sa u përket zakoneve fetare.

Art. 57. Asnjë klerik nuk mund të funksionojë fenë ortodokse në Shqipëri pa qenë i emëruar dhe i lidhur me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Art. 58. Të gjithë ata Klerikë për të cilët flet artikulli 16 dhe që ndodhen në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilët nuk kanë konditat e lypura prej atij artikulli, që ditën e aprovimit të këtij Statuti janë të pushuar nga funksioni Fetar klerikal.

Art. 59. Asnjë laik ose Murg nuk mund të dorëzohet Prift ose Dhjak pa pasur pëlqimin e Sinodit dhe pa pasur diplomën e Seminarit Ortodoks.

Art. 60. Të gjitha marrëdhëniet që do të ketë Kisha Autoqefale e Shqipërisë me Qeverinë Mbretnore do të bëhen me anën e Ministrisë së Drejtësisë.

Art. 61. Çdo Peshkopatë ka vulën e saj në të cilën do të jetë shkruar: Peshkopata e (Emri i Dioqezës).

DISPOZITAT E FUNDIT

Art. 62. Në rast herezie të një pjese ose të gjithë popullsisë Ortodokse të një krahine, Kishat, Manastiret dhe pasuritë e tyre i mbeten Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Art. 63. Në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshohen, të modifikohen ose të abrogohen artikujt 1,2, e 3.

Art. 64. Mund të ndryshohen me vendim të Këshillit Mikst bashkë me Këshillin e përhershëm artikujt: 10; 14 a, b; 25; 40; 48; 49; 52 e 60.

Dispozitat e tjera të këtij Statuti mund të ndryshohen me vendim të një kongresi tjetër.

Ky statut i paraqitet Qeverisë për të marrë formën ligjore.

Korçë, 29 Qershor, 1929.

Më poshtë jepet e plotë lista e të gjithë delegatëve të Kongresit të dytë Kishtar të Korçës që është dhënë më sipër kur nisi punimet ky Kongres.

III. KRYETARI I K.O.A.SH-IT VISARION XHUVANI SHPJEGON STATUTIN

Sinodi i Shenjtë në shkurt të vitit 1929 u krijua me episkopë kanonikë shqiptarë që e kishin dhe kulturën kishtare për të hedhur themelet e shëndosha të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (K.O.A.Sh): Visarion Xhuvani kishte mbaruar studimet e mesme dhe të larta teologjike në Athinë, Agathangjel Çamçe ishte edhe me përvojën e lëvizjes kombëtare shqiptare. Më 1922 mori gradën e Arkimandritit dhe më 1929 u hirotonis dhe u emërua episkop në Berat Ikonomi i Madh Mitrofor Atë Vasil Marko, i cili në Kongresin e Beratit u zgjodh Kryetar i Këshillit të Lartë. Në këtë Kongres edhe Arkimandrit Ambrosi u emërua episkop i Gjirokastrës.

Kongresi i dytë kishtar i Korçës miratoi Statutin e përhershëm (definitiv) të K.O.A.Sh-it, Rregulloren e K.O.A.Sh-it dhe forumet drejtuese të kishës. Kjo që përgjigjja më e mirë ndaj pretendimeve absurde të Patriarkanës së Stambollit dhe të Patriarkanës greke, që penguan gati 7 vjet rrugën e autoqefalisë për Kishën Ortodokse Shqiptare.

Në mbyllje të punimeve të Kongresit kishtar të Korçës Imzot Visarioni bëri deklaratën e tretë për të paraqitur përmbledhtas përfundimet e Kongresit: “Tue ndjekë udhën e shembullat e shenjta të mbledhjeve të hirshme të kohëve të lumtuna të Apostujve, bamë më 1 qershor të vitit 1929 thirrjen për mbledhjen e gjithë vllazënve dhe bijve tanë në Krisht, meshtarë dhe laikë të krishtenë ortodoksë të Shqipnisë, bamë thirrje për t’u mbledhun në Kongresin e dytë Kishtar në Korçë.

Ekzakt të dielën kur u mbledh në Niqea Sinodi i parë Ekumenik para 1604 vjetësh në prezencë të mbretit Kostandin i Madh, edhe këtu, më 16 qershor 1929 përfaqësuesit e klerit të popullit të gjithë Shqipnisë, në prezencë të përfaqësuesit të Mbretit, banë thirrje të përzemërta në Perëndi për me lypë hirin e shpirtit të shenjtë” (Gazeta e Re. 16.7.1929).

Deklarata e Kryepiskopit Imzot Visarion Xhuvanit paraqiti çështjet më të rëndësishme të Statutit përfundimtar, duke dhënë edhe përfundimet historike të këtij kuvendi të rëndësishëm kishtar:

-“Kisha Ortodokse e Shqipnisë asht pjesë e pandame e Kishës së shenjtë, që asht pjesë e përgjithshme apostolike dhe përbahet prej gjithë ortodoksëve të Shqipnisë, asht e bashkueme me të gjitha patriarkitë e shenjta dhe me kishat ortodokse të botës.

-Gjuha zyrtare e kishës asht shqipja.

-Autoriteti ma i naltë asht Sinodi i Shenjtë episkopal, i përbamë nga Kryepiskopi, Episkopët, zavendësat e tyne, Ikonomi i Madh Mitrofor, të cilët duhet të jenë prej gjaku dhe gjuhe shqiptarë dhe nënshtetas shqiptarë.

-Vendimet e Statutit kërkojnë vendosjen e rregullit, të disiplinës dhe zbatimin e urdhnave të eprorëve. Disiplina e fortë, kultura, morali dhe zakonet e mira janë shtylla për të mbajtur ndërtesën shpirtnore të kishës së shenjtë.

-Asnji pasuni kishtarë e tundshme ose e patundshme të mos përdoret, veç për misionin e shenjtë shpirtnor të kishës, për këtë qëllim u formuen këto organe:

-a) Sinodi i Shenjtë për qeverisjen shpirtnore. b) Këshilli Mikst (i përziem) i përbamë prej Sinodit dhe katër antarëve laikë, që do të kujdeset për kontrollin dhe rregullimin e pasunive. c) Këshilli administrativ i përhershëm ekonomik financiar.

Qëllimi kryesor i kësaj mbledhjeje të përgjithshme asht bashkimi shpirtnor i gjithë të krishtenëve për të sigurue solidaritetin e gjithë atyne që bajnë grigjën e anijes shpëtimtare që ka emnin e bekuem “Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipnisë”. Qëllimi tjetër asht që të vemë të gjitha fuqitë tona për organizimin dhe rregullimin e mirë të saj”.

Kongresi i dytë kishtar i Korçës e gjykoi të domosdoshme hartimin dhe miratimin e Rregullores së K.O.A.Sh-it, e cila do të ishte shtylla e dytë e çeliktë mbi të cilën do të mbështetej veprimtaria e Kishës. Për qartësimin e ideve të Rregullores korrespondenti i “Gazetës së Re” mori këtë intervistë prej Imzot Visarion Xhuvanit:

“Intervistë me Kryetarin Imzot Visarion

Kongresi panortodoks i Korçës votoi Statutin por me që s’kishte kompetencë të votonte rregulloren e la këtë të hartohet prej një komisioni kompetent brenda 6-mujve. Unë nuk mund të qeveris Kishën pa ligje relative të administrimit të saj të përgjithshëm. Prandaj urdhënova këshillin e caktuem prej Kongresit për hartimin e rregullores në fjalë,

të mblihdet menjherë pas mbylljes së Kongresit e brenda 10 ditëve rregullorja të jetë e kryeme.

Me kohë kam hartue projektin relativ dhe sot ditën e ejte në ora 5 pasdreke, fillojmë mbledhjen e Këshillit Mikst bashkë me 4 anëtarët që janë zgjedhur posaçërisht për hartimin e rregullores. Mbledhjet do të zhvillohen përditë në orën 5-8 në pallatin e Mitropolisë së Korçës dhe janë të hapuna.

Për hir të kësaj Rregulloreje që ka randësi të madhe për Kishën iu luta Qeverisë të më lejë në dispozicion edhe Z. Kov Deliana, Kryetar i Këshillit të Shtetit, i cili ka bamë studime të posaçme të ekonomisë politike dhe sa për pikpamjen gjuhësore Kostaq Cipun, profesor në Liceun e Korçës. (Gazeta e Re. Nr. 206. 9.7.1929)”

IV. ÇFARË PARASHIKONTE RREGULLORJA E K.O.A.SH-IT

Imzot Visarioni hapur dhe me shumë çiltëri ftoi për diskutimin e Rregullores Administrative të Kishës të gjithë njerëzit dashamirës e të interesuar. Mbledhjet e hapura dëshmuuan për një transparencë shembullore në shqyrtimin e çështjeve të Rregullores dhe grupi që punoi mundi të vjelë mendimin më racional për mbarëvajtjen e veprimtarisë kishtarë. Kjo transparencë shembullore është mbështetur dhe realizuar sipas traditës së kuvendeve popullore shqiptare, ku kanë të drejtë të barabartë të gjithë të shprehin mendimin dhe qëndrimin e tyre dhe fuqia e argumentit është përcaktuese në marrjen e një vendimi dhe jo sasia e pjesëmarrësve që votojnë formalisht për të.

Ky dokument themelor u projektua me mençuri nga Imzot Visarion Xhuvani dhe me shumë kujdes u hartua nga bashkëpunëtorët e tij. Rregullorja Administrative përcaktoi qartë të drejtat dhe detyrat e çdo forumi drejtues të Kishës. Ajo është ndërtuar në mënyrë hierarkike. Forumet japin llogari njëri pas tjetrit deri te forumi më i lartë. Është përcaktuar qartë dhe në mënyrë demokratike zgjedhja e anëtarëve drejtues. Të gjitha forumet drejtohen nga besimtarë të zgjedhur lirisht, por që plotësojnë kushtet e Rregullores. Ato kanë afat kohor vetëm dy ose tre vjet dhe mund të zgjidhen vetëm deri në dy mandate.

Rregullorja ka përcaktuar hierarkinë drejtuese dhe detyrat:

-Organi më i lartë është Këshilli Mikst, i cili administron të gjitha pasuritë kishtarë, mblihdet një herë në vit dhe kryesohet nga Kryeepiskopi. Vendimet ai i merr me shumicë votash. Këshilli Mikst përbëhet nga klerikë dhe laikë dhe ka afat kohor dy ose tre vjeçar. Ai cakton administratorët e manastireve, të cilët quhen igumenë.

-Këshilli igumenal përbëhet nga igumeni dhe nga 4 laikë e mblihdet një herë në muaj dhe kujdeset për mbarëvajtjen, rregullin dhe pasuritë e manastirit.

-Pleqësitë kishtarë (dhimogjeronditë) zgjidhen në mënyrë indirekte një anëtar për 250 besimtarë. Ato kanë për detyrë të emërojnë kujdestarin (epitropin), të zgjedhin priftërinjtë dhe dhjakët, të administrojnë pasuritë e kishës. Kujdestarët kanë për detyrë që të kujdesen për mbarëvajtjen e kishës, për buxhetin dhe të ardhurat.

-Organika administrative e Kishës fillon me anëtarët e Sinodit, përcakton pagat e tyre dhe honorarët e Këshillit Mikst, të organeve të tjera drejtuese që punojnë në administratë, në kisha dhe në manastire.

Rregullorja ka përcaktuar dhe kuotat (taksat) që paguan çdo ortodoks i martuar sipas të ardhurave të tyre.

RREGULLORJA
E ADMINISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KISHËS

Organizimi i brendshëm i Kishës dhe administrimi i pasurive të manastireve, të kishave dhe të komuniteteve fetare, si dhe të çdo lloj dhurate ose ndihme që bëhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

KAPTINA I
KËSHILLI MIKST

Art. 1.-Autoriteti m'i lartë për administrimin dhe kontrollimin e pasurive është Këshilli Mikst, i cili e ushtron kompetencën e tij me anën e Këshillit Ekonomik të Përhershëm, sipas detyrave dhe të drejtave që i caktohen në këtë Rregullore.

Art. 2.-Këshilli Mikst formohet sipas dispozitave relative të Statutit.

Anëtarët laikë zgjidhen në këtë mënyrë:

Peshkopi i çdo Dioqeze një muaj më parë se të mbarojë periudha e anëtarëve të Këshillit Mikst, provokon, me anë deklarate, kandidaturën e çdo besniku që ka cilësitë e kërkuara prej artikullit 3 për anëtar të Këshillit Mikst. Kandidaturat pranohen brenda 15 ditëve prej datës së deklaratës.

Peshkopi emrat e kandidatëve u a komunikon të gjitha pleqësive kishtare të Dioqezës së tij me anën e zëvendësve lokalë.

Pleqësitë kishtare, me vendim të tyre, zgjedhin një prej kandidatëve të paraqitur.

Vendimi i dërgohet Qendrës së Peshkopatës me anë të zëvendësve.

Pleqësia Kishtare e Qendrës së Peshkopatës (Dhimogjerondia) deklaron për anëtar të Këshillit Mikst kandidatin që ka fituar shumicën e votave. Në rast njësie votash, Pleqësia Kishtare e Qendrës heq shortin midis atyre që kanë vota të njëshme.

Çdo anëtar zgjidhet për dy vjet dhe mund të rizgjidhet për periudhën e dytë po jo dhe për të tretën.

Art.3.-Anëtarët laikë duhet të kenë mbaruar një shkollë të mesme të plotë dhe të kenë të gjitha cilësitë që kërkohen për nëpunësit e Shtetit.

Art.4.-Kompetenca e Këshillit Mikst është:

a) të caktojë mënyrën e përgjithshme për administrimin e pasurive të Kishave, të Manastireve, të komuniteteve Ortodokse, të çdo lloj dhurate dhe ndihme si dhe të subvencionit të Shtetit;

b) të kontrollojë të gjitha veprimet e Këshillit Ekonomik të Përhershëm;

c) të vendosë mbi jetërsimin e pasurive;

ç) të hartojë buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës, një kopje e të cilit i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë në konformitet me dispozitat e ligjit të administrimit të pasurive të komuniteteve për aprovim.

MBLEDHJET E KËSHILLIT MIKST

Art. 5.-Këshilli Mikst detyrohet të mbledhet një herë në vit në kohën kur ndodhet i mbledhur Sinodi, sipas thirrjes së Kryetarit.

Kryepeshkopi, në rast pune të jashtëzakonshme, që i përket kompetencës së Këshillit Mikst, e mbledh këtë pasi të marrë pëlqimin e shumicës së anëtarëve.

Art. 6.-Mbledhjet e Këshillit Mikst kryesohen prej Kryepeshkopit. Këshilli Mikst ka kuorum kur ndodhen tre laikë dhe tre klerikë midis të cilëve përmblihet dhe Kryetari.

Vendimet merren me shumicë votash. Në rast njësie, paravlen ana e Kryetarit.

KAPTINA II KËSHILLI EKONOMIK I PËRHERSHËM

Art. 7.-Këshilli Ekonomik i Përhershëm formohet sipas artikullit 51 të Statutit dhe anëtarët e tij zgjidhen për tre vjet.

Pas mbarimit të këtij afati, anëtarët laikë mund të zgjidhen pasi të kalojë një periudhë tre vjetësh prej ditës së mbarimit të afatit të tyre.

Anëtarët laikë duhet të kenë të gjitha cilësitë që kërkohen për nëpunësit e Shtetit.

Art. 8.-Këshilli Ekonomik i Përhershëm emëron administratorët e Manastireve të cilët janë klerikë dhe mbajnë titullin Igumen. Kryetari dekreton emërimin e tyre, duke pasur vetëm arsye shpirtërore.

Igumeni merr rrogën që caktohet në buxhet.

KAPTINA III KËSHILLI IGUMENAL

Art. 9. –Këshilli Igumenal përbëhet prej Igumenit dhe dy laikëve, një prej qytetit dhe një prej fshatit më t'afërm të manastirit.

Anëtarët laikë të këtij këshilli zgjidhen si pason:

Peshkopi paraqet gjashtë kandidatë, tre prej fshatit në të cilin ndodhet Manastiri dhe tre prej qytetit më t'afërm, Qendër Peshkopate ose Qendër zëvendësie. Kandidatët e fshatrave i paraqiten pleqësive të fshatrave përkatëse të cilat prej të treve zgjedhin dy; kandidatët e qyteteve i paraqiten pleqësive kishtare të qytetit përkatës dhe ajo prej të treve zgjedh dy. Të katër kandidatët e zgjedhur në këtë mënyrë i paraqiten Këshillit Ekonomik të Përhershëm, i cili prej tyre zgjedh dy, një prej qytetit dhe një prej fshatit.

Art. 10. –Kompetenca e Këshillit Igumenal është:

a) të kqyrë mbarëvajtjen dhe rregullin e Manastirit, të administrojë pasuritë e tij, sipas urdhërave hierarkike;

b) të vërë në ankand çdo shfrytëzim pasurie të tundshme dhe të patundshme;

c) të shesë në ankand, sipas ligjeve të ankandeve, produktet dhe frytet e përmotshme. Në rast nevoje, Këshilli Igumenal mban të drejtën të bëjë shitje pa ankand të produkteve dhe të fryteve të përmotshme një herë në çdo 2 muaj dhe vetëm kur shuma nuk kapërcen të 150 (njëqind e pesëdhjetë) fr. ari.

ç) të mbledhë të ardhurat, arkëtar i të cilëve do të jetë anëtari laik prej qytetit. Ky paguan me urdhër-pagese të nënshkruar prej Igumenit, në bazë të vendimit të Këshillit Igumenal, i cili e ka për kompetencë të caktojë shumën e përmuajshme për nevojat e ditës.

d) të mbajë libra kontabiliteti të rregullshme për të cilat ka një ndihmës llogaritar me shpërblim të caktuar në buxhetin e Manastirit;

dh) të vendosë mbi nevojën e jetërsimit të pasurive të patundshme, i cili përmbrohet pasi vendimi të aprovohet prej Këshillit Mikst.

Këshilli Igumenal dorëzon në çdo gjashtë muaj t'ardhurat në Arkën e Përgjithshme dhe gjithashtu paraqet një raport relativ.

Art. 11.- Në fund të çdo adjudikate Këshilli kompetent, me anën e Kryetarit të tij, duhet të lidhë kontratë me sipërmarrësin dhe ta vërtetojë në noteri. Shpenzimet përkatëse rëndojnë mbi sipërmarrësin me gjithë taksat shtetërore dhe komunale të lypura prej ligjeve.

MBLEDHJET E KËSHILLIT IGUMENAL

Art. 12. – Këshilli Igumenal mblidhet një herë në muaj rregullisht dhe, në rast nevoje, dy herë.

Art 13. – Peshkopi ruan mbi Igumenin të gjitha të drejtat kanonike për disiplinën kishtare si dhe për lejimin ose pushimin e meshimit për arësye kanonike dhe të justifikuara.

KAPTINA IV PLEQËSITË KISHTARE

Art. 14. – Pleqësitë kishtare (Dhimogjeronditë) të qytetit përbëhen prej gjashtë vetash dhe zgjidhen për dy vjet.

Zgjedhja e këtyre Pleqësive bëhet në mënyrën indirekte si pason:

Prej 1 gjer më 1000 frymë zgjidhen katër për çdo 250 frymë;

Prej 1001 gjer më 2000 frymë zgjidhen tre për çdo 250 frymë;

Prej 2001 gjer më 3000 frymë zgjidhen dy për çdo 250 frymë;

Prej 3001 e lart zgjidhet një për çdo 250 frymë;

Art. 15. – Zgjedhësit e parë që të mundin të votojnë duhet të kenë të gjitha ato cilësi që kanë zgjedhësit e parë në zgjedhjen parlamentare dhe të jenë në rregull me pagesat fakultative dhe llogaritë kishtare.

Art. 16. – Zgjedhësit e dytë duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën shqipe dhe të jenë 25 vjeç e lart.

Art. 17. – Pleqtë (Dhimogjerondët) duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën shqipe dhe të jenë 30 vjeç e lart.

Art. 18. – Pleqësitë Kishtare të katundevet përbëhen prej priftit të fshatit dhe dy laikësh. Këta të fundit zgjidhen prej popullit të katundit për dy vjet dhe zgjedhjet e tyre konfirmohen prej Peshkopit.

Mbledhjet e Pleqësive Kishtare të fshatrave mbahen nën kryesinë e priftit.

Kompetenca e tyre është si ajo e Pleqësive të qyteteve.

Pleqësitë kishtare të katundeve zgjedhin dy kandidatë për kujdestar. Këta i paraqiten Peshkopit, i cili emëron një prej tyre.

Art. 19. – Administrimi i pasurivët të kishave dhe të komuniteteve fetare bëhet prej Peshkopit ose Zëvendësit të tij së bashku me Këshillat Kishtarë të qyteteve ose të katundeve.

Art. 20. – Kompetenca e Pleqësive Kishtare është:

a) të emërojë kujdestarët (epitropët e Kishave)

b) të zgjedhë priftërinjtë dhe dhjakët duke votuar për këtë punë dhe kujdestarët e Kishës përkatëse në të cilën emërohen prifti ose dhjaku;

- c) të kqyrë mbarëvajtjen dhe rregullin e Kishës, të administrojnë pasuritë e saj sipas urdhërit hirarkik dhe të veprojnë sipas artikullit 10 të kësaj Rregulloreje.
- Në emërimin e priftërinjve dhe të dhjakëve, Peshkopi mban veton për arësye shpirtërore, të cilat nuk detyrohet t'i bëjë të njohur asnjëri dhe në asnjë mënyrë.
- ç) të hartojë buxhetin preventiv të çdo viti dhe t'ia dërgojë Peshkopatës sipas artikullit 48 të Statutit.

Art. 21.- Në rast neglizhence të rëndë ose mosmarrëveshjeje të Pleqësive, dërgohet si inspektor një prej Qendrës mbi raportin e të cilit Këshilli Ekonomik i Përhershëm vendos duke pasur të drejtë të shpërndajë Pleqësinë e vjetër dhe të zgjedhë një të re.

Kujdestarët e Qendrave të Peshkopatës pushohen për neglizhencë të rëndë prej Pleqësisë Kishtare dhe ata jashtë Qendrës prej Peshkopit, pas propozimit të Këshillave Kishtare lokale.

Art. 22. – Pleqësitë Kishtare si dhe ato Igumenale veprojnë sipas buxhetit të përgjithshëm t'aprovuar prej Këshillit Mikst.

Art. 23. – Peshkopi ruan veton për psaltët dhe kishtarët.

KAPTINA V KUJDESTARËT

Art. 24. – Kujdestarët e Kishave të qyteteve dhe të katundeve emërohen prej Pleqësive Kishtare relative, dekretohen prej Peshkopit kompetent dhe janë dy për secilën kishë. Në kishat që kanë popullsi të madhe emërohen dhe dy ndihmës kujdestarë. Koha e vazhdimit të tyre është dy vjet dhe shërbejnë darovisht.

Art. 25. – Të drejtat e kujdestarëve janë:

- a) të marrin pjesë në Këshillin e Pleqësive Kishtare për zgjedhjen e priftërinjve dhe të dhjakëve;
- b) të emërojë dhe të pushojë, së bashku me Pleqësitë Kishtare, psaltët dhe kishtarët;

Vendimet dekretohen prej Peshkopit kompetent. Organizimi i Koreve mbetet në kompetencën e Peshkopëve.

c) të kujdesen për mirëmbajtjen e Kishës, të shpenzojnë sipas buxhetit të caktuar dhe të kujdesen për shtimin e t'ardhurave;

ç) t'inkasojë t'ardhurat dhe çdo katër muaj të paraqesë një raport për gjendjen e Kishës dhe të personelit të saj.

Kujdestarët e kishave të katundeve si dhe arkëtarët e Këshillit të kujdestarëve të qyteteve janë të detyruar t'i dorëzojnë të hollat në çdo tre muaj Arkëtarit të Pleqësisë Kishtare të vendit.

Arkëtarët e Pleqësisë Kishtare tepricat e të gjitha të ardhurave ia dërgojnë Arkëtarit të Qendrës së Peshkopatës në fund të çdo viti.

Në rast se teprica kalon 2000 (dy mijë) fr. ari, këto depozitohen në një nga Bankat shqiptare më të afërme.

Regjistrat do të bëhen prej Qendrës në formë të njëshme, do të shpërndahen ndër Dioqeza dhe do të vërtetohen prej Peshkopit.

Art. 26. – Çdo Pleqësi Kishtare emëron prej gjirit të saj arkëtarin. Kur kujdestarët janë më tepër se një, Peshkopi emëron arkëtar njërin prej tyre; në rast se është i vetëm, ky ipso facto mbetet arkëtar.

Arkëtarin e Këshillit të kujdestarëve do t'i dorëzojë tepricat e kishës, sipas buxhetit, në Arkën e Pleqësisë kishtare lokale. Kjo ia dorëzon Arkës së Qendrës së Dioqezës, e cila ia dorëzon Arkës së Përgjithshme. Peshkopët tepricat i dorëzojnë një herë në vit në Qendër.

Art. 27. – Kujdestarët detyrohen të regjistrojnë të gjitha të ardhurat hollësisht në libra zyrtare të dërguara posaçërisht prej Kryesisë.

Art. 28. – Priftërinjtë mund të transferohen për arsye të jashtëzakonshme prej Peshkopit të Dioqezës dhe me pëlqim të Kryepeshkopit.

KAPTINA VII ANËTARËT E SINODIT

Art. 29. – Mitropoliti i Qendrës dhe Kryepeshkopi merr një rrogë të përmuajshme prej 800 (tetëqind) fr. ari dhe një shpërblim përfaqësimi prej 300 (treqind) fr. ari në muaj.

Peshkopët kanë nga një rrogë të përmuajshme prej 600 (gjashtëqind) fr. ari.

Ikonomi i Madh Mitrofor ka një rrogë të përmuajshme prej 400 (katërqind) fr. ari dhe 100 (njëqind) franga ari si shpërblim i anëtarit të Sinodit të Shenjtë.

Peshkopët titullarë (pa Dioqezë) kanë një rrogë prej 400 (katërqind) fr. ari në muaj.

Në rast se një Peshkop mban zëvendësinë e një Peshkopate tjetër, merr dhe gjysmën e rrogës së Peshkopit që zëvendëson.

PERSONELI

Art. 30. – Sekretari i Përgjithshëm ka rrogë të përmuajshme fr. ari 300 (treqind) në muaj.

Llogaritari i Përgjithshëm ka rrogë të përmuajshme 250 (dyqind e pesëdhjetë) fr. ari.

Sekretari 160 (njëqind e gjashtëdhjetë);

Kopisti 150 (njëqind e pesëdhjetë);

Dhjaku ose nëndhaku i kryesisë 120 (njëqind e njëzet);

Dy shërbëtorët nga 100 për çdo njeri;

Predikonjësi i Përgjithshëm 300 (treqind).

PERSONELI I KËSHILLIT MIKST

Art. 31. – Për mbledhjet e rregullshme të Këshillit Mikst çdo anëtar laik për shpërblim dhe shpenzimet e udhëtimit merr 400 (katërqind) fr. ari.

Për mbledhjet e jashtëzakonshme çdo anëtar laik merr shpenzimet e udhëtimit dhe 20 (njëzet) fr. ari. në ditë.

ANËTARËT E KËSHILLIT EKONOMIK

TË PËRHERSHËM

Art. 32.- Çdo anëtar i Këshillit Ekonomik të Përhershëm merr 10 (dhjetë) fr. ari për çdo mbledhje.

PERSONELI I PESHKOPATAVE

Art. 33. – Sekretari i Peshkopatave merr një rrogë të përmuajshme prej 200 (dyqind) fr. ari;

Dhjaku ose nëndhjaku i çdo Peshkopate 100 (njëqind);

Shërbëtorët 80 (tetëdhjetë).

Zëvendësit lokalë klerikë marrin nga 30 (tridhjetë) fr. ari.

Për subvencionin e priftërinjvet vihet në dispozitë një shumë prej 30.000 (tridhjetmijë) fr. ari.

Për përmbushjet e Seminarit lihen në dispozitë 40.000 (dyzetmijë) fr. ari.

Art. 34. –Këshilli Mikst në hartimin e buxhetit është i detyruar të caktojë shumën e të hollave të duhura për të dërguar dhe për të përmbajtur në një nga fakultetet teologjike dy gjer më katër studentë.

Për botimin e revistës lihen në dispozitë 600 (gjashtëqind) fr. ari.

CILËSITË E PERSONELIT

Art. 35 – Predikonjësi i Përgjithshëm dhe Instruktori duhet të jetë i diplomuar prej një fakulteti teologjike dhe, në rast nevojë, këtë vend mund t'a zërë dhe një nga graduatët klerikë të provuar në zotësi.

Art. 36 – Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë mbaruar një shkollë të mesme dhe duhet të dijë një gjuhë të huaj të Oksidentit.

Llogaritari i Përgjithshëm duhet të ketë mbaruar një shkollë tregtare ose një shkollë të mesme;

Sekretari duhet të ketë mbaruar një shkollë qytetëse;

Sekretari i Dioqezave duhet të ketë mbaruar një shkollë qytetëse.

EMËRIMET

Art. 37 – Predikonjësi i Përgjithshëm emërohet me vendimin e Sinodit dhe me dekretimin e Kryepeshkopit.

Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe pushohet sipas Statutit.

Llogaritari i Përgjithshëm emërohet dhe pushohet prej Këshillit Ekonomik të Përhershëm.

Dhjaku ose nëndhjaku i Kryesisë, kopisti dhe shërbëtorët emërohen dhe pushohen prej Kryepeshkopit.

Sekretarët e Dioqezave emërohen dhe pushohen prej Pleqësive Kishtare dhe dekretohen prej Peshkopit kompetent.

Dhjaku ose nëndhjaku dhe shërbëtorët emërohen dhe pushohen prej Peshkopit.

DETYRAT E TYRE

Art. 38. – Detyrat e Predikonjësit të Përgjithshëm dhe të Instruktorit të klerit janë:

- a) të predikojë Fjalën e Perëndisë, sipas instruksioneve të marra nga Kryesia;
- b) të stërvitë klerin në gjuhën amtare dhe në rregullën kishtarë për sa u përket shërbesave të hirshme;
- c) të përmbushë çdo mision për inspektimin e manastireve dhe kishave si dhe çdo mision tjetër kishtar të ngarkuar prej Kryesisë.

Art. 39. – Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm janë:

- a) të rregullojë të gjitha veprimet e sekretarisë për të cilat është përgjegjës përpara Kryetarit;
- b) të mbajë procesverbalet e mbledhjeve si dhe të gjithë korrespondencën
- c) të përkujdeset për mirëmbajtjen e arkivave dhe të protokollit me anën e dipendeteve të tij.

Art. 40. – Detyrat e Sekretarit janë:

- a) të zbatojë urdhërat e Sekretarit të Përgjithshëm;
- b) të mbajë në rregull arkivat dhe protokollin;
- c) të mbajë korrespondencën private të Kryesisë dhe të përmbajë çdo punë që i përket Zyrës së tij.

Art. 41. – Detyrat e Llogaritarit të Përgjithshëm janë:

- a) të zbatojë urdhërat e Sekretarit të Përgjithshëm për sa u përket të ardhurave dhe të prishurave;
- b) të përkujdeset për zbatimin e plotë të buxhetit.
- c) të jetë në dispozitë të Këshillit Mikst dhe të Këshillit Ekonomik të Përhershëm për sa u përket llogarive;
- ç) të mbajë në rregull regjistra dhe dëftesë-pagesat për mungesën e të cilave është përgjegjës;
- d) të jetë në korrespondencë me Dioqezat për sa i përket buxhetit;
- dh) të lëshojë dëftesë-pagesat në bazë të vendimeve të Këshillave përkatëse. Dëftesë-pagesat duhet të jenë të nënshkruara prej tij dhe prej Kryepeshkopit. Gjithashtu nënshkruhen prej tij dhe prej Kryepeshkopit urdhër-pagesat ose urdhër-marrjet.

Art. 42. – Kopisti ekzekuton të gjitha urdhërat që merr prej Kryesekretarit.

Art. 43. – Të gjithë funksionarët e Kishës janë të detyruar të punojnë sipas orarit të zyrave qeveritare.

Art. 44. – Arkëtari inkason të ardhurat dhe paguan me mandat-pagese si më sipër.

Art. 45. – Për shkak mospërmbushjeje detyre, autoritetet kompetente për emërimin e tyre kanë të drejtë të përdorin më parë qortimin, pastaj gjobitjen me një pjesë të rrogës dhe më në fund pushimin prej pune.

KAPTINA VIII PAGESAT FAKULTATIVE

Art. 46. – Pagesat fakultative shkojnë në Arkën e Përgjithshme të Kishës. Peshkopët janë përgjegjës për mbledhjen e pagesave fakultative.

Për të përmbushur sa më mirë dhe në mënyrën më efektive këtë detyrë, këta do të jenë në bashkëpunim me Pleqësitë Kishtare të Qendrave si dhe të katundeve.

Art. 47. – Pagesat fakultative do të paguhen prej çdo Ortodoksi të Krishterë të martuar.

Art. 48. – Pagesat fakultative do të jenë një gjer më pesë fr. ari. në mot.

Klasat e komunitetit ortodoks që paguajnë janë: e para, e dyta, e treta. Përveç këtyre, Këshillat Kishtare caktojnë dhe një klasë nderi. Klasa e parë paguan pagesë fakultative pesë fr.ari, klasa e dytë dy franga ari dhe e treta një fr. ari.

Klasa e nderit paguan sipas dëshirës.

Art. 49. – Klasat e ndryshme caktohen prej Pleqësive Kishtare, të cilat i dërgojnë përfundimin Këshillit Ekonomik të Përhershëm.

Art. 50. – Pagesat mbliidhen prej klerikësh ose laikësh që do të caktohen prej Peshkopit. Prej të ardhurave fakultative 10 (dhjetë) për qind i mban Peshkopi dhe 10 (dhjetë) për qind kleriku ose laiku që ngarkohet për mbledhje.

TË NDRYSHME

Art. 51. – Klerikët të çdo grade të cilët ndodhen pa punë dhe që s'kanë mjetet e jetesës së tyre dhe jetojnë duke lypur ose në një mënyrë që cenon dinjitetin e gradës së tyre, dërgohen me vendim të Këshillit Disiplinor peshkopal në një nga Manastiret.

Art. 52. – Manastiret që nuk janë në gjendje financiare të përmbajnë Igumenin dhe t'u bëjnë ballë shpenzimeve të ndryshme, pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme deklarohen me vendim të Këshillit Ekonomik të përhershëm, si pjesë e pandarë e Manastirit më t'afërm.

Art. 53. – Priftërinjtë që janë në shkallë të përdorin gjuhën shqipe në meshë, në rast se nuk konformohen me urdhërat e Kryetarit të Sinodit për përdorimin e gjuhës shqipe në Kishë, pushohen nga shërbimi i tyre administrativisht dhe humbasin çdo të drejtë relative me shërbimin e tyre të gjertanishëm.

Ky pushim bëhet me vendim Kryepeshkopal.

Art. 54. – Psaltët dhe koret, në rast që nuk konformohen me urdhërat e Kryetarit të Sinodit për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë, pushohen menjëherë nga shërbimi i tyre.

Art. 55. – Kjo Rregullore, pas tre vjetësh, mund të modifikohet prej Këshillit Mikst së bashku me Këshillin Ekonomik të përhershëm në konformitet me Statutin.

Art. 56. – Kjo Rregullore i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë për aprovim.

Korçë, 20 korrik 1929

Kryetari i Këshillit për hartimin e kësaj Rregulloreje

Kryepeshkopi Visarion

Anëtarët :

Agathangjel

Ambrosi

Ik. M. Mitr. V. Marko

Av. Ilia Kotta

Vasil Avrami

Thoma Papapano

Dr. Mihal Cane

Kristaq Zaguridhi

Vasil Bakalli

Dr. Zoi Xoxa

Vërtetohet njësia me origjinalin

Durrës, 6-IX-1929

Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Kryepeshkopi.

Vetëm një njohës i shkëlqyer i rregullave kishtare, i përkushtuar për të lartësuar punët fetaro-kombëtare, vetëm një organizator i talentuar mundi të përfshinte në punë vartësit e kualifikuar për të ngritur kolonat e çeliktatë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë: Statutin e përhershëm dhe Rregulloren e Administrimit të Përgjithshëm të Kishës. Ky ishte Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Visarion Xhuvani.

Për hartimin e Rregullores së Administrimit të Përgjithshëm të Kishës kontribut të shquar kanë dhënë dhespotët Agathangjel e Ambros, Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marko, si dhe avokat Ilija Kota, Vasil Avrami, Thoma Papapano, dr. Mihal Cane, Kristaq Zaguridhi, Vasil Bakalli, dr. Zoi Xoxa e në mënyrë të veçantë Kov Deliana. Me punën e tyre të përbashkët më 20 korrik të vitit 1929 u miratua Rregullorja e mësipërme.

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me Sinodin e Shenjtë episkopal, me Statutin Definitiv dhe me Rregulloren e Administrimit të Përgjithshëm përmbushi kërkesat kanonike të Autoqefalisë dhe e meritonte Tomusin e Patriarkanës së Stambollit. Për fat të keq nuk ndodhi kështu, u deshën edhe gati 9 vjet që të ullej zemërimi i Patriarkanës së Stambollit. Gjatë kësaj kohe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, e ngritur mbi themele të shëndosha kombëtare dhe kanonike, eci pa u lëkundur në rrugën që përcaktuan Kongresi i parë historik kishtar i Beratit dhe Kongresi i dytë i Korçës.

Përkrahja e plotë nga populli shqiptar dhe mbështetja shtetërore e kohës u shoqëruan dhe me një hare të paparë ndonjëherë. Vendimet historike që u morën me shkathtësi të pabesueshme prej organizatorëve patën si kundërpërgjigje mosbesimin e plotë të atyre që donin ta shihnin Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë gjithnjë si shtojcë të Kishës greke e të Patriarkanës së Stambollit.

V. ROLI I MBRETIT ZOG NË KRIJIMIN E K.O.A.SH-IT

Kongresi i dytë i Korçës nuk ishte vetëm kurorëzim i dëshirës së hershme të ortodoksëve shqiptarë, por ai pati mbështetje dhe përkrahje nga shteti dhe qeveria shqiptare. Naltmadhnia e Tij, Mbreti i Shqiptarëve Zogu I, dërgoi si përfaqësues të tij në Kongresin kishtar Z. e tij, kolonel Gjilardi, inspektor i ushtrisë mbretërore shqiptare, si dhe përfaqësuesin e Qeverisë, Z. Vasil Bidoshi, anëtar i gjyqit të diktimit për të marrë pjesë në mbledhjet e Kongresit me kompetenca ligjore.

Vlerësim të veçantë i bëri Kongresit Naltmadhnia e Tij, Mbreti Zog I, nëpërmjet letrës që i dërgoi Kryeministrit Koço Kota:

“Zoti Kryeministër!

Mundimet e rrjedhuna prej traditave të gabueshme shekullore, ngatërrimet e nxjerruna prej autoriteteve hyjnore, i përballonte vetëm vullneti i patundun e dashunia që

populli shqiptar ka për lirinë. Më 1922 kur Unë isha ministër i Punëve të Brendshme e Ju prefekt i Beratit iu arrit qëllimit për me u mbledhë Kongresi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat.

Mundimet që Ju hoqët në këtë periudhë, ashtu dhe koha e çmueshme që ju bjerrët me dërgim delegacionesh në Kostandinopol, dhe ma pastaj diskutimet e papërfundueshme me përfaqësuesit e Patriarkanës në Tiranë, janë shembulla e paharrueshme, që kanë hjekë ortodoksët për këtë qëllim.

Tue pa kundërshtimet e randa që u bajshin, Shqipnia, vërtet që nuk kish tjetër rrugë, por o me u përkulë e me hjekë dorë prej një të drejte njerzore që i ka falë natyra, ose me veprue kështu si veproï. Veprimi i bamun asht aq legal dhe i drejtë, si ka qenë edhe në shtete të tjera.

Përveç se janë rrujtun e bamun të gjitha formalitetet kanonike, por asht sovraniteti i popullit që i jep fuqi legale çdo krijimi sado i naltë e i shenjtë që të jetë.

Shteti shqiptar nuk ndahet në Ortodoksë, Katolikë e Myslimanë, por asht një dhe i pandamë, shtet i lirë, nuk ka shumicë e pakicë, nuk ka një fe zyrtare, por të gjitha fetë i mbron e i nderon. Megjithkëtë nuk lejon në asnjë mënyrë e prej kurkujt, që feja të përdoret si mjet cenimi i këtij vllaznimi të një gjaku e të një gjuhe.

Madhëshinë e kësaj vepre do ta ndjejnë gjeneracionet që do të vijnë.

Falenderoj Ju personalisht, Klerin Ortodoks për qëndrimin e tij patriotik, ashtu dhe gjithë shtypin kombëtar, i cili diti të mbrojë tezën e tij.

Zog I

Tiranë 19 qershor 1929

(Marrë nga Gazeta e Re, 20 qershor 1929)

Me vëmendje e ndoqën Kongresin Kishtar të të gjithë ortodoksëve shqiptarë Konsujt e shteteve miq të Mbretërisë dhe të Kishës Shqiptare, Deputetë, Kryetari i Gjyqit, Komandantët e ushtrisë dhe të xhandarmarisë, Kryetari i Bashkisë, Këshilli i Mitropolisë, Epitropët e kishave, gazetatat, trupi arsimor me gjithë nxënësit, si dhe i gjithë populli pa dallim feje.

29 qershori i vitit 1929, dita e mbylljes së punimeve të Kongresit, ishte dita më e hareshme për qytetarët e Korçës. I gjithë tregu ishte mbyllur, para Kinema Luksit parakaluan nxënësit e shkollave. Gëzueshëm jehoi banda e qytetit. Një gëzim i tillë dhe një miratim i njëzëshëm mbretëroi në të gjitha qytetet e vendit, ku u shpreh me entuziazëm në Te Deum-et që u organizuan me pjesëmarrës dashamirë të Kishës Kombëtare Shqiptare pa dallim feje.

Kryesia e Sinodit të Shenjtë me një shpallje të veçantë ftoi të marrin pjesë në Te Deum-in e Kishës së Shën Gjergjit në ora 10:30 qytetarët e Korçës, delegatët e Kongresit, Konsujt e shteteve miq, të deleguarit e Qeverisë dhe autoritetet e larta të vendit që ndodheshin në Korçë. Prej Kishës anëtarët e Sinodit të Shenjtë dhe 12 priftërinjtë me dhjakonët, kongresistët, autoritetet dhe i gjithë populli u kthyen në Pallatin e Mitropolisë, ku në emër të nismëtarit të Kongresit, Kryetari i Sinodit, Fortlumturia e Tij, Kryeepiskop Visarioni përshëndeti të pranishmit. Në emër të Kryesisë së Sinodit të Shenjtë u shpreh besimi i plotë se i gjithë populli i Korçës nuk do të kursehej për të shfaqur solidaritetin dhe entuziazmin me vepra dhe sakrifica të rralla për Kishën e Shenjtë Ortodokse Autoqefale Shqiptare, ashtu si ka vepruar historikisht.

Në darkën madhështore të shtruar për nder të përfundimeve të Kongresit morën pjesë edhe Konsujt e Italisë e të Jugosllavisë, Myftiu e shumë të ftuar. I dërguari i posaçëm i Mbretit, kolonel Gjilardi, duke ngritur gotën përshëndeti Kryetarin e Sinodit të Shenjtë Visarion Xhuvanin dhe gjithë anëtarët e Kongresit: “Në emër të Mbretit tonë uroj dhe lus fatbardhësi të plotë për të gjithë ju dhe për popullin të cilin me meritë të plotë keni fatin e madh ta përfaqësoni” (Gazeta e Re, 2 korrik 1929).

Milto Sotir Gurra në shkrimin e së dielës ka vënë në dukje se veç harmonisë fetare të ortodoksëve të Korçës e të Shqipërisë është edhe toleranca fetare. Në darkë morën pjesë edhe 60 të ftuar bashkë me 46 delegatët. Mbas përshëndetjes së të deleguarit të Mbretit e mori fjalën Fortlumturia e Tij, Visarioni, i cili theksoi rolin e fesë në përparimin e kombit shqiptar. Kisha do të organizohet dhe do të forcohet, do të futet në disiplinë e do të jetë mjet i zhvillimit dhe i lartësimit të Kombit dhe të Mbretërisë.

Më pas ngritën gotën Hirësia e Tij, Myftiu i Korçës M. Mulla për të përshëndetur Kongresin e dytë kishtar të Korçës dhe vendimet e tij: “Ligjet fetare nuk janë krijuar kurrë që të jenë në kundërshtim me ligjet kombëtare. Predikimi në gjuhën shqipe sjell qytetërimin e përparimin dhe çdo komb duhet ta zhvillojë fenë e vet në interesa kombëtare”.

Vënia në dukje e harmonisë dhe e tolerancës fetare ngriti më lart vlerat e Kongresit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Kjo cilësi sublimë shoqëroi gjatë gjithë jetës veprimtarinë e Visarion Xhuvanit dhe të klerit atdhetar shqiptar. Në darkë ishin ftuar prefekti Hilë Mosi, Kryemyftiu, dy Baballarë, gazetarë etj. Në dollinë e tij prefekti Hilë Mosi ngriti gotën për shëndetin e Kryehirësisë së Tij, Visarion Xhuvanit dhe e siguroi atë se Qeveria Shqiptare do ta përkrahë Kishën në realizimin e detyrave fetaro-kombëtare.

Në dollinë e fundit Kryeepiskopi ndër të tjera tha: “Për herë të parë në historinë e përbotshme ngre dolli për lulëzimin e përparimin e Kishës Ortodokse Autoqefale një katolik dhe një kryetar mysliman. Kjo tregon edhe një pikë të naltë që Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare asht institut kombëtar”.

Kongresi i dytë kishtar i Korçës ishte gëzim i madh për të gjithë vendin dhe u miratua nga i gjithë populli shqiptar. Njëpër një u shpreh edhe një herë uniteti vëllazëror midis ortodoksëve, katolikëve dhe myslimanëve. Ai pohoi dhe vërtetoi se shteti shqiptar nuk ndahet sipas besimeve, ai është një i vetëm dhe respekton njëlloj besimet fetare, dënon çdo lloj përçarjeje që mund të vijë për arsye fetare. Kongresi i Korçës u përshëndet nga i gjithë populli sepse vendimet e tij ishin shtylla të patundshme mbi të cilat nuk mbështetej vetëm dogma fetare, por lumturia e gjithë kombit shqiptar, që priste me padurim realizimin e veprës së filluar nga rilindasit tanë dhe më herët për emancipimin dhe të mirën e Atdheut. Është kjo arsyeja që në të gjithë vendin u organizuan Te Deum-e solemne dhe madhështore.

Në dioqezën e Gjirokastrës, në një qark me popullsi myslimane dhe ortodokse, në datën 1 korrik 1929 u organizua një festim i madh për nder të Kongresit kishtar të Korçës. Kremtimit i dha hijeshi të veçantë zbulurimi i qytetit me flamurë kombëtarë, veçanërisht i vendit ku u zhvillua Te Deum-i, në krye të të cilit ishin Episkop Ambrosi, Ikonom Papapavli, Thoma Papapano, Kostandin Lito, delegatë të Kongresit të Gjirokastrës, Libohovës, Delvinës, Sarandës, Konispolit.

Në këtë Te Deum solemn morën pjesë shumë myslimanë dhe greqishtfolës të Dropullit, personalitete të qytetit, si prefekti Zef Kadarea, kryetari i Bashkisë Javer

Rushiti, deputeti myfti Halil Peshkëpia etj. Këta mbushën Kishën dhe mjediset rreth saj. Në fjalën e tyre sekretari i Mitropolisë, prefekti dhe myftiu folën për rëndësinë kombëtare të Kongresit kishtar të Korçës dhe e quajtën atë ngjarje të rëndësishme në historinë e rilindjes kombëtare shqiptare. Kjo ngjarje u quajt prologu i një periudhe të ndritshme kombëtare për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Kongresi pati mbështetje të plotë në të gjitha kishat e krahinës së Himarës, në festimet e të cilave mori pjesë Dr. Mihal Cane, delegat i Kongresit. Jehonë të veçantë pati përhëndetja midis banorëve të fshatit Vuno: “Fshati i Vunoit është veçanërisht i lumtur që u celebrua Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale, ai është i bindur se këtej e tutje do të rregullohet kisha. Bijtë e këtij fshati pa përjashtim e kanë përkrahur këtë çështje, zgjidhja e së cilës u bë sipas dëshirës së të gjithë elementit ortodoks (Gazeta e Re. 13 korrik 1929).

Te Deum-et dhe festimet në dioqezën e Gjirokastrës dëshmuuan se populli ortodoks me gjithë zemër e donte Kishën Autoqefale Kombëtare dhe mbështeti vendimet historike të Kongresit të dytë kishtar të Korçës.

Më 6 korrik të vitit 1929 Episkop Imzot Agathangjeli, Ikonom Atë Theodor Brisku, Ikonom Atë Polizoi, delegatë të Kongresit dhe klerikët e tjerë të dioqezës së Beratit organizuan Te Deum-in madhështor. Edhe në këtë qark pjesëmarrja ishte e jashtëzakonshme. Hapat e parë vendimtarë të Autoqefalisë u hodhën në qytetin e Beratit, prandaj edhe pjesëmarrja popullore ishte shumë e hareshme për festën. Mbas Te Deum-it mësuesi Z. Përmeti lexoi deklaratën me të cilën u përkrahën dhe u përhëndetën vendimet e Kongresit kishtar të Korçës. Nga ky Te Deum iu dërgua një telegram urimi Kryepiskopit Visarion, në të cilin u shpreh gëzimi shpirtëror për Kongresin e Korçës si një vepër e shenjtë kishtarë. Me këtë veprim u tregua hapur para botës se ndërhyrjet fanariote për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë nuk mund të duroheshin më.

Kisha e Shën Marisë në Elbasan dhe mjediset e jashtme të saj nuk kishin parë ndonjëherë kaq shumë njerëz për të marrë pjesë në Te Deum-in madhështor. Brenda në Kishë për të ndjekur Te Deum-in zunë vend paria vendore, delegatët e Kongresit Kostaq Cipo, Kov Deliana, Dhimitër Papajani, Taq Buda delegat i Shpatit. Mbas lutjeve kishtarë foli arsimtari i nderuar i qytetit, Vasil Llapushi. Ndër të tjera ai tha: “Vepra të tilla përparimtare bahen në hijen e lirisë që mbretnon në Shqipëri dhe sigurohen nga N.M. Tij Mbreti Zog”. Urimet e personaliteteve pjesëmarrëse dhe të të gjithë të pranishmëve i priti Imzot Eugjeni.

Në këtë gëzim dhe miratim të Kongresit të Korçës mori pjesë edhe peshkopata e Kishës Shqiptare të Bostonit. Ajo e uroi Qeverinë Mbretërore me këtë telegram: “Peshkopata e këtushme i shfaq Qeverisë Mbretërore gëzimin e saj për mbrojtjen që i dha zgjidhjes së çështjes kishtarë ortodokse dhe shpreson edhe në zhdukjen e përçarjes së shkaktuar nga nëpunësit e saj këtu”

Administrator Protopap Kondili, Chariman Kristo Kirka

Kryeministri Koço Kota në emër të Qeverisë i ktheu këtë përgjigje: “Në emër të Qeverisë që kryesoj Ju falenderoj për ndjenjat e sinqerta që shfaqni, duke ju siguruar se Qeveria nuk bëri gjë tjetër, përveç se realizoi një nga pikat e Idealit Kombëtar dhe do të vazhdojë pa pushim për plotësimin e çdo qëllimi të shenjtë, që lartëson prestigjin e shtetit dhe siguron mbarëvajtjen e Kombit” (Gazeta e Re, 26 korrik 1929).

Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Visarion, i erdhi ky telegram nga Bostoni: “Imzot Visarionit, Tiranë.

Kisha Shën Trinia dëshiron të jetë në juridiksionin e Kishës Autoqefale të Shqipërisë dhe nëse pranohe mi lajmëroni telegrafisht. Përgjigja është e paguar. Jemi kundër Peshkopatës së këtushme se s'ka lidhje me Kishën Shqiptare”

Për komisionin Kristo Josef

Boston 25.10.1930”.

Kryesia e Kishës Ortodokse Shqiptare iu përgjigj telegramit të tyre shkurt dhe qartë:

“Pranojmë. Përgëzojmë. Bekojmë. Shkruani.

Kryeepiskopi i Shqipërisë

Visarioni

Tiranë 30.10.1930” (marrë nga revista Kisha Kombëtare, N. 15, 9 nëntor 1930, faqe 4).

Kisha Kombëtare Autoqefale ishte në rrugë të drejtë dhe të gjitha vendimet e Kongresit të parë kishtar të Beratit dhe të dytë të Korçës jo vetëm mbështeteshin kanonikisht, por ato u miratuan edhe nga mbarë populli shqiptar. Kjo i dha krahë parisë së saj të ecte me hapa të sigurtë drejt modernizimit dhe përkrahjes prej patriarkanave të tjera evropiane dhe ballkanike.

Në Shqipëri veprimtaria kishtarë e Sinodit të Shenjtë dhe e të gjithë klerikëve ortodoksë u mbështet fuqishëm e me entuziazëm nga të gjithë shqiptarët në Te Deum-et e organizuara në të gjitha dioqezat dhe në kremtimet e kishave të veçanta të fshatrave.

VI. SI REAGUAN GREKËT KUNDËR AUTOQEFALISË SHQIPTARE

Këtë ndjenjë gëzimi, këtë entuziazëm të shpalljes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare fletorja greke “Eleftheron Vima”, organ i Venizellos, më datën 5 shtator 1929 e paraqiti me ngjyra të zeza dhe mohoi punën e atdhetarëve shqiptarë, duke e quajtur Visarionin aventurier dhe pseudopeshkop, që ka vepruar sipas tyre kundër kanoneve të Kishës Ortodokse dhe e ka shkëputur Kishën Shqiptare që ishte në juridiksionin e Patriarkanës Ekumenike. Z. Koço Kota kjo gazetë e ka quajtur si njeriun që nuk zbatoi Akordin e vitit 1926 të miratuar nga Eksarku Krisanthos për caktimin e episkopëve shqiptarë, për qeverisjen dhe ndarjen e Kishës, për shpalljen e Autoqefalisë dhe për dërgimin e Tomusit sipas zakonisht.

Të gjitha veprimet që gjetën një miratim të gëzueshëm dhe mbarëpopullor u quajtën prova të shfaqjes së nacionalizmit të flaktë, të shpirtit të pabindur të Shqipërisë së atëhershme (është fjala për vitin 1929), veçanërisht të metodave oligarkike tiranike të myslimanëve të Tiranës, të cilët drejtojnë shtetin e përbërë prej shumë racash e fesh të ndryshme, shtet që nga dita në ditë po bëhet më i guximshëm. (A.Q.Sh. F 251. D. 850. kutia 251)

Nuk mjaftoi ky shkrim, por për të denigruar dhe demaskuar punën e patriotëve shqiptarë, shovinistët grekë vunë në veprim andartët në kufirin greko-shqiptar, të cilët me propagandën e tyre vorioepirote vepruan edhe kundër Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. (A.Q.Sh. Fondi 151. dosja 323. kutia 9. xhaketa 410. viti 1929). Për këtë lëvizje dhe ndërhyrje të hapur Ministria e Punëve të Jashtme iu drejtua me notë verbale Legatës së Qeverisë Greke në Tiranë. Për të gënjer besimtarët ortodoksë të kolonive shqiptare në Greqi, Amerikë, Rumani, Egjipt u angazhuan klubet vorioepirote. (A.Q.Sh. Fondi 151. kutia 60. xhaketa 389-399, viti 1929)

Më i rëndë është rasti i ndërhyrjes të konsullit grek në punët e brendshme të vendit tonë në Sarandë. Për këtë ka pasur korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Shqipërisë. (A.Q.Sh. fondi 151, dosja 345, kutia 10, xhaketa 431, viti 1929)

Këto veprime e shumë të tjera që pasuan më vonë nuk mundën ta kthejnë nga rruga e nisur të gjithë ortodoksën shqiptare, e cila u gëzua bashkarisht sepse gjithnjë e më shumë ata ishin bindur se anija e Kishës Ortodokse në përpjekje me tallazet e ndikimet e huaja dhe e lënë pa zot, pa udhëheqës, tashmë ka hyrë në limanin e organizimit dhe të zhvillimit Apostolik dhe Kombëtar. (revista Kisha Kombëtare. N. 15, 9 nëntor 1930. faqe 3)

Vetëm njerëzit puthadorë të Patriarkanës Ekumenike dhe greke nuk morën pjesë në gëzimin e përbashkët të shpalljes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare, e cila i ka plotësuar me kohë të gjitha kushtet kanonike. Në dokumente dhe në zbatimin e tyre nuk ka asnjë cenim të vogël për të gjitha kanonet e shenjta të Kishës Ortodokse.

Autoqefalia shqiptare i ka plotësuar të gjitha këto kushte:

-Është shpalluar në një shtet sovran e të lirë.

-Ka pasur Sinod të Shenjtë episkopal me episkopë kanonikë.

-Kisha ka funksionuar mbi bazën e një Statuti të përhershëm dhe të një Rregulloreje për administrimin e brendshëm të miratuar njëzëri nga delegatët e Kongresit kishtar të Korçës dhe të përcaktuar dhe të miratuar nga të gjithë ortodoksët shqiptarë.

-Është drejtuar nga Sinodi i Shenjtë Episkopal dhe nga klerikë e laikë të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe demokratike nga të gjithë banorët e dioqezave, pleqësive, epitropive.

-Është e pajisur me literaturën liturgjike të përshtatshme shumë kohë përpara vitit 1929, nga vitet 1866-1884 nga Kostandin Kristoforidhi, në vitet 1914 nga Noli e më vonë nga Sinodi i Shenjtë. Për këtë literaturë kishtarë nuk ka pasur asnjë lloj kritike apo mosaprovimi.

-Është seminari priftëror për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm, si edhe revista për propagandën fetare.

-Pasuritë e tundshme dhe të patundshme administrohen mirë dhe vetëm për qëllime fetare nga Këshilli Mikst.

Të gjitha këto janë të mjaftueshme për të bindur dhe ndriçuar mendjen e çdo shqiptari ortodoks e atdhetar për drejtësinë e vendimeve të Kongresit të dytë kishtar të Korçës.

Me gjithë pengesat jo të vogla, të cilat filluan nga jashtë dhe u shumuan edhe nga brenda prej atyre që nuk i çmuan vlerat fetaro-atdhetare të veprimtarisë kishtarë të Sinodit të Shenjtë të drejtuar nga Visarion Xhuvani, shqiptarizimi i Kishës eci çdo ditë e më mirë. Këtë e ka paraqitur Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në komunikatën e përkujtimit të trevjetorit të mbledhjes së Sinodit të Shenjtë, në të cilën ndër të tjera është shkruar: “Veprat dhe përparimet kryesore që i ka ba K.O.A.Sh-i mbrenda vitit të dytë të stabilitetit të saj nën drejtimin e Sinodit të Shenjtë të kryesuem prej Kryepiskopit Imzot Visarionit, me ndihmën e Perëndisë, të Mbretit dhe të gjithë dashamirëve të misionit të shenjtë social-shpirtnor dhe patriotik, janë këto:

1-U botue libri i gjithë shërbimeve të shenjta për çdo nevojë fetare të popullit, si dhe mesha e shenjtë me të gjitha pjesët e mëngjesorit dhe mbramësore.

2-U botue Ungjilli i madh, i ndamë në 365 pjesë të përditshme.

3-U botue Apostulli (letrat dhe veprat e Apostujve), i ndamë në 365 pjesë të përditshme sipas Rregullores së Ortodoksisë.

4-U botue libri i të Kremteve të mëdha (përmbledhja e 12 librave të të Kremteve të çdo mueji).

5-U botue libri i Shërbesës së Vojit të bekuem.

Këto botime plotësojnë nevojat e klerikëve për të krye të gjitha shërbesat fetare dhe e shkëputin Kishën nga influenza e randë e Fanarit dhe përdorimi i gjuhës së huej, sepse ato janë ma afër dhe ma të kuptueshme për ta”.

Ndër të tjera në këtë komunikatë është theksuar se çdo gjë që është bërë gjatë këtyre vjetëve, është bërë me shumë mundime e sakrifica. Komunikata përfundon me vlerësimin e punës së Visarionit për shqiptarizimin e kishës dhe për përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha shërbesat kishtarë ortodokse. Futja e gjuhës shqipe në veprimtaritë e përditshme të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë shënoi shkëputjen e plotë të Kishës nga ndikimi shumëvjeçar i Fanarit dhe i Kishës greke (revista Kisha Kombëtare, Nr 4, 17 gusht 1930). Kështu u realizua aspirata e hershme e besimtarëve shqiptarë për t’u lutur e për të shprehur kulturën e tyre kombëtare në gjuhën e ëmbël amtare shqipe.

PËRPFJEKJET PËR FUTJEN E GJUHËS SHQIPE NË LITURGJINË E KISHËS SHQIPTARE

LITURGJIA SHQIPE NGA PAL ENGJËLLI TE DHASKAL TODRI

Si erdhën librat e Shenjtë dhe fjalët e Zotit në trojet shqiptare? Kush janë përkthyesit e këtyre librave dhe në ç’kushte historike nisën të përdoren këto libra në veprimtarinë kishtare të popullit shqiptar? Në letërsinë shqiptare të shek. XII-XVII vend të veçantë ka pasur tema fetare, e cila u trajtua dhe u lëvrua në kohën kur kleri katolik udhëhiqte edhe veprimtarinë arsimore. Në ato kohë ka pasur kundërshtime të ashpra midis dy besimeve kristiane, katolicizmit dhe ortodoksisë, si edhe ndaj islamizmit të përhapur nga Perandoria Osmane. Në këto kushte nisën edhe përpjekjet këmbëngulëse për ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, si tipar themelor i identitetit etnik të popullit shqiptar.

Kisha katolike me qendër në Vatikan, për të penguar përhapjen e protestanizmit në Shqipërinë e Veriut dhe për ta mbrojtur atë nga islamizimi që shtoej çdo ditë e më shumë prej administratës osmane, pranoi që në meshë të përdorej veç latinishtes edhe gjuha shqipe. Në gjuhën shqipe të kohës është shkruar formula e pagëzimit që përpara shekullit XV.

Pal Engjëlli (1417-1469) është një figurë shumë e rëndësishme politike e shoqërore e kohës së Skënderbeut. Si Kryepeshkopi i Kryepeshkopatës së Durrësit ai kishte vendin më të nderuar në hierarkinë klerikale të kohës. Ai ka udhëzuar dhe këshilluar që ritet fetare të bëheshin brenda rregullave kanonike kishtare. Më 8 nëntor të vitit 1462 në kishën e Shën Trinisë të Peshkopatës së Lezhës, u mbledh Sinodi i Shenjtë i Kryepeshkopatës, që nëpërmjet letërqarkores udhëzonte priftërinjtë në kisha dhe familjarët në shtëpi lejohen të pagëzojnë në raste tepër të veçanta fëmijët e porsalindur, duke thënë në gjuhën shqipe këtë formulë gjatë ceremonialit të pagëzimit: “Unë të pagëzoj në emër të atit, të birit e të Shpirtit të Shenjtë”.

Kjo shprehje kishtare ka rëndësi të madhe, sepse trojet shqiptare përfshiheshin brenda Perandorisë Osmane. Pagëzimi gjatë ceremonialit në shtëpitë e shqiptarëve ka ndikuar në ruajtjen e krishterimit të tyre në kushtet e rënda historike.

Përhapja e formulës së thjeshtë të pagëzimit nëpërmjet kësaj letërqarkoreje ka rëndësi dhe vlera të veçanta: Me këtë Pal Engjëlli njësoi në të gjitha kishat dhe në familjet e shqiptarëve përdorimin e një formule të vetme pagëzimi në gjuhën shqipe të

vendit, duke mënjanuar formulat e tjera në gjuhë të huaja ose formula pagëzimi të gabuara.

-Ai u preu rrugën ndikimeve të huaja jo vetëm gjatë ritit të pagëzimit, por çeli edhe udhën për përdorimin e shqipes së shkruar në bazë të gjuhës së folur të popullit shqiptar.

-Ai dha në mënyrë të prerë porosinë që t'i pagëzonin të porsalindurit vetëm me këtë formulë dhe ceremoniali të bëhej në gjuhën shqipe.

-Kjo formulë të përdorej në çdo pagëzim gjithnjë dhe në mënyrë të pandërprerë, duke kaluar brez pas brezi në shekujt pasardhës.

-Ai e shkroi këtë formulë në shqipen e dialektit të veriut dhe me alfabetin latin, duke shënuar me largpamësi një ngjarje të shënuar kulturore për popullin shqiptar.

-Pal Engjëlli u preu rrugën jo vetëm kishave të huaja, por edhe çdo shteti tjetër që të mos ndërhyjnë në punët e brendshme të kishës shqiptare. Ai kundërshtoi hapur propagandën e brendshme dhe qëllimet e mbrapshta të çdo kishe e të çdo shteti tjetër ndaj popullit shqiptar dhe vendit të tyre. Pal Engjëlli është i pari personalitet i shoqërisë shqiptare dhe i kishës së krishterë që hodhi farën e mbarë për lëvrimin e gjuhës shqipe edhe në veprimtarinë e tjera shoqërore e kulturore të shqiptarëve. Ai është pararendësi i asaj pune të mëvonshme që u bë gjatë shekujve nga klerikët e laikët e tjerë në dobi të kishës dhe të çështjes kombëtare.

Dokumentimet e shkrimit në gjuhën shqipe vinë më të plota me **Gjon Buzukun (1555)**, i cili na ka lënë “Mesharin”, ku janë përkthyer në gjuhën shqipe pjesë të ndryshme liturgjike për shërbesat fetare. Këto kanë qenë përpjekjet e para që u bënë për të përdorur gjuhën shqipe në kishë. Me kalimin e kohës këto përpjekje u zgjeruan dhe u shumëfishuan.

Pjetër Budi (1566-1622) i avancoi përpjekjet e tij me ide të tjera për çështjen e përdorimit të shqipes në liturgjinë fetare. Ai i ka lidhur këto përpjekje iluministe të kohës me veçimin e Shqipërisë dhe të Ballkanit nga Perandoria Osmane. Për të arritur këtë synim të rëndësishëm kombëtar ai kërkoi edhe bashkëpunimin me shqiptarët myslimanë të asaj kohe. P. Budi nuk kishte besim në veprimtarinë e prelatëve të huaj, në dëshirën e tyre për të vepruar në të mirë të vendit e të kombit shqiptar. Ai ata i shihte si vegla të qarqeve të huaja, që vepronin në trojet shqiptare. Me këto pikëpamje Budi në vitin 1622 organizoi një mbledhje të klerikëve katolikë shqiptarë për të vendosur që mbas kësaj kohe të mos pranonin asnjë peshkop me kombësi të huaj.

Kjo pikëpamje e tij u rishfaq fuqishëm edhe pas 307 vjetësh, kur zuri vend dhe u zyrtarizua në Statutin e Përhershën (Definitiv) të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të vitit 1929, që u miratua në Kongresin e Dytë Gjithortodoks Shqiptar të Korçës (më 16 qershor të vitit 1929).

Vepra e parë e P. Budit është “Doktrina e krishterë”, një katekizëm i përkthyer shqip bashkë me disa (dhjetë) vjersha fetare (botuar së pari në vitin 1618 dhe ribotuar në Romë më 1636 dhe 1664). Në vitin 1621 P. Budi botoi veprën e dytë “Rituali roman” dhe pastaj “Pasqyrën e të rrëfyemit”, që janë përkthime fetare në gjuhën shqipe. Që në këtë kohë P. Budi ka ngulmuar që gjuha shqipe të futej mirë në praktikën fetare. Gjuha shqipe e veprave të P. Budit është gegërishtja e mesme me ndikime të gegërishtes veriore të trojeve shqiptare.

Frang Bardhi (1606-1643) është i pari autor shqiptar që arriti ta kurorëzojë traditën e deriatëhershme të përkthimit në gjuhën shqipe me hartimin e të parit fjalor të mirëfilltë dygjuhësh të leksikografisë shqipe në vitin 1635: “Fjalor latinisht-shqip”.

Pjetër Bogdani (1625-1689) botoi në vitin 1685 veprën origjinale “Çeta e profetëve”, në parathënien e së cilës kërkoi prej bashkatdhetarëve ta ruanin e ta lëvronin gjuhën shqipe si mjetin kryesor të shprehjes kulturore të popullit shqiptar.

Veprat e letërsisë së shkruar të autorëve tanë të periudhës së vjetër, që trajtojnë në radhë të parë temën fetare, shënojnë njëkohësisht brezin e parë që u përpoq për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, që është tipar themelor për ruajtjen e identitetit etno-kulturor të popullit shqiptar.

Jul Variboba (1724-1788), poet arbëresh i shek. XVIII nga Mbusati (San Giorgio Albanese) i Kozencës në Kalabri (Italia Jugore), ka shërbyer disa kohë si prift në fshatin e vet të lindjes. Në Romë kaloi vitet e tjera të jetës, ku më 1762 botoi vëllimin poetik “Gjella (jeta) e Shën Mërisë Virgjër”, poemë e gjatë në dy pjesë bashkë me një tufë vjershash. Subjekti fetar i kësaj vepre është larguar mjaft nga tradita kishtare e paraqitjes së figurave biblike, të cilat J. Variboba i ka përkthyer si njerëz të zakonshëm në mjedise vallesh e vajesh të ngjashme me ato të poezisë popullore arbëreshe. Kjo vepër e Jul Varibobës është një ndër veprat e para artistike të poezisë shqiptare të shkruar në variantin e arbërishtes në shek. 18. J. Variboba është përfaqësuesi kryesor i letërsisë së vjetër arbëreshe që lëvroi temën fetare për qëllime kishtare dhe mësimore.

VEPRIMTARIA E KLERIT ORTODOKS PËR SHQIPTARIZIMIN E KISHËS DHE PËR PËRDORIMIN E GJUHËS SHQIPE NË LITURGJITË FETARE

1.PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË E BESIMTARËVE SHQIPTARË PËR SHQIPTARIZIMIN E KISHËS.

Ortodoksët atdhetarë shqiptarë për një kohë të gjatë janë ndeshur me vështirësi të ndryshme, të cilat kanë penguar futjen e gjuhës shqipe në liturgjinë kishtare. Trysnia islamizuese ndaj popullit shqiptar është rritur deri në shkallën e vënies në rrezik edhe të vetë identitetit kombëtar të shqiptarëve. Metodot imponuese kanë qenë edhe në trajtën e privilegjeve për ata shqiptarë që ndërronin besimin, shpesh të shoqëruara edhe me tryzni administrative dhe me ndëshkime të rrepta për ata që bënë përpjekje për shkrimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe. Megjithatë shqiptarët i kanë ruajtur shumë emërtime fshatrash që lidheshin me shenjtore të ndryshëm në shumë krahina të vendit të tyre. Disa festa e kremtime të besimtarëve ortodoksë shqiptarë kanë mbetur të paprekura. Kriptoortodoksia e banorëve shqiptarë të krahinës së Shpatit në afërsi të qytetit të Elbasanit dëshmon më së miri ruajtjen e besimit ortodoks në këtë trevë të Shqipërisë së Mesme.

Të rënda kanë qenë edhe ndërhyrjet shoviniste të shteteve fqinje, të cilat shkuan edhe deri në mohimin e kombësisë shqiptare, duke i quajtur të gjithë ortodoksët shqiptarë si popullsi greke, kryesisht për shqiptarët e jugut. Ideja e “Epirit të Veriut” u shoqërua me domosdoshmërinë e përdorimit të gjuhës greke në kishë, duke e cilësuar greqishten si të vetmin mjet gjuhësor për të komunikuar me Zotin. Shovinistët grekë mohuan në mënyrë të prerë aftësitë dhe mundësitë e gjuhës shqipe për t’u përdorur në

liturgjitë kishtare. Kjo u shoqërua me egërsinë çnjerëzore të veprimtarisë së mitropolitëve dhe të peshkopëve të huaj ortodoksë, të cilët kanë ndëshkuar në mënyrën më barbare ata shqiptarë që guxuan të përdornin gjuhën shqipe në kishë. Mallkimet kishtare të tyre arritën deri në zhdukjen fizike të bësimitarëve atdhetarë shqiptarë.

Përdorimi i detyrueshëm i gjuhës greke në kishë u shoqërua me veprimtarinë e hapur për greqizimin e disa krahinave të Shqipërisë së Jugut. Ata mbollën edhe farën e keqe të përçarjes së shqiptarëve ortodoksë dhe të shtimit të grindjeve ndërmjet tyre për të arritur shkallë-shkallë në asimilimin etnik nëpërmjet kishës, gjuhës dhe kulturës greke.

Për një periudhë disashekullore (nga shek. XV deri në shek. XIX) shqiptarëve ortodoksë u është dashur të përballojnë dy trysni të fuqishme: islamizimin dhe greqizimin e tyre. Për të përballuar të dyja trysnitë duheshin: ndjenja e fuqishme e atdhedashurisë, shpirti i sakrificës dhe i vetëflimit, niveli i kulturës së lashtë iliro-shqiptare dhe veprimtaria intelektuale për të dhënë në lartësinë e merituar shkrimet e shenjta. Të gjitha këto u bënë ballë trysnive islamizuese dhe greqizuese të shqiptarëve dhe të kulturës së tyre.

2-INSTITUCIONET KRYESORE QË NDIKUAN NË PËRGATITJEN DHE NË BOTIMIN E LETËRSISË KLERIKALE ORTODOKSE NË GJUHËN SHQIPE.

Kreu i Kishës katolike me Papatin në krye lejoi përdorimin e gjuhës shqipe krahas latinishtes në disa shërbesa fetare në Shqipërinë e Veriut. Në shek. IX apostujt Qirili dhe Metodi përkthyen në sllavisht Shkrimet e Shenjta për ta futur këtë gjuhë në shërbesat kishtare. Veprimtaria e tyre u vijua nga Shën Klementi dhe Shën Naumi, të cilët hodhën themelet e gjuhës kishtare në Kishës Ortodokse Bullgare. Në shek. XV Shën Sava përcaktoi shërbesat kishtare që do të kryheshin në gjuhën e popullit.

Të hershme janë edhe përpjekjet e klerikëve shqiptarë për të futur gjuhën shqipe në kishë. Dokumenti më i vjetër është **“Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve”**, e cila i përket shek. XV. Ajo përbëhet nga tri pjesë të ndryshme: 1-pjesë nga ungjilli i Mateut që këndohet të Premten e madhe gjatë shërbesës së Epitafit. 2-urimi “Për shumë vjet o Kryezot” dhe 3- Himni i Pashkëve “Krishti u ngjall”. Ky dokument është gjendur në bibliotekën Ambroziana të Milanos dhe për studiuesit autori i saj ka qenë një prift shqiptar i ritit lindor. Perikopeja është shkruar në dialektin jugor të shqipes dhe me shkronjat greke të alfabetit, duke dëshmuar se shqipja është shkruar si në trojet veriore ashtu edhe jugore shqiptare.

Akademia e Voskopojës dhe Manastiri i Shën Gjon Vladimirit kanë qenë dy qendra kryesore institucionale ku kanë ushtruar veprimtarinë e tyre klerikët dhe njerëzit më të ditur të kohës, të cilët kanë bërë përpjekje të mëdha për futjen e gjuhës shqipe në kishë. Ata përkthyen dhe përshtatën në gjuhën shqipe librat bazë të Kishës, si Dhiata e Vjetër, Dhiata e Re, liturgjitë kryesore që lexoheshin në kishë dhe botime të tjera fetare.

Mbas shkrimit të shqipes dhe përvojës së një letërsie kishtare të shekujve të mëparshëm, kur u përdor kryesisht alfabeti latin, shekulli XVIII e gjeti gjuhën shqipe në një gjendje të ndryshimit të saj të vetëvetishëm si gjuhë që e ka përdorur populli shqiptar gjatë një rrjedhe historike shumëshekullore. Ndikimit kulturor romak iu shtua edhe ndikimi kulturor i Perandorisë Bizantine. Nga shkrimet e vjetra të shqipes u desh të kalohej pas një ndërprerjeje të gjatë kohore në përtëritjen e traditës shkrimore, e cila duhej të ripërcaktonte edhe shkronjat e alfabetit të saj.

Mungesa e një alfabeti për gjuhën shqipe ka qenë pengesë shumë e madhe, prandaj ata që duhej të ringjallnin traditën e shkrimit të shqipes në fushën e botimeve kishtarë përdorën edhe alfabetin grek në shkrimet e në përkthimet e tyre, ashtu siç u përdor alfabeti turko-arab nga klerikët myslimanë. Alfabeti me bazë shkronjat greke nuk i përmbush më së miri që të japë pak a shumë të plotë sistemin e fonemave të gjuhës shqipe, prandaj edhe ndërmorën përcaktimin e alfabeteve të veçanta, siç bëri Teodor Haxhifilipi (Dhaskal Todri).

Murgjit e Manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan me punën e tyre të përkushtuar e mjaft modeste kanë dhënë ndihmesë të shquar për futjen e gjuhës shqipe në kishë. Pas tyre edhe autorë të tjerë janë përpjekur të fusin në liturgjinë fetare gjuhën shqipe. Ndër të hershmit është **Theodor Bogomili**, prift i Shpatit të Elbasanit, vepra e të cilit është quajtur më vonë nga studiuesit me emërtimin Anonimi i Elbasanit. Ky autor ka përkthyer e përshtatur pjesë nga të katër ungjijtë që janë përdorur për nevoja liturgjike. Përkthimi i tij është i lirë në të folmen e Elbasanit. Alfabeti i tij është origjinal me 40 shkronja, ka më tepër shkronja sllave se sa greke. Ky alfabet i vjetër i gjuhës shqipe i përket gjysmës së dytë të shekullit XVIII. Pjesët e përkthyera për predikime fetare kanë tiparet gjuhësore të së folmes së Elbasanit. Gjuha shqipe del me tipare drejtshkrimore mjaft të qëndrueshme. Kjo dëshmon për një traditë të mëparshme shkrimore që autori e ka njohur. Ai ka përdorur një alfabet të posaçëm, i ndryshëm nga alfabetet e mëvonshme origjinale. Alfabeti i Theodor Bogomilit është i pari alfabet origjinal i gjuhës shqipe që njohim deri më sot.

Mitropoliti i Durrësit, Grigori, profesor i Akademisë së Voskopojës, ka qenë klerik me kulturë të gjerë, autor i shumë librave fetarë. Ai ka përkthyer në gjuhën shqipe Dhiatën e Vjetër dhe Dhiatën e Re, ka përdorur alfabet origjinal dhe me këto vepra të tij i është kundërvënë ndikimit të kishës greke gjatë asaj kohe. Përpjekjet e tij për shkrimin në gjuhën shqipe dhe për përkthimet liturgjike janë para dhe pas vitit 1772, kur ka përkthyer pjesë nga Dhiata e Re dhe e Vjetër.

Tjetër klerik i fundit të shek. XVII dhe i fillimit të shek. XVIII është **Nektar Tërpo Voskopojari**, intelektual i shquar i Akademisë së Voskopojës, propagandues i zellshëm dhe njeri i guximshëm, i cili me veprimtarinë e tij iu kundërvu islamizimit të popullsisë ortodokse shqiptare. Ai ka shkruar rreth viteve 1720-1730 librat “Çështje të ndryshme teologjike” dhe më 1732 botoi në Venedik veprën e dytë “Besimi”. Me këto vepra ai ka dhënë ndihmesë edhe për shkrimin e gjuhës shqipe.

Teodor Haxhifilipin (1730-1806) populli e ka quajtur **Dhaskal Todri**. Ai ka lindur në Elbasan, mësimet e para i ka kryer në vendlindje dhe më pas ndoqi Akademinë e Voskopojës. Ka shërbyer si mësues dhe si predikues në kishë. Ka përkthyer në gjuhën shqipe pjesë nga Dhiata e Vjetër dhe e Re si dhe liturgjinë e Shën Joan Gojartit. Kjo e fundit i ka shpëtuar zhdukjes dhe sot ruhet në Arkivin e Shtetit një kopje e mëvonshme e kopjuar nga Haxhi Josifi, igumen i Manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Gjatë viteve 1751-1801 ka mbajtur kodikun e kishës së Shën Marisë në Elbasan dhe më 1750-1751 Kodikun e Argjendarëve të Elbasanit. Me alfabetin e tij përhapi shkrimin e gjuhës shqipe në liturgjinë fetare, por edhe në veprimtarinë ekonomike të tregtarëve elbasanas. Dhaskal Todri e gjallëroi shkrimin e gjuhës shqipe në kohën kur kleri fanariot dhe grek, si dhe administrata e Perandorisë Osmane ndëshkonin me ashpërsinë më të madhe përpjekjet për zgjimin dhe rritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Në Shqipërinë e Mesme dhe jo vetëm në Elbasan është ndjerë më shumë veprimtaria e klerikëve të Manastirit të Shën Gjon Vladimirit, të cilët kanë ushqyer një lëvizje të gjerë atdhetare shqiptare që drejtohej si kundër Perandorisë Osmane, ashtu edhe kundër ndikimeve të klerikëve të lartë grekë, të cilët kanë penguar futjen e gjuhës shqipe në kishë. Dhaskal Todri u shqua për këto qëndrime kryesore: 1. Për pajtimin e klerikëve shqiptarë dhe për forcimin e unitetit midis tyre. Në vitin 1779 mori pjesë në mbledhjen e Voskopojës për pajtimin e peshkopëve të Durrësit, Gorës dhe të Mokrës, të cilët kishin mosmarrëveshje midis tyre. Dhaskal Todri e ka firmosur dokumentin e pajtimit jo si klerik, por si shqiptar atdhetar. 2. Është shquar për përkthimin e librave që përdorehin në kishë. Ai përktheu Dhiatën e Vjetër, Dhiatën e Re, Liturgjinë e Shën Joan Gojartit, librin e Orëve dhe libra të tjerë. 3. Botimet e Dhaskal Todrit janë shkruar me alfabetin e tij origjinal të përbërë prej 53 shkronjash. Dëshira e Dhaskal Todrit që të ngrinte në Elbasan një shtypshkronjë ku të shtypeshin libra në gjuhën shqipe. Me ndihmën e tregtarëve elbasanas dhe voskopojarë shkoi në disa vende të Evropës për të derdhur shkronjat e alfabetit të tij. Gjatë kthimit prej Manastirit, në Dhiavat të Resnjës, u vra nga qiraxhinjtë. Kjo vrasje e fshehtë është lidhur me qëllimet e kishës greke për të zhdukur me agjentë të tjerë të paguar të gjithë ata shqiptarë atdhetarë që përpiqeshin për identitetin e tyre kombëtar.

Dhaskal Todri krijoi një traditë të re të shkrimit të shqipes, e cila u përhap në shkolla dhe në mbajtjen e regjistrave për të dhënat ekonomike të tregtarëve të Elbasanit. Tradita e tij shkrimore në gjuhën shqipe vazhdoi deri në fillimet e shekullit XIX dhe zëvendësoi përdorimin e greqishtes me gjuhën shqipe.

Dhaskal Todri është lëvruar i shquar dhe një nga pararendësit e hershëm të Rilindjes Kombëtare, i cili me traditën e vet shkrimore gjeti mbështetje në mbarë trojet e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut.

Zgjimit të ndërjegjes kombëtare të shekullit XVIII dhe XIX i dha shtysë edhe përpjekja e ortodoksëve shqiptarë për t'u shkëputur nga sundimi i dyfishtë: nga zgjedha e Perandorisë Osmane dhe nga ndikimi nënshtues fanariot. Ky zgjim u fuqizua sidomos me lëvizjen letrare të kohës, me përkthimin e librave liturgjike edhe në qytete të tjera, si në Berat, Gjirokastrë, Janinë etj.

Ikonom Kostandin Berati (1745-1825) ka përkthyer në gjuhën shqipe lutje të ndryshme fetare dhe pjesë ungjillore që u përdorën në shërbesat kishtare, një vjershë me dyzetekatër vargje të titulluar “Zonja Shën Mëri para kryqës”. Ai është hartuesi i dy fjalorëve të vegjël dygjuhësh greqisht-shqip. Përkthimet e tij nuk u përhapën gjerë sepse në trajtën e tyre të dorëshkrimeve ato nuk u arrit që të botoheshin.

Lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse nuk ishte vepër vetëm e klerikëve, por edhe e intelektualëve të shquar të vendit, të cilët më shumë se të tjerët kuptuan dhe e ndjenë zgjedhën e dyfishtë osmane dhe fanariote.

Atëherë mjeku **Vangjel Meksi (1760-1823)** nga Labova e Gjirokastrës, i diplomuar në Itali, në vitin 1814 përktheu dhe botoi ungjillin sipas Mateut, duke përdorur alfabetin grek. Në vitin 1821, i nxitur nga komuniteti shqiptar i Vjenës, ai përktheu Dhiatën e Re. Këto përkthime u mbikqyrën dhe u redaktuan nga peshkopi Grigor Gjirokastriti. Përkthimet e V. Meksit shënojnë një shkallë të lartë në arritjet për përdorimin e gjuhës shqipe në tekstet liturgjike e në veprimtarinë e përditshme kishtare.

Bashkëkohësi i Vangjel Meksit, Grigor Gjirokastriti, në vitin 1824 botoi Ungjillin sipas Mateut dhe Dhiatën e Re. Këto përkthime të Dhiatës së Re janë të parat midis

popujve të Ballkanit, dy vjet para përkthimit bullgar dhe gati 20 vjet më përpara se përkthimi në rumanisht.

Më vonë në vitin 1827 botimi i përkthimit të G. Gjirokastritit pati jehonë të madhe tek arvanitasit e Greqisë, të cilët në vitin 1858 e ribotuan në Athinë. Grigor Gjirokastriti, kur ishte mitropolit i Eubesë, përktheu broshurat fetare “Kryqi i Krishtit”, “Jeta e Shën Joan Pagëzorit”, “Ligji i artë” etj.

Një figurë mjaft e shquar e lëvizjes kombëtare shqiptare është **Kostandin Kristoforidhi (1826-1895)**, i cili vijoi denjësisht traditën e krijuar në Elbasan për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë prej pararendësve të tij Anonimi i Elbasanit, Dhaskal Todri etj. Kristoforidhi provoi në teori dhe në praktikë bashkësinë dhe njësinë e gjuhës shqipe në dy trajta themelore dialektore, gegërisht dhe toskërisht dhe njësinë e kombit shqiptar. Veprat shkencore shumë të rëndësishme për gjuhën shqipe janë “Gramatika” (1882) dhe “Fjalori i gjuhës shqipe”, i cili mundi ta shohë dritën e botimit në vitin 1904 në Athinë.

Kostandin Kristoforidhi ka përkthyer Dhiatën e Re, Historinë e Shkronjës së Shenjtë, Psalltirin, Të Bërat dhe të Dalat, Fjalët e urta të Sollomonit dhe Isainë, si edhe pjesë të tjera të Dhiatës së Vjetër. Më 24 shkurt 1895 ai mbylli sytë përgjithmonë në qytetin e lindjes në Elbasan. Gjithë jetën e tij ia kushtoi predikimeve të fjalës së shenjtë, të Ungjillit, i frymëzuar prej idealit të bekuar të shqiptarizmit. Mësimet e larta i bëri në Britaninë e Madhe. K. Kristoforidhi ka hartuar “Fjalorin e gjuhës shqipe”, vepër shumë e rëndësishme leksikografike e gjuhësisë shqiptare. Sipas Kryepeshkopit të Shqipërisë, Visarion Xhuvanit, bashkëqytetarit të vet, Kostandin Kristoforidhi vuri baza të shëndosha për botimin në gjuhën shqipe të librave të shenjtë. Të gjitha përkthimet e tij shquhen nga pastërtia dhe përdorimi i shkëlqyer i gjuhës shqipe. Pjesa më e rëndësishme e tyre kanë kaluar provën e gjatë të kohës. Asnjë kritikë qoftë nga përmbajtja qoftë edhe nga zgjedhja e fjalëve të duhura shqipe nuk është bërë për to. Dhiata e Re është botuar për herë të parë më 1879 në dialektin e toskërishtes dhe është ribotuar më 1911 dhe është kontrolluar më 1929 nga gjuhëtarë e personalitete të shquara të vendit (si A. Xhuvani, Zoi Xoxa dhe prof. M. Sherko), është miratuar nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe është ribotuar më 1930 për t’u përdorur në shërbesat kishtarë dhe në Akademinë teologjike shqiptare.

Ungjilli i përkthyer prej K. Kristoforidhit më 1870 përdoret edhe sot nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Për edukimin fetar të fëmijëve ortodoksë K. Kristoforidhi përktheu përveç Biblës edhe tekste fetare shkollorë si “Historia e Shkronjës së Shenjtëruar” dhe “Katër Katekizmat”. K. Kristoforidhi punoi për Shoqërinë Biblike të Britanisë së Madhe dhe nuk bashkëpunoi me të për përhapjen e protestantizmit në Shqipëri, sepse nuk dëshironte përçarje fetare, e cila do të dëmtonte interesat kombëtarë të popullit shqiptar.

Veprimtaria për përkthimin në gjuhën shqipe të letërsisë kishtarë e vuri K. Kristoforidhin në krye të atdhetarëve të Rilindjes sonë Kombëtare që u përpoqën për shqiptarizimin e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Elbasani me Anonimin, Dhaskal Todrin, K. Kristoforidhin e të tjerë murgj të Manastirit të Shën Gjon Vladimirit e futi gjuhën shqipe në liturgjinë kishtarë dhe përdori në shkrimin e gjuhës shqipe alfabetet origjinale. Veprimtaria e kësaj qendre kulturore kishtarë u përhap në rrethe të tjera të vendit. Korça u dha trojeve shqiptare martirët, dëshmorët dhe shenjtorët e vet, të cilët u masakruan në mënyrë barbare nga

përfaqësuesit e lartë të patriarkanave fanariote dhe greke nëpërmjet mitropolitëve dhe dhespotëve që shërbenin në strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Perandorisë Osmane, me politikën e saj për islamizimin e popullsisë kristiane, iu desh në periudha të caktuara që të mbështeste edhe qëndrime liberalizuese ndaj besimtarëve të krishterë shqiptarë. Pengesat për futjen e gjuhës shqipe në liturgjinë kishtare kanë qenë shumë të mëdha, shpesh të pakapërcyeshme. Ato u shoqëruan me qëndrime mjaft agresive dhe kanë mbetur gjithnjë të pambështetura nga pikëpamja kanonike. Sidomos mitropolitët dhe dhespotët grekë që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre kishtare në Shqipëri janë udhëhequr nga ideja e përparësisë së gjuhës greke në trojet shqiptare dhe në vende të tjera të Ballkanit. Ashtu siç e gëzuan të drejtën e tyre popujt sllavë të Ballkanit e të Evropës që të përdornin sllavishten në liturgjinë kishtare, edhe shqiptarëve nuk u duhej mohuar e drejta e tyre e ligjshme për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë dhe në shkollat e vendit.

Babai i historisë kishtare të krishterimit Eusebi, i cili ka jetuar në shek. IV, na ka lënë këtë porosi shumë të çmueshme: “Se pas ardhjes së Krishtit iu dha gjithë kombeve e drejta të përdorin gjuhë të ndryshme që ka çdo komb (dhe përpara Krishtit) po Perëndia urdhëroi që profecitë të kuptohen nga të gjithë kombet me anën e shpjegimit” (cituar sipas Dh. Bedulit, Gjuha shqipe në kishë, Tiranë 1997, faqe 6).

Për shekuj me radhë nuk janë përmbushur këto fjalë profetike, qëndrimet kundërshtuese morën trajtat e politikave vorioepirote dhe u shoqëruan me mallkime kishtare, me dredhira e pabesira, me ndëshkime të rënda që çonin në zhdukjen fizike me helmime dhe vrasje. I pari shqiptar i njohur që u bë viktimë e zemërimit kishtar është **Dhaskal Todri**, i cili u vra në vitin 1805 kur po kthehej nga Evropa me shkronjat shqipe për të ngritur një shtypshkronjë për botimet në gjuhën amtare. Stërnipi i Dhaskal Todrit, mësuesi i nderuar Vilson Todri, ka shkruar këto kujtime: “Nuk dimë me saktësi ku është vrarë stërgjyshi ynë. Sipas gojëdhanës duhet të jetë vramë në rrethinat e Manastirit, në Dhiavat të Resnjës. Vrasja mendohet të jetë akt i kishës greke. Kisha nuk lejonte shkrimin e gjuhëve jogreke, sidomos të shqipes. Stërgjyshi asht përndjekë edhe pas vdekjes. Me urdhën të Patriarkanës në vitin 1827, në kohën e kolerës, u dogjën të gjitha dorëshkrimet” (marrë nga gazeta “Tirana Observer”, 30 prill 2005).

Fund tragjik ka pasur edhe **Naum Velqiharxhi (1797-1846)**, i cili vdiq i helmuar nga Patriarkana greke, sepse më 1846 botoi “Qarkoren” (Enciklikën), me të cilën kërkoi t’i jepej rëndësi mësimi të gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare. Ai i kërkoi Patrikut Ekumenik që të përktheheshin librat e shenjtë në gjuhën shqipe dhe u bëri thirrje bashkatdhetarëve që të mësonin gjuhën shqipe e të përhapnin dituritë pa pasur dallime fetare.

Petro Nini Luarasi (1865-1911), një nga mësuesit e parë të shkollës shqipe dhe dëshmor i shkrimit të gjuhës shqipe në vitin 1883 u mësoi nxënësve gjuhën e tyre amtare dhe e futi gjuhën shqipe në predikimet kishtare. Kjo veprimtari e armiqësoi shumë si me administratën e Perandorisë ashtu edhe me krerët grekë të kishës ortodokse shqiptare. Mitropolit i grek i Kosturit e shkishëroi dhe e mallkoi. Për këtë veprim antishqiptar të kishës P.N. Luarasi ka shkruar pamfletin “Mallkimi i shkronjave shqip dhe çpërfolja e shqiptarit” dhe poemën “Kundër mallkimit të gjuhës shqipe”, me të cilat zbuloi hipokrizinë e klerikëve të huaj që u shërbenin lakmive të shovinizmit grekomadh. P.N. Luarasi ia çori maskën dhe tregoi fytyrën e vërtetë të Fillaretit, dhespotit të Kosturit, si agjent fanariot në shërbim të shovinizmit grek. Pamfleti i P.N. Luarasi i demaskoi

qarqet fanariote si agjenturë e veprimtarisë së fshehtë të shovinizmit të huaj kundër popullit shqiptar. Për t'i shpëtuar ndëshkimit të pritur prej fanariotëve dhe për të vijuar veprimtarinë atdhetare P.N.Luarasi shkoi në Amerikë. Pas shpalljes së hyrietit më 1908 u kthye në atdhe, megjithatë ai nuk i shpëtoi dënimit të përcaktuar nga ata që nuk e donin. Tre vjet më vonë, më 1911, P.N. Luarasi vdiq i helmuar nga agjentët e Fanarit e të Patriarkanës greke.

Nga fundi i viteve 1880 lëvizja kombëtare shqiptare i kapërceu caqet e lëvizjes kulturore-atdhetare dhe u orientua drejt shkëputjes prej Perandorisë Osmane që po i vinte fundi. Në lëvizjen kombëtare shqiptare mori pjesë edhe mësuesi i ri i gjuhës shqipe, **Kristo Negovani (1875-1951)**. Pasi mbaroi shkollën qytetëse në Athinë shërbeu si mësues në fshatrat Negovan dhe Ballkamen. Për qëllime atdhetare u dorëzua prift dhe filloi të meshojë në gjuhën shqipe duke iu kundërvënë propagandës shkombëtarizuese të shovinistëve fqinjë, të cilët nëpërmjet ndikimit të tyre në kishën shqiptare synonin në radhë të parë helenizimin në gjuhë e në kulturë të besimtarëve ortodoksë shqiptarë. Këto dy institucione të rëndësishme, kisha ortodokse dhe shkolla, duhej të përballonin në thelb qëllimet e mbrapshta për greqizimin e një pjese të rëndësishme të popullit shqiptar. Papa Kristo Negovani mundi me shumë përpjekje të botojë 9 vepra shkollore dhe kishtarë në gjuhën shqipe. Veprimtarinë e vet fetare me ungjillin në dorë ai e shoqëroi edhe me veprimtarinë e shquar kombëtare si publicist për t'u treguar të gjithë shqiptarëve se gjuha shqipe dhe besimi i krishterë nuk janë të lidhur me gjuhën dhe kombësinë greke, se “Zoti, Perëndia nuk ndalon çdo komb që të këndojë në gjuhën e tij”.

Kisha e fshatit Negovan u bë vatër përlëshjesh midis atdhetarëve shqiptarë dhe grekomanëve të shitur të asaj kohe. Më 10 shkurt, ditën e Shën Harallambit, në prani të dhespotit të Kosturit Karavangjeli, Papa Kristoja e mbajti meshën në gjuhën shqipe. Dhespoti i zemëruar doli nga kisha duke mallkuar priftin dhe urdhëroi fshehurazi çetën e andartëve, të cilët brenda 24 orëve vranë 25 veta. Natën e 12 shkurtit të vitit 1905 Papa Kristoja me të vëllanë dhe 4 atdhetarë të tjerë shqiptarë u vranë barbarisht nga andartët e urdhëruar prej dhespotit të Kosturit, Karavangjeli.

Në historinë e shqiptarizimit të kishës kombëtare shqiptare vrasja e Kristo Negovanit shënon fillimin e përpjekjeve të shqiptarëve që u martirizuan për qëndrimet e hapura atdhetare.

Pas shpalljes së hyrietit në vitin 1908 lëvizja shqiptare për çlirimin e vendit hyri në fazën e saj përfundimtare. **Mihal Grameno (1871-1937)** ka qenë ndër më aktivët që ndezën luftën atdhetare me botimin e gazetës “Lidhja Ortodokse” dhe me vepra të tjera. Ata e vunë theksin për çlirimin e vendit dhe për demaskimin e pikëpamjeve dhe të veprimeve shoviniste të shteteve fqinje. Midis tyre më i rrezikshmi ishte shovinizmi grek, që udhëhiqej nga politika e megaliidesë. Synimi i tyre për ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe në liturgjinë kishtarë ishte i papranueshëm nga shumica e intelektualëve shqiptarë.

Në artikujt publicistikë M.Grameno kërkoi pavarësinë nga Patriarkana Ekumenike dhe meshimin në gjuhën shqipe në të gjitha kishat e vendit. Në tetor të vitit 1909, në emër të ortodoksëve shqiptarë, në artikullin “Të naltit Shenjtërisë së tij, Joaqimit III, Patrik Ekumenik” M. Grameno kërkoi hapur që të lejohej gjuha shqipe në kishë. Për këtë qëllim dhe ideal kombëtar të shqiptarëve dhanë jetën dëshmorët e parë shqiptarë si Papa Kristo Negovani, Spiro Tola, Papa Vasili, Papa Thanasi etj:

“Në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit të Shenjtë, mjaft i naltë shenjtor! Britma e ortodoksëve arriti gjer në qiell! Gjakrat, vajet, vrasjet, të gjitha të këqijat e përditshme midis vëllezërve kapërcyen çdo kufi”. Në vitin 1909 në gazetën “Lidhja Ortodokse” u përshkruan meshimet në gjuhën shqipe nga F. Noli në Amerikë dhe nga Arkimandrit Harallamb Ballamaçi në Rumani. Mbajtja e meshës së parë në gjuhën shqipe u quajt ditë historike. Ashtu si Sinodi i Shenjtë i Rosisë dhe i Rumanisë dhanë bekimet e tyre, po kështu u shpresua që edhe Patriku do të jepte bekimin e vet që të meshohej shqip në kishat shqiptare. Por Patriku i Stambollit jo vetëm që nuk e dha bekimin në atë kohë, por nxiti peshkopët dhe mitropolitët për të penguar e për t’i luftuar të gjithë ata klerikë që do të meshonin në gjuhën shqipe.

Në numrin 3 të datës 17 gusht 1909 “Lidhja Ortodokse” publikoi dialogun e **Papa Llambros** nga Berati me dhespotin për çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe në meshë: “Ne tani u ndërgjegjësuam si Apostull Pali dhe kërkojmë që të na jepet Ungjilli në përdorimin e gjuhës sonë ashtu si Arabët, Rusët, Bullgarët, Serbët e Rumunët”.

Po kjo gazetë në Nr.5, tetor 1909, në artikullin “Të naltit shenjtëri Joaqim III, Patrik Ekumenik” jep dëshmorët e shqiptarizmit si Papa Kristo Negovanin etj, 4 vrasje që u bënë brenda 6 muajve: Spiro Tola, Papa Vasili, Papa Thomai, që u vra në kishë. Në fshatin Progër një i vdekur mbeti pa u varrosur, sepse kishte kërkuar në gjallje të tij që t’u jepej e drejta shqiptarëve një orë e më parë.

“Një ditë historike” është titulli i artikullit të botuar në N.8, datë 17 nëntor 1909. “Historike do të mbetet dita e parë e vjeshtës së vitit 1909. Në këtë ditë prifti ortodoks, i bekuari Harallamb nga Berati, në kryeqytetin e Rumanisë meshoi për herë të parë në gjuhën e bukur dhe të ëmbël shqipe, duke lavdëruar Perëndinë dhe Zotin Jesu Krisht. Ky sihariq u përhap në Shqipëri dhe në gjithë botën. Sinodi i Rosisë që ka 100 milionë ortodoksë dhe ai i Rumanisë dhanë bekimin e tyre.

Nuk duhet t’u besohet fjalëve të disa shqiptarëve që nuk e duan gjuhën shqipe. Kemi besim se Patriku do të japë bekimin e tij”.

Me dhimbje të thellë dhe hidhërim të madh dha lajmin e kobshëm të varrosjes së priftit **Vasil Negovani** “Lidhja Ortodokse” në Nr. 12 të datës 27 janar 1909: “Më 16 të këtij muaji në moshën 27 vjeçare, i goditur me temjanicë në kishë dhe i burgosur, vdes Atë Vasili. Pse predikoi shqip e goditën në mes të kishës me temjanicë. Shqiptarët e Manastirit, ortodoksë dhe myslimanë, mbi 1500 veta e përcollën në varr. 7 kurora me lule u vunë mbi varr”.

Përpjekjet e besimtarëve atdhetarë shqiptarë, të cilët u ngritën për të mbrojtur gjuhën shqipe dhe për ta futur atë në liturgjinë kishtare frymëzuan Mihal Gramenon për të shkruar novelën “Varri i Pagëzimit”. Kjo vepër letrare akuzon hapur klerin dhe kishën greke si forca shkombëtarizuse që veprojnë kundër popullit shqiptar.

Martir tjetër që iu përkushtua çështjes kombëtare shqiptare dhe kishës ortodokse është **Atë Stath Melani**. Ai u bë prift në Amerikë në vitin 1899. Kur u kthye në atdhe u përfshi në lëvizjen kombëtare shqiptare dhe demaskoi shovinizmin grek dhe administratën osmane. Kur dhespoti grek e qortoi se kishte meshuar në gjuhën shqipe, Atë Stath Melani iu përgjigj: “Hirësi, shqiptarët merren vesh me Perëndinë më mirë dhe më shpejt me shqipen se sa me greqishten”. Mallkimit të peshkopit iu përgjigj: “Do t’ju jem mirënjohës, hirësi, të më dërgoni në skëterrë, pasi atje nuk do të kem zotërinë tuaj, e kështu do të më lini të qetë së paku atje”.

Atë Stath Melanin e vranë dhe e masakruan bandat greke më 24.12.1917 brenda në fshatin e tij. Atëherë gazeta “Albania” (Nr. 4, 16.III. 1918) shkroi: “S’ka zemër shqiptari që të mos pikëllohet, s’ka sy shqiptari që të mos lëshojë lot për të pavdekshmin hero dhe dëshmor të madh të Shqipërisë, Atë Stath Melanin”.

Kërkesat për përdorimin e gjuhës shqipe në meshën kishtare kanë nisur që herët, ato morën hov në vitin 1850 dhe përsëri në mes të shekullit 19 u rritën edhe më shumë. Për Kishën Ortodokse Shqiptare janë vendimtare vitet 20-30 të shek. 20, kur u krijua Sinodi i Shenjtë i saj dhe u miratua Statuti përfundimtar (definitiv). Për të përballuar pengesat e shumta besimtarët ortodoksë shqiptarë nuk u trembën nga përndjekjet, helmimet dhe vrasjet. Historia e kishës shqiptare ka martirët e vet dhe shumë njerëz të shquar që iu përkushtuan idealeve atdhetare, duke nisur me Anonimin e Elbasanit, Dhaskal Todrin, Vangjel Meksin, Naun Veqilharxhin, Kostandin Kristoforidhin, Petro Nini Luarasin, Papa Kristo Negovanin, Atë Stath Melanin etj.

Në kolonitë shqiptare të Amerikës dhe të Rumanisë, ku trysnia e të huajve ndaj shqiptarëve është ndjerë më pak, kanë qenë më të favorshme kushtet për t’iu përkushtuar qëllimeve kombëtare e fetare. Kur Perandoria Osmane në vitet 1900-1912 ishte në grahmenë e fundit të qenies së saj, lëvizja për pavarësinë kombëtare shqiptare mori hov të ri, kërkesat u kristalizuan dhe u përcaktuan më qartë, duke kërkuar me çdo kusht edhe autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare dhe shkëputjen e saj nga ndikimi i Kishës greke. Në shtator të vitit 1907 në Amerikë u krijua shoqëria fetare “Nderi shqiptar”, e cila e përqendroi veprimtarinë e saj për themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare dhe për shkëputjen nga Kisha ortodokse greke, duke përballuar të gjitha ndërhyrjet dhe intrigat e kësaj kishe nga klerikët grekë që ishin në Amerikë.

Kjo shoqëri bëri kërkesën e parë drejtuar Sinodit të Shenjtë të Kishës Ruse në mërgim për të shuguruar një prift shqiptar: “Muarmë vesh më së fundi se mjerimi ynë s’ish aq në ndryshimin fetar, sa ndër krerët fetarë të huaj e në meshtarët shqiptarë që vepronin si vegla të tyre të verbra. Na duheshin dhe na duhen priftërinj, peshkopë dhe hoxhallarë e myftinj shqiptarë të vërtetë. Jo vegla politike të huaja”.

Hedhja e themeleve për kishën kombëtare shqiptare erdhi nga vendosmëria dhe përpjekjet e besimtarëve ortodoksë e atdhetarë shqiptarë. Më 8 mars të vitit 1908 **F. Noli** u shugurua prift dhe u bë promotor i përpjekjeve të shqiptarëve të Amerikës për të çuar deri në fund kërkesën për autoqefalinë kishtare. Pajisja e kishës me librat e nevojshme liturgjike në gjuhën shqipe ishte e domosdoshme. Pa këto libra nuk mund të kryheshin shërbesat fetare. Ka qenë F. Noli, i cili nga viti 1908 deri në vitin 1914 mori përsipër dhe shqipëroi 6 libra duke u mbështetur edhe në përvojën e paraardhësve të vet. Fan Noli e ka çmuar veprën e madhe të Kostandin Kristoforidhit: “Natyrisht nuk mund të mbetesha i kënaqur nga përkthimet e vjetra të atdhetarit të shkëlqyer Z. K. Kristoforidhit dhe u përpoqa t’i ndreq ato që hynë në këtë libër pas përparimit që ka bërë gjuha shqipe që nga koha e tij, pa mohuar që puna e tij që një ndihmë dhe themeli për mua...”

Kështu ka shkruar F. Noli në parathënien e librit të shërbesave të shenjta të Kishës Ortodokse. Në vitin 1908 F. Noli përktheu librin liturgjik “Shërbesa e javës së madhe”, i cili përmban himne dhe pjesë që lexoheshin gjatë javës së madhe dhe ditën e pashkëve. Në vitin 1909 përktheu librin “Shërbesa të Shenjta të Kishës Ortodokse”, ku ka përfshirë shërbesat kryesore të Kishës Ortodokse Lindore. Në vitin 1911 përktheu librin “Të kremte të mëdha të Kishës Ortodokse”, ku janë himnet dhe leximet e të kremteve kryesore. Në vitin 1913 përktheu librin “Triodi i Vogël” që ka himne dhe

lexime të kreshmëve dhe të ditës së Pashkëve. Gjatë vitit 1914 përktheu librin “Lutjesorja”, ku jep himnet e së dielës. Në vitin 1914 përktheu edhe librin “Pesëdhjetorja e Vogël” me shërbesën e plotë të së dielës së Pashkëve të Mëdha deri në Rushajet.

Gjatë viteve 1914-1952 F. Noli, pas një redaktimi gjuhësor dhe disa plotësimeve me urata, përgatiti botimin e dytë të përkthimeve liturgjike, të cilat i përmbloodhi në tri vëllime:

1-“Uratortja e Kishës Ortodokse” (1941), e cila plotësoi një nevojë të ngutshme të Kishës Ortodokse Shqiptare.

2-“Kremtorja e Kishës Ortodokse” (1947)

3-“Triodi dhe Pesëdhjetorja” (1952)

Këto ribotime më të plota përsëri mbeten për t’u përsosur më tepër po të krahasohen me tekstet origjinale që përdoren në Kishën Ortodokse.

MIRATIMI PËRFUNDIMTAR I PËRDORIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË KISHË

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 kërkesa e hershme e ortodoksëve shqiptarë për futjen e gjuhës shqipe në kishë do të përmbushej më lehtë, sepse ajo u mbështet edhe nga shteti shqiptar, i cili miratoi disa vendime në Këshillin Kombëtar në vitet 1920 dhe 1923. Këto vendime miratuan zyrtarisht përdorimin e gjuhës shqipe në shërbesat kishtarë, në letërkëmbim dhe në shkrimin e dokumenteve fetare, si mbajtja e regjistrave të pagëzimit, të kurorëzimit të martesave dhe të vdekjeve. Pengesë kryesore tani doli vetëm ndërhyrja e klerikëve grekë që shërbenin pranë kishave ortodokse shqiptare, të cilët u përpoqën të ndalonin futjen e gjuhës shqipe në shërbesat fetare. Klerikët atdhetarë shqiptarë nuk iu bindën më urdhërave të dhespotëve grekë. “Megjithëse qe urdhëruar që gjatë Javës së Madhe në kishë të këndohej greqisht, **Atë Thanasi** në Pogradec, mbasi e këndoi ungjillin greqisht e përktheu shqip. Banorët e Pogradecit nuk e përfillën urdhërin, ata kënduan shqip” (gazeta Kuvendi, 29 maj 1920). Më 17 prill 1921 u mbajt mesha e parë shqip në Pogradec nga Arkimandrit A. Çamçe dhe Ikonom Josif Marko. Në meshë morën pjesë Atë Thanasi dhe Atë Nestori. Psalltën Thanas Kenxholli, Dhimitër Tushemishti dhe Llambi Thoma (gazeta Koha, Nr. 42, 30 prill 1921).

Futjes së gjuhës shqipe në kishë i dolën pengesa të tjera, të cilat u krijuan nga filogrekët. Klerikët grekë e quajtën të mjaftueshme përdorimin e gjuhës greke dhe të panevojshme përdorimin e gjuhës shqipe në liturgjinë kishtarë. Kështu u krijuan dy ndarje kryesore midis ortodoksëve shqiptarë, të cilët mbrojtën tezat e veta me këmbëngulje.

Debatet e tyre ishin pengesa kryesore, sepse çështja themelore për futjen e gjuhës shqipe në kishë u bë e pazgjdhshme. Kjo përçarje cenonte edhe unitetin kombëtar të shqiptarëve. I frymëzuar nga ideja për mbrojtjen e të drejtave kombëtare shqiptare, Kryetari i Bashkisë së Durrësit, **Kostë Paftali**, bëri thirrjen për mbledhjen e një kongresi kishtar për të vendosur përfundimisht dhe për t’i dhënë zgjidhje çështjes aq të diskutueshme midis ortodoksëve shqiptarë.

Ky kongres u mbledh në Berat më 19 shtator të vitit 1922, ku morën pjesë delegatë klerikë dhe laikë të zgjedhur nga besimtarët ortodoksë të të gjitha krahinave të vendit. Ky është Kongresi historik që përcaktoi udhën nëpër të cilën duhej të ecte Kisha Ortodokse Shqiptare drejt autoqefalisë së saj. Kongresi miratoi statutin e përkohshëm (provizor), ku me një nen shumë të rëndësishëm u vendos kanonikisht dhe ligjërisht përdorimi i gjuhës shqipe në kishë. Meqenëse disa klerikë nuk ishin të ushtruar për përdorimin e gjuhës shqipe në veprimtarinë kishtarë, ata u lejuan përkohësisht të përdorin një gjuhë tjetër, por me kusht që pjesët kryesore të shërbesave t'i bënin në gjuhën shqipe.

Mungesa e librave fetarë në gjuhën shqipe ishte pengesë tjetër, prandaj sipas statutit u lejuan përdorimi i librave ekzistues deri sa të botoheshin libra të rinj, të miratuar nga Këshilli i Lartë i Kishës Ortodokse Shqiptare.

Nga Kongresi i parë i Beratit e deri në **Kongresin e dytë Kishtar të Korçës** (1929) është koha e përpjekjeve të mëdha dhe e punës këmbëngulëse të klerikëve shqiptarë, me Visarion Xhuvanin në krye, të cilët përballuan intrigat e atyre që sabotonin përdorimin e gjuhës shqipe në kishë. Kryepeshkopi i zgjedhur Visarion Xhuvani kërkoi që mesha e shenjtë dhe ungjilli të mbaheshin e të ishin përkthyer në gjuhën shqipe. Pretendimet fanariote për paaftësinë e gjuhës shqipe që të jepte të përkthyer Ungjillin, i cili sipas tyre ishte i kuptueshëm për të gjithë vetëm në gjuhën greke, ishin hedhur poshtë që më parë me përkthimet dinjitoze të disa personaliteteve të kulturës shqiptare. Visarioni argumentoi: “Më 1872 asht botue përkthimi i Ungjillit prej K. Kristoforidhit, por edhe para tij ka pasun përkthime të tjera, për to nuk ka pasun asnjë kritikë. Kjo vërteton se gjuha shqipe asht në gjendje me i dhanë kuptimin e duhur Ungjillit dhe meshës ashtu dhe ma mirë se gjuhët e tjera”.

Nga viti 1908 deri në vitin 1914 F. Noli kishte përkthyer librat më kryesorë për shërbesat fetare. Kjo është një e dhënë tjetër që flet për forcën shprehëse të gjuhës shqipe, për aftësinë e saj për t'u përdorur në kishë. Futja e gjuhës shqipe në liturgjitë kishtarë nuk mund të mbështetej vetëm në dëshirën e zjarrtë të ortodoksëve atdhetarë. Ajo kishte nevojë për një mbështetje të ligjshme nga pikëpamja kanonike, e cila u arrit me dokumentet e rëndësishme historike për Kishën Ortodokse Shqiptare që u hartuan dhe u miratuan në Kongresin e Beratit dhe të Korçës (përkatësisht në vitin 1922 dhe 1929).

Në nenin X të Statutit të Përkohshëm (provizor) të vitit 1922 është shkruar: “Gjuha e Kishës është shqipja, por meqenëse disa nga kleri e nga koret nuk janë stërvitur në gjuhën kishtarë dhe në anën tjetër mungojnë mjetet e duhura, u jepet e drejta të vazhdojnë në gjuhën e gjertanishme (greqisht), duke u kujdesur me sa është e mundur të këndohen në gjuhën e kishës (shqip) këto: 1- Paqësoret, të cilat përmbledhin lutjet për shtetin dhe kishën. 2-Ungjilli, Apostulli dhe predikimet. 3-Ati ynë, dhe sa mund të shtojë koha”.

Kongresi i dytë gjithortodoks i mbajtur në Korçë në vitin 1929 vendosi dhe miratoi Statutin e Përhershëm (definitiv) dhe Rregulloren e Administrimit të Kishës. Në nenin 3 të këtij Statuti është përcaktuar qartë: “Gjuha zyrtare e Kishës është shqipja”.

Neni 7: “Asnjë libër nuk mund të përdoret në kishë pa pëlqimin zyrtar të Sinodit, kështu dhe në shkollë për mësimin e fesë Ortodokse pa pëlqimin zyrtar të Sinodit dhe të Ministrisë së Arsimit”.

Neni 8: “Librat e Kishës që janë përkthyer do të kqyren prej Sinodit, i cili ka detyrë të kujdeset sa më shpejt për përkthimin dhe botimin e librave të kishës që mungojnë”.

Rregullorja e Administrimit të Kishës ka përcaktuar këto nene:

Neni 16: “Zgjedhësit e dytë duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë në gjuhën shqipe dhe të jenë 25 vjeç e lart”.

Neni 17: “Pleqtë (Dhimogjerondët) duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën shqipe dhe të jenë 30 vjeç e lart”.

Me këto vendime të miratuara në dy kongreset kishtarë të Kishës Ortodokse Shqiptare nga të gjithë delegatët dhe të miratuara edhe zyrtarisht nga qeveria shqiptare, gjuha shqipe fitoi të drejtën e ligjshme dhe të patjetërsueshme të përdorimit të saj në veprimtarinë kishtarë. Përpara Sinodit të Shenjtë të Kishës sonë Ortodokse doli detyra që të fitohej koha e humbur, prandaj u angazhuan intelektualët ortodoksë më cilësorë, si Dr. Zoi Xoxa, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Fot Papajani, M. Sherko, Foqion Postoli, Sotir Peci e shumë të tjerë. Brenda dy vjetëve u botuan dhe u vunë në përdorim të kishës librat më kryesorë.

Veprimtaria e **Sinodit të Shenjtë të kryesuar nga Kryepeshkopi Visarion Xhuvani** u shoqërua pandërprerë me përgatitjen metodike të mbajtjes së meshave, me pajisjen e kishës me literaturë liturgjike, me krijimin e një brezi të ri klerikësh me arsim të mesëm e të lartë. Me rastin e përkujtimit të trevjetorit të krijimit të Sinodit të Shenjtë, kjo veprimtari u dha përmbledhtas nëpërmjet komunikatës së Kryesisë së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë: “Vepra dhe përparimet kryesore që ka në KOASH brenda vitit të dytë të stabilitetit të saj nën drejtimit e Sinodit të kryesuem prej Kryepeshkopit Imzot Visarionit, me ndihmën e Perëndisë, të Mbretit dhe të të gjithë dashamirëve të misionit të shenjtë social-shpirtnor dhe patriotik, janë këto:

1. U botue Ungjilli i gjithë shërbimeve të shenjta për çdo nevojë fetare të popullit, si dhe mesha e shenjtë me të gjitha pjesët e mëngjesorit dhe të mbramësorës.
2. U botue Ungjilli i madh, i ndamë në 365 pjesë të përditshme.
3. U botue Apostulli (letrat dhe vepra e Apostujve) i ndamë në 365 pjesë të përditshme sipas Rregullores së Ortodoksisë.
4. U botue Libri i të Kremteve të mëdha (përmbledhje e 12 librave të të kremteve të çdo mueji të vitit).
5. U botue libri i Shërbesës së Vojit të bekuem”.

Këto botime plotësuan nevojat e klerikëve për të kryer të gjitha shërbesat fetare, u nda përgjithmonë kisha nga përdorimi i gjuhës së huaj greke, lutjet dhe shërbesat u bënë për besimtarët ortodoksë shqiptarë më të kuptueshme për ta. Gjatë këtyre viteve në shërbim të veprimtarisë kishtarë u botuan 22 numrat e revistës “Kisha Kombëtare”, në të cilën klerikët dhe besimtarët shqiptarë patën mjaft materiale për edukimin fetarokombëtar.

Përdorimi i gjuhës shqipe në kishë u mbështet edhe nga psalltët dhe koret kishtarë. Që në fillim u tregua kujdes i veçantë për grupet korale kishtarë. Gjatë dy viteve të para u ngritën koret në Tiranë, Pogradec, Korçë dhe Durrës. Kryepeshkopi Visarion Xhuvani u kujdes veçanërisht për repertorin e koreve, kërkoi që të jenë cilësore dhe të pajisura me muzikë kishtarë bizantine dhe moderne.

Futja e gjuhës shqipe në të gjitha shërbesat e shenjta ishte porosia e përhershme për të gjithë priftërinjtë. Në dy qarkore njëra pas tjetrës janë këshilluar dhe janë qortuar

ata klerikë që e përdornin gjuhën amtare shqipe vetëm në festa të veçanta: “Asht vu re se prej disa meshtarëve, sado që kanë në dorë librat e meshës së shenjtë në gjuhën amtare, nuk i përdorin në shërbesat e shenjta çdo ditë, por rrallë dhe në disa festime zyrtare, punë që shkaktohet vetëm nga moskujdesi dhe plogështia e klerit dhe e psalltëve. Kjo mungesë na ka tërheqë vërejtjen e duhur dhe nuk u ban nder priftnave të përndershëm dhe kishës sonë nacionale.

Prandaj porosisim dhe urdhnojmë që paskëtaj mos përsëritet gabimi i sipërpërmendun. Gjithashtu porosisim dhe të ndershmit psalltës të çdo kishë, që paskëtaj çdo pjesë dhe çdo shërbim fetar që asht botue, në asnjë ditë nuk duhet të këndohet në gjuhë të huej.

Hiri i Zotit tonë Jesu Krisht qoftë ndihmë kurdoherë mbi Ju.

Mitropoliti Visarion

(AQSh. F. 141, dosja 1565, viti 1930)

Kryepeshkopin Visarion Xhuvani e ka preokupuar shumë edhe e ardhmja e gjuhës shqipe në kishë, sidomos roli i mësimin të gjuhës amtare për fëmijët, të cilët i ka cilësuar si e ardhmja e ndritur e kombit. Për këtë arsye ai dha mbështetjen e rëndësishme për përkthimin e 15 librave për fëmijë: Historia e Dhiatës së Vjetër; Historia e Dhiatës së Re; Katekizma Kristiane; Lutjesori i Vogël; Libri i Mistereve; Historia Kishtare; Dogmatika; Spjegime Ungjijsh; Misionari; Morali; Arkeologjia Biblike etj.

Pas shumë përpjekjesh e martirizimesh, veprimtaria e shquar e brezave të intelektualëve të mbështetur nga ortodoksët atdhetarë e përparimtarë shqiptarë vijoi edhe pas viteve 30 të shek. XX për konsolidimin e gjuhës shqipe në shërbesat fetare dhe në literaturën kishtare. Këmbëngulja e Sinodit të Shenjtë të drejtuar nga Kryepeshkopi Visarion Xhuvani bënë që gjuha shqipe të ketë jo vetëm Ungjijtë, por edhe shtypin e vet për të edukuar besimtarët me normat e moralit kristian.

KLERIKU ATDHETAR VISARION XHUVANI – MBROJTËS I GJUHËS LETRARE DHE I SHKOLLËS SHQIPE NË PARLAMENTIN E SHQIPËRISË (1920-1924)

Me veprimtarinë e tij atdhetare dhe kishtare, Visarion Xhuvani ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e kombit shqiptar. Jeta e këtij personaliteti të shquar është e mbushur me përpjekje të pareshtura për arritjen e qëllimeve madhore në shërbim të popullit shqiptar dhe të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ai kishte ide mjaft të qarta për bashkëlidhjen e kombit me fenë, për bashkëjetesën e pavarësisë kombëtare shqiptare me pavarësinë kishtare, ku harmonia e tyre brendashtetërore nuk duhej cenuar prej ndërhyrjeve të shteteve të tjera, të cilat kanë qenë në kundërshtim edhe me kanonet e përgjithshme të kishës ortodokse. Visarion Xhuvani u përpoq me të gjitha forcat e tij për të vënë në jetë të drejtën e ortodoksëve shqiptarë për pavarësi kishtare në shtetin e tyre, e cila qëllimisht është penguar për interesa dhe shkaqe politike.

Pasi mbaroi shkollën në lagjen e Kalasë në Elbasan, ku veç mësimëve greqisht mësohej fshehurazi edhe gjuha shqipe me librat e shkruar e të përkthyer të Kostandin Kristoforidhit, në vitin 1906, kur ishte 19 vjeç, Visarion Xhuvani u regjistrua në Shkollën e mesme Kishtare të Athinës për t'u bërë klerik. Këtë shkollë e përfundoi në vitin 1911 dhe po atë vit filloi studimet e larta në Universitetin e Athinës në Fakultetin e Teologjisë. Studimet e larta teologjike i përfundoi në vitin 1914 me vlerësim maksimal, duke iu dhënë titulli kishtar i arkimandritit, titulli më i lartë i kryetarëve fetarë të manastireve ortodokse. Visarion Xhuvani menjëherë u hyri studimeve pasuniversitare, që i përfundoi me marrjen e gradës shkencore të doktorit në teologji. Pra, që në moshë të re 27-vjeçare, Visarion Xhuvani u pajis me kulturë të shëndoshë, ai përqafoi idetë iluministe të kohës, të cilat u bënë udhërrëfuese të veprimtarisë së mëpastajme atdhetare dhe kishtare në shërbim të kombit shqiptar dhe të Kishës Ortodokse Shqiptare.

Në vitin 1918 Visarion Xhuvani u emërua lektor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Athinës dhe po atë vit u dorëzua prift. Pas një viti filloi punën mësimore në famullinë e Prezhisë në Ankarali të Sofjes (Bullgari). U emërua drejtues i kishës ortodokse të atjeshme dhe në këtë mënyrë nisi udhën për t'u fronësuar peshkop. Ky emërim ishte shprehje e një vlerësimi të veçantë për aftësitë kishtare të Visarion Xhuvanit, i cili nuk u josh nga ofertat për tituj e për nderim jashtë vendit të vet të lindjes.

Dëshira e tij e zjarrtë, që buronte nga bindjet e tij atdhetare të rrënjosura që në fëmijëri në familjen e vet në lagjen e Kalasë së Elbasanit, ishte që në Shqipëri t'i kushtohej organizimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Gjatë kohës që ishte në Bullgari, me shqiptarët e mërguar atje Visarion Xhuvani u lidh ngushtë me ta. Që atëherë nisi veprimtaria e tij e mirëfilltë atdhetare dhe fetare për lartësimin e kombit shqiptar, për vetëdijësimin e shqiptarëve edhe nëpërmjet organizimit të kishës së tyre ortodokse.

Nga Bullgaria Visarion Xhuvani shkoi në vitin 1919 në Rumani si misionar që të ngjallte e të rrënjoste ndjenjën e atdhetarisë dhe të autoqefalisë kishtarë, duke meshuar në gjuhën shqipe në kishat ortodokse të mërgimtarëve shqiptarë. Në Rumani u njoh më nga afër me lëvizjen atdhetare dhe fetare të shqiptarëve të atjeshëm. Nëpërmjet kishës u përpoq të ngjallte e të forconte atdhedashurinë, bashkimin dhe unitetin kombëtar të bashkëkombasve, që ishte i domosdoshëm për të përballuar propagandën e përçarjes kombëtare e fetare të popullit shqiptar.

Me titullin kishtar të Arkimandritit, që e mori më 29 nëntor të vitit 1919, Visarion Xhuvani u kthye nga Rumania në fund të këtij muaji në Shqipëri për të organizuar në vendin e vet Kishën Ortodokse Shqiptare. Kur erdhi në Shqipëri ishin mbushur 7 vjet nga shpallja e pavarësisë sonë kombëtare. Të krishterët ortodoksë të Elbasanit, Tiranës, Kavajës dhe të Pogradecit dëgjuan në kishat e tyre meshimin në gjuhën amtare shqipe. U plotësua kështu një aspiratë e kahershme liridashëse, për të cilën kishin punuar dhe ishin martirizuar breza atdhetarësh shqiptarë dhe klerikë patriotë. Pra, vitet 1918-1920 shënojnë fillimin e pjesëmarrjes aktive të Visarion Xhuvanit në lëvizjen përparimtare politike të kohës, i cili u udhëhoq nga ideja e përparimit shoqëror të kombit shqiptar dhe nga ideja e konsolidimit të organizimit shtetëror të Atdheut.

Në atë kohë veprimtaria e shquar atdhetare e fetare e Visarion Xhuvanit nxiti ortodoksët e Elbasanit, pak më pas edhe të qyteteve të tjera, që t'i drejtoheshin me një peticion “Qeverisë së Durrësit, çdo zyre të shtetit shqiptar, çdo pleqësie (dhimogjerondie) të Elbasanit e të Durrësit, çdo shoqnie shqiptare, si edhe çdo shqiptari dhe Shenjtditunisë së tij Visarion Xhuvanit” që të niste zyrtarisht puna për organizimin e kishave ortodokse në qytetet dhe krahinat shqiptare. “Nga ana e gjithë klerit dhe popullit tonë njoftojmë se më 29 nëntor 1919 Atë Visarioni hypi në fronin e shejtë dhe kështu u vendos të jetë Arkipeshkop i Elbasanit, Tiranës, Kavajës, Shpatit, Pogradecit dhe gjithë krahinave të tyre” - kështu është shkruar në këtë peticion, i cili është firmosur nga këto personalitete të kohës për Elbasanin: Taq Buda, Andon Beça, Vladimir Biba, Aleksandër Xhuvani, Thanas Floqi, dr. Simon Popa, Kostë Haxhinikolla dhe Simon Shuteriqi. Ky peticion mbyllet me fjalët: “Sa thamë, kemi besim se Atë Visarion Xhuvani do ta pranojë punën e sipërme për të mirën e vendit dhe të fesë sonë”.

Peticioni i Elbasanit u nënshkrua dy-tre muaj më vonë edhe nga përfaqësuesit e bashkësisë ortodokse të Pogradecit: nga Pandeli Pasko, vëllezërit Kyçyku dhe mjaft të tjerë. Idetë e këtij peticioni u përhapën shpejt edhe në qytete të tjera, si në Tiranë, Durrës dhe në Kavajë. U krijua kështu një lëvizje e gjerë ortodokse në mbarë Shqipërinë e Mesme, kërkesat e së cilës u miratuan shumë shpejt nga Qeveria shqiptare e kohës nëpërmjet një vendimi zyrtar. Në këtë vendim është shkruar: “Tue marrë parasysh atdhetarinë e tregueme të zotit Arkimandrit Visarion Xhuvani, u vendos që zotnia e tij, sipas kërkesës së popullit të Elbasanit, Durrësit, Kavajës etj., të emnohet Arkimandrit i Ortodoksëve”. Me këtë vendim të Qeverisë së Durrësit, të janarit të vitit 1920, u

realizuan përpjekjet dhe kërkesat e ortodoksëve të Shqipërisë së Mesme për të pasur në krye të Dioqezës së Durrësit Visarion Xhuvanin. Kështu Visarion Xhuvani zuri vendin e dhespot Jakovit (klerik grek), që ishte në drejtim të Dioqezës së Durrësit por që lëvizja mbarëshqiptare e mbështetur dhe nga lëvizja e fuqishme për pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare e dëboi, sepse në kundërshtim me qëllimet fetare ai u shërbente interesave të Kishës greke.

Në vitet 1912-1920 kanë ndodhur shumë ngjarje të rëndësishme historike për popullin dhe shtetin shqiptar. Rëndësi të veçantë ka Kongresi i Lushnjës, i cili u mbledh më 28-31 janar të vitit 1920, kur Shqipëria ishte pushtuar nga ushtritë e huaja dhe kur Konferenca e Paqes (1919-1920) e shteteve fituese të Luftës së Parë Botërore nuk kishte marrë parasysh kërkesat për ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar, duke u bërë lëshime kërkesave shoviniste të shteteve fqinje ndaj vendit tonë. Madje atëherë u hartuan edhe projekte copëtimi që synonin deri edhe zhdukjen e shtetit të pavarur shqiptar.

Këto plane u kundërshtuan fuqishëm nga atdhetarët shqiptarë të mbledhur në Kongresin e Lushnjës. Përfaqësues gati të të gjitha krahinave të Shqipërisë së pavarur u shprehën në atë Kongres për organizimin e qëndresës së armatosur në mbrojtje të vendit prej synimeve të huaja, duke rrëzuar edhe Qeverinë shqiptare të dalë nga Kongresi i Durrësit në vitin 1918, e cila u tregua e paaftë të mbronte interesat kombëtarë të shqiptarëve.

Kongresi i Lushnjës zgjodhi organet e larta shtetërore. Ai zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetash, si organ kolegjal që përfaqësonte kryetarin e shtetit, i cili do të zgjidhte më pas si Kryeministër të Qeverisë shqiptare Sulejman Delvinën. Gjithashtu Kongresi i Lushnjës zgjodhi Këshillin Kombëtar prej 37 anëtarësh me funksionet e organit më të lartë ligjvënës (parlamentit) të shtetit shqiptar. Ky Këshill Kombëtar në zgjedhjet e prillit të vitit 1921 u plotësua me 75 anëtarë dhe funksionoi deri më 30 shtator të vitit 1923, kur përmbushi mandatin dhe u kalua në fushatën e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese në dhjetor të vitit 1923.

Pikërisht pjesëmarrësit e Kongresit të Lushnjës e zgjodhën në mungesë Visarion Xhuvanin (sepse ishte në Rumani) si anëtar të Këshillit Kombëtar (senator) që të përfaqësonte Elbasanin në këtë organ të lartë ligjvënës të shtetit shqiptar. Në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1923 Visarion Xhuvani u zgjodh deputet i Durrësit në Asamblenë Kushtetuese dhe gjatë ushtrimit të funksioneve të saj u ndërruan disa kryeministra të qeverive të atëhershme, duke përfshirë edhe Fan Nolin më 1924.

Kështu vitet 1920-1924 janë koha e angazhimit të plotë politik (V. Xhuvani ka qenë edhe anëtar i Partisë Popullore) dhe në funksionet e larta të pushtetit ligjvënës si këshilltar dhe deputet, kur Visarion Xhuvani u shqua si shumë aktiv në diskutimet e debatet parlamentare për të gjitha çështjet që preokuponin shtetin e atëhershëm shqiptar. Po në atë kohë Visarion Xhuvani nisi të parashtrijë dhe të shtjellojë edhe veprimtarinë fetare për autoqefalinë e Kishës Ortodokse. Ai arriti të mbrojë një varg aktesh kryesore e të rëndësishme për organizimin e Kishës Ortodokse dhe të bëjë që ato të miratohen në parlamentin shqiptar.

Në Këshillin Kombëtar dhe në Parlament Visarion Xhuvani u shqua si mbrojtës i flaktë i përparimit arsimor e kulturor nëpërmjet shtrirjes dhe mbështetjes që dha për shkollat shqipe në Shqipëri. Njësimi i sistemit arsimor dhe i programeve shkollore, si edhe zbatimi i shqipes letrare në tekstet mësimore ishin problem themelor në fushën e

arsimit tonë kombëtar. Qendër kryesore për vënien në jetë të këtyre detyrave shumë të rëndësishme u bë Elbasani me përvojën e Shkollës Normale.

Veprimtaria atdhetare e kulturore e disa brezave të klerikëve me qendër të tyre Manastirin e Shën-Gjon Vladimirit, përpjekjet e hershme për shkrimin e shqipes me alfabetin e krijuar prej tyre, si Tedor Haxhifilipi (Dhaskal Todri) dhe të tjerë anonimë që nuk janë bërë të njohur deri më sot, puna e palodhur e intelektualëve të shquar, si Kostandin Kristoforidhi, Aleksandër Xhuvani etj., të gjithë këta faktorë bënë që Elbasani të dalë në kryet e vendit për shkrimin dhe shkollimin e brezave të rinj shqiptarë në gjuhën amtare shqipe. Prandaj edhe Shkolla Normale u çel në Elbasan sepse këtu ishte krijuar prej kohësh një mjedis popullor arsimeash, kishte edhe intelektualë vendës që morën përsipër misionin fisnik të përgatitjes së arsimtarëve për nevojat e shkollës në të gjitha trevat shqiptare. Këta punuan me përkushtim, kapërcyen fillimet e vështira të mësimin në Shkollën Normale, u mbështetën dhe u përkrahën nga opinioni i përparuar kulturëdashës i Elbasanit edhe me ndihma financiare shumë të nevojshme në atë kohë.

Në vitin 1920, në një mbledhje të radhës të Këshillit Kombëtar, u bisedua edhe për mbylljen e Shkollës Normale dhe për mundësinë e hapjes së saj në një qytet tjetër. Atëherë në mbrojtje të Shkollës sonë Normale në Këshillin Kombëtar doli Visarion Xhuvani, i cili argumentoi bindshëm vijimin e rregullt të saj në Elbasan: “Ministria e Arsimit ka venduem mbylljen e Shkollës historike Normale t’Elbasanit tue qitë për shkak mungesën e fryteve të nxânësve e të mësuesve t’asaj shkolle”. Mungesën e fryteve të punës për përgatitjen e normalistëve Visarion Xhuvani e hodhi poshtë me këto fjalë: “Shumë veta janë pajisë me mësimet e asaj shkolle, ata gjinden edhe sot; këtë na e rrëfen edhe statistika e nëpunësve”. Për mungesën e nxënësve Visarion Xhuvani tha: “Kjo shkollë ka pasë nxânës që prej vjetës 1908-1920 dhe s’ka se si të mos ketë mbaskëndej”. Mungesën e mësuesve, dmth të profesorëve të Shkollës Normale, Visarion Xhuvani e kundërshtoi me këto fjalë: “Në Shkodër gjinden shumë djem të mirë e të zotët të dalun prej shkollave t’Austriës. Pra asnjë shkak i Ministrisë s’Arsimit nuk mbështetet në themele të forta e bijnë poshtë... Shkolla Normale është mbajtur me patriotizëm t’Elbasanasve. Kjo shkollë nuk është mbyllë as në kohë të sundimit t’Esad Toptanit, as t’Austriës, as t’Italisë dhe shfaq idhmin që po dishrohet me u mbyllë sot... Bashkimi i gjuhës kombtare rrjedh vetëm prej shkollës dhe i duhet vue ma e madhja fuqi shkollave. Tue u pasë ndodhë Elbasani në kërthizë të Shqipnisë e tue e pasë pranue dialektin e tij si gjuhë zyrtare, kërkoj vazhdimin e kësaj Shkolle Normale edhe për të përnjisuemit e dialektit që është pranue për gjuhë zyrtare” (*Bisedimet e Këshillit Kombtar*, mbledhja 56, viti 1920, f. 123).

Me këtë mbrojtje të Shkollës Normale në Këshillin Kombëtar Visarion Xhuvani u bë edhe përkrahës kryesor i atij vendimi shumë të rëndësishëm e që është ngjarje madhore historike për përcaktimin e gjuhës letrare të përbashkët shqipe, të cilin e arriti Komisia Letrare e Shkodrës më 1916. Ky vetëdijësim i intelektualëve shqiptarë për domosdoshmërinë e një gjuhe shqipe të normuar e të mbështetur në të folmen e Elbasanit e me disa plotësime të tjera, u bë në vitet e para të pavarësisë së Shqipërisë dhe atëherë askush nuk e vuri në dyshim nevojën “e një gjuhe të përbashkme”. Të gjithë pjesëmarrësit e Komisë Letrare nga treva të ndryshme shqiptare dhe me Gjergj Pekmezini si kryetar e parapëlqyen të folmen e Elbasanit për vlerat e saj gjuhësore dhe si dialekt i gegërishtes jugore “që të jetë si urë në mes të dy dialekteve” kryesore të shqipes, prandaj dhe u kërkua në Shqipërinë e Mesme. Në këtë të folme ishte përkthyer nga

Kostandin Kristoforidhi “Dhiata e Re”, që u bë gjedhe (model) kryesore e shkrimit të shqipes. “Për ta përmirësue gjuhën letrare të zgjedhun” Komisia e Shkodrës ngarkoi Aleksandër Xhuvani, i cili së bashku me albanologun austriak Rajko Nahtigal bëri kërkime të mëtejshme gjuhësore në Elbasan dhe më gjerë në Shqipërinë e Mesme.

Në përfundim të kërkimeve të tyre nga data 17 maj e deri më 26 maj 1917, albanologu i Universitetit të Gracit në Austri, Rajko Nahtigal, na ka lënë të shkruar gjermanisht një raport me titull: “Çështja e gjuhës së përbashkët shqipe”. Ai ka përvijuar rrugët e mundshme për të zgjidhur çështjen e gjuhës letrare shqipe dhe ka miratuar përfundimin se duhet pranuar si bazë e saj dialektore një e folme qendrore që flitet në Shqipëri të Mesme dhe me qendër qytetin e Elbasanit: “Më mirë se një koine e gegërishtes së veriut me bazë shkodranishten është padyshim koineja e Kristoforidhit, mbasi unë kam gjithnjë parasysh interesin e të gjithë popullit” - shkroi atëherë Rajko Nahtigali në raportin e tij.

Vendimi i Komissisë Letrare të Shkodrës për gjuhën letrare shqipe u miratua edhe nga albanologë të njohur të kohës si Maksimilian Lamerci. Ky vendim merrte parasysh edhe përvojën më të vjetër shkrimore të autorëve veriorë, si Gj. Buzuku, P. Budi, F. Bardhi e P. Bogdani, por edhe jugorë si L. Matrënga etj. Kështu që në këtë zgjidhje për shqipen letrare të përbashkët u mishërua një përvojë shkrimore e gjerë gege dhe toske, që mbështetej në tiparet themelore të strukturës fonetiko-gramatikore të gegërishtes jugore dhe linte hapur udhën e përthithjes së çdo vlere gjuhësore dialektore për gjuhën e përbashkët letrare shqipe.

Në themelet e gjuhës së përbashkët të miratuar nga Komisia Letrare Shqipe u mbështetën edhe gjuhëtarët dhe intelektualët e tjerë të Shkollës Normale, si Aleksandër Xhuvani, Dhimitër N. Paparisto etj, të cilët me tekstet e tyre mësimore për mësimin e gjuhës shqipe në shkollë dhanë zgjidhje edhe për përcaktimin e atyre trajtave gjuhësore që mungonin në rregullat drejtshkrimore të Komissisë Letrare të Shkodrës. Përvoja mësimore e Shkollës Normale për mësimin e gjuhës shqipe ishte laborator i kohës për mësimin e gjuhës letrare shqipe me baza më të shëndosha shkencore. Aleksandër Xhuvani, si titullar kryesor i Shkollës Normale, e lëvroi shqipen e përbashkët letrare me bazë dialektore gegërishten jugore në të gjitha veprat e veta mësimore dhe gjuhësore deri në fund të jetës së tij më 1961. Këtë gjuhë shkroi dhe mbrojti në Këshillin Kombëtar dhe në Parlamentin shqiptar edhe Visarion Xhuvani. Në botimet e tij kishtare dhe në veprimtarinë meshtarë nëpër kishat ortodokse shqiptare ai shkroi dhe foli në gjuhën letrare të përbashkët shqipe. Fjala e tij shqipe e qartë, e gjallë e plot ëmbëlsi u dëgjua në fillim në kishat e shqiptarëve të mërguar në Bullgari, pastaj në Rumani dhe menjëherë në Shqipëri, në Elbasan, Tiranë, Durrës, Kavajë, Pogradec, Berat etj. dhe në foltoret e Këshillit Kombëtar dhe të Parlamentit shqiptar.

Visarion Xhuvani u shqua në Këshillin Kombëtar për mbrojtjen e arsimit në gjuhën shqipe dhe nxiti përgatitjen e shëndoshë të arsimtarëve shqiptarë në vend. Ai ka mbështetur Ministrinë e Arsimit të kohës për përmirësimin e përgjithshëm arsimor të vendit, ashtu siç edhe ka kritikuar ashpër shfaqjet e punës së dobët në këtë fushë. “Puna e arsimit është një çështje jetike për Shtetin, edhe të mos dhanunit rëndësi kësaj çështjeje është një vepër antiqeveritare e antishtetnore... Shkollat janë me të vërtetë shumë të nevojshme, dhe do t'ishte më mirë që një vend, në vend që të ketë tri kisha, të ketë një kishë, po të ketë shkolla që i bëjnë nevojë [nevojiten], pse kishën mund ta bëjë njeri

[kushdo] edhe në shpi të vet” - këto janë fjalët e Visarion Xhuvanit në Këshillin Kombëtar (*Bisedimet e Këshillit Kombtar*, mbledhja 70, 16. 6. 1923, f. 1246).

Visarion Xhuvani e sheh lartësimin dhe përparimin e kombit shqiptar nëpërmjet arsimimit të shëndoshë të të gjithë brezave, duke qenë kështu përcues i ideve të iluminizmit evropian në Shqipëri. Arsimi sipas tij është pasqyra se në ç`shkallë është kombi ose më mirë se në ç`shkallë do të gjendet në të ardhmen kombi shqiptar, sepse ai hedh bazat e së ardhmes, që janë në të vërtetë baza dhe shpresa e organizimit shtetëror të popullit shqiptar.

U kufizova posaçërisht në vitet e para të veprimtarisë atdhetare e kishtarë të Visarion Xhuvanit, duke vënë në dukje mbrojtjen e gjuhës dhe të shkollës shqipe prej tij në Këshillin Kombëtar dhe në Parlamentin shqiptar në vitet 1920-1924. Visarion Xhuvani ka marrë pjesë në të gjitha diskutimet për problemet e jetës shqiptare.

Për Visarion Xhuvanin ka ndodhur një varrim i dyfishtë. Një herë është varrosur për së gjalli në vitin 1947 në moshën 60-vjeçare e deri në moshën 75-vjeçare në skëterrën e burgut të Burrelit. Këtë martirizim të gjatë, që nuk arriti t`ia bëjë dot Patriarkana e Stambollit dhe Kisha greke, ia bëri regjimi komunist, i cili e paragjykoji si kundërshtar politik dhe ideologjik.

Për së dyti herë Visarioni qëndron i varrosur, i braktisur dhe i harruar, nga drejtuesit e sotëm të Kishës Ortodokse Shqiptare. A do ta lënë në këtë gjendje vlerësimin e veprës madhore atdhetare e kishtarë të Visarion Xhuvanit edhe drejtuesit vendorë dhe qendrorë të shtetit shqiptar?

Vepra e Visarion Xhuvanit meriton të lartësohet si vepër e shquar e një elbasanasi dhe shqiptari të madh. Ai sot prehet në një varr të thjeshtë pranë Manastirit të Shën-Gjonit, ku edhe mbylli sytë përgjithmonë, por eshtrat e tij duhet të prehen në një vend tjetër, atje ku kombi shqiptar nderon përherë bijtë e tij të shquar e të martirizuar për popullin dhe Atdheun.

VISARION XHUVANI - MARTIR I KISHËS ORTODOKSE

Kur fillova të shkruaj për Kryepiskopin e Shqipërisë, Fortlumturinë e Tij Visarionin, e kisha të vështirë për të radhitur mendimet dhe kjo e ka një shkak, sepse duhet një penë e fuqishme për të përmbledhur në një shkrim të vetëm gjithë jetën e tij prej martiri, që për fat të keq nuk është vlerësuar ashtu siç duhet. Kryepiskop Visarioni ka qenë edhe një nga pararendësit e përpjekjeve për autoqefalinë e Kishës Ortodokse, prandaj meriton vendin që i takon karahas patriotëve të tjerë që sakrifikuan për këtë çështje madhore të kombit tonë. Në librin e studiuesit Nos Xhuvani me titull "Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare" është trajtuar jeta dhe veprimtaria e këtij kleriku të lartë të Kishës Ortodokse. Autori ka pasqyruar shumë materiale nga arkivat, të cilat i paraqiten lexuesit për herë të parë duke krijuar imazhin e plotë të patriotit Visarion Xhuvani dhe të përpjekjeve të tij për çështjen kombëtare shqiptare.

Imzot Visarioni lindi më një maj të vitit 1887 në Lagjen Kala të Elbasanit. Studimet e mesme i kreu në Shkollën Kishtare të Athinës. Në vitet 1911-1914 ndoqi studimet e larta për Teologji në Universitetin e Athinës. Më pas vijoi me studimet pasuniversitare, në përfundim të të cilave mori titullin "Doktor" dhe në vitin 1918 u emërua Lektor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Athinës. Po këtë vit dorëzohet në gradën priftërore nga Mitropoliti Jakov dhe pas një viti filloi punën misionare duke shkuar në Sofje të Bullgarisë. Më 1919 gjendet misionar Rumani për të organizuar komunitetin shqiptar. Gjatë predikimeve të tij, kleriku Visarion përpiquej që të ngjallte ndjenjën e patriotizmit dhe të autoqefalisë. Në 29 nëntor të vitit 1919 Visarioni mori ofiqin e Arkimandritit. Tashmë ishte kandidat i mundshëm për gradën episkopale. Në shtator të vitit 1922 e gjejmë pjesëmarrës në Kongresin e parë panortodoks të Beratit, në të cilin u propozua kandidat për episkop. Më tre maj të vitit 1925 Arkimandrit Visarioni, duke marrë bekimin e patrikut të Serbisë, Dhimitrit, u dorëzua në gradën episkopale në Hercegnov (Kotor) prej dy episkopëve rusë Ermogenit të Ekaterinosllavit dhe Mihailit të Aleksandrovskit. Imzot Visarioni ishte në krye të të gjitha përpjekjeve që bëheshin për njohjen e autoqefalisë dhe për organizimin strukturor hierarkik të kishës shqiptare. Mendimet dhe pikëpamjet e tij për këtë problem i botoi më 1926 në veprën në dy pjesë me titullin: "Çështje politiko-religjioze, Kostandinopojë - Tiranë".

Imzot Visarioni duke u mbështetur në ndihmën e pakursyer që i premtoi qeveria dhe mbreti, si dhe me shpresë se do të gëzonte përkrahjen e Kishave Ortodokse të Serbisë dhe të Rumanisë, mori përsipër të zgjidhte problemin e autoqefalisë të Kishës Ortodokse.

Në vitet 1925-1926 qeveria shqiptare filloi negociatat me Patriarkanën Ekumenike për njohjen e autoqefalisë. Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës atëherë vendosi të njohë një autonomi të kufizuar të Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Në vitin 1926 Patriarkana Ekumenike dërgoi në Shqipëri Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin si eksark patriarkal që të bisedonte për çështjen e autoqefalisë, por pa ndonjë rezultat konkret sepse qeveria shqiptare kërkonte autoqefalinë e plotë dhe pa kushte. Në vitin 1929 kur Imzot Jerotheu u detyrua të largohej nga Shqipëria për t'u vendosur në Malin Athos, ndërsa Imzot Kristofor Kisi vendosi që të qëndronte vetëm si murg i thjeshtë, do t'i vinte radha Imzot Visarion Xhuvanit të merrte drejtimin e kishës. Por që të sanksionohej plotësisht autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë nevojitej të krijohesh një sinod, i cili do të udhëhiqte kishën. Që të formohej Sinodi i Shenjtë nevojiteshin të paktën katër episkopë, ndërsa në Shqipëri në atë kohë ekzistonte vetëm një episkop që ishte Imzot Visarioni. Për të dorëzuar episkopët e tjerë nevojiteshin të paktën dy mitropolitë, prandaj u kërkua ndihma e episkopit serb Imzot Viktorit (i cili ishte Vikar i Patrikut Dhimitër në qytetin e Shkodrës).

Kështu më 12 shkurt të vitit 1929 u bë dorëzimi i episkopëve dhe disa ditë më vonë më 18 shkurt 1929 Imzot Visarioni me mbështetjen e qeverisë shqiptare do të formonte Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga Fortlumturia e Tij Visarioni, Kryepiskop i gjithë Shqipërisë, që kishte në juridiksion Mitropolinë e Korçës, Imzot Agathangjel Çamçe, Mitropolit i Beratit, Imzot Efthim Eugjeni, Mitropolit ndihmës i Kryepiskopit dhe Imzot Ambrosi, Mitropolit i Drinopulit (Gjirokastrës). Mesha e parë episkopale u celebrua më 24 shkurt të vitit 1929 në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë.

Fortlumturia e Tij Visarioni menjëherë filloi të konsolidonte strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Kështu më 16 qershor të vitit 1929 thirri Kongresin e dytë Kleriko-laik në qytetin e Korçës, i cili plotësoi Statutin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të miratuar në Kongresin e Beratit. Kongresi i Korçës vendosi krijimin e një këshilli për administrimin e pasurive të kishës. U vendos ndarja kishtare në bazë dioqeze duke formuar dioqezat e Korçës, Durrësit, Beratit dhe të Gjirokastrës. Prej vitit 1922 e deri më 1929 qendra kishtare ishte Korça, ndërsa duke filluar nga viti 1930 kaloi në Tiranë, duke marrë emrin Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe e Elbasanit. Kryepiskop Visarioni, vazhdoi punën me organizimin e strukturave të kishës duke çelur në Durrës një kurs për përgatitjen e priftërinjve, i cili më 1930 u kthye në një Seminar katërvjeçar. Dërgoi studentë nëpër Universitetet Teologjike jashtë shtetit dhe më pas krijoi një komision për përkthimin dhe botimin e librave liturgjikë në gjuhën shqipe etj.

Në vitin 1931 Fortlumturia e Tij, Visarioni me ftesë të Lordit Dikson mori pjesë në Kongresin e Aleancës Ndërkombëtare për Paqe në Kembrixh të Anglisë. Në vitin 1932 u prit në audiencë nga Mbreti i Rumanisë Karoli II. Gjithashtu mori pjesë në Konferencën e Bashkimit Botëror të Kristianizmit që u mbajt në Bukuresht, ku zhvilloi bisedime me Patrikun Miron, i cili shprehu simpati për Kishën e Shqipërisë. Në shtator të vitit 1933 Kryepiskop Visarionin e ftojne në mbledhjen e Këshillit Botëror për Miqësinë e Popujve që u mbajt në Sofje të Bullgarisë. Gjatë ditëve të qëndrimit në Sofje, Fortlumturia e Tij Visarioni u dekorua nga Mbreti i Bullgarisë Boris me urdhërin "Kryqi i

madh kombëtar i Bullgarëve". Në 30 qershor të vitit 1935 Kryeepiskop Visarioni referoi për "Gjendjen aktuale të kishës me shtetin dhe influenza e kishës në shoqërinë kristiane të Shqipërisë" në Konferencën e Kishave të Ballkanit që u mbajt në Herzegovina të Jugosllavisë. Pjesëmarrës në mbledhjen e Përbotshme të Kishave në Montreux të Zvicrës që u mbajt në gusht të vitit 1935. Në sajë të aktivizimit të Kryeepiskop Visarionit nëpër aktivitetet ndërkombëtare, qëndrimi i disa kishave ortodokse ndaj kishës sonë filloi të ndryshojë. Kjo u duk në telegramet e urimit për Krishtlindjet e vitit 1935 që mori Fortlumturia e Tij, nga primatët e kishave të Serbisë, Rumanisë, Polonisë dhe të Bullgarisë.

Patriarkana Ekumenike i shkishëroi episkopët e Sinodit të kryesuar nga Imzot Visarioni. Gjithashtu Sinodin e ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë e njohu vetëm Sinodi i Kishës ruse në emigracion. Fortlumturia e Tij Visarioni i dërgoi një telegram Patriarkanës Ekumenike me anën e të cilit kërkonte ndjesë, por asnjëherë nuk mori përgjigje. Patriarkana kërkonte me çdo kusht dorëheqjen e tij, derisa në vitin 1936 Kryeepiskop Visarioni dha vetë dorëheqjen nga kryesia e kishës.

Në vitin 1942 Visarion Xhuvani u dorëzua në Mitropolit i Beratit, Myzeqesë, Vlorës dhe Kaninës. Në këtë detyrë qëndroi deri në vitin 1947 kur e arrestuan dhe e burgosën. Akuzat ndaj Mitropolitit Visarion qenë nga më të ndryshmet, të artikuluar nga njerëzit e sigurimit të shtetit në bashkëpunim me ata të kishës. Ata e akuzonin sikur kishte punuar për rrëzimin e pushtetit popullor duke ngjallur pakënaqësi të besimtarët ortodoksë, sikur kishte dekonspiruar letrat e kryesisë së kishës, abuzime në detyrë gjatë kohës që ishte Mitropolit i Beratit etj. Më 23 dhjetor të vitit 1948 u bë gjyqi, gjatë të cilit Mitropolitit Visarion u dënua me 20 vjet heqje lirie dhe humbje të të drejtave politike për 5 vjet. Gjatë 15 vjetëve të dënimit në burgun e Burrelit, ndonëse në moshë të thyer, Mitropolitit Visarion qëndroi me burrëri.

Shkrimtari Agim Musta në librin "Mandelat e Shqipërisë" ka shkruar për Visarion Xhuvanin: "Nuk kisha veçse dy javë që ndodhesha në burgun e Burrelit, kur një mbrëmje dallova në sfondin e korridorit një njeri me raso të zezë, fytyrë dhe flokë të bardhë si dëbora, një Abat Faria i gjallë, që ecte i kërrusur nga pesha e viteve dhe e vuajtjeve". Gjatë kohës së qëndrimit në burg, besimtarët dhe të afërmit druheshin të shkonin për vizitë te Visarioni, por kishte edhe nga ata që duke marrë parasysh të gjitha pasojat venin dhe i shpinin ushqime, si për shembull Papa Kozmai i Bestrovës dhe besimtari Vangjel Manushi. Kur doli nga burgu më vitin 1962 Visarioni ishte në moshën 75-vjeçare. Njeriu që iu gjend në këto momente kritike ishte Atë Erazmi Jorgo, i cili u kujdes për të duke i dhënë veshjet e veta klerikale. Në vjeshtën e vitit 1962 Visarionin e çuan në Manastirin e Shën Gjonit pranë Elbasanit, ku kaloi vitet e fundit të jetës së tij, derisa ia dorëzoi shpirtin Perëndisë më 15 dhjetor të vitit 1965. Në përkujtim të jetës dhe veprës së Kryeepiskopit Visarion janë organizuar sesione shkencore, artikuj të shumtë janë botuar në shtypin periodik etj. Varrit të tij, që gjendet në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, në vitin 1996 i vunë Kryqin e granitë dhe në pllakën përkujtimore është shkruar: Visarion Xhuvani. Kryeepiskop i Shqipërisë 1929-1937. Mitropolit i Beratit 1942-1945.

Dr. Myzafer Berberi

**VISARION XHUVANI - ATDHETAR I SHQUAR
I NDËRGJEGJES KOMBËTARE DHE KRYEPESHKOPI I PARË
I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE**

(Kushtuar veprës “VISARION XHUVANI – NË KISHË, NË PARLAMENT DHE NË BURG”, përgatitur për botim nga NOS XHUVANI dhe PAVLI HAXHILLAZI, Tiranë 2007, 520 faqe)

Fondin e kulturës sonë kombëtare vitet e fundit e pasurojnë me vlera të veçanta dhe dy vepra të rëndësishme për figurën e ndritur të atdhetarit dhe të teologut të shquar shqiptar – Visarion Xhuvani. Këto vepra janë monografia “Visarion Xhuvani-apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare” të autorit Nos Xhuvani dhe redaktorë shkencorë gjuhëtari Pavli Haxhillazi dhe historiani Kasem Biçoku (botuar në vitin 2003) dhe vëllimi i veprës me dokumente “Visarion Xhuvani- në Kishë, në Parlament dhe në burg”, përgatitur nga Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi dhe redaktor i saj Pavli Haxhillazi (botuar në vitin 2007), pas një pune të lodhshme, me stil hulumtues shkencor e historik, me përkushtim e durim, me saktësi e korrektësi, bazuar në dokumente të Arkivit Qendror të Shtetit, nga botime që ruhen në Bibliotekën Kombëtare, si dhe nga mjaft dokumente të tjera të mbetura në errësirën e dekadave nga frika e represionit politik. Këto dy vepra i dhurojnë kulturës sonë kombëtare dhe bëjnë të njohur veprimtarinë plot dritë e përkushtim të atdhetarit të shquar shqiptar – Visarion Xhuvani.

Këto dy libra cilësorë janë mjaft të domosdoshëm për të ndriçuar më tej figurën e teologut dhe të dijetarit të shquar shqiptar, Visarion Xhuvani, në 120- vjetorin e lindjes së tij.

Visarion Xhuvani ka lindur më 1 maj 1887 në lagjen “Kala” të qytetit të Elbasanit. Mësimet e para, të shkollës fillore, i mori në qytetin e tij. Shkollën e mesme e mbaroi në Athinë. Studimet e larta i vazhdoi për teologji dhe i përfundoi po në Athinë në vitin 1914. Studimet pasuniversitare, për teologji, i kreu në universitetin prestigjioz të Kembrixhit, Angli, ku mori gradën doktor në teologji. Në vitin 1918 u emërua lektor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Athinës. Në vitin 1919 shkon misionar në Bullgari e Rumani për të organizuar komunitetin shqiptar. Më 29 nëntor të vitit 1919 mori ofiqin e Arkimandritit. Në shtator të vitit 1922 ishte një nga nismëtarët e organizimit të kongresit të parë gjithortodoks shqiptar në Berat, ku u propozua kandidat për episkop. Në vitin 1925 Arkimandrit Visarioni u dorëzua në gradën episkopale. Më 18 shkurt 1929 formoi Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Nga viti 1929 deri në vitin 1937 ka qenë Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në maj të vitit 1936, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Sinodit Episkopal dha dorëheqjen nga funksioni i lartë i Kryepeshkopit. Në vitin 1942 u dorëzua Mitropolit i Beratit, Myzeqesë, Vlorës dhe Kaninës. Vazhdoi me këtë detyrë deri në vitin 1945. Në vitin 1947 u arrestua dhe u burgos nga diktatura komuniste. Më 23 dhjetor të vitit 1947 u dënua me njëzet vjet burg. U lirua nga burgu në mars të vitit 1962. Në vjeshtën e vitit 1962 u vendos në manastirin e Shën Gjjonit, Elbasan. Më 15 dhjetor 1965 u nda nga jeta.

E ndjej të nevojshme të theksoj që megjithëse Visarion Xhuvani shumë vite të moshës së rinisë i kaloi në shkollimin teolog grek, mbeti gjithë jetën i pandikuar nga ata, një patriot i shkëlqyer sepse, sikurse thoshte At Gjergj Fishta: “Atdhetaria e tij ishte e

kultivueme qysh në djep”. Ai u edukua dhe trashëgoi vlerat e shquara njerëzore fisnike dhe atdhetare të familjes Xhuvani.

Duke lexuar këto dy vepra, gjithkush e ndjen se plotëson dijet e tij me vlerat e veçanta të veprimtarisë idhujtare të gatuara plot sakrifica e mundim të të ndriturit Visarion Xhuvani. Analiza psikologjike dhe historike e autorit vjen në një induksion të përkryer për të shfaqur vlerat e vërteta të heroit të veçantë shqiptar- Visarion Xhuvani. Autori, me erudicionin e tij, ka arritur të pahësojë meritat e shquara njerëzore në vlerat e një studimi të mirëfilltë, duke i dhënë lexuesit jo vetëm kënaqësinë, por edhe krenarinë e bashkëkombasit të vet, atdhetarit të madh teolog Visarion Xhuvani. Tashmë, me botimin e këtyre dy veprave, lexuesit njihen dhe qartësohen më tej me vlerat historike kombëtare të krishterimit shqiptar në një luftë të ashpër kundër armiqve të saj: Fanarit grek dhe Patriarkanës së Kostandinopojës, të cilët, ashtu sikurse për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe përhapjen e saj, edhe në fushën e krishterimit synuan dhe synojnë ta mbajnë atë nën tutelën politike për interesa të ulta shoviniste. Në këtë luftë të ashpër, të mundimshme dhe me gjak, të zhvilluar për disa dekada, kolosët e teologjisë kristiane shqiptare: Dhaskal Todri, Papa Kristo Negovani, Kostandin Kristoforidhi, Mihal Grameno, Gjergj Fishta, Fan Noli, Visarion Xhuvani etj., dolën fitues dhe lanë pas një histori të pavdekshme. Lufta e tyre plot sakrifica dhe mundim, plot dinjitet dhe dritë, si teologë dhe patriotë, është më shumë se fitorja e disa betejave historike, sepse dominuan në forcimin e ndërgjegjes kombëtare në momentet më të vështira të kombit, atëherë kur shteti shqiptar hidhte hapat e parë të organizimit të tij.

Veçanërisht shquhet në këtë luftë atdhetari i madh dhe teologu Visarion Xhuvani. Në atë kohë të vështirë, ai si hero legjendar me vizion të ri mbi përparimin e kombit, mori përsipër një mision të mundimshëm e plot sakrifica, duke iu përkushtuar në gjithçka kombit të vet. Si njohës i mirë i filozofisë teiste, ai e quante dhe e vlerësonte fenë si pjesë përbërëse të ndërgjegjes kombëtare. Për të plotësuar boshllëqet e kësaj kulture dhe për ta vënë në rolin që duhej, në zhvillimin dhe forcimin e ndjesisë kombëtare, ai ndërmori një veprimtari të gjerë për të kurorëzuar dëshirat dhe përpjekjet plot luftë e mundim të paraardhësve të vet: Kostandin Kristoforidhit, Dhaskal Todrit, Mihal Gramenos etj. Puna e tij u përqëndrua në organizimin e kishës ortodokse shqiptare, në shqiptarizimin dhe futjen e gjuhës shqipe gjatë mbajtjes së riteve kishtarë, në zgjerimin e rolit të besimit ortodoks për edukimin fetar e atdhetar mbi bazën e traditës shqiptare dhe në finalizimin e përpjekjeve të luftës së gjatë shekullore për mëvetësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare, për ta shpëputur nga tutela arkaike e Patriarkanës së Kostandinopojës dhe nga manteli intrigues politik e shovinist i kishës greke. Jo vetëm mund, por edhe gjak ishte derdhur nga atdhetarët shqiptarë për të arritur këtë aspiratë, por nuk kishin mundur. Visarion Xhuvani, i gatuar me gjakun e patriotizmit shqiptar, me atdhedashurinë si virtyt hyjnor, i plotësuar me kulturë të gjithanshme, iu përvesh luftës e punës për ta çuar deri në fund këtë aspiratë të popullit. Ai punoi njëherësh në disa drejtime: në atë të organizimit të kishës, të përgatitjes teorike të elementit drejtues kishtar mbi baza kombëtare, të njohjes dhe përmirësimit të kanonizimit kishtar, të legjislacionit politiko-religjioz dhe sidomos në kombëtarizimin e Kishës Ortodokse Shqiptare me përdorimin në të gjuhës shqipe në të gjitha ritet fetare, të vendosjes në krye të klerit vetëm shqiptarë në gjak e në nënshtetësi, si dhe në plotësimin e literaturës liturgjike me libra shqip. Në botimet e tij të herëpashershme Visarion Xhuvani shpalosi platformën teorike e praktike nëpër të cilën duhej të ecte Kisha Ortodokse Shqiptare.

Puna e mundimshme e tij do të konsakrohej në Kongresin e parë gjithortodoks shqiptar, në Berat. Në këtë kongres Visarion Xhuvani argumentoi unanimitetin kombëtar për shpalljen e pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare. Lufta që kishte filluar qysh në vitin 1909 me krijimin e “Lidhjes Ortodokse” të Mihal Gramenos, e cila kishte vendosur të mos njihete patrikun grek si kryetar të fesë së tyre. E pas saj, kjo luftë ishte bërë edhe më e fuqishme në përpjekjet e kolonive shqiptare të Rumanisë, Bullgarisë, Amerikës. Të gjitha këto mundime u kurorëzuan me shpalljen de facto të pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare më 12 shtator 1922 në Kongresin e Beratit.

Kongresi i Beratit ishte kongresi i parë gjithortodoks shqiptar, i cili, përveç shpalljes së pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare, mori dhe një sërë vendimesh të tjera të rëndësishme për organizimin dhe drejtimin e Kishës. Ai zgjodhi dhe Këshillin e Lartë Kishtar, i cili kishte atributet e Sinodit të Shenjtë.

Visarion Xhuvani u ngrit me forcë kundër ndërhyrjeve të Patriarkanës së Kostandinopojës për të vënë në jetë qëllimet e djallëzuara të shovinistëve grekë. Në Kongresin e Beratit ai pati rol të veçantë, sepse ishte kleriku më i formuar, i vetmi me gradë në teologji, njohës i mirë i kanoneve të shenjta dhe i rregullave kishtarë. Njëherësh ai ishte senator dhe deputet, njohës i mirë i ligjeve të shtetit.

Si atdhetar Visarion Xhuvani ka qenë mjaft i shqetësuar dhe kundërshtonte me forcë vendimet dhe ndërhyrjet e Patriarkanës së Kostandinopojës dhe të Kishës Greke për mospërdorimin e gjuhës shqipe në liturgjitë fetare. Me logjikë të shëndoshë, njohje të thella filologjike dhe historike, iu kundërvu atyre duke argumentuar se misioni kishtar në Shqipëri do të përputhej me interesin kombëtar dhe se kjo realizohej më së miri me gjuhën shqipe. “Filologjikërisht gjuha jonë është në gjendje me na shërbye për këtë punë”, - theksonte ai. Gjithashtu, Visarion Xhuvani deklaronte “Kisha nuk asht një vend vetëm për t’ju lutun Zotit, po asht një vend ku ungjilli në gjuhën e vet tregon si duhet të punojmë për kombin”. Ai kërkoi në Kongresin e Beratit që kryefetarët, drejtuesit e fesë të jenë shqiptarë dhe njerëz të njohur, besnikë ndaj Atdheut dhe popullit. “Në emnofshim në Sinodin Shqiptar persona që kanë luftue Kishën Autoqefale dhe Shqiptarizmen deri më sot, shpejt kemi me u pendue keq”, - theksonte ai.

Visarion Xhuvani arriti ta shqiptarizojë plotësisht kishën tonë kombëtare, ta shkëpuste atë nga varësia e Fanarit dhe të plotësonte kushtet për të merituar Tomusin Patriarkal.

Krahas veprimtarisë së tij të palodhur për organizimin e kishës ortodokse, ai plotësoi boshllëkun e madh të literaturës liturgjike në gjuhën shqipe, ku përveç artikujve, referateve, drejtimit të revistës “Kisha Kombëtare” etj, vlerë të madhe kanë veprat e tij: “Çashtje politike-religjioze” dhe “Kujtim vepre dhe intrige”.

Lufta patriotike e Visarion Xhuvanit binte në kundërshtim me qëllimet e Patriarkanës dhe të Fanarit, prandaj qysh në fillim të veprimtarisë së tij u përplas në luftën kundërshtuese e të gjithanshme të tyre. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare pati kundërveprim të egër nga Patriarkana e Stambollit dhe sidomos nga Kisha Greke, e cila nuk u ndal në këtë luftë. Me format më të ndyra që nga mallkimi i gjuhës shqipe e deri te shtypi e provokimet, gjatë gjithë kohës bënë çmos të pengonin futjen e gjuhës shqipe në kishë dhe vepruan me të gjitha mënyrat që të mos organizohej kisha shqiptare, të mos njihet Sinodi i Shenjtë Shqiptar, të mos njihet dhe të mos pranohej Visarion Xhuvani në krye të kishës shqiptare, duke shpifur e trilluar gjithçka kundër tij, duke futur agjentët e politikës së tyre, andartët, në kufirin greko-

shqiptar, të cilët propagandonin dëshirën e dështuar vorioepirote dhe villnin vrer kundër Kishës së Pavarur Ortodokse Shqiptare. Ishte një veprimtari e ethshme e qarqeve greke me moral të ulët e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Mirëpo ju kujtojmë një thënie latine: “Quos Deus vult perdere, dementat prius” (Kush i lutet Zotit për të shkatërruar, ai i pari merr të keqen). Zemërimi i kishës shoviniste greke shpërtheu me të gjitha format dhe intrigat kundër Visarion Xhuvanit. Si mantel e njëherësh dhe si djep i kultivimit të satanait dhe të mënyrave më intriguese për të brengosur shpirtrat paqësorë të popujve fqinjë, bëri që Patriarkana e Kostandinopojës (e cila vazhdimisht ka qenë e njësuar me interesat e Kishës Greke) të mos pranonte pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Në përgjigje të kësaj lufte politike shoviniste greke, Visarion Xhuvani iu kundërvu me forcë duke kërkuar se “Nji kishë e nji shteti tjetër të mos urdhënojë ma nji kishë të nji shteti tjetër, dmth, Kishë të lirë në nji Shtet të lirë” dhe: “Shqipnia independente asht dhe do të jetë e përjetshme ashtu si çdo shqiptar”.

Visarion Xhuvani mbronte me çdo kusht unitetin kombëtar të popullit shqiptar dhe kërkonte që t’i viheshin kufijtë tek thana veprimtarive antishqiptare të Kishës Greke dhe Patriarkanës së Kostandinopojës. Prandaj kërkonte në parlamentin shqiptar që ai të ndërhynte fort kundër ndërhyrjeve të huaja në çështjet fetare të shqiptarëve. Si deputet ai është shprehur në parlament: “Edhe sot nuk kemi shpëtue nga intrigat e hueja, prandaj qeveria duhet të dijë mirë veprimet fetare dhe kur të jetë e nevojshme të bajë detyrën e vet sipas ligjit”, sepse “Autoqefalinë që realizuem me shumë gjak e sakrifica duhet ta ruejmë si sytë e ballit nga ndërhyrjet djallëzore të Kishës Greke. Mos u besoni grekëve, por zbatoni porosinë e Lamartinit që thërriste: “Boria e dha alarmin. Ngrihuni të mbroni kombin, për të mos u pendue”, - thërriste shpirti i tij kombëtar, ashtu sikurse poeti i shquar francez Alfonso de Lamartin.

Një arritje tjetër e Visarion Xhuvanit ishte krijimi i Sinodit të Shenjtë, me të cilin realizohej pavarësia e plotë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Kështu, në shkurt të vitit 1929 ai u bë përfaqësuesi i ngjarjeve kulmuese për historinë kristiane në Shqipëri. Ai formoi Sinodin e Shenjtë dhe mori drejtimin e kishës shqiptare. Puna e Visarion Xhuvanit për kurorëzimin e kësaj ngjarjeje të madhe me vlera historike u përgëzua nga mbarë kombi ynë brenda dhe jashtë kufijve. Për jehonën e tij shkruan shumë shtypi i asaj kohe. Më 26 shkurt 1929, paria më e lartë e kishës bëri betimin përpara mbretit. Gjatë betimit Visarion Xhuvani shprehu vendosmërinë për misionin e tij kombëtar e shoqëror në nderimin dhe lartësimin e atdheut, për të cilin ai u betua me jetën e tij. Këtë betim e mbajti të shenjtë gjatë gjithë jetës dhe në kushtet e tmerrshme të torturave çnjerëzore nga diktatura e proletariatit.

I etur për të realizuar qëllimin e tij madhor për të mirën e kombit, Visarion Xhuvani organizoi Kongresin e dytë gjithortodoks shqiptar, i cili u mbajt më 16 qershor 1929 në Korçë. Në këtë Kongres u miratua njëzëri statuti që sanksiononte pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare (e proklamuar në Kongresin e Beratit më 12 shtator 1922). Vendin kryesor në statut e zinte çështja kombëtare e mbështetur në kanonin: “Kishë e lirë në shtet të lirë”. Statuti sanksiononte se gjuha zyrtare e kishës është gjuha shqipe. Sanksionohej gjithashtu ruajtja e pavarësisë së kishës dhe fryma kombëtare e saj, ku përcaktohej në mënyrë të prerë: kryepeshkopi, peshkopët, zëvendësit e tyre, Ikonomi i Madh Mitrofor, sekretari i përgjithshëm i Sinodit dhe përbërja e Sinodit duhej të ishin shqiptarë prej gjaku e gjuhe, si dhe të kishin nënshtetësinë shqiptare. Këtë çështje Visarion Xhuvani e vlerësonte me rëndësi historike dhe politiko-religjioze. Ai deklaronte:

“Kemi pra detyrë me organizue e me rregullue vetë, neve shqiptarët kishën tonë me Sinod Episkopal shqiptar dhe jo të vrasim mendjen me bisedue kot me botën” dhe vazhdon “n’asht se pranohet një grek në shërbim aktiv në Shqipni...prish dinjitetin nacional të Kishës shqiptare dhe asht shkak konkurence të influencave të hueja në Shqipni, përzien keq politikën e jashtme të Republikës sonë dhe trazon politikën e mbrendshme, por dhe humb krejt karakterin kombëtar”. Ai theksonte gjithashtu se forcat fetare antishqiptare shpresonin të gjenin ditën e mundshme për të përmbysur Kishën e Pavarur Ortodokse Shqiptare ose, të paktën, ta bënin vegël të qëllimeve të tyre në dëm të Shqipërisë. Krijimi i Sinodit të Shenjtë i tregoi botës se shqiptarët ishin të aftë të qeveriseshin dhe të organizoheshin edhe fetarisht vetë. Është rasti të kujtojmë se çfarë paradoksi ndodhi 70 vjet më vonë, kur përfaqësuesit e lartë të shtetit shqiptar dhe disa politikanë, që për mangësi të kulturës së tyre apo të vetëdijshëm për t’i shërbyer klerit shovinist grek, bënë një retrospektivë të habitshme antikombëtare dhe pranuan që në krye të Kishës së Pavarur Ortodokse Shqiptare të vihej greku Janullatos. Po të dojë dikush, le ta besojë si vepër “të mirë”, por u kujtoj një thënie të vjetër latine se “Graeca fides, nulla fides” (Miqësia e grekut nuk ka besë).

Në Kongresin gjithortodoks shqiptar të Korçës Visarion Xhuvani argumentoi mbi bazën kanonike dhe të eksperiencës së të gjitha kishave të tjera ortodokse se pavarësia e kishës sonë nuk kishte nevojë të njihej nga Patriarkana e Stambollit, mbasi për atë duheshin dy kushte të cilat i plotësonte kisha shqiptare. Ato ishin: pavarësia politike e shtetit dhe pavarësia e popullit ortodoks shqiptar. Ai sqaroi se mbi bazën e këtyre dy kushteve ishin krijuar të gjitha kishat e tjera ortodokse, si në Rusi, Poloni, Bullgari, Rumani, Serbi, Greqi etj. Duke demaskuar politikën kishtare famëkeqe të Fanarit, ai shkruan: “Nën rroben e zezë t’Episkopit mshiheshe kurdoherë ungjilli i intrigës dhe i ambicjeve personale, profesioni ma antikishtar i fesë ortodokse... Dhe kësisoj priftënit e Fanarit, që flisnin gjithmonë mbi fuqinë e Qiellit, nuk mejtoheshin përveç se për fuqinë dhe interesat e Dheut”.

Si teolog dhe filozof ai thekson: “Feja nuk asht një orakull misterioz, një dogmë e koklavitun në gjuhë të pakuptueshme... pohime janë ungjillet, të cilat janë përkthye në gjithë gjuhët e ortodoksëve të botës, pa përjashtue edhe shqipen”. Prandaj, ai tepër i vendosur përsëriste vazhdimisht se gjuha zyrtare e kishës do të jetë shqipja.

Kongresi i dytë gjithortodoks i mbajtur në Korçë shënoi një periudhë të re – periudhën e ringjalljes kombëtare me triumfin e gjuhës shqipe në të gjitha ritet fetare të kishës. Kongresi pati jehonë mbarëkombëtare. Më duket me vend të ritheksoj një sentencë të përgatitësve të librit: “Vetëm një organizator i shkëlqyer i rregullave kishtare, i përkushtuar për të lartësuar punët fetaro-kombëtare, vetëm një organizator i talentuar mudi të përfshinte në punë vartësit e kualifikuar për të ngritur kolonat e çeliktat të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, statutin e përhershëm dhe rregulloren e administrimit të përgjithshëm të kishës; ky ishte Fortlumturia e Tij, Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë – Visarion Xhuvani”.

Ndërkohë, lufta e Patriarkanës dhe e Kishës Greke vazhdoi të thellohej dhe të kundërvihej edhe më shumë, madje, vazhdon edhe tani, sepse kisha greke e ka në traditën e vet. Ajo u përqëndrua edhe më shumë në ndërthurjen e intrigave dhe të shpifjeve kundër Visarion Xhuvanit. Këtë luftë ajo nuk e bëri vetëm drejtpërsëdrejti ndaj Kishës së Pavarur Ortodokse të Shqipërisë, por edhe në planin ndërkombëtar, gjithkund ku ajo mund të lëshonte mallkimin e satanait. Mirëpo “Abusus non tollit usum” (Abuzimi nuk

ka fuqi për të kundërshtuar). Përgatitja teologjike, erudicioni i shumanshëm, takti dhe diplomacia e Visarion Xhuvanit bënë që t'i afrohen shumë miq, të cilët u munduan ta ndihmonin edhe pse zemërimi i Patriarkanës dhe i Fanarit ishte i egër dhe vazhdoi gjatë. Me veprimtarinë e tij fetaro-politike ai hodhi dritë mbi të vërtetën, ngjalli mbresa të pashlyeshme dhe fitoi respektin e të huajve. Kryepeshkopi Visarion Xhuvani e paraqiti denjësisht Kishën e Pavarur Ortodokse të Shqipërisë në shumë veprimtari ndërkombëtare: në vitin 1931 në Kongresin e Aleancës Ndërkombëtare për Paqe në Kembrixh, Angli; në vitin 1932 në Rumani; në vitin 1933 në Bullgari; në vitin 1935 në Hercegovinë të Jugosllavisë; po në vitin 1935 në Mbledhjen e Përbotshme të Kishave në Zvicër. Pjesëmarrja e tij dinjitoze në këto veprimtari bëri që të ndryshonte opinionin e kishave të vendeve të tjera të keqinformuara nga Kisha Greke. Ndërkohë, Visarion Xhuvani nderohet si mik i madh nga shumë klerikë të Evropës dhe përfaqësues të shteteve, të cilët e prisnin me nderim e kënaqësi (Bullgari, Rumani, Poloni, Serbi, Danimarkë etj).

Megjithëse Kisha e Pavarur Ortodokse e Shqipërisë i kishte plotësuar të gjitha kushtet për të merituar Tomusin Patriarkal, Patriarkana Ekumenike e kushtëzonte dhënien e tij (Pra njohjen e Pavarësisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë) me largimin e Kryepiskopit Visarion Xhuvani dhe me vendosjen e një Kryepiskopi që dëshironte ajo, si dhe në caktimin e dy dhespotëve prej Kishës Greke për dioqezat e Korçës dhe Gjirokastrës. Kështu që në vitet 1935-1937 pavarësia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë ishte një nga temat e ditës për diplomacinë shqiptare. Qeveria e atëhershme bëri dy hapa pas të imponuara nga Patriarkana e Kostandinopojës: largoi Visarion Xhuvanin nga funksioni i drejtimit të kishës shqiptare dhe pranoi kompromisin që mbështetej në kërkesat e saj. Në këto kushte Visarion Xhuvani dha dorëheqjen, duke deklaruar shkaqet kryesore të saj, midis të cilave theksoi edhe njëherë që për 17 vjet rresht kundërshtarët e Patriarkanës dhe të Fanarit u ndodhën përballë vendosmërisë së tij. Pas kësaj, ai bëri detyrën fisnike si Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe i Myzeqesë. Pak vite më pas, me ardhjen në pushtet, diktatura komuniste nuk mund të bashkekzistonte me fenë. Prania e saj e pengonte për ushtrimin e filozofisë marksiste-leniniste, prandaj e shpalli fenë armike të saj, si luftë klasash. Fenë dhe kultet e saj i shikonte si organe të reaksionit borgjez, pra, si kundërshtarë politikë të saj. Duke marrë nga filozofia e V.I.Leninit dogmën e tij se “Lufta kundër fesë nuk është propagandë abstrakte, por praktike, konkrete, mbi bazën e luftës së klasave”, diktatura komuniste në Shqipëri filloi represionet ndaj udhëheqësve të klerit, sidomos ndaj atyre që ishin teologë të vërtetë, si dhe shkatërrimin e gjithë bazës së kulteve fetare. Kjo ishte një domosdoshmëri, sepse lufta midis ateizmit dhe fesë ishte shprehje e luftës së klasave. Ajo ishte një luftë e pamëshirshme kundër shpirtit të lirë. Pra, ajo vrau ndërgjegjen, e cila është çerdhja e paprekshme e lirisë së njeriut. Kështu që, në vitin 1947, Visarion Xhuvani u dënua me njëzet vjet burg nga gjykata ushtarake e Vlorës, i akuzuar si fajtor për krime kundër diktaturës së proletariatit (agjitacion e propagandë, lidhje me armiqtë, me misionet angleze e amerikane etj). Një vit më vonë, në vitin 1948, e dërgojnë të vuajë dënimin në burgun famëkeq të Burrelit, ku në moshë madhore u nënshtrohet torturave çnjerëzore. Atje për 15 vjet bëhet bashkëvuajtës me besimtarë të tjerë: ortodoksë, myslimanë, katolikë dhe ideorë të tjerë të mendimit e fjalës së lirë. Në burg gëzonte nderimin dhe bëhet idhull për bashkëvuajtësit. Një prej tyre kujton fjalët e tij: “Petro, mor bir. Me plumb më qëlluen të mallkuemit që pengonin autoqefalinë e kishës shqiptare, por unë i përballova. Jam krenar që e kreu misionin tim. Së bashku me

klerikë të tjerë atdhetarë bamë çmos dhe e shkëputëm kishën nga Patriarkana Greke, e cila kishte synime të këqija ndaj vendit tonë”.

Në vitin 1962 Visarion Xhuvani u lirua nga burgu duke marrë me vete pesë vjet të kufizimit të të drejtave të lirisë. Më 15 dhjetor të vitit 1965 ndërroi jetë, duke mbyllur sytë përgjithmonë. Por fatkeqësitë kanë heroizmin dhe lavdinë e tyre, sepse, siç thoshte Napolon Bonaparti “.....me kohë shpata mundet gjithnjë nga shpirti”.

Teologu i shquar Visarion Xhuvani, mbrojtjen e krishterimit ortodoks e shikonte si në anën dogmatike, ashtu dhe në rëndësinë e tij për forcimin e moralit kombëtar, duke krijuar kështu hapësira të reja të zhvillimit shpirtëror në botën kristiane. Ai kishte një besim teist, ku rolin e ndërgjegjes njerëzore e shikonte në veprim, aktiv në fenomenet shoqërore dhe jo në pritje të mëshirës apo fatalitetit, prandaj kërkonte që klerikët, mësuesit, diplomatët, shtetarët të ishin njerëz të zotë dhe të punës.

Filozofia teiste e Visarion Xhuvanit ka vlera të veçanta në përmbajtjen e saj kombëtare. Ajo është pjesë e ndërgjegjes kombëtare, brenda së cilës ai e shikon fenë në zhvillim, në thyerjen e dokeve që rëndojnë jetën shpirtërore dhe ekonomike të shoqërisë. Ai kërkon zbatimin e kanoneve kishtarë brenda të cilave besimi dhe bota shpirtërore e njeriut pasurohet dhe merr vlera të veçanta. Pra, në filozofinë e tij ai mendon të shkrijë esencën fetare në esencën njerëzore, botën e besimit hyjnor në botën njerëzore, ku shpirti i njeriut pasurohet më tej. Në këto pikëpamje filozofike e teologjike, ai gatuan vlerat e botës shpirtërore me përparimin dhe nivelet që arrin shoqëria njerëzore. Në veprën e tij ka një “teologji shkencore” që vihet në veprim të shoqërisë. Ndryshe nga Kisha Greke që brengos shpirtat, ngjall cmirën dhe hipokrizinë, Visarion Xhuvani çliron shpirtin dhe i hap dritë mendimit për përparim e vëllazërim. Si teolog ka qenë për një edukatë të shëndoshë të mbështetur në parimet e kohës. Ai kërkonte civilizimin kristian me qytetërim të zhvilluar. Deizmi i Visarion Xhuvanit është i veçantë në zhvillim të botëkuptimit hyjnor, në të cilin ai ruan thellësitë e botës shpirtërore në madhësinë hyjnore të lidhur me jetën.

Për t’u shënuar është botëkuptimi fetar i Visarion Xhuvanit në hapësirën midis besimeve të ndryshme. Ai i shikonte fetë e tjera, katolike dhe myslimane, si motra në shërbim të kombit, prandaj i respektonte ato me ndërgjegje të lartë. Në Kongresin e dytë gjithortodoks shqiptar, që u mbajt në Korçë, u shpreh edhe një herë uniteti vëllazëror midis ortodoksëve, katolikëve dhe myslimanëve. Përfaqësues të feve të ndryshme uronin për arritjen e suksesshme të fesë ortodokse. Kongresi vërtetoi se shteti shqiptar nuk ishte i ndarë sipas besimeve fetare, por ishte një i vetëm, respektonte fetë dhe dënonte çdo lloj përçarjeje fetare. Nga kjo pikëpamje kongresi u kthye në një festë të vërtetë kombëtare.

Visarion Xhuvani mbronte kulturën fetare të trashëguar, e cila mbante kombin shqiptar të bashkuar, në këtë kuptim ai ishte dhe simbol i ndërgjegjes kombëtare. Ai përfaqësonte kulturën shqiptare në hapësira poliedrike. Në botëkuptimin e tij bashkoheshin dhe drejtuesit e tjerë klerikë. Në Kongresin e dytë gjithortodoks shqiptar, Myftiu i Korçës u shpreh: “Ligjet fetare nuk janë krijuar që të jenë në kundërshtim me ligjet kombëtare, predikimi në gjuhën e vet amtare sjell qytetërimin e përparimin dhe se çdo komb duhet të zhvillojë fenë e vet sipas interesave kombëtare”. Visarion Xhuvani ishte kundërshtar i rreptë ndaj çdo ndërhyrjeje për të prishur vëllazërimin ndërmjet besimeve fetare dhe dënonte veprimet e kishës së satanait, siç e quante ai Kishën Greke. Kur vdiq Myftiu i Tiranës në vitin 1938, Visarion Xhuvani mbajti një fjalim prekës në

varrezat, saqë të gjithë pjesëmarrësit në ceremoninë e përmortshme mbetën të habitur. Lotët e tij për atë që e cilësonte vëlla shpirti ishin prekëse për të gjithë.

Ai kishte një botëkuptim teist modern. Ishte kundër zakoneve të një arkaizmi të pakuptimtë që rëndonte botën shpirtërore dhe gjendjen ekonomike. Në mars të vitit 1934, në një predikim, theksoi: “Sa punë e keqe asht zakoni i ortodokseve të Shkodrës me qa e me gërthitë tue qitë britma të mëdha e ulërима kur vdes ndonji njeri, e me e përcjellë këtë me potere të mëdha vajtimesh të kota, që janë turp për një të krishtenë dhe mëkat i madh”.

Në të kundërtën nga çka filozofia marksiste akuzon fenë se është opium për popujt, Visarion Xhuvani zgjon e lind tek ajo virtyte kombëtare e njerëzore dhe i zhvillon ato. Ai tregon kujdes të veçantë dhe për çështjet me karakter fetaro-social dhe për psikologjinë e besimtarëve. Në një bisedë me pleqësinë e Pogradecit hodhi idenë e kufizimit të dhuratave të tepërta që bëheshin në dasma, në shpenzimet e vdekjes, në kufizimin e kohës së rënies së kabanave si dhe të shërbesave të tjera që shkaktonin ngarkesë të tepërt ekonomike dhe psikologjike. Në anën tjetër, ai kërkonte që të ruhej me besnikëri tradita e mirë kanonike dhe të trashëgohej në brezat e ardhshëm “drita dogmatike e fesë sonë të artë” - siç e quante ai.

Dituria poliedrike e Visarion Xhuvanit është shkrirë thellësisht dhe gjerësisht për problemet më të rëndësishme të kombit. Ai e vlerësonte besimin fetar si pjesë të pandarë të ndërgjegjes kombëtare dhe i hapte këtij besimi rrugë të reja në bashkëjetesë me elementët e tjerë të kulturës për përparimin e kombit. Veçanërisht si deputet dhe si senator, ai këmbëngulte në njësimin dialektor dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Arsimimi i kombit për të ishte çështje jetike. Ai kërkoi dhe luftoi derisa e realizoi qëllimin e futjes së gjuhës shqipe si të vetmen gjuhë zyrtare në kishë, i bindur në idenë filozofike se “Dituria në gjuhë të vet e mban gjallë një komb”. Si atdhetar dhe iluminist ai mendonte se në shkollat shqiptare, veç gjuhës së pastër shqipe, duhej të mësoheshin dhe gjuhët e gjalla evropiane të kombeve të përparuara, nga të cilat pritej zhvillimi i mëtejshëm i vendit tonë si: anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja e italishtja, kurse gjuhët greke, turke e latinishten i quante arkaike, prej të cilave nuk kemi ç’ të fitojmë.

Problemin e gjuhës Visarion Xhuvani e merr si një nocion filozofik duke i dhënë rëndësi të madhe për zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Ai e vlerëson gjuhën si formë të ekzistencës së mendimit dhe e çmon rolin e madh të saj për forcimin e mendimit, pra si kusht të domosdoshëm të veprimtarisë së përgjithshme të mendimit kombëtar. Nocionin filozofik të gjuhës ai e merr të pandarë nga ndijimet të cilat e lidhin njeriun drejtpërsëdrejti me botën e jashtme. Duke pasur këtë kuptim për këto nocione, ai arrin në sentencën e tij “Gjuha asht ajo që të ban edhe me ndie”. Lartësimin e kombit ai e lidhte domosdoshmërisht me arsimimin e shëndoshë të të gjithë brezave dhe sidomos për fëmijët e nënat. Madje, ai del mbi hapësirën e teologut, si filozof iluminist i shquar dhe shprehet: “Shkollat janë me të vërtetë shumë të nevojshme dhe do të ishte mirë që në vend të tre kishave të ketë një shkollë, sepse kishën mund ta bajë njeriu edhe në shtëpinë e vet”. Me përparimin e shkollës ai shikonte përparimin e kulturës kombëtare, zbatimin e normave morale, në traditat me vlerë kombëtare. Ai nuk ishte thjesht vetëm si predikues i botëkuptimeve të tija, por dhe merrte pjesë në vënien e tyre në jetë. Ai theksonte: “Nxanësve duhet t’u japim një mësim e moral të vërtetë, të dinë të mirën e të keqen, këtë e kam për parim dhe e kam përdorë edhe në kishë”. Me arsimimin dhe edukimin e brezit të ri ai vlerësonte mjaft rolin e nënave dhe të mësuesve. Mësuesit duhej të ishin shembuj të respektimit ndaj prindërve, të ruanin zakonet dhe dinjitetin kombëtar. Kështu ai vinte

në jetë idenë e shkrimtarit të madh francez, Viktor Hygo: “Dy të parët deputetë të popullit janë nëna dhe mësuesi”. Ai protestoi bashkë me qytetarët e vet kundër mendimit të qeverisë për të mbyllur Shkollën Normale të Elbasanit. Ndërhyri me forcë kundër pikëpamjeve për të mos mbështetur gjuhën zyrtare dhe mbrojti me vendosmëri njësimin e gjuhës letrare shqipe. Gjatë diskutimit të tij në parlament për këtë çështje, u shpreh: “Ministri që do të botojë tekste shkollore në dialekte të ndryshme, do të ketë mallkimin e brezave që do të vijnë”. Visarion Xhuvani e vlerësoi problemin e arsimit si çështje jetike për kombin: po të mos i vihej rëndësia e duhur këtij problemi, do të krijohej një vepër antishqiptare dhe antishtetërore. Madje, ai e quante të domosdoshme edhe krijimin e shkollave shqipe në kolonitë shqiptare: Rumani, Bullgari, Rusi, Greqi, Turqi etj, në mungesë të të cilave ata ishin në rrezik të greqizoheshin, turqizoheshin etj.

Visarion Xhuvani shquhet si atdhetar i përkushtuar. Ai dënonte rëndë tradhëtarët e Atdheut. Duke diskutuar në parlament për tradhëtinë e Esad Toptanit, midis të tjerave, theksoi: “Duhet që parlamenti ta dënojë Esadin dhe pas vdekjes, e ta kuptojë e gjithë bota se Parlamenti Shqiptar i jep dënimin tradhëtarëve edhe pas vdekjes, që ta kuptojë se tradhëtia nuk mbetet kurrë pa dënim”.

Ai këmbëngulte dhe hapte hapësira që shteti shqiptar të bazohej më shumë në zhvillimin e degëve që sillnin përparimin e kombit: në ekonomi, arsim e shkencë dhe të lehtësohej nga shpenzimet e tepërta në administratë apo ushtri, të cilat rëndonin mbi jetën e varfër të popullit.

Me shqetësim ai shpaloste dijet e tij në fushën e politikës së jashtme dhe të diplomacisë, problemet e së cilës në atë kohë ishin më imediate se kurrë, mbasi nga politika e jashtme varej ndriçimi ose errësimi i gjithë shtetit të ri shqiptar. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar, në datën 5 tetor 1920, ai theksonte: “Politika e jashtme asht punë minuti, e cila mund ta zmadhojë ose ta zvogëlojë një shtet, mund ta vorfnojë a ta begatojë. Ministri s’pret po fluturon shpejt. Ministri i jashtëm duhet të ketë katër palë sy e katër palë veshë dhe të jetë i shkathët pa masë.... Në këtë ministri duhet të jenë zgjuet natë e ditë, se na rrethojnë krijime ngatërresash të ndryshme e të paprituna. Të mos i humbasim rastet, të cilat s’i gjejmë për njëqind vjet”.

Si njeri me kulturë të gjithanshme ishte i shqetësuar dhe ndihmonte me dijet e tij në shumë fusha të tjera të shoqërisë shqiptare. Si parlamentar dhe atdhetar theksonte nevojën e përparimit dhe të civilizimit të gruas shqiptare si faktor i rëndësishëm në përparimin e kombit. Ai luftoi në parlament për të drejtat e gruas, për një legjislacion të kohës me vështrim të drejtuar në vendet e përparuara të Evropës. I vendosur kundërshtoi nenin që lehtësonte burrat për t’i ndarë gratë. Vlerësoi rolin e tyre të shquar në historinë e kombit tonë, duke shfaqur njëherësh respektin dhe nderimin për to. “Edukatën që kemi sot ua kemi borxh nanave tona” – theksonte ai, duke na kujtuar njëherësh thënien e Dr.Charles D. McIver: “Kur mëson një burrë, mëson vetëm për një njeri, por kur mëson një grua, mëson një familje e tërë”.

Visarion Xhuvani e ndjente si një obligim të madh detyrën e senatorit dhe të parlamentarit. Ndonëse shquhej për nivel të lartë të dijeve, ai thoshte se përpara se të shkonte në parlament, i ishte dashur të bënte shumë punë për t’u përgatitur për çështjet që do të diskutoheshin, duke shfrytëzuar literaturën e nevojshme. Ai e vlerësoi parlamentin në shkallën më të lartë, sepse atje shfaqej zëri dhe vullneti i popullit me anë të përfaqësuesve të vet. Mendonte se në çdo shtet parlamenti ka rëndësi më të madhe se institucionet e tjera shtetërore. Respektonte parlamentin si ligjvënës, po ashtu kërkonte

dhe angazhimin e parlamentarit si një detyrim ndaj popullit të vet. “Deputetët gjithnji duhet të jenë në mbrojtje të kombit, të japin mendime me vlerë për përparimin e vendit dhe të qëndrojnë larg interesave personale e krahinore” – thoshte ai. Duke sjellë përvojën e shteteve të tjera e të përparuara, ai kërkonte ndarjen e tre pushteteve: legjislativit, ekzekutivit dhe të gjyqsorit.

Figura e Visarion Xhuvanit është model i peshës së ndërgjegjes në interes të kombit. Në kompleksitetin e tij ai është misionar i përparimit kombëtar në teologji dhe në shkencë, arsim e kulturë, ekonomi dhe diplomaci. Në çdo fushë ai shfaqte vlerat si një dijetar i vërtetë, hapte hapësira të reja me një vizion të gjerë aq shumë të domosdoshëm për kombin. Jeta e tij është luftë e plot shqetësime, me sakrifica të mëdha, si atdhetar i devotshëm dhe i shquar për mbrojtjen e vlerave të kombit dhe të zhvillimit të mëtejshëm; më 15 dhjetor të vitit 1965 ai u nda nga jeta, duke lënë pas veprën e tij të ndritur.

Në kushtet e diktaturës së egër komuniste, njerëz të thjeshtë e të ndershëm u kujdesën që të mos i humbte varri. E ruante populli që e do dhe e nderon me përshpirtje plot dhimbje. Ai vazhdon të jetojë, sepse njerëzit e mëdhenj fillojnë të jetojnë kur vdesin. Visarion Xhuvani nuk ishte vetëm atdhetar e teolog i shquar i ndërgjegjes kombëtare, por dhe një burrë shumë fisnik me zemër të madhe. Në shpirtin e tij kishte dhimbje për të gjitha shtresat e shoqërisë. Fisnikëria e tij nuk ishte vetëm një mirësjellje, por ndjesim i përgjithshëm shpirtëror e mendor që mbarnte me vete trashëgiminë, - virtyt që s’e humbi derisa mbylli sytë. Dhe le të kujtojmë një qëndrim hyjnor të tij. Gjatë hetimit torturues në burgun e Vlorës e kishin varur me kokë poshtë. Ja shkulin qimet e mjekrës dhe i bërtisnin: “Fol!” Ai lëvizte buzët nga dhimbjet torturuese: “Çfarë the?” e pyesnin persekturorët. Ai përgjigjej: “I lutem Zotit t’ju falë mëkatet!”

Autorë të ndryshëm, klerikë të lartë, patriotë të shquar, studiues bibliografë, kritikë e shkrimtarë e kanë vlerësuar Visarion Xhuvanin: “I shenjtë, Apostull i atdhetarizmit, Shpirtndritur me kulturë enciklopedike, Figurë e merituar kombëtare, Optimist, Energjik, Njeri i kalitur, Orator i pathyeshëm, Burrë i zgjuar, Figurë e shquar e kombit, Abati Faria, Patriot i madh, Mësues e prind, Nacionalist-demokrat, Trim legjendar, Patriot i papërkulur, Largpamës, Filozof i ortodoksisë, Filozof trim, Teolog i urtë, Poliglot, Mitropolit i lavdishëm, Atdhetar i lindur, Teolog e patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare. Kurse jetën e tij të shkrirë për Atdheun e popullin – Dritë të kombit. Të gjitha këto janë vlerësimet më të arrira nga vepra e Hirësisë së Tij – Imzot Kryepeshkop i Shqipërisë - Visarion Xhuvani.

Është obligim i çdo shqiptari ta nderojë këtë figurë të ndritur të kombit tonë. Është nder i institucioneve të larta: të Kuvendit, Presidencës dhe të Qeverisë që të vlerësojnë me vepra honorifike figurën e lartë e të ndritur dhe të përvuajtur të Visarion Xhuvanit. Është kënaqësi për çdo shqiptar ta shohë emrin e Visarion Xhuvanit të shkruar me shkronja të arta në sheshe, rrugë e shkolla, për ta nderuar dhe për të mos e harruar kurrë. Është domosdoshmëri shpirtërore që të bëhen përshpirtje të herëpashershme nderimi në kishat shqiptare, për të cilat ai sakrifikoi aq shumë.

TITUJT E VEPRAVE, REFERATEVE DHE TË ARTIKUJVE TË KËTIJ LIBRI SIPAS RENDIT TË TYRE, SI DHE DATAT KUR DHE KU JANË BOTUAR PËR HERË TË PARË

PJESA E PARË

1. *Çështje politiko-religjioze Kostandinopol-Tiranë, Pjesa I* prej **Visarion Xhuvanit**, Tiranë, 15 maj 1926, 14 f.
2. *Çështje politiko-religjioze Kostandinopol-Tiranë, Pjesa II* prej **Visarion Xhuvanit**, Tiranë, 15 maj 1926, 12 f.
3. *Kujtim vepre dhe intrige*, prej **Visarion Xhuvanit**, Tiranë, 1926, 36 f.
4. *Formimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare nga pikëpamja juridike dhe kanonike* prej **Visarion Xhuvanit**, botuar për herë të parë në: *Gazeta e Re*, viti I, Nr. 191, e enjte, 20 qershor 1929; dhe ribotuar në: “*Visarion Xhuvani, Vepra*”, Tiranë, 2007, përgatitur për botim nga Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi.
5. *Referate mbi krizën politiko-fetare të Komunitetit Ortodoks të Shqipërisë këto ditë, Pjesa I* prej **Visarion Xhuvanit**, Tiranë 1937, dorëshkrim i daktilografuar në Arkivin Qendror të Shqipërisë, Fondi 536, viti 1937, dosja 1432, fleta 1-17. Botuar së pari në: “*Visarion Xhuvani, Vepra*”, Tiranë, 2007, përgatitur për botim nga Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi.

PJESA E DYTË

6. *Imzot Visarion Xhuvani për autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare* prej **Nos Xhuvanit** dhe **Pavli Haxhillazit**, publikuar për herë të parë në këtë libër.
7. *Kongresi i Beratit-ngjarje e shënuar historike për Kishën Ortodokse Shqiptare (10-11.IX. 1922)* prej **Nos Xhuvanit** dhe **Pavli Haxhillazit**, botuar së pari në gazetën “*Tema*”, nga data 10-11 prill deri më 16 prill 2005 (në gjashtë numra të saj dhe në faqen 9 të çdo gazete).
8. *Krijimi i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (me rastin e 75-vjetorit të tij)* prej **Nos Xhuvanit** dhe **Pavli Haxhillazit**, botuar së pari në gazetën “*55*” nga data 6 tetor deri më 7 tetor 2004 (në dy numra të saj dhe në faqet 12-13 të çdo gazete); botuar gjithashtu në “*Gazetën Shqiptare*” të datës 15 tetor 2004 me titull: Kur krijohej Kisha Ortodokse Shqiptare, në faqet 14 dhe 15 të kësaj gazete.
9. *Kongresi i dytë gjithortodoks i Korçës e vuri Kishën mbi baza kanonike e kombëtare (16.VI-29.VI.1929)* prej **Nos Xhuvanit** dhe **Pavli Haxhillazit**, botuar së pari në gazetën “*Tema*” nga data 5-6 qershor e deri më 11 qershor 2005 në gjashtë numra të saj dhe në faqet 12-13 të çdo gazete.
10. *Përpyekjet për futjen e gjuhës shqipe në liturgjinë e Kishës Shqiptare* prej **Nos Xhuvanit** dhe **Pavli Haxhillazit**, botuar së pari në gazetën “*Tema*” nga data 30 shtator deri më 2-3 tetor 2005 në tri numra të saj dhe në faqet 14 dhe 15 të kësaj gazete.
11. *Kleriku atdhetar Visarion Xhuvani-mbrojtës i gjuhës letrare dhe i shkollës shqipe në Parlamentin e Shqipërisë (1920-1924)* prej **Pavli Haxhillazit**, botuar së pari në gazetën “*Tema*” të datës 16 qershor 2004, në faqet 8 dhe 9 të kësaj gazete dhe me titullin : Kontributi i harruar i Visarion Xhuvanit; mbititulli i saj është: Visarion Xhuvani-mbrojtës i gjuhës letrare dhe i shkollës shqipe në Parlamentin e Shqipërisë (1920-1924).
12. *Visarion Xhuvani-martir i Kishës Ortodokse Shqiptare* prej **Andrea Llukanit**, botuar së pari në gazetën “*55*” të datës 21 maj 2004, në faqen 18 të kësaj gazete.
13. *Visarion Xhuvani-atdhetar i shquar i ndërgjegjes kombëtare dhe Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, prej Dr. **Myzafer Berberit**, botuar së pari në gazetën “*55*”, të datave 5,6, dhe 7 nëntor të vitit 2007, përkatësisht në faqet 6,15,15 të tre numrave të kësaj gazete.

PASQYRA E LËNDËS

PJESA E PARË

PJESA E DYTË

FOTOGRAFI